

RËNDËSIA E FAMILJES NË EDUKIMIN MORAL

Ayşe Kutlu


Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Psikologji-Pedagogji, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Kseanela Sotirofski

Numri i fjalëve: 57.586

Tiranë, Nëntor 2016



DEKLARATA E AUTORËSISË

Në të gjithë tezën, nga fillimi deri në përfundimin e saj, i jam përmbajtur rregullave akademike me rigorizitet. Të gjitha të dhënat në këtë tezë janë përftuar dhe pasqyruar në përshtatje me kuadrin e rregullave akademike dhe sjelljes etike. Gjithashtu, në këtë punim të përgatitur në përputhshmëri me rregullat e shkrimit të tezës, deklaroj se në rastet kur kam përfituar nga veprat e autorëve të tjerë, i kam referuar në përshtatje me rregullat akademike.

ABSTRAKTI

Bërthama e shoqërisë dhe baza e saj është familja. Ajo zë një vend të rëndësishëm në radhën e insitucioneve sociale. Prindërit kanë një rol të pazëvendësueshëm në përcjelljen e vlerave universale tek brezi i ri, formimin e personalitetit, si dhe edukimin moral të fëmijëve. *Edukimi edhe pse mund të shikohet si pjesë e shkollimit, hapat e tij të para jepen në gjirin e familjes.* Qëndrimet morale të nevojshme që i nevojiten përgjatë gjithë jetës, fëmija i mëson nga udhëzimet e prindërve dhe sidomos nga modeli i tyre dhe shembulli personal. *Tiparet që fitohen janë të shumta, por përmendim, bujarinë, drejtësinë, sakrificën,* të cilat formohen gjatë periudhës së fëmijërisë duke u mëkuar me kujdes në familja. Në këtë periudhë, përfaqësimi dhe ndikimi prindëror mbi fëmijën është shumë i rëndësishëm. Sidomos komunikimi me fëmijën dhe qëndrimet kundrejt tyre janë elementë themelorë që ndikojnë në organizimin e mëvonshëm të të gjithë jetës.

Jo vetëm në kohën e lirë, por gjatë gjithë veprimtarisë prindërit duhet t'i kushtojnë kohë dhe t'i japë përparësi shëndetit dhe edukimit të fëmijës së tyre. Prindërit, duke plotësuar detyrimet në mënyrë të vazhdueshme ndaj fëmijëve, përgatisin terrenin e përshtatshëm që ata të formohen mirë. *Shkolla, si plotësuese e familjes, kryen një funksion të rëndësishëm në edukim.* Në përfitim të vlerave të përbashkëta, të shëndosha dhe morale tek fëmijët, nevojitet bashkëpunimi i pandërprerë i familjes me shkollën.

Në këtë studim bëhet përkufizimi i zhvillimit, edukimit moral dhe analizohet rëndësia e rolit të familjes në të. Duke dhënë informacionet e nevojshme rreth teorive, edukimit dhe zhvillimit moral, përqëndrohemi në metodat e përdorura për edukimin e fëmijës, që është një proces tejet delikat. Punimi bazohet në psiko-analizën, mësimin social dhe zhvillimin e njohjes. *Kampion të studimit janë nxënësit e klasës së nëntë, të 26*

shkollave publike, të cilkit 9-vjeçarë në Tiranë. Kështu që me ta janë përzgjedhur dhe realizuar 2321 anketime. Duke realizuar një studim të nisur nga kjo pikë, kemi anketuar nxënës të klasave të nënta të nivelit 9-vjeçarë, lidhur me dallimet në rritjen e tyre, ndryshimet midis vlerave që zotërojnë, për faktorët ndikues në përvetësimin e vlerave dhe sjelljeve morale. Anketave iu është bërë një vlerësim statistikor. Për të mbledhur të dhënat si mjet është përdorur ndarja e anketave në dy grupe. Në grupin e parë hyjnë informacionet personale të nxënësve, kurse në pjesën e dytë përfshihen faktorët që ndikojnë në përfitimin e sjelljeve dhe vlerave morale tek nxënësit.

Për të arritur rezultatet nga anketat e kryera është përdorur programi SPSS paket 17.0. Në përfundim të kërkimit, duke analizuar faktorët ndikues në fitimin e vlerave dhe sjelljeve morale prej nxënësve, vërejmë se faktorët kryesor ndikues janë: **gjinia, zona ku jeton, mosha, gjendja ekonomike dhe arsimore e prindërve, afërsia e tyre me fenë**, pra vihet re se gjendja reale e prindërve është një faktor i rëndësishëm ndikues. Si përfundim nga anketat dhe statistikave e bëra me nxënësit, konstatojmë se familja zë një vend të rëndësishëm në përçarjen e vlerave dhe sjelljeve të larta morale tek nxënësit.

Fjalët kyçe: *Familje, edukim, moral, edukimi moral, vlera.*

ABSTRACT

“Family”, as the basis and the nucleus of a society, has an important place among other social institutions. Family bears an effective role in both conveying international merits to the next generation and forming one`s self; moreover, mother and father holds an integral status in children`s moral education.

Although school seems to be the place of education, family is where the first steps of education are taken. Children learn the lifelong necessary moral attitudes by taking his parents as role models within their guidance. Many good traits such as generosity, truthfulness, sacrifice are shaped by family–given education in childhood. Parents` impact on the child and their modelling is of utmost importance at this point. Especially parent-child interaction and the attitude towards children are among the basics which affect forming their life.

Parents should give priority to the child by concerning themselves with him not only in free times but also in other times. If parents take this as the starting point, they will have paved the way for good education. School is also an important factor in education because it completes the family. In the acquisition of common and moral values, school and family must be in a vital connection.

In this study, it is suggested that family is of utmost importance in moral education along with defining moral development and moral education. The study also informs about moral education, development and theories along with the methods used during the education. Moreover, research has been done in the light of all the information collected in order to determine especially the importance of the family and the factors effecting

moral attitudes of the 9th class students from different segments of society in Tirana, Albania.

The study sample consists of 2321 students from Tirana center secondary schools chosen by proportionate cluster sampling. The surveys carried out has been evaluated statistically. A two-part survey has been used to collect data. The first part includes student personal information whereas the second part includes questions measuring the factors effective in gaining moral value and behavior.

After the survey conducted, SPSS 17.0 has been used for analyzing data. As a result, it is seen that gender, place of living, age, educational and economical status of the parents, religious tendency of the family and their living together has affected the students` choices. As a conclusion of the survey and statistical data, it is clearly seen that family has a serious place in moral value and behavior gaining of the students.

Key words: *Family, education, moral, moral education, value.*

FALENDERIME

Për realizimin e këtij punimi, falenderoj për vëmendjen, durimin, inkurajimin dhe mbështetjen shpirtërore, dhënë në mënyrë të vazhdueshme, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, si dhe bashkëshortin tim Adil Kutlu, për ndihmën e vazhdueshme duke më qëndruar gjithmonë pranë. Gjithashtu falenderoj Prof. Dr. Tomi Treska, Prof. Dr. Ylljet Aliçka dhe anëtarët e tjerë të komisionit për qasjet e tyre konstruktive në ditët doktoriale. Një falenderim shkon dhe për Dr. Nazmi Xhomara dhe Prof. Asoc. Dr. Bekir Çınar. Në të njëjtën kohë falenderoj zonjën Myrvete Kali për ndihmën në fazën e ndërtimit dhe shpërndarjen e anketave.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E AUTORËSISË	II
ABSTRAKTI.....	III
ABSTRACT	V
FALENDERIME	VII
TABELA E PËRMBAJTJES	VIII
LISTA E GRAFIKVËVE.....	XIII
LISTA E TABELAVE	XIV
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	XV
KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1. Qëllimi i kërkimit	2
1.2. Problemi i kërkimit	5
1.3. Rëndësia e kërkimit	5
1.4. Pyetjet kërkimore.....	7
1.5. Hipotezat e kërkimit	8
1.6. Variablat	8
1.7. Argumente në favor të tezës kërkimore.....	9
1.8. Përkufizimet e termave:.....	10
1.8.1. Bashkëjetesa e nënës dhe babait (familja e shëndoshë)	10
1.8.2. Niveli arsimor i nënës dhe i babait	11
1.8.3. Vendi ku jeton dhe qyteti nga vjen.....	11
1.8.4. Qëndrimi i prindërve ndaj fëmijës.....	12
1.8.5. Gjendja ekonomike e familjes	12
KAPITULLI II: SKELETI TEORIK.....	14
2.1. Botime dhe kërkime të ngjashme	14
2.2. Morali	16
2.3. Baza filozofike e konceptit të moralit.....	24
2.4. Problemi i burimit të moralit	29
2.5. Ndryshimi i moralit.....	31
2.6. Pjekuria morale.....	32

2.7. Faktorët qe ndikojnë moralin.....	34
2.7.1. Faktorët biologjikë (Trashëgimia).....	34
2.7.2. Faktorët socialë.....	37
2.7.2.1. Familja.....	38
2.7.2.2. Qëndrimet e prindërve.....	39
2.7.2.2.1. Qëndrimi autoritar i prindërve (Shtypës).....	40
2.7.2.2.2. Qëndrimi fleksibël (Qëndrim i përqëndruar tek fëmija)....	42
2.7.2.2.3. Qëndrimet e pavendosura dhe tëpaekuilibruara.....	43
2.7.2.2.4. Qëndrimi i tepruar mbrojtës.....	44
2.7.2.2.5. Qëndrimi indiferent, i paregjistruar	45
2.7.2.2.6. Qëndrimet demokratike (Qetësues dhe tolerant)	46
2.7.2.3. Mjedisi shoqëror, grupmosha	47
2.7.2.4. Shkolla.....	51
2.7.2.5. Mjetet e komunikimit masiv.....	54
2.7.2.6. Ekonomia.....	57
2.7.2.7. Kultura.....	59
2.7.3. Faktorët psikologjikë	61
2.7.3.1. Identifikimi	61
2.7.3.2. Empatia.....	61
2.7.3.3. Ndërgjegjia-vetëdija morale	62
2.7.3.4. Ndërgjegjia	62
2.7.3.5. Personaliteti	63
2.7.3.6. Zakonet, temperamentit	63
2.8. Çfarë është vlera?	64
2.8.1. Klasifikimi i vlerave	67
2.8.2. Mësimi i vlerave	70
2.8.3. Përçimi i vlerave dhe familja.....	72
2.8.4. Universaliteti i vlerës.....	73

KAPITULLI III: KONCEPTE TEORIKE E EDUKIMIT DHE ZHVILLIMIT

MORAL	77
3.1. Lidhja e moralit me edukimin.....	77
3.2. Edukimi moral	80
3.3. Qasjet në edukimin moral.....	87
3.4. Çfarë është zhvillimi?.....	90
3.4.1. Rritja.....	91
3.4.2. Pjekuria.....	92
3.4.3. Mësimi.....	92
3.4.4. Gatishmëria.....	93
3.5. Kriteret e zhvillimit.....	93
3.6. Periudha kritike.....	95
3.7. Fushat e zhvillimit	96
3.8. Periudhat e zhvillimit.....	96
3.9. Zhvillimi moral.....	97
3.10. Teoritë e zhvillimit moral.....	99
3.10.1. Eric Ericson	103
3.10.1.1. Besimi themelor, mosbesimi	105
3.10.1.2. Autonomia, dyshimit dhe turpi.....	106
3.10.1.3. Iniciativa kundrejt ndjenjës së fajit.....	107
3.10.1.4. Shkathësia kundrejt ndjenjës së poshtërsisë	107
3.10.1.5. Fitimi i identitetit kundrejt ngatërimit të rolit	108
3.10.1.6. Afrimimiteti kundrejt largësisë.....	109
3.10.1.7. Produktiviteti kundrejt recesionit	110
3.10.1.8. Integritet kundrejt dëshpërimit	111
3.11. Teoria e njohjes	112
3.11.1. Jean Piaget	113
3.11.1.1. Periudha e ndjenja - veprimeve	115
3.11.1.2. Periudha përpara veprimeve	116
3.11.1.3. Periudha e operacioneve konkrete	116

3.11.1.4. Periudha e veprimeve abstrakte	116
3.11.1.5. Periudha përpara moralit.....	117
3.11.1.6. Periudha e varur nga jashtë. Periudha heteronome.....	117
3.11.1.7. Periudha e pavarësisë. Bashkëpunimi i vërtetë.....	118
3.11.2. Kohlberg	120
3.11.2.1. Niveli përpara traditës.....	120
3.11.2.2. Niveli i traditës	121
3.11.2.3. Niveli pas traditës	122
3.11.2.4. Dilema Henze e Kohlberg	123
3.11.3. Carol Gilligan	125
3.11.4. John Dewey	125
3.12. Teoria e sjelljes dhe e mësimimit social.....	126
KAPITULLI IV: MARRËDHËNIA E PRINDËRVE ME FËMIJËT	128
4.1. Marrëdhënia e prindërve me fëmijët	128
4.1.1. Dëgjimi aktiv	131
4.1.2. Pse është i dobishëm dëgjimi aktiv?.....	132
4.1.3. Në vend të mesazhit “Ti”, mesazhi “Unë”	134
4.1.4. Ekuilibri i ndëshkimit dhe shpërblimit për të fituar kompetencat e moralit.....	135
4.1.4.1. Dhurata, ekuilibri në dhurata.....	135
4.1.4.2. Metodatat që pengojnë ndëshkimin dhe shpërblimin.....	137
4.1.4.3. Metoda e privimit nga mundësitë financiare dhe ndëshkimet fizike.....	139
4.2. Mjetet dhe metodatat e përdorura tek edukimi moral.....	143
4.2.1. Loja dhe lodrat.....	144
4.2.2. Tregime dhe përralla.....	147
4.2.3. Libri	152
4.2.4. Muzika.....	152
4.2.5. Teatri dhe kinemaja	154
4.2.6. Aforizmat (maksima) dhe proverba.....	159

4.3. Si mund të arrihet bashkëpunimi shkollë - familje për edukimin moral	160
4.4. Sjelljet përfaqësuese për të cilatduhet të bëjnë kujdes nëna dhe babai në edukimin moral	172
4.4.1. Përshtatja midis nënës dhe babait	174
KAPITULLI V: METODOLOGJIA	177
5.1. Metodatat e përdorura	177
5.2. Kampionimi	177
5.3. Pse klasat e 9-ta?	179
5.4. Instrumentet	179
5.5. Përse është zgjedhur vrojtimi me pyetësorë	181
5.6. Hartimi i pyetësorit	181
5.7. Testimi i pyetësorit	183
5.8. Besueshmëria dhe vlefshmëria e pyetësorit	184
5.9. Kufizimet e kërkimit	184
5.10. Puna në terren	186
5.11. Mbledhja e të dhënave primare	186
5.12. Analiza e të dhënave primare	186
KAPITULLI VI: ANALIZA E REZULTATEVE	188
6.1. Analiza e përgjithëshme statistikore	188
6.2. Analiza faktoriale	201
KAPITULLI VII : KONKLUSIONE	214
7.1. Konkluzione	214
7.2. Rekomandime	223
7.2.1. Rekomandime për studimet e mëpasme	225
BIBLIOGRAFIA	226
ANEKS	242
SHTOJCA I	251

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku VI.1 Gjinia	188
Grafiku VI.2 Statusi familjar i prindërve	190
Grafiku VI.3 Vendbanimi	193
Grafiku VI.4 Edukimi arsimor i prindërve.....	194

LISTA E TABELAVE

Tabela II.1 Ky klasifikim i vlerave tregohet në tabelën e mëposhtme.....	69
Tabela III.1 Periudhat e zhvillimit.....	97
Tabela III.2 8 Fazat e zhvillimit të njeriut sipas Eric Ericson	104
Tabela III.3 Tabela e përmbajtes së zhvillimit psiko - social.....	111
Tabela III.4 Hapat e zhvillimit moral sipas Piagetit.....	119
Tabela III. 5 Fazat e zhvillimit moral të Kohlberg.....	123
Tabela IV.1 Komunikimi verbal dhe kuptimi	133
Tabela IV.2 Shembuj të komunikimit: “Ti” dhe “Unë”	134
Tabela IV.3 Masat e marra për të penguar sjelljet e pa dëshiruara përpara ndëshkimit..	138
Tabela VI.1 Shpërndaja e nxënësve sipas moshave	189
Tabela VI.2 Shpërndarja e numrit të nxënësve sipas shkollave	189
Tabela VI.3 Profesioni për babain.....	191
Tabela VI.4 Profesioni për nënën.....	192
Tabela VI.5 Niveli mesatar i të ardhurave në familje	195
Tabela VI.6 Vlerësimi për faktorët e ndikimit tek sjellja ndaj të tjerëve	196
Tabela VI.7 Vlerësimi për faktorët e ndikimit tek toleranca dhe respekti	197
Tabela VI.8 Vlerësimi për faktorët e ndikimit te edukata	199
Tabela VI.9 Vlerësimi për faktorët e ndikimit tek respekti për familjen dhe shoqërinë .	200
Tabela VI.10 Peshat faktoriale të variablit të pavarur - Sjellja ndaj të tjerëve.....	202
Tabela VI.11 Peshat faktoriale të variablit të pavarur - Toleranca dhe respekti	202
Tabela VI.12 Peshat faktoriale të variablit të pavarur- Edukata	203
Tabela VI.13 Peshat faktoriale të variablit të varur - Respekti për familjen dhe	204
Tabela VI.14 Korrelacioni midis variablave të pavarur	205
Tabela VI.15 Analiza e regresionit të shumfishtë midis variablave të pavarur dhe	206

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

SPSS	:	Paketa Statistike për Shkencat Sociale
Prof. Dr.	:	Profesor Doktor
SHBA	:	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
F.B.I	:	Byroja Federale e Investigimeve
UNESCO	:	Kombet e Bashkuara Arsimore, Shkencore dhe Kulturore
DIT	:	Testi i Përcaktimit të Vlerave
etj.	:	E të tjerë
p.sh.	:	Përshembull
dmth.	:	Domethënë

KAPITULLI I: HYRJE

Njeriu si qenie njerëzore, nuk mund të jetojë i vetëm, ai mund ta vazhdojë jetesën vetëm brenda një grupi. Me bashkimin e njerëzve formohen grupe, ndërsa me bashkimin e grupeve formohen shoqëritë. Në një situatë të tillë, shoqëria, për të përballuar nevojat e saj, bashkohet duke ndarë mes vetes një kulturë të përbashkët. Në rastet kur shumë njerëz bashkohen në një grupim marrëdhënia e tyre formon një rrjet (Hunt, 1972: 20).

Shoqëria njerëzore është një tërësi që përbëhet nga elementë materialë dhe shpirtërorë. Ajo që e bën të ketë kuptim të plotë shoqërinë është dimensiononi i saj kulturor dhe shpirtëror. Dimensiononi shpirtëror dhe cilësor i shoqërisë përbëhet nga marrëdhëniet e ndryshme që krijohen brenda saj, ndërveprimet dhe vlerat e veanta të individëve të saj të spikatur. Prej këtij këndvështrim, shoqëria e ndërtuar mbi vlera sociale shihet një fushë që gjendet në ndikimin e vazhdueshëm të këtyre vlerave (Broom and Selznick, 1956: 29). Vlerat sociale janë tërësia e rregullave dhe besimeve morale të përgjithshme që duhet t'u përshtaten anëtarët e shoqërisë, duke qënë se janë pranuar unanimitet nga shoqëria si të nevojshme, të domosdoshme dhe të drejta. Këtu hyjnë: ***drejtësia, ndershmëria, zellshmëria***, etj. (Doğan, 2008: 321).

Elementët kryesorë që përbëjnë strukturën shoqërore të familjes janë: edukimi, ekonomia, feja, politika dhe organizmat sociale. Institucionet brenda kësaj strukture, shfaqen si pjesë të domosdoshme për vazhdimësinë e jetës dhe mirëfunksionimin e saj. Në këtë temë, Emile Durkheim, në librin me titull: "*Morali Profesional*" thotë: "***...nëse nuk do të ishin vlerat morale, insitucionet sociale nuk do të funksiononin normalisht dhe me***

efikasitet. Arsyja e shfaqjes së problemeve të ndryshme shqetësuese në shoqëri është largimi e tjetërsimi prej këtyre vlerave...” (Durkheim, 1986: 7). Institucionet në strukturat shoqërore funksionojnë tipikisht si një orë. Mekanizmi i përgjithshëm i orës, ku si e tillë perceptohet shoqëria njerëzore përbëhet kryesisht nga familja. Mjediset e para shoqërore me të cilat përballet njeriu i zakonshëm janë institucionet si: feja, politika dhe ekonomia, çka përbëjnë anën tjetër të mekanizmit të orës. Si shembull, integrimi i vlerave familjare me ato ekonomike e edukative sociale duhet të vijë dhe jenë në përshtatshëmri të plotë (Rodney, 1987: 94).

Nga të gjithë insitucionet shoqërore më e rëndësishmja ka qenë, është dhe mbetet familja. Familja është ajo që edukon, kujdeset dhe rrit fëmijën, kështu që vendin dhe rolin e saj primar nuk mund ta zërë asnjë insitucion tjetër. Ajo edhe në shoqëri është një burim i pashtershëm vlerash, pasi ndjenjat njerëzore në funksionimin e saj zenë vendin qendëror. Për këto arsye, familja klasifikohet si një institucion shkatërrues nga Ferdinand Mount, ndërsa Platoni i jep asaj një vend të rëndësishëm krahas *“shtetit”* duke theksuar rëndësinë që ka. Në të njëjtën kohë familja është dhe mbetet transmetuesi i vlerave universale humane tek gjeneratat dhe mësuesi që harmonizon emocionet e njeriut me fuqinë morale (Ashford, 2009: 5).

1.1. Qëllimi i kërkimit

Në një kohë kur shkenca dhe teknologjia botërore përparojnë me shpejtësi, edhe shoqëria njerëzore po përjeton ndryshime të mëdha. Bashkë më një ndryshim të tillë, kombet e ndryshëm duhet t’u bëjnë ballë dhe zgjidhin porbleme të shumta politike dhe

morale. Nga këto probleme mund të përmendim: luftërat, urinë, armët kimike, shkeljet e të drejtave të njeriut, terrorizmin ndërkombëtar, genocidin, racizmin ekstrem, si dhe problemin gjithnjë në rritje të korrupsionit (Sandin, 1992: 1).

Kur shohim Amerikën dhe botën perëndimore, dimë se ato kanë kohë që përballen me probleme të tilla të rënda. Po të shohësh statistikën e FBI-së, për fëmijët e moshës 13-14 vjeçare, arrestimet për krime me bazë dhunën, vrasjet dhe vjedhjet janë dyfishuar, krimet kanë pësuar një rritje deri në 53% (Lickona, 1992: 35). Kjo gjendje e vështirë nuk është situatë që përjetohet vetëm në vendet dhe shtetet e zhvilluara. Numri i rasteve të krimeve të ndodhura në vende më pak të zhvilluara nuk mund të nënvleftësohet. Bile, në vendet e botës më pak të zhvilluar vërehet se po hasen shpesh e më shpesh këto lloj problemesh shqetësuese.

Këto shifra tronditëse dhe ngjarje rrëqethëse shprehin se: mbrojtja e brezave të rinj, e familjes dhe shoqërisë, si dhe përgatitja e anëtarëve të saj që të jenë të dobishëm për shoqërinë, bie si përgjegjësi edukimi kryesisht mbi familjet. Për një strukturë të shëndetshme sociale, nga pikëpamja shoqërore, është i rëndësishëm pranimi i vlerave universale dhe përvetësimi i sjelljeve të larta qytetare, *Nga pikëpamja e pritshmërisë për shfaqje morale të mira dhe të rëndësishme vendin kryesor e ka familja, edukimi, mësuesi dhe shkolla.* Kjo është në ditët e sotme dhe do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen guri i themelit të strukturave sociale, edukative dhe politike (Acuner, 2004: 5).

Nga kjo pikë, qëllimi kryesor i kërkimit tonë shkencor është analizimi i ndryshimeve në përfitimin e vlerave morale tek nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave 9-vjeçare. Nëse

ka apo jo dallime thelbësore mes tyre. Nëse ka, cila është arsyeja reale? Cilët janë faktorët socialë që ndodh kështu? Në të njëjtën kohë do të studjohet vendi i familjes si një nga faktorët më të rëndësishëm e përcaktues në edukimin e fëmijëve.

Qëllimi i kerkimeve tona janë: sjelljet dhe vlerat morale; sjellja ndaj të tjerëve, toleranca, edukata dhe respekti për familjen dhe shoqërinë.

Studimi synon të evidentojë se sa ndikim ka faktori familje përballë faktorëve shkollë dhe mjedis ose rreth shoqëror, në përfitimin e vlerave morale të nxënësve.

Këto do të mund t'i materializojmë si më poshtë:

1. Analiza e faktorëve të ndryshëm, ka apo jo ndikim tek përfitimi i sjelleve dhe vlerave morale tek fëmijët e klasës së nëntë të shkollës 9-vjeçare? Për këtë do të analizohen në mënyrë sistematike faktorët si: gjinia, mosha, të qënurit bashkë i prindërve, niveli i edukimit të prindërve, qëndrimet kundër fëmijës, gjendja ekonomike, qytetet nga të cilët fëmijët vijnë?

2. Faktorët që kanë ndikim tek fitimi i sjelljeve dhe vlerave morale nga fëmijët e klasës së nëntë të shkollës 9-vjeçare, ka ndryshim nga shkolla në shkollë?

3. Në përfundim të këtij studimi duhet të kuptojmë e përcaktojmë qartë sjelljet dhe vlerat morale të kampinomit dhe zërthejmë nivelin e kuptimit të këtyre vlerave.

4. Përcaktimi i vendit dhe rolit të familjes, grada e ndikimit të saj në përvetësimin e sjelljeve dhe vlerave morale nga famijët.

1.2. Problemi i kërkimit

Në shoqëri ekzistojnë disa rregulla të cilat rregullojnë jetën sociale si dhe marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin. Familja, shkolla dhe mjedisi përreth janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në formimin e këtyre rregullave. Në këtë kontekst, ka një rëndësi të veçantë vënia në dukje e ndikimit të familjes në përfitimin e sjelljeve dhe vlerave morale të fëmijëve.

1.3. Rëndësia e kërkimit

Në qëndër të shumë veprimtarive të rëndësishme në jetë janë fëmijët. E ardhmja e një kombi janë fëmijët e tij, brezi i ri. Shtetet hartojnë plane dhe projekte, punësim për arsimtarë, harmonizojnë pëpjekjet e shkollës dhe prindërve për miredukimin e brezave të ardhshëm.

Për vazhdimin e jetës së një peme nevojiten farërat, për të vazhduar jetën e shoqërisë njerëzore duhen fëmijët. Kombet që lënë pas dorë mirërritjen dhe miredukimin e fëmijëve të tyre shuhen, jetojnë në vështirësi. Ata që braktisin kulturën e tyre në duar të pakujdesshme janë të detyruar të humbin thelbin dhe ardhmërinë e tyre.

Çdo fëmijë, sikurse fara, kur t'i vijë koha, do të çelë profilin e vetes në shërbim të familjes dhe shoqërisë. Për formimin e personalitetit dhe individualitetit të fëmijëve, roli dhe rëndësia e prindërve është e madhe. Edukimi i fëmijës nga prindërit është përgjegjësi e dorës së parë. Sipas Şengün struktura e parë e mbrojtjes dhe kujdesjes për fëmijët, është familja. Ajo nuk është vetëm vendi i lindjes së tij, por edhe i rritjes, formimit dhe pjekurisë.

Familja është institucioni themelor i përgatitjes së fëmijëve, i transmetimit të vlerave kulturore e morale, i traditave dhe zakoneve familjare, shoqërore dhe kombëtare (Şengün, 2003: 217).

Sipas **Kaya**, familja është autoriteti i parë dhe i vetëm në procesin e zhvillimit të mirë të fëmijëve, sidomos gjatë viteve të para të fëmijërisë, ku atij i transmetohen vlera morale. Fëmijës duhet t'i jepet shembulli model, me anë të cilit të dallojë sjelljen e kulturuar e të saktë. Babai duke u bërë disiplinori e vendimmarrësi, ndërsa nëna individi që luan rolin pajtues e përfshirës në marrëdhëniet midis individëve. Kështu që fëmija me anë të shembullit prindëror miraton dhe përvetëson vlerat e shëndosha morale që i përkasin familjes së tij e i demonstroi ato në shoqëri (Kaya, 1993: 24).

Sipas **Gündüz**, fëmija shpërfaq në mënyrë të plotë ndikimin e familjes së tij në të gjitha rolet e saj, përgjatë zhvillimit të personalitetit në shkollë. Sidomos në vitet e para të edukimit, për shkak të formimit të individualitetit dhe personalitetit, brezat e kësaj periudhe janë shumë delikatë. Prandaj duhet kujdes, durim dhe përkushtim, me qëllim plotësimin e vlerave të larta morale familjare, shoqërore dhe kombëtare (Gündüz, 2003: 195).

Sipas **Kaya**, edukimi formal që jepet nëpër shkollë, për përgatitjen e individit për shoqërinë, vepron në përputhje me objektiva të caktuar. Njerëzit, thekson ai, duhen rritur me vlerat kombëtare, morale, njerëzore dhe kulturore. Qëllimi është të mirërriten si njerëz të ekuilibruar nga ana emocionale, morale, mendore dhe trupore. Kështu që roli i edukimit në shkollë dhe qëllimi i përgjithshëm i edukimit moral zë një vend të rëndësishëm (Kaya, 1993: 24).

Ndërkohë që sipas *Güngör*, ndër qëllimet e përgjithshme të edukimit moral është arritja e pjekurisë morale e individit. Qëllimi i edukimit moral në shkolla është të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë për shekullin e zhvillimit, duke u fshirë atyre të gjitha ndikimet negative jashtë shkolle, t'i përgatitë ata të bëhen anëtarë të mirë dhe të denjë të shoqërisë (Güngör, 1998: 46).

Sipas *Aydın*, morali nuk duhet të mbetet vetëm teorik, praktika e tij është e rëndësishme për jetën, ajo mund të përforcohet me aktivitete humane. Ashtu si njeriu, nëse nuk ndjek një vizatim sipas ngjyrave që beson, edhe morali mbetet thjeshtë një sistem e jo bindje. Në këtë situatë, kur morali individual, shoqëria dhe familja nuk ndikon, roli i një moralizuesi teorik gjithashtu nuk kryen punë. Edukimi moral është procesi i rritjes së individit gjatë të cilit nuk duhet të hiqet kurrësesi dorë nga sjelljet e drejta pasi i përfiton ato. Një komb që dëshiron të garantojë gjeneratën e ardhshme, duhet të luftojë të rrisë një brez të respektueshëm ndaj vlerave morale. Edukimi moral i brezit të ri duhet të jetë një nga qëllimet më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore (Aydın, 2003: 50).

1.4. Pyetjet kërkimore

Pyetjet e zhvilluara lidhen me objektivin e mësipërm të studimit në këtë mënyrë:

Pyetja kërkimore 1: A vërehen dallime midis nxënësve që banojnë në qytet dhe atyre që banojnë në fshat lidhur me ndikimin e familjes në sjellje dhe vlera morale?

Pyetja kërkimore 2: A ka kuptim të flitet për dallime të rëndësishme statistikore sa i takon respektit për familjen dhe shoqërinë tek nxnësit e shkollave të ndryshme? Nëse po, ku vërehen më së shumti këto dallime?

Pyetja kërkimore 3: A mund të themi se ndikimi i familjes tek sjellja dhe vlerat morale të fëmijëve është më i lartë tek familjet ku prindërit jetojnë bashkë?

1.5. Hipotezat e kërkimit

Hipoteza 1: Të gjithë faktorët e sjelljeve dhe vlerave morale si edukata, toleranca, respekti dhe sjellja ndaj te tjerëve, ndikojnë tek respekti për familjen dhe shoqërinë.

Hipoteza 2: Gjinia nuk është faktor që ndikon në përvetësimin e sjelljeve dhe vlerave morale.

Hipoteza 3: Me rritjen e nivelit social-ekonomik në familje ulët edhe ndikimi i familjes në përfitimin e sjelljeve dhe vlerave morale.

Hipoteza 4: Në familjet me nivel të lartë edukimi, ndikimi i familjes në përfitimin e sjelljeve dhe vlerave morale është më i ulët krahasuar me familjet me nivel arsimor më të ulët.

1.6. Variablat

Duke ju referuar informacionit të pyetësorit si dhe arritjes së qëllimit të këtij punimi, elementët e tij janë grupuar në faktorë të cilët janë variabël të pavarur si dhe në variabël të varur.

Kështu, variabëlat e pavarur të cilët lidhen me faktorët që kanë patur ndikim në jetën sociale dhe kulturore të nxënësve, janë:

Sjellja ndaj të tjerëve: që matet me 6 pyetje

Toleranca dhe respekti: që matet me 7 pyetje

Edukata: që matet me 8 pyetje

Variabli i varur është:

Respekti për familjen dhe shoqërinë: që matet me 9 pyetje

Të gjitha pyetjet matin nivelin e tre faktorëve sipas shkallës ordinale (Ordinal scale)

1- **Familja**

2- **Shkolla/mësuesit**

3- **Shoku/shoqja**

Faktorët e pavarur maten në total me 21 pyetje ndërsa variabli i varur matet me 9 pyetje:

1.7. Argumente në favor të tezës kërkimore

Supozimet që kalojnë në kërkim janë në këtë formë:

1. Në këtë punim mund të mendohet, se mjetet e përdorura për të mbledhur të dhënat dhe për të matur karakteristikat e dëshiruara, janë mjetet e duhura.

2. Është hedhur mendimi se ata që përbëjnë subjektin e kërkimit, nxënësit e klasave të nënta të shkollës 9-vjeçare, gjatë mbledhjes së të dhënave i janë përgjigjur pyetjeve në mënyrë të saktë e të sinqertë.

3. Subjekti i kërkimit, nxënësit e klasave të nënta të shkollës 9-vjeçare, mund të jenë të përshtatshëm për të bërë një kërkim të tillë, se janë në gjendje të japin përgjigje përfaqësuese dhe të vendosura.

1.8. Përkufizimet e termave:

1.8.1. Bashkëjetesa e nënës dhe babait (familja e shëndoshë)

Çdo fëmijë vjen në këtë botë i pajisur me aftësi të caktuara dhe familja luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tij. Koha më e mirë për të edukuar fëmijën janë vitet e fëmijërisë, kur formohet pjesa më e madhe e karakterit. Vendi më i mirë është familja dhe edukuesit më të mirë janë nëna dhe babai. Familja është vendi ku fillon komunikimi dhe zhvillimi social. Bashkë me zhvillimin social mësohet gjuha dhe transmetimi tek brezi tjetër i rregullave morale dhe vlerave tradicionale. Këto realizohen vetëm në një familje të shëndoshë. Fëmijët e rritur e të edukuar në një ambjent ku prindërit jetojnë sëbashku dhe i përshtaten njëri-tjetrit zënë vend në shoqëri si individë të pavarur. Në një studim të realizuar mbi të rinj të burgosur është vënë re se 70 % prej tyre vijnë nga familje të ndara, të cilët janë rritur të ndarë për arsye të ndryshme. Bazuar në këtë përfundim mund të themi, se bashkëjetesa harmonike e prindërve dhe mbështetja e familjes në themele të shëndosha, mundëson rritjen e fëmijës në mënyrën më ideale dhe fitimin e sjelljeve të dëshiruara (Menderes, 2005: 135).

1.8.2. Niveli arsimor i nënës dhe i babait

Sigurisht që edhe ambjenti përreth luan një rol shumë të rëndësishëm në pasqyrimin e vlerave morale të fëmijës. Fëmija ka nevojë për një model të një nëne dhe babai të arsimuar dhe të informuar për të realizuar një zhvillim sa më të shëndetshëm. Para se fëmija të arrijë periudhën e përcaktimit të vlerave në mënyrë të vetëdijshme pranon sjelljet dhe shpjegimet e prindërve. Këtu duhet të nënvizojmë rëndësinë e nivelit arsimor të prindërve në zhvillimin e paragjyqimeve morale të fëmijës dhe në shndërrimin e tyre në gjykim. Niveli arsimor i prindërve është i rëndësishëm në përcaktimin e vlerave morale të fëmijës që do të zhvillojë më pas. Prandaj niveli i tyre arsimor duhet të jetë i mjaftueshëm për ta realizuar këtë (Acuner, 2004: 110).

1.8.3. Vendi ku jeton dhe qyteti nga vjen

Veçoritë shoqërore, ekonomike, kulturore të familjes janë faktorë shumë të rëndësishëm të cilët ndikojnë në zhvillimin fizik dhe social të fëmijës. Faktorë si feja e nënës dhe babait, mosha, zgjuarsia, të ardhurat, vendi ku jeton, qëndrimi i familjes dhe pritshmëritë, veçoritë e shtëpisë ku jeton, largësia e shtëpisë nga shkolla, librat në shtëpi, etj, pra, secili prej tyre janë faktorë efektivë në suksesin dhe edukimin e fëmijës. Veçoritë etnike të vendit ku jeton fëmija, veçoritë shoqërore e ekonomike të ambjentit, përjashtimi shoqëror i lagjes ku jeton ndikojnë në vlerat morale dhe qëndrimet e fëmijës (Richards, 1986: 128).

1.8.4. Qëndrimi i prindërve ndaj fëmijës

Qëndrimi i nënës dhe babait ndaj fëmijës ndikon në formimin e personalitetit të fëmijës duke krijuar efekte pozitive ose negative në mësimin e ndjenjave dhe sjelljeve. Në të njëjtën kohë qëndrimet e nënës dhe babait ndikojnë edhe tek suksesi akademik i fëmijës. Studimet e realizuara flasin për lidhjen e fortë mes qëndrimit të prindërve dhe përshtatshmërisë sociale dhe individuale të fëmijës. Ndërkohë që marrëdhënia e krijuar me prindërit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, për fat të keq prindërit nuk kanë një politikë të matur dhe të shëndetshme në sjelljejen ndaj fëmijës. Nëse prindërit njohin cilësitë e sjelljes dhe informohen rreth tyre mund të luajnë një rol më efektiv në fitimin e vlerave pozitive nga ana e fëmijës. Megjithëse klasifikimi i këtyre qëndrimeve mund të pasqyrojë qëndrimet kryesore, të cilët janë: qëndrimi autoritar, qëndrimi i pavendosur, qëndrimi demokratik, qëndrimi mbrojtës, qëndrimi i painteresuar dhe qëndrimi indifirent (Ersanlı, 1986: 57).

1.8.5. Gjendja ekonomike e familjes

Profesioni i nënës dhe babait, të ardhurat dhe niveli ekonomik janë faktorë që përcaktojnë nivelin socio-ekonomik. Veçanërisht gjendja social-ekonomike brenda të cilit gjendet individi ndikon në zhvillimin dhe sjelljet e fëmijës. Niveli i lartë ekonomik i familjes ndikon në ndryshimin e formës së shikimit të ngjarjeve dhe tek disa familje sjell lehtësira dhe efekte pozitive në edukimin e fëmijës duke krijuar një atmosferë më pozitive. Fëmijët të cilët janë pjesë e familjeve me një nivel të lartë ekonomik zotërojnë më shumë mundësi dhe si rrjedhojë mund të ngrihen më lart në edukimin dhe zhvillimin moral.

Fëmijët e familjeve të tilla nuk arrijnë të shpalosin aftësitë e tyre për shkak të mungesës së kushteve (Tural, 2002: 35).

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK

Në këtë kapitull do të përpiqemi të paraqesim “Botime dhe kërkime të ngjashme” dhe perkufizimet e termave të përdorura në kontekstin konceptual dhe teorik të kornizës së hulumtimeve që u kryen në terren.

2.1. Botime dhe kërkime të ngjashme

Në këtë pjesë do të paraqesim disa kërkime që janë bërë në lidhje me përfitimin e vlerave morale dhe ndikimin e faktorit familje në të.

Nucci (2001) e ndanë kërkimin në dy pjesë. Struktura morale dhe pjesa që analizon zhvillimin e vlerave morale. Ai jep informacione mbi të rinjtë katolikë, të krishterë, ortodoksë dhe hebrenj, bazuar tek intervistat direkte të realizuara me ta.

Hart, Atkins dhe Ford (1999), afron një model që analizon përbërjen e personalitetit moral dhe ndikimin e familjes në formimin e personalitetit tek adoleshentët. Në vitin 1986, një studim në mbi 6.000 fëmijë amerikanë u fokusua në ndikimin e zhvillimit të identitetit moral tek adoleshentët dhe ndikimi i familjes në to.

Gorman, Duffy dhe Heferman (1994), grupmoshës së studentëve që i përkasin periudhës midis 18-41, duke iu zhvilluar kurse mbi përgjegjësinë sociale Rest (1979), aplikoi testin DIT dhe vlerësimi i gjykimeve morale të nxënësve vërtetoi hipotezën e hedhur prej tyre.

Addad dhe Leslau (1990), në kërkimet e bëra tek grupet fajtoresh dhe grupet jo fajtoresh, ai intervistoi 100 të rritur dhe 1003 adoleshentë. Nga këto 83 duke i marrë si shembull

njerëzish të pafajshëm, sipas pikëpamjes së të pafajshmëve se ata që janë të fajshëm bëjnë më shumë vlerësime rreth gjyqimeve morale.

Ma (1989), duke u bazuar tek studimi i realizuar nga Rest, (1979) bëri një studim duke marrë si kampion, nxënësit e klasave të 10-ta dhe 11-ta, nga të cilët, 160 ishin vajza dhe 82 ishin djem aziatik. Së bashku me këto ishin përzgjedhur 62 vajza e 58 djem anglezë që ndiqnin po klasën e 10-të dhe 11-të. Nga gjetjet e kërkimit ka një lidhje të rëndësishme midis drejtimit moral dhe gjyqimeve morale.

Feather (1988), bëri një kërkim në Australinë Lindore (Adelaide) me nxënës të katër shkollave të mesme me nivele të ndryshme socio-ekonomike, të cilët ndiqnin klasën e 11-të, duke përfshirë si përfundim 133 nxënës. Rokeach (1973) ka aplikuar DIT. Gjetjet në fund të studimit tregojnë se midis gjyqimeve morale dhe karakteristikave personale ka një lidhje pozitive e cila është e përshtatshme dhe e llogjikshme.

Çileli (1981), gjatë studimeve për doktoraturën mori si kampion familjet që i përkisnin nivelit socio-ekonomik të klasës së mesme të grupmoshës midis 14-28 vjeç, aty ku vazhdonte studimet në Wanstead School dhe Chinford Senior School, ndërsa për këtë kishte zgjedhur 103 nxënës. Në bazë të testit DIT, në këtë kërkim rezultoi se nga pikëpamja e shkollës, gjinisë dhe moshës kishte diferenca të ndjeshme në pikët e klasifikimit midis shkollave.

Turiel, Edwards dhe Kohlberg (1978), në kërkimin e tyre të bërë në Turqi si kampion morën Manisën, Izmirin dhe Ankaranë, duke përfshirë grupmoshën 10-23 vjeç, nga të cilët mori 113 të rinj. Në kërkim u përdor versioni turqisht i “Anketa e Dilemës Morale” e

Kohlberg. Në përfundim të kërkimit u vërejt se me rritjen e moshës rriten edhe gjykimet morale.

Durkheim (1902), afërsisht 100 vjet më parë (1902-1903) bëri një studim duke i ndarë nxënësit e degës së mësuesisë në profilin “Edukimi Moral”, ku jepte mësim. Ai vërejt se nota e lëndës së sociologjisë ishte e rëndësishme. Mendimtarja dhe sociologia u përpoq që t’i vinte në ndihmë shoqërisë duke theksuar se, duhet të ekzistojë mirëkuptim laik për moralin në shoqëritë moderne. Ajo tha se duhet të motivohen mënyra efikase e të demonstrohen argumente të forta nga mësuesit lidhur me këtë temë, me qëllimin e vetëm që t’iu transmetohen fëmijëve të moshës fillore shkollore norma të mira morale.

2.2. Morali

Fjalën “*moral*” e hasim në fjalorin “Longman” të gjuhës angleze ku i jepen këto kuptime:

1. Parimet që kanë të bëjnë me sjelljet e mira dhe të këqia.
2. Ndryshimi mes të mirës dhe së keqes.
3. Aftësia për të kuptuar ndryshimin mes të mirës dhe së keqes (Longman, 2005: 104). Fjala “*moral*” e cila rrjedh nga fjala “*moralis*”, në latinisht, për herë të parë është përdorur nga Cicero, si ekuivalente e fjalës greke “*ta etika*” (Audi, 1979: 101).

Në **Fjalorin Terminologjik të Filozofisë**, me autore Bedia Akarsu, morali përkufizohet si:

1. a). Tërësia e rregullave etike, ligjeve dhe parimeve që rregullojnë marrëdhëniet midis njerëzve e që janë të pranuar nga grupe të ndryshme shoqërore në periudha të caktuara. **b).** Fusha e vlerave morale që u ndryshon përmbajtja dhe përfshirja në shoqëri në kohë të caktuara.

2. Tërësia e rregullave operative të pranuar nga një person ose një grup njerëzish.

3. Një varg mendimesh, të cilat kanë lidhje me të moralshmen.

4. Si një degë e filozofisë: a). Mësime konceptuale mbi moralin. **b).** Mësime filozofike që marrin në shqyrtim probleme mbi veprimet morale të njerëzve në jetën personale dhe shoqërore (Akarsu, 1975: 9).

Fjalorët nuk vënë në dukje një diferencë të qartë midis “moralit” dhe “etikës”. Në përgjithësi, morali ka të bëjë me mënyrën se si duhet të sillemi me njerëzit. P.sh., Sarunas dhe Romualdas (2005), në punimin e tyre kanë arritur në konkluzionin se, nxënësit e shkollave vlerësojnë si të moralshëm atë që sillet mirë me njerëzit e tjerë dhe i ndihmon ata në momente të vështira. Ndërsa etika, në përgjithësi, në një kornizë më të përgjithshme, i referohet tërësisë intelektuale të çështjeve të tilla (Hinde, 2002: 2). Koncepti moral, në një kuptim të përgjithshëm, përkufizohet si vlerat, rregullat dhe sjelljet që kanë një kuptim parësor për anëtarët e një shoqërie. Ajo që i lidh personat me njëri-tjetrin është vlerë e shoqërisë. Vlerat shoqërore kanë ndikim në gjykimin moral të individëve dhe pasqyrojnë veçoritë e sistemit shoqëror. Në një kuptim, sjelljet morale që ushtrojnë individët janë pasqyrimi i vetë shoqërisë.

Pyetja: “Ç’është morali?” shoqërohet nga shumë pyetje të tjera. Natyrshëm përkufizimi që do t’i bëhet asaj, duhet të përfshijë edhe përgjigjet e këtyre pyetjeve. Kjo pyetje është shumë dimensionale dhe paraqet interes edhe për disiplina të tjera, si: arsimit, psikologjia, sociologjia, filozofia, teologjia dhe politika. Për këtë arsye, para se t’i jepet përgjigje kësaj pyetjeje dhe pyetjeve të tjera që lindin prej saj, edhe po të mos u jetë dhënë përgjigje, është mirë që ato ngrihen si pyetje; sepse, t’i mendosh këtë pyetje, bën të nevojshme të mendosh edhe të tjerat.

Çfarë është morali? Cili është burimi i tij? A është ai relativ? A ndryshon nga shoqëria në shoqëri dhe nga shekulli në shekull? Cila është lidhja e tij me rregullat? Cila është arsyeja që individi zbaton rregullat? Si fillon individi të zbatojë rregullat, a i zbaton rregullat apo zgjedh t’u nënshtrohet atyre me vetëdije të lirë? Nëse i zbaton apo i zgjedh sa zgjat kjo? Përse dhe kur fillon të bindet duke zgjedhur, *ndjeshmëria ndaj së drejtës, të gabuarës, të drejti dhe fajtorit*, që janë themeli i moralit përfitohen gjatë jetës në shoqëri apo janë aftësi të lindura? Cili është kriteri i sjelljes së moralshme? A mësohet morali? (Çiftçi, 2003: 43-73).

Kimi, një djalë 25-vjeçar, për një kohë të gjatë kishte qenë subjekt i një studimi të Kohlberg. Kur e pyetën se *“çfarë kuptimi ka për të morali?”*, përgjigjia e tij ishte hapi i pestë i modelit *Kohlberg*: “Askush në botë nuk e di këtë. *Mendoj se duhet të pranosh të drejtat e individëve, të mos cënosh të drejtat e të tjerëve, të tregohesh i drejtë ashtu siç do të dëshiroje të silleshin të tjerët me ty.* Besoj se kuptimi i kësaj është të mbrosh të drejtat e qenies njerëzore dhe të bësh ç’të duash pa cënuar dhe shkelur të drejtat e të tjerëve” (Althof dhe Graz, 2000: 97).

Përgjithësisht dihet se morali, është detyrimi që kemi kundrejt shoqërisë në të cilën jetojmë. Por, a nuk ka njeriu përgjegjësi edhe ndaj njerëzve dhe shoqërive të tjera në botë? Ose, cilat janë përgjegjësitë e njerëzve që jetojnë të vetëm si *Robinson Cruso*? Nisur nga fakti se nuk është pjesë e shoqërisë, a ka ai përgjegjësi morale? Nëse e përkufizojmë moralin vetëm si përgjegjësi ndaj shoqërisë në të cilën jetojmë, cilat do të jenë përgjegjësitë tona ndaj shoqërive dhe njerëzve të tjerë në botë? A kanë lidhje me moralin probleme si; derdhja e mbetjeve të naftës në det, kryerja e provave atomike në oqeanë, shkarkimi i mbetjeve atomike në vendet e prapambetura, përhapja e viruseve dhe krimet kibernetike, shkatërrimi i historisë dhe trashëgimisë njerëzore? Të gjitha këto dhe probleme të ngjashme, nëse kanë lidhje, do duhet të ndryshojmë botëkuptimin për moralin dhe ta ripërkufizojmë atë.

Individi është qenie sociale dhe ka nevojë të dojë, të duhet, të jetë pjesë e një grupi, të jetë i suksesshëm në grup e të lavdërohet. Këto nevoja, ia bëjnë atij të detyrueshme jetën në grup. Nga ana tjetër, individi ndjen edhe nevojën e lirisë, përgatitjes së vetes, lumturisë personale, suksesit të tij, madje përpiqet për arritjen e tyre. Këto dy nevoja të ndryshme, mund të përplasen me njëra- tjetrën. Rregullat vlejné për minimizimin e kësaj përplasjeje duke i mundësuar individit që të jetojë në paqe me të tjerët dhe fitojë liri maksimale. Këto janë rregullat që bëjnë të mundur jetën në bashkësi dhe i sigurojnë individit liri maksimale e të nevojshme. Ndërkohë që individi përjeton lirinë e tij, rregullat parandalojnë cënimin e lirisë së tjetrit. Kështu që, nga njëra anë ato kufizojné individin, ndërsa në anën tjetër parandalojnë shkeljen dhë cënimin e lirisë së tjetrit, iu jep individëve lirinë e nevojshme. Në këtë kuptim, rregullat janë garancia e lirisë individuale. Ndërsa morali individual, është

procesi i zbatimit të këtyre rregullave me vetëdije dhe vullnet të plotë, ndërtimi i koshiencës tek ta (Çiftçi, 2003: 120). Për këtë arsye, Piaget, teksa studion zhvillimin e moralit tek fëmijët, fokusohet në mënyrën se si ata i zbatojnë rregullat e lojës kur luajnë, se si është zhvilluar vetëdija e tyre ndaj rregullave. Në shkencat psikologjike koncepti i moralit, përkufizohet si “*sjellje e moralshme*”. Sjellja e moralshme, përshkruan individin që i përket pjesërisht “mjedisit” brenda një sistemi të normave morale, përcakton masën e ndikimit që mjedisi ka mbi të. Morali individual nuk mund të kufizohet vetëm me sjelljet, ai përfshin mendimin e mirë dhe procesin e vetëdijësimit. Për këtë arsye, morali i grupit vlerësohet më së shumti si shoqëror. Në kuptimin e vetëdijësimit dhe sjelljes morale, koncepti i moralit, është riformimi i moralit shoqëror nga individi.

Sjellja morale nuk është e pavarur nga normat morale të shoqërisë, ajo zhvillohet kur individi është në ndërveprim me shoqërinë. Për të kuptuar dhe përkufizuar sjelljet morale duhet të shqyrtohet dhe përkufizohet mendimi moral dhe procesi i vetëdijësimit. Është aftësia e gjyqimit moral ajo që rrit cilësinë morale të sjelljeve tona (Trautner, 1991: 123).

Sipas *Hinde*, morali përcakton rregullat se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të bëjnë njerëzit, ai është një ndarje mes “të mirës” dhe “të keqes”. Por kur flitet për moralin, në përgjithësi bëhet fjalë për sjelljet e mira dhe ato që priten të ushtrohen (Hinde, 2002: 24).

Ndërsa *Güngör* mbështet këndvështrimin e *Hindes* për moralin dhe pretendon se morali lindi si nevojë e jetës së përbashkët me qëllim që të rregullojë marrëdhëniet mes njerëzve. Moralisht e “*keqe*” është të ushtrosh sjellje në dëm të njerëzve, ndërsa e “*mirë*”

është të ushtrosh sjellje që u pëlqejnë të tjerëve e që mundësojnë mbarëvajtjen e jetës mes njerëzve (Güngör, 1998: 35).

Sipas *Güngör* (2003), për pyetjen se çfarë është morali, mund të kërkohet përgjigje në tre mënyra:

1. Të ndajë të mirën nga e keqja.

2. Të sillat sipas kësaj ndarjeje.

3. Nënkupton që, me shfaqjen e virtyteve njeriu të përjetojë ndjenjën e kënaqësisë dhe krenarisë, ndërsa për veprimet pa kriter të ndjejë turp e fajësi.

Duke marrë parasysh këto tre veçori, në përkufizimin e moralit, teoricienët e zhvillimit sugjerojnë tre komponentë për përkufizimin e moralit:

1). **Elementi emocional:** Janë ndjenjat që orientojnë aktet e fajësisë, dëshpërimin për tjetrin, mendimit që rrjedh nga veprimet e drejta e të gabuara.

2). **Elementi i njohjes:** Metodën e ndjekura për konceptimin e të drejtës, të gabuarës dhe mënyrës së sjelljes.

3). **Elementi i sjelljes:** Ky element tregon se si duhet të sillemi kur mbetemi nën ndikimin e gënjeshtërisë, frikës apo cënimit të vlerave të tjera morale (Güngör, 2003: 125).

Kur marrim në shqyrtim studimet e kryera për moralin, dhe kur kërkojmë rreth përkufizimit e kriterëve të larta të “moralit të pjekur”, hasim tre kritere që përfaqësojnë qasje të ndryshme:

Internalizimi i normave: Përmbushja e kërkesave dhe obligimeve normative pa detyrim apo të jetuarit në përputhje me normat e mbrojtura nga vetë individi, kontrolli i jashtëm.

Ndjeshmëria e drejtësisë: Vetëdija dhe ndjeshmëria për rregullat e drejtësisë, mbi shpërblimin dhe dënimin, burimeve të shkëmbimit dhe ndarjes në një sistem shoqëror.

Heqja dorë nga nevojat dhe interesat personale: I referohet gjendjes së ndjenjës së quajtur kënaqësi shpirtërore, si heqja dorë nga nevojat dhe interesat personale bazuar në përgjegjësinë reciproke, empatisë dhe përjetimit të ndjenjës së fajësisë (Trautner, 1991: 145).

Morali është vetëdija e njeriut. Ndërsa vetëdija, është procesi i vlerësimit dhe gjykimit bazuar në mendime. Morali është vetëdija e bazuar në mendje dhe ndjenja, që vetëmenaxhohet nga “*e drejta - e gabuara*” dhe “*e mira - e keqja*”. Ai është një akt personal i vetëdijes që integrohet me ndërgjegjen e vendimeve (Spohn, 2000: 122-139). Njeriu nuk është objekt i moralit, por është subjekti i tij, pra është ndërtues i moralit të vet. Morali nuk është diçka që imponohet nga jashtë, ai formohet brenda individit, ashtu sikurse zhvillohet gjuha dhe mendja, është një strukturë ontogenetike. Internalizimi i vlerave morale është më shumë se qëndrim ndaj vlerave, është aftësia e gjykimit që përfshin procesin e vetëdijshëm të njohjes (Çiftçi, 2003: 133).

Sipas Savater (2001), moral do të thotë “jetë e mirë”. Ndërsa jeta e mirë, nënkupton plotësimin e dëshirave si dhe realizimin e asaj që duhet bërë. Jeta e mirë bashkon jetën e lumtur me të jetuarit e drejtë (Savater, 2001: 29). *Leenders dhe Daniel* (2005), të cilët bëjnë

ndarjen e fajit të moralshëm dhe fajit të pamoralshëm, në punimin e tyre, kanë konkluduar se personat që mendojnë se kanë kryer një faj të moralshëm ndjehen më të kërcënuar për identitetin e tyre. Këta persona, për faktin se kanë bërë atë që kanë ndjerë dhe menduar se duhet të bëjnë ndihen “*fajtorë*”, si përfundim, shfaqin më shumë pakënaqësi në krahasim me të tjerët (Leenders dhe Daniel, 2005: 65-79).

Edhe *Hortman* ndan të njëjtat mendime për moralin. Ai mbron idenë se sjellje të moralshme janë ato që falin lumturi, si individit ashtu edhe shoqërisë. Askush nuk do të dëshironte të jetonte në një botë që i ka humbur vlerat (Akarsu, 1998: 24).

Küng dhe *Kuschel*, e shohin moralin si një forcë dhe dritë të fshehtë, që i jep njeriut një personalitet të drejtë dhe të shëndoshë, që mban larg shoqërinë nga anarkia dhe individin nga dhuna. Madje, ata shprehen se pas çdo mendimi, ideje dhe sjelljeje të individit në jetën e përditshme qëndrojnë vlerat morale (Küng dhe Kuschel, 1995: 13).

Sipas *Kohlberg* (1984), morali është një aftësi njohëse, është të sillesh sipas rregullave të përcaktuara nga shoqëria njerëzore, që përkojnë me parimet universal (Krebs dhe Denton, 1997: 131).

Morali është një sistem vlerash të dobishme që mban në këmbë gjithë shoqërinë. Mosrespektimi i vlerave morale, si fillim, nënkupton eliminimin e institucionit social të quajtur shoqëri. Kur kjo nuk ekziston, nuk mund të bëhet më fjalë për asnjë sistem vlerash. Në një shoqëri ku secili përpiqet për interesin personal dhe nuk mendon për të tjerët, nuk mund të bëhet fjalë për jetën artistike dhe as atë socio-ekonomike (Güngör, 1998: 25).

2.3. Baza filozofike e konceptit të moralit

Në historinë e mendimit morali është shqyrtuar në aspekte të ndryshme. Pyetje si: cilat sjellje përbëjnë bazën e moralit, cilat janë sjelljet e “*mira*” dhe të “*këqija*”, që në Greqinë e lashtë kanë qenë subjekt i filozofisë së moralit.

Filozofi i Antikitetit, *Sokrati* (469-399), është i pari që ka hulumtuar me seriozitet e në mënyrë gjithëpërfshirëse përreth moralit. Ai shprehet se, në sjelljet tona në vend që të pranojmë normat dhe rregullat e pranuar nga të tjerët, duhet të mendojmë rreth tyre. Ai e përmbloodhi konceptin e moralit me shprehjen “*jeta e gjykuar, nuk ia vlen të jetohet*”. Në thelbin e të qenit i moralshëm dhe në arritjen e së mirës, qëndron fakti që njeriu të bëjë atë që i bie për pjesë. Ai mbron idenë se, morali është thelbi i rendit shoqëror (Güngör, 1998: 13).

Ndërsa *Platoni* (427-347), ka një qasje paksa më ndryshe për moralin. Themeli i virtyshmërisë është dija, pra, virtyti është çështje dije. Një njeri i zakonshëm i pëlqen të gjitha gjërat e mira, ndërsa dija do vetëm të mirën. Kur shprehet se me arritjen e të mirës njeriu dhe shoqëria do të arrijnë lumturinë e vërtetë, mendon se kjo mund të arrihet vetëm me anë të shtetit. Me këtë doktrinë të moralit, Platoni ka ndikuar filozofët pas tij, por njëkohësisht ka udhëhequr edhe formimin Eudoimonist (*filozofia e lumturisë*) (Arslan, 2001: 110).

Kant (1724-1804) nuk pajtohet me moralin hedonist të Platonit. Në konceptin moral të Kantit, rregullat e moralit duhet të jenë vija frymëzimi. Ato duhet të jenë të pavarura nga ndjenjat dhe dëshirat, dhe nën mbikqyrjen e mendjes. Sipas tij, morali nuk është as

lumturia, as një parim që ndryshon nga individi në individ. Morali është mendja dhe ndërgjegjia që e diferencon njeriun nga qeniet tjera. Njeriu mund të ushtrojë sjellje të lira vetëm me mendje dhe ndërgjegje të pastër (Kant, 1964: 112).

Sipas *Aristotelit*, të gjitha gjallesat, si nevojë të natyrës kanë fuqi të fshehta, të cilat janë të detyruara t'i zhvillojnë. Njeriu, fuqi më të lartë ka mendjen, ai mund ta arrijë lumturinë vetëm duke përdorur atë. Të jetuarit me virtyte, është ideale për individin dhe shoqërinë (Hançerlioğlu, 1982: 24).

Sipas *Spinozës* (1632-1677), Perëndia është identik me natyrën, dhe qëllimi i dijes është që njeriu të zotërojë natyrën. Njeriu është i detyruar të zbatojë rregullat taksative të sistemit tërësor perëndi-natyrë. Sipas Spinozës, virtyti është të jesh i fortë.

Sipas *J. J. Rousseau* (1712-1778), vendimi i shumicës është i rëndësishëm, ndaj për të “mirën” duhet të ketë një koncept që e ndajnë të gjithë njerëzit. Njeriu, në të gjitha veprimet, duhet të mbajë logjikën në plan të parë.

Hegel (1770-1831) thekson se kryqëzimi i moralit me interesin personal mund të bëhet i mundur vetëm në një formë të re të shoqërisë.

Sipas *Marx'a* (1818-1883), natyra e njeriut mund të ndryshojë vetëm me heqjen e procesit të pronës private. Kështu, duke bërë të mundur përshtatjen e njeriut me natyrën mund të zgjidhet problemi i moralit.

Nitche (1844-1900) paraqiti konceptin e njeriut superior. Njeri superior është ai, që përtej vlerave ekzistuese, prodhon vlera të reja. Nitche dhe rryma ekzistencialiste kritikonin shoqërinë në të cilën jetonin dhe propozonin një stil të lirë jetese, të pavarur nga morali.

Historikisht, janë vërejtur tre pikëpamje të mëdha përreth moralit.

Së pari, është mendimi i mbrojtur nga teologët si *Shën Agustini*, se: “*mëkati i parë vjen nga lindja*”.

Së dyti, është mendimi i “*Pafajësisë së lindur*” i mbrojtur nga *Jean Jacques Rousseau*. Sipas tij, fëmijët lindin të pafajshëm dhe sjelljet negative e të pamoralëshme i mësojnë nën ndikimin e të rriturve.

Së treti, është mendimi “*Tabula Rasa*” i *John Locke*. Sipas këtij mendimi, fëmijët vijnë në këtë botë të zbrazët. Më pas arsimit dhe jeta i bën ata të moralshëm ose mëkatar (Anderson, 1984: 46).

1. Mëkatar i lindur: Fëmijët lindin me prirje negative si: egoiste, agresive dhe seksuale. Këto prirje mund të zhbëhen me anë të edukimit prindëror në moshë të vogël (*ndëshkimi*). Ky mendim themelor që i ka bazat në krishtërim, rishfaqet në psiko-analizë, dhe e sheh fëmijën si një paketë stimulësh (*pervers polymorpf*). Standartet morale bazohen në domosdoshmërinë e largimit të impulsit antishoqëror nga vetëdija. Në përshtatje me këtë, objektivat arsimore, janë shtypja e impulseve antishoqërore me ndjenjën e fajësisë. Në të kundërt, ato shfaqen. Suksesi në edukimin moral varet nga arritja e kontrollit të stimulëve negativë.

2. Mendimi “Tabula Rasa”: Fëmija i sapolindur nuk është as i keq e as i mirë, ai mund të marrë çdo lloj forme prej mjedisit social. Ky artikulum që buron nga imperializmi anglez, mbrohet në psikologji, veçanërisht nga teoricienët e edukimit. Për të ushtruar sjellje morale të pjekura (*objektivi i zhvillimit*), duhet të shtypen sjelljet sociale të padëshiruara e të edukohen sjellje pro sociale (*altruiste*). Sjellja morale, shihet si e barabartë dhe e përputhshme me normat sociale të kulturës.

3. Pafajësi nga lindja: Ky koncept i egër fisnik që zgjatet deri te *Rousseau*, pranon se të këqijat e para tek njeriu, formohen nën ndikimin e mjedisit (*edukimi dhe prindërit*). Për këtë arsye, edukimi është një mjet që mundëson zhvillimin e lirë të fëmijës pa i kufizuar potencialin.

Edhe pikëpamjet e teoricienëve si *Piaget* dhe *Kohlberg* janë më të përafërta me këtë. Morali heteronom (*me fokus të jashtëm, i mbikqyrur nga jashtë*) i vendosur nga të rriturit (*shoqëria*), është shkalla e parë e papjekur e moralit. Kjo shkallë, nëse nuk parandalohet nga mjedisi me edukim autoritar, përkufizohet si moral autonom që ushqehet nga maturimi i njohjes dhe marrëdhënieve me bashkëmoshatarët. Pjekuria morale, është aftësia e të marrurit vendime morale autonome në përputhje me principet e drejtësisë universal (Piaget, 1992: 89).

Këto pikëpamje, në një nivel të rëndësishëm kanë ndikuar edhe në rrymat bashkëkohore të psikologjisë së fushës së moralit. Doktrina e “*fajësisë së lindur*” me origjinë religjioze, rishfaqet edhe në psiko-analizë, e cila e sheh fëmijën si një paketë stimujsh. Standartet morale bazohen në domosdoshmërinë e largimit të impulsit

antishoqërorë nga vetëdija. Suksesi në edukimin moral, është arritja e kontrollit të stimujve negative (Trautner, 1991: 56).

Kuptimi njerëzor i doktrinës “*Tabula Rasa*” mbrohet nga teoricienët. Sjellja e pjekur morale “shfaqet kur fëmija fillon të dëgjojë kërkesat e ndërgjegjes. Kjo pjekuri, zhvillohet gjatë kohës që ai mbështetet në gjykimin e tij, sipas organizimit të jetës dhe aktiviteteve ditore. Pra, në maturimin moral, progresi përcaktohet me rritjen e lirisë individuale, e cila i mundëson individit të zgjedhë të mirën” (Onur, 1991: 114).

Trautner, mbron idenë se, për të ushtruar sjellje morale të pjekura, duhet që të shuhen sjelljet sociale të padëshiruara dhe shfaqen sjellje të pavarura. Sjellja morale shihet si e barasvlerëshme dhe e përputhur me normat sociale të kulturës (Trautner, 1991: 29).

Sjelljet të cilat do të jenë subjekt i kornizës morale të këtij studimi janë rregullat e moralit universal. Bazuar në parimet e përcaktuara në "*Deklaratën e Etikës Botërore*", aprovuar nga *Parlamenti i Besimeve Botërore*, në vitin 1993 në Chicago, që konkludon se duhet të respektohen të gjithë pa dallim feje, race e gjuhe, të vlerësohet çdo krijesë e botës, ta trajtojmë tjetrin, ashtu siç dëshirojmë të trajtohem ne vetë nga të tjerët, të kemi mirëkuptim dhe solidaritet, etj. (Tarhan, 2006: 86).

Deri këtu treguam se morali është tërësi e rregullave të miratuara nga shoqëria. Edhe procesi i vendosjes së këtyre rregullave e parimeve është një çështje që duhet diskutuar. Shpesh herë përballemi me pyetje: se si dhe nga burojnë vlerat e mira e të këqija, që i vishen sjelljeve morale? Cilat sjellje janë të moralshme, etj? A është Zoti apo njeriu ai që e përcakton të mirën? A është qëllimi baza e sjelljeve të mira apo rezultatet e saj, si: lumturia,

kënaqësia dhe zbatimi i urdhrave të Zotit, të cilat shfaqen në fund? Të gjitha këto pyetje na shtyjnë të hulumtojmë rreth pyetjes se cili është burimi i moralit.

2.4. Problemi i burimit të moralit

Në historinë e mendimit burimet e moralit ndahen në dy: ata që mendojnë se burimi i moralit duhet të kërkohet tek qëllimi dhe ata që mendojnë se përfitohet nga sjellja.

Sipas mendimtarit gjerman, *Kant* (1724 - 1804), burimi i moralit duhet të kërkohet tek qëllimi, që i orienton njerëzit drejt sjelljes. Sipas tij, sjelljet e ushtruara lirisht janë vetëm sjellje të moralshme. Nuk mund të bëjmë fjalë për sjellje të lirë nëse me to njerëzit synojnë të marrin kënaqësi, të përfitojnë ose synojnë të fitojnë përlqimin e Perëndisë. Për këtë arsye, Kanti shprehet se morali buron nga ndjenja e detyrës dhe qëllimi që shkakton sjelljen, mund të jetë vetëm burim i moralit (Akarsu, 1982: 207).

Kundrej kësaj ideje, mendimtarë e teologë të tjerë mbrojnë idenë se burimi i moralit është i lidhur me rezultatin e arritur nga sjellja. Disa prej tyre e lidhin moralin me kënaqësinë, përfitimin dhe lumturinë, ndërsa disa të tjerë e cilësojnë atë si zbatim të urdhërave të Perëndisë. Ndërsa mendimtari francez *Sartri*, i cili mendon se burimi i moralit është njeriu, shprehet se sjelljet që njeriu ushtron lirisht janë të moralshme, dhe se çdo sjellje për të cilën nuk ndjehet pendesë është në përputhshmëri me moralin (Sartre, 1996: 90-93).

Filozofët anglezë *D. Hume*, *J. Bentham* (1832) dhe *S. Mill* (1873) janë përpjekur të zhvillojnë një botëkuptim të moralit të përshtatshëm me atë të shoqërive demokratike.

Lumturia shoqërore është parësore kundrejtë lirisë individuale. Ky mendim, në historinë e filozofisë njihet si *Utilitarizëm* (Kiraz, 2005: 57).

Filozofët e lashtësisë, *Aristipi*, *Hegesiusi* dhe *Epikuri*, e konsiderojnë kënaqësinë si burim të moralit. Masa e “*të mirës*” është kënaqësi, ndërsa masa e “*të keqes*” është dhimbja. Këto nuk janë vetëm kënaqësi fizike por edhe shpirtërore. Burime të moralit mund të jenë edhe kënaqësitë shpirtërore, si miqësia dhe drejtësia, të cilat i kanë hije njeriut (Russell, 1991: 47).

Sokrati, *Platoni* dhe *Aristo*, nisur nga fakti se gjëja më e rëndësishme e njeriut është mendja, mbrojnë idenë se morali duhet të bazohet tek ajo, e cila vjen nga lindja, ose më saktë nga dija. Kjo rrymë përjetoj periudhën e saj më të ndritur në sajë të mbështetjes që i dha filozofi anglez *J. J. Rousseau* (1712-1778), dhe *Shaftesbury* (1671-1713), i cili në librin e tij të titulluar “*Virtyti dhe lumturia*” e mbështeste atë (Ross, 1993: 227-230).

Një tjetër burim, në të cilin bazohet morali përgjatë historisë së mendimit, është religjioni. Edhe pse mendimet filozofike kanë ndikuar mbi popujt në aspektin e vendosjes së moralit në zemrat e njerëzve, asnjëherë nuk kanë mundur me qenë më ndikuese sa feja. Sipas religjioneve monoteiste Perëndia krijoi gjithësinë e, ndërkohë, iu përcaktoi njerëzve disa rregulla morale për t’i zbatuar. Zbatimi i këtyre rregullave nënkupton të qenit i moralshëm. Sipas këtij mendimi, burim i rregullave të moralit janë urdhëresat dhe ndalesat e Perëndisë (Draz, 1993: 4-11).

2.5. Ndryshimi i moralit

Morali është një sistem vlerash që mban në këmbë të gjitha shoqëritë e për të cilin flitet në çdo vend dhe kohë. Besimtarët ose jobesimtarët, fetarët dhe jofetarët, madje dhe ateistët kanë moralin e tyre. Edhe pse rregullat e moralit janë universale, në mjedise e zona, shoqëri, kultura dhe qytetërime të ndryshme komentohen dhe praktikohen në mënyra të ndryshme. Rregullat e moralit që nuk ndryshojnë në thelb e karakter, ndryshojnë në pamje, detaje dhe praktikë. Nisur nga kjo, sikurse mund të flitet për moralin budist, hebre e të krishterë, mund të flitet edhe për moralin e racave dhe fiseve të ndryshme. Faktorët historikë si fetë, kulturat, traditat dhe klima, ndikojnë në formimin dhe ndryshimin e moralit (Uludağ, 2001: 126).

Sipas shpjegimeve të teologëve, përsa kohë ndryshon besimi, tradita dhe gjykimi i vlerave në shoqëri, ndryshon edhe morali i njerëzve. Me përjashtim të virtyteve si: drejtësia, barazia, të drejtat e njeriut dhe solidariteti, të cilat janë parime të moralit universal, rregullat e tjera të moralit nuk kanë këto përmasa. Këto vlera ndryshojnë nga njëra shoqëri në tjetrën (Onur, 1997: 156).

Shkurtimisht, bashkë më ndryshimin e kohës, ndryshojnë njerëzit, ngjarjet, mjedisi shoqëror dhe kushtet e jetesës. Në këtë situatë, mes kaq shumë gjërash të ndryshme, është i pashmangshëm ndryshimi i rregullave dhe vlerave morale.

2.6. Pjekuria morale

Pjekuria morale, i referohet situatës së të qenit në majën më të lartë në aspektin e ndjenjës morale, mendimeve, gjykimeve dhe sjelljeve, si dhe të qenit zotërues i cilësive të larta morale. Pjekuria morale, është niveli i përsosur i cili bën të mundur që ndërgjegjia të kuptojë ndjenjat, mendimet, gjykimet, qëndrimet e individit, çdo lloj personaliteti të moralit dhe zhvendosjes së tij. Personi me maturi morale, pritet të jetë i besueshëm, i përgjegjshëm, i respektueshëm, i drejtë, të ketë autokontroll, të ketë aftësi empatie të zhvilluara. Të jetë njeri i mirë dhe mbi të gjitha, të jetë një qytetar i denjë që respekton rregullat dhe ligjet (Lickona, 1991: 51).

Gjatë rishikimit të literaturës mbi pjekurinë morale, në studimet e kryera, përballemi me teorinë e zhvillimit moral të teoricienit të famshëm, *Lawrence Kohlberg*. Niveli dhe faza e zhvillimit të gjykimit moral të propozuar nga Kohlberg, njëkohësisht vlerësohet edhe si niveli i pjekurisë morale. E rastisim atë si në punimet e vetë autorit, ashtu edhe tek studiuesit e tjerë të fushës (Hauser dhe të tjerët, 2007: 1–3).

Thomas E. Lickona thekson se pjekuria morale vjen nga tre dimensione: mendimi moral, ndjenja morale dhe sjellja morale. Për pjekurinë morale, janë të rëndësishme informacioni për moralin, shqisa e moralit dhe sjellja morale, pra përkatësisht, zakonet e mendjes, zakonet e zemrës dhe zakonet e veprimit. Informacioni mbi moralin, kërkon vetëdijen për vlerat morale dhe vendimarrjen. Ndjenja morale, kërkon ndërgjegje dhe vetëbesim. Ndërsa sjellja morale, kërkon që mendimi dhe ndjenja morale të vihen në lëvizje

vetvetiu. Sipas *Lickona*, sjellja morale shfaqet në fund të mendimit e ndjenjës morale dhe përcakton gjendjen e pjekurisë morale të njerëzve (Lickona, 1991: 51–58).

Edhe morali i shoqërisë, është në proporcion me pjekurinë morale të individëve. Sa më të zhvilluara të jenë ndjenjat, mendimi, qëndrimi dhe sjelljet morale të individit, aq më shumë rritet përgjegjësia morale e tij. Nëse morali i individëve nuk është maturuar, botëkuptimi i tyre për moralin shoqëror mbetet në një kornizë të caktuar. Në këtë situatë, individit nuk e ndjen veten përgjegjës për shumë sjellje. Një sjellje e tillë e largon individin nga shoqëria, dobëson moralin e individit dhe vetë shoqërisë (Erdem, 2002: 158–159).

Individët që kanë nivelin e duhur të pjekurisë morale kanë një përputhshmëri mes dëshirës dhe sjelljes, në këtë mënyrë nuk e sforcojnë veten. Ndaj ndiejnë kënaqësi për sjelljet e mira që bëjnë. Edhe njerëzit që pengojnë dëshirat dhe kërkesa e tyre janë të moralshëm. Në të dyja situatat, individët me moral i ngjajnë njëri-tjetrit në sjellje, nuk ushtrojnë sjellje të këqija. Individit që i pengon dëshirat, nuk merr kënaqësi nga sjella e tij. Se bëhet fjalë për konflikt mes dëshirës dhe sjelljes (Aydın, 1991: 212).

Për pjekurinë morale, nuk mjaftojnë vetëm vetitë e moralit si mendimi, ndjenja dhe gjykimi, këto vlera duhet të shndërrohen në sjellje dhe qëndrime, duhet të kenë qëndrueshmëri deri në përputhshmëri mes mendimit dhe sjelljes. Kthimi i të gjitha këtyre në zakone morali, përbën pjekurinë morale (Fukuyama, 1998: 59). Si përfundim, pjekuria morale është të japësh zgjidhje të pjekura për kuptimin e jetës.

2.7. Faktorët që ndikojnë moralin

Në hulumtimet e kryera rreth zhvillimit të njeriut, vërehet se *ai është një qenie biologjike, psikologjike dhe sociale*. Njeriu siç ka anën biologjike, ka edhe anën e tij shpirtërore. Njeriu, i cili ka nevoja materiale dhe shpirtërore, me kohë tregon zhvillim pozitiv të dykahshëm. Procesi i zhvillimit dhe pjekurisë morale është njëri prej tyre. Njerëzit, veçoritë morale që zotërojnë, i përfitojnë gjatë procesit të zhvillimit dhe rritjes. Zhvillimi moral, është njëri nga elementët më të rëndësishëm të zhvillimit njerëzor. Njeriu, që nga lindja deri në fund të jetës përjeton procese të ndryshme, si zhvillimi biologjik, psikologjik e social. Zhvillimi i tij moral formohet paralelisht me këto procese.

Për të realizuar një proces të shëndoshë të zhvillimit moral, ndikimi i faktorëve që e orientojnë atë është e rekomandueshme të jenë në përputhje me dëshirat dhe pritshmëritë e shoqërisë. Prandaj, është e rëndësishme të dihet se ç'është cilësia, sasia dhe efektet e faktorëve psiko-social që ndikojnë këtë proces, e bëjnë të mundur fitimin e aftësisë së sjelljes dhe mendimit moral të individit. Faktorët që ndikojnë te morali i individit shqyrtohen në tre grupe: biologjik, psikologjik dhe sociologjik (Bacanli, 2003: 11).

2.7.1. Faktorët biologjikë (Trashëgimia)

Atkinson përcakton trashëgiminë, zhvillimin fizik, gjininë dhe inteligjencën si faktorë biologjikë që ndikojnë zhvillimin moral. Sidomos, ai mbron idenë se trashëgimia është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e cilësive të nivelit moral (Atkinson, 1995: 130).

Studiuesi anglez i Shkencave të Natyrës *Edward O. Wilson*, në esenë e tij të titulluar **“The Biological Basis of Morality”**, botuar në revistën *“Atlantic Monthly”*, në prill të 1998-tës, pretendon se religjioni dhe morali nuk janë fenomene që i përkasin vetëm jetës shoqërore, njëkohësisht ata janë disa të vërteta të shkruara në genet tona. Më pas revista *“Newsweek”* ka botuar dy studime që kanë të bëjnë me këtë temë (Tarhan, 2006: 92).

Trashëgimia nënkuptom kalimin e disa karakteristikave fizike dhe mendore që gjenden tek nëna e babai nëpërmjet geneve të fëmija gjatë fekondimit të embrionit. Gjallesat lindin pasardhës të ngjashëm me veten. Sipas shkencës psiko-gjenetike, si veçori fiziologjike madhësia, struktura e kockave, gjinia, flokët dhe ngjyra e syve, e të tjera, ashtu dhe veçoritë psikologjike si aftësia mendore, ekuilibri ndjesor dhe temperamentit, kalojnë te fëmija nga nëna dhe babai.

Ndërsa mjedisi, është një koncept që përfshin të gjithë faktorët jo të trashëgueshëm që kanë ndikim në personalitetin dhe sjelljen e individit. Mjedisin e individit mund ta ndajmë në dy përbërës: **fizik** dhe **social**. Teksa elementë si bimët, kafshët, moti, temperatura, drita, etj. përbëjnë mjedisin fizik të individit. Njerëzit që e rrethojnë individin, zakonet dhe traditat e tyre, përbëjnë mjedisin social e kulturor të tij (Gürün, 1991: 17).

Vërejmë se fëmijët që rriten në mjedise të përbashëkta kanë zhvillim dhe sjellje të ndryshme. *Kjo tregon ndikim biologjik*. Vëllezër e motra që rriten në të njëjtin mjedis familjar, krijojnë personalitete të ndryshme nga njëri tjetri. Edhe pse gjenden në të njëjtën klasë dhe arsimohen nga i njëjti mësues, nxënësit nuk arrijnë suksese të njëjta në nivel suksesi. Fakti që edhe pse individët gjenden në të njëjtin mjedis, sjellja, suksesi dhe

interesat e ndryshme, mund të shpjegohet vetëm me mbartjen e veçorive të ndryshme trashëguese (Baymur, 1994: 210).

Studimet hulumtojnë rreth pyetjes se, kush ndikon më shumë në zhvillimin dhe sjelljen e individit, trashëgimia apo mjedisi? Konkluzioni është se që të dyja këto kanë ndikim në natyrën dhe sjelljen e njeriut. Nuk mund të pretendohet se në zhvillimin e individit luan rol vetëm trashëgimia apo vetëm mjedisi. *Trashëgimia është një faktor që përcakton se deri në çfarë mase mund të zhvillohet një veçori fiziologjike ose psikologjike.* Trashëgimia përcakton kufijtë minimal dhe maksimal të zhvillimit individual. Ajo është në një marrëdhënie të vazhdueshme me mjedisin. Zhvillimi lind si rezultat i ndërveprimit të vazhdueshëm mes trashëgimisë dhe mjedisit (Başaran, 1990: 27).

Sipas përfundimeve të studimeve të kryera mbi trashëgiminë dhe mjedisin, ka rezultuar se në krahasim me mjedisin, trashëgimia ndikon më shumë në zhvillimin e veçorive fizike dhe aftësive individuale. P.sh., është vërejtur se trashëgimia luan rol më shumë së elementët e mjedisit mbi inteligjencën, ndikimi i mjedisit mbi inteligjencën dhe aftësinë e mendimit mbetet në vend të dytë. Ndërsa kushtet mjedisore ndikojnë më shumë në veçoritë e karakterit, si: ndroja, dashamirësia dhe dashakeqësia. Është arritur si konkluzion se mjedisi është më ndikues se trashëgimia në zhvillimin moral (Baymur, 1994: 224).

Studimet vërtetojnë se, *arsyet e zhvillimit të individëve me tipare të ndryshme, janë përcaktimi i dallimeve seksuale, mendore dhe aftësive të trashëguara.* Në të vërtetë, vërtetohet se, sipas gjinive, femrat janë më të kuptueshme, më të ndjeshme, më pasive, më

të varura, më të bindura, më të gatshme për të ndihmuar të tjerët dhe krijojnë lidhje të afërta, ndërsa meshkujt janë më dominues, më pak të përgjegjshëm, i shprehin më pak ndjenjat dhe janë më agresivë. Rezulton se individët me inteligjencë sociale arrijnë t'i kuptojnë më mirë njerëzit, i kuptojnë më mirë marrëdhëniet ndërpersonale dhe sipas tyre sillen me njerëzit. Sipas aftësive, tek individët që kanë potenciale të ndryshme vërehen prirje për t'u marrë me shpikje shkencore, artistike, sjellje kreative, etj.

Pavarësisht të vërtetës se ekzistojnë veçori personaliteti të trashëgueshme në lidhje me dallimet gjinore, mendore e aftësive, nuk ka veçori të caktuara morale të trashëgueshme që burojnë nga këto dallime. Pra, nuk ka ndonjë gjetje ku të vërehen dallime në veçoritë individuale morale që të jenë të lidhura me dallimet gjinore, mendore dhe aftësitë (Temel, 1991: 84).

2.7.2. Faktorët socialë

Edhe pse njeriu nuk lind i pajisur me moral, sërish ai nuk është krejtësisht bosh. Zhvillimi biologjik, psikologjik dhe social i njeriut është i përshtatshëm për të pasur një personalitet me moral. Që në moshë të vogël njeriu shfaq interes dhe dëshirë për vlerat morale. Sjelljet vlerësohen në formën e gjykimit moral *mirë-keq*, e *drejtë-gabim*, etj. Këto gjykime njerëzit i mësojnë po nga njerëzit. Që në moshë të vogël, prindërit orientojnë sjelljet e fëmijëve të tyre. Në qoftë se gjykimi i vlerave, informacioni se çfarë është e mira dhe e keqja do të ishte i trashëgueshëm nga lindja, nuk do të ndjehej nevoja për ndërhyrje në sjelljet e fëmijëve e orientimin e tyre. Përveç kësaj, rregullat e moralit nuk do të ishin të ndryshme në të gjitha shoqëritë (Guillaume, 1970: 48).

2.7.2.1. Familja

Familja është një strukturë sociale ku njeriu lind, rritet dhe mbrohet. Në të njëjtën kohë, familja është institucioni themelor ku fëmijët mësojnë vlerat morale e kulturore, përgatiten për jetën, traditat e zakonet përcillen nga brezi në brez. Marrëdhënia e fëmijëve të sapolindur me mjedisin, justifikohet me pafuqinë e tyre fizike.

Marrëdhënia e foshnjes me nënën, është hapi i parë i hedhur drejt sociale. Me këtë hap fëmijës fillojnë t'i zhvillohen veçoritë dhe aftësitë e mbartura nga lindja. Detyra e nënës në këtë proces është e veçantë. Sepse fëmija, fillon të flasë, të shikojë e kuptojë ngjarjet nga perspektiva e marrëdhënies me nënën. Ky është funksioni i parë i amësisë. Nënat janë në qendër të vëmendjes së aktivitetit shoqëror. Përfundimisht, marrëdhënia e fëmijës me nënën shndërrohet në një mekanizëm shpirtëror të automatizuar dhe vë në dukje stilin e jetës së fëmijës (Adler, 1996: 15).

Familja është burimi i parë dhe më autoritar në procesin e zhvillimit moral. Sidomos në vitet e para të fëmijërisë, ajo siguron modelet dhe shembujt e nevojshëm për përcjelljen e normave shoqërore dhe vlerave morale tek fëmija, si dhe e motivon atë drejt sjelljes së duhur. *Familja është mjedisi i parë ku përdoren metodat e shpërblimit dhe ndëshkimit, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mësimin e sjelljeve.* Babai ka rolin e personit që merr vendime, që iu vendos kufizime fëmijëve, dhe i disiplinon ata. Ndërsa, nëna, merr përsipër rolin e përballimit të nevojave të anëtarëve të familjes, rregullatorit të sjelljeve dhe negociatorit të qëndrimeve në marrëdhëniet mes tyre. Kështu që, fëmija duke u identifikuar më prindërit merr nga vlerat e tyre.

Sipas *Adler*, pesë vitet e para të jetës familjare janë vitet që lënë gjurmë të thella dhe të qëndrueshme në formimin e moralit (Adler, 2005: 103). Ndërsa *Russel*, teksa mbështet pikëpamjen e Adler, thekson se morali i fëmijës formohet në gjashtë vitet e para të jetës (Russel, 1999: 7).

Sipas *Lickonas*, edukimi prindëror luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e moralit që fëmija do të ketë në të ardhmen. Nëse prindërit e edukojnë fëmijët me cilësitë e moralit të mirë, ai bëhet një person me moral të mirë. Nëse edukohet me cilësitë e moralit të keq, ai do të bëhet një person me moral të keq. Por, nuk duhet harruar e vërteta se prindërit, si fillim dëshirojnë që fëmija të jetë delikat ndaj së drejtës, pastaj të ketë gjykim të drejtë, dhe së fundmi, të bëjë atë që mendon se është e drejtë (Lickona, 1992: 51).

Struktura familjare dhe të qeniet e saj e shëndëtshme ndikojnë në formimin moral të fëmijës dhe e orientojnë drejt atë. Sidomos, *shpërbërja e familjeve nga vdekjet ose divorcet, mund të bëhet shkak i përjetimit të problemeve serioze në moshë të re për përshtatjen e fëmijëve me strukturën familjare*. Mosmarrëveshjet ndërmjet prindërve ndikojnë negativisht në zhvillimin moral të fëmijëve. Njëkohësisht, fëmijët mësojnë të gënjejnë, t'u kundërvihen të tjerëve dhe të përdorin fjalë të turpshme. Këta lloj prindëris bëhen shembull i keq për fëmijët dhe janë shkaktarë që ata të bëhen grindavecë dhe të pa marrë vesh (Binbaşioğlu, 1998: 55–57).

2.7.2.2. Qëndrimet e prindërve

Kur përmedet mjedisi ajo që të vjen në mendje, si fillesë, është familja. Sepse pas pjesëmarrjes njeriu vë përballë familjen dhe qëndrimet e prindërve. *Mënyra e afrimit të*

prindërve ndaj fëmijës, forma e aplikuar e disiplinës formësojnë personalitetin e fëmijës dhe karakteristikat e tjera të individit. Në të njëjtë kohë këto qëndrime ndikojnë në suksesin e fëmijës në shkollë dhe jetë. Në përgjithësi qëndrimet e prindërve mund të renditen në këtë mënyrë:

2.7.2.2.1. Qëndrimi autoritar i prindërve (Shtypës)

Shtypës - Qëndrimi autoritar i prindërve: kur flitet për qëndrimin e prindërve, merr rëndësi, dashuria e tyre ndaj fëmijëve, kontrolli i sjelljeve të aplikuara nga fëmija dhe natyra e disiplinës. Të qenit prind autoritar do të thotë që rregulli i vendosur dhe aplikimi i rregullave të bëhet pa diskutuar me fëmijën, pa u marrë vesh me të, po negociuar, mospranim total i dëshirave të tyre. Këta prindër, shtypës dhe të orientuar nga bindja, janë kufizues dhe ndëshkues, diktojnë fëmijët që të tregojnë respekt dhe bindje ndaj rregullave të tyre. Ky qëndrim është shkaku i zhvillimit social të pamjaftueshëm. Në një ambient të tillë nuk ka vend për diskutime. Mendimi i prindërve, me fjali kufizuese të tilla: “Këtë do ta bësh vetëm në formën që kam thënë unë, dhe kaq. Unë jam nëna/babai, kurse ti je fëmija” sforcuojnë fëmijët që të bëjnë atë që ata kërkonë. Dëshirat dhe nevojat e fëmijës nuk merren në konsideratë nga prindër të tillë (Yavuzer, 2003: 35).

Familjet “autoritare” në shikim të përgjithshëm:

a). Bindja absolute e fëmijës, plotësimi i dëshirës apo urdhërit pa e diskutuar aspak atë.

b). Nuk do që të krijojë lidhje shpirtërore dhe të përzemërta me fëmijën, kanë tendencë t'i shikojnë problemet jo me syrin e fëmijës, por sipas gjykimeve të tyre, duan që marrëdhënia me fëmijën të ketë distancë në mes.

c). Vendimet që do të marr në lidhje me fëmijën i marrin vetë pa i dhënë të drejtë fjale fëmijës. Nuk i marrin në konsideratë nevojat apo pëlqimet e fëmijës, nuk i lënë ata që të bëjnë zgjedhje të lire (Güngör, 2002: 122).

Familjet autoritare u afrohen fëmijëve me një qëndrim të sertë, të ftohtë dhe të prerë. Përballë fëmijës vendosin dëshirat e tyre dhe duan që të bëhet ashtu sikurse ata duan. Edhe kur ka ndërveprim me fëmijët ai është i pamjaftueshëm e i vështirë. Nuk i japin mundësi fëmijës të shprehë ndjenjat dhe mendimet. Fëmijët i detyrojnë të përshtaten me rregullat e vendosura prej tyre. Në edukim i japin vend ndëshkimeve të shpeshta. Edhe gabimi më i vogël i fëmijës përfundon me ndëshkim. Disa prindër ushtrojnë ndaj fëmijës së tyre edhe ndëshkime fizike, siç është rrahja, disa të tjerë i turpërojnë, fajësojnë dhe ndëshkime të tjera emocionale. Disa të tjerë mund të quhen fëmijë më të privilegjuar se ndëshkohen duk iu ndaluar aktivitetet që kanë qejf. Qëndrimet e prindërve autoritarë vënë në përdorim presionin e tepërt dhe disiplinën e rreptë ndaj fëmijës (Razon, 1981: 23).

Emocionet dhe mendimet e njerëzve merren në konsideratë për aq kohë sa janë nën korinza të autoritetit të vendosur, ato që nuk i nënshtrohen autoritetit janë të pavlerë. Në një mjedis të tillë familjarë, *fëmija mësohet të mos u besoj mendimeve dhe ndjenjave të vetes*. Presioni më i madh është mirënjohja ndaj personit autoritar, çuarja në vend e pritshmërive të tij, të kuptuarit se mendimet dhe ndjenjat mund të ndryshohen. Fëmija rritet

përbrenda si një njeri bosh, ndërsa nga jashtë si një njeri gjeometrik (Cüceloğlu, 2002: 111).

Prindërit e këtij qëndrimi duke qënë se ushtrojnë një disiplinë të rreptë, bëjnë që fëmija të përshtatet me zor me çdo rregull. *Dikush që është nën presionin e prindit apo të çdo njeriu tjetër, në vend që të jetë i qetë, i sjellshëm, i kujdeshsëm dhe i ndershëm, bëhet i pakënqaur, zemërbutë, i turpshëm, i dënueshëm lehtë nga të tjerët, me një natyrë shumë të ndjeshme.* Një fëmijë i rritur me këtë qëndrim ka frikë të marrë kritika nga prindërit, bën gjithmonë kujdes për sjelljen. Frika e të gabuarit është e madhe. Duke ndjerë se nevojat dhe dëshirat e tij nuk marrin asnjë vlerë, ka frikë t'i shpreh ato. Tek fëmijët e rritur në familje autoritare vihen re këto karakteristika: mungesë dashurie ndaj prindërve, ndërtimi i marrëdhënieve të lëkundura me njerëzit, grindavecë dhe jo të shkueshëm, të paaftë që të kontrollojë emocionet, shpërthyes, mosbesues, frikë dhe ndrojtje të panevojshme (Tuzgöl, 1998: 12).

2.7.2.2.2. Qëndrimi fleksibël (Qëndrim i përqëndruar tek fëmija)

Neglizhenca dhe toleranca e tepruar ndahet në dy dimensione të ndryshme:

Qëndrimet neglizhente: Prindërit e pa interesuar nuk tregojnë interes për jetën e fëmijëve. Për këtë grup prindërisht jeta e tyre sociale është më e rëndësishme. Në një mjedis të tillë jeta sociale është e varfër, vetëkontrolli është shumë i ulët, rriten fëmijë që nuk mund ta fitojnë lehtë lirinë. Këta fëmijë e ndiejnë shumë nevojën e interesimit të prindërve.

Qëndrimet me tolerancë të tepruar: Ata që ndodhen në këtë qasje janë prindërit që ua plotësojnë dëshirat fëmijëve me këmbëngulje, i llasojnë, u japin shumë liri, përulen me lehtësi, të butë e të paqëndrueshëm në sjellje, neglizhojnë me fëmijët në dimensione të terpuara, i braktisin ata. Në pamje duken shumë të intersuar për fëmijën, demonstrojnë një kontroll jo të sukseshëm me todhe, për pak shkojnë në gjendje katastrofike. Në një mjedis të tillë zhvillimi social është i pamjaftueshëm. Vetëkontrolli është i ulët. *Tolerantët e tepruar i lejojnë fëmijët të bëjnë çfarë të duan.* Si përfundim, fëmijët e një familje të tillë asnjëherë nuk do të mund të kontrollojnë vetë veprimet e tyre. Ata presin që të udhëzohen gjithmonë dhe dëshirat t'u plotësohen (Yavuzer, 2003: 45).

Familjet që në fokus kanë fëmijët, në përgjithësi janë familje që kanë fëmijë të moshës së mesme ose familje që e rrisin fëmijën në mesin e të rriturve, duke qenë kështu i vetmi fëmijë në grupin ku ndodhet. Në një familje të tillë, fëmija është i vetmi person që zotëron iniciativën, gjithë personat e tjerë të familjes plotësojnë dëshirat e tij pa hezitim. Ajo që jepet në këtë rast është një dashuri e tepruar dhe përkujdesje e dëmshme. Forma disiplinore është e rreme dhe me një tolerancë të tepruar. Ajo dëshmohet si rezultat i pamjaftueshmërisë dhe dobësisë së familjes.

2.7.2.2.3. Qëndrimet e pavendosura dhe tëpaekuilibruara

Ky qëndrim, është një llojë mosmarrëveshje që shfaqet midis prindërve, kur nëna apo babai mund të ndryshojnë sjellje apo shfaqin një mënyrë krejt të ndryshme nga e para. Ky qëndrim, në pamje të parë, duket sikur është një shfaqje mes tolerancës së tepruar dhe ndëshkimit të fortë. Ka disiplinë, por nuk dihet se kur dhe se duhet të shfaqet. Për këtë

arsye nuk dihet asnjë herë se çfarë do të ndodh në fund të sjelljes së fëmijës. Prindërit e këtij qëndrimi bëjnë sikur nuk e shikojnë sjelljen e fëmijës, ndërsa një herë tjetër e ndëshkojnë rëndë për të njëjtën sjellje. Arsyeja e vërtetë e kësaj është gjendja emocionale e momentit. Si pasojë, fëmija nuk e shtron pyetjen nëse një sjellje është e drejtë apo e gabuar, dhe kur mund të ndëshkohem nëse e bëj. Prindërit që zotërojnë një sjellje të tillë të ndryshueshme, me dashje ose pa dashje, bëjnë që fëmija ta përvetësojë këtë mënyrë sjellje. Fëmijët që rriten brenda këtij stereotipi nuk kanë besim tek vetja. *Mund të jenë në të njëjtën kohë, të pavendosur e të turpshëm, por edhe kryelartë e rebelë* (Öğretir, 1999: 34).

Prindërit, përsa i përket rritjes së fëmijës, shfaqen të paqëndrueshëm dhe në mospërputhshmëri, kështu që fëmija do të hasë brenda një kohe të shkurtër, standarte dhe sjelljeje të ndryshme të prindërve. Kufizimet e nevojshme dhe të arsyeshme të vendosura për fëmijën, mbështesin zhvillimin personal dhe aftësinë për të pasur sjellje të vetëkontrolluara, kjo lidhet kryesisht me qëndrimet në sjellje të prindërve (Yılmaz, 2002: 86).

2.7.2.2.4. Qëndrimi i tepruar mbrojtës

Mbrojtja e tepruar e prindërve, kontrolli dhe kujdesja më shumë se e nevojshme, bëjnë pjesë në këtë grup. Përfundimi i këtij qëndrimi është, lidhja e fëmijës më shumë se sa duhet me të tjerët, mosbesim tek vetja, apo tek një njeri që ka gjendje emocionale kritike. Kjo është një lidhje që zgjat gjatë gjithë jetës, e cila ndikon negativisht në pjekurinë psiko-sociale, kështu që fëmija nuk i jep vetes mjaftueshmërisht pavarësi. *Fëmijët e mbrojtur së tepërmi bëhen shumë të ndërrvarur dhe duan që çdo gjë të tyren ta drejtojnë prindërit. Ato*

janë të paaftë për të vendosur vetë, nuk bëjnë asgjë pa pyetur dhe pa u konsultuar, dhe nuk mund të integrohen kollaj. Nuk janë të lirshëm në të vepruar, janë të ngathët dhe si pasoj të pasigurtë. Ato i kërkojnë gjërat duke qarë, nëse nuk ua jep qajnë deri sa t'i marrin, kanë pëshpërimit apo teprime të tipit “**më the, të thashë**”, dhe bëhen kokëfortë. Duke qenë se nuk është mësuar të mbrojnë veten, nuk mbrohen, tregojnë përshtatshmëri të shpejtë, janë të turpshëm, zhvillojnë një personalitet të trembur. Mund të ndodh dhe e kundërta, të bëhen autoritarë, përdorin rrethanat, të papërgjegjshëm, kështu që zhvillojnë një personalitet të përkëdhelur. Fëmijët e mbrojtur së tepërmi, duke qenë se e kanë të penguar edhe zhvillimin shpirtëror, kur rriten janë femënorë, çdo gjë e presin të gatëshme. Nëse nuk u realizohet ajo që pretendojnë mërzen shumë dhe zhvillojnë një personalitet nervoz (Navaro, 1987: 25).

Prindërit që bëjnë çdo gjë për fëmijën, e nuk pretendojnë asgjë prej tyre, nuk marrin asnjë mesazh që tregon diçka të besueshme në lidhje me kapacitetin e mësimit dhe të qenurit të lirë prej fëmijës. *Mbrojtja i bën fëmijët të lidhur dhe pazgjidhje*. Këta fëmijë mund ta ndiejnë se i duan, por nuk e ndiejnë veten të aftë në asnjë temë (Humphreys, 2002: 56).

2.7.2.2.5. Qëndrimi indiferent, i paregjistruar

Qëndrimi indiferent dhe i pa regjistruar e tregojnë prindërit që i lënë fëmijët vetëm, që nuk i shikojnë ata, dhe duket sikur i injorojnë. Një mjedis që të çon në abuzim emocional mes prindërve dhe fëmijëve është një trekëndësh me mungesë komunikimi (Yavuzer, 1995: 35). Në këtë qëndrim familjar, prindi është i painteresuar për fëmijën. Duke i anashkaluar nevojat e fëmijës, fëmija nuk di asnjë rregull, nuk i intereson suksesi i fëmijës ndërkohë që

gabimet ua përpalsin vazhdimisht në fytyrë. Këta prindër në shumicën e rasteve nuk merren fare me fëmijën. Ose mund të ndodh që eksperiencat e tyre janë aq të këqija sa që nuk gjejnë forcë t'i dalin zot fëmijës. Një fëmijë i rritur në një ambient të tillë, është një njeri i dështuar. Fëmijët e kësaj situatë qëndrojnë largë ndihmës, janë të egër dhe nervoz, shfaqin emocione kritike, kundrejt të tjerëve sforcohen që të mbrohen, sidomos ndaj më të vegjëlve e më të dobëtve se vetja kanë ndjenja negative dhe shfaqin situata të mungesit të respektit për veten. Nëse prindërit janë edhe indiferent edhe neglizhentë, tek fëmija mund të shfaqen sjellje shumë agresive (Öğretir, 1999: 23).

2.7.2.2.6. Qëndrimet demokratike (Qetësues dhe tolerant)

Në konceptin e këtyre prindërve, fëmijës duhet t'i gjendesh pranë dhe ta mbështesësh, por në të njëjtën kohë nuk duhet neglizhuar me vendosjen e kufirit dhe kontrollin e sjelljes së fëmijëve. Midis prindit dhe fëmijës ka komunikim me fjalë. *Prindi që i tregon dëshirat dhe pikëpamjet në mënyrë të hapur dhe në formë të kuptueshme krijon mjedis të ngrohtë komunikimi me fëmijën.* Dukë qënë në marrëdhënie të drejtëpërdrejtë me fëmijën, i tregon atij interes duke e dëgjuar në mënyrë aktive. Një qasje e tillë përgatit mjedis të përshtatshëm për një zhvillim social të mirë. Kontrolli i mjaftueshëm i prindit, qëndrimi kompetent, së bashku me dashurinë dhe lirinë e fëmijës, bën që të ndodhin dy qasje të kundërta në të njëjtën kohë, kontrolli dhe dashuria (Yavuzer, 1995: 120).

Në qëndrimin demokratik të familjes, fëmijët ndihmohen që të përshtaten me rregullat dhe standartet që duhet të përvetësojnë, e të jenë në përputhshmëri të plotë me to. Të dyja palët u japin rëndësi mendimeve të njëri-tjetrit. Secili prej tyre i jep hakun për gjërat e

drejta tjetrit. Fëmija që ndodhet pranë njohjes së përgjegjësisë, mbështet për të zhvilluar një personalitet të lirë. *Familjet demokratike, janë tolerante e të besueshme* kanë qëndrim mbështetës për njëri-tjetrin. Ato aplikojnë një kontroll që mund ta logjikojë edhe fëmija. Në vend të kufizimeve të prera, fëmijës i jepet e drejta e fjalës dhe e drejta e zgjedhjes, me mirëkuptim plotësohen nevojat e tyre reciproke, etj. (Özgüven, 2001: 76).

Familja demokratike ka një marrëdhënie **“me dashuri të pakushtëzuar”** dhe një **“mirëkuptim empatik”**, duke zbuluar qëndrimet dhe sjelljet i nxjerrin në pah. Problemet që shfaqen i zgjidhin me komunikim e dialog: në shtëpi ka një mjedis të ngrohtë, ka rregulla **“të ndarjes”** dhe të **“bashkëpunimit”**. Qëllimi është sigurimi i zhvillimit të fëmijës si dhe fitimi i njohurive dhe i ndjenjës së përgjegjësisë. Në familjet demokratike, kur është e nevojshme fëmijëve iu vendoset kufi. *Në përgjithësi nëna është e dashur dhe e ngrohtë, kurse babai është pak më autoritar.* Dialogu miids babait dhe fëmijës nuk pritet, në vend të frikës tregohet respekt dhe dashuri (Humphreys, 2002: 21).

Në këto familje fëmija ka të drejtën e fjalës. Tregohet respekt për ndjenjat dhe këndvështrimet e tij, kështu që ai gjen dashuri dhe inkurajim. Në një mjedis të tillë fëmija zotëron aftësinë për t’u zhvilluar. Fiton lirinë dhe është i aftë të vendosë vetë dhe të marrë vetë përgjegjësi.

2.7.2.3. Mjedisi shoqëror, grupmosha

Njerëzit nevojat e ndryshme sociale dhe psikologjike mund t’i plotësojnë vetëm duke u bërë pjesë e një grupi. *Duke u bërë pjesë e një grupi, njeriu ndihmohet të fitojë një pozicion social, kurse nga ana psikologjike formimin e një ekuilibri.* Tek këto grupime

hyjnë grupet shoqërore dhe grupmoshat. Grupet shoqërore dhe grupmoshat në përgjithësi formohen prej anëtarëve që kanë të njëjtën moshë dhe vendndodhje. Përfshijnë njerëz me nivele të ngjashme ekonomiko-sociale, me fe dhe prejardhje etnike të njëjtë. Qëllimet, interesat, pritshmëritë, vlerat, parimet dhe mënyrat e komunikimit janë të njëjta (Köse, 1997: 141).

Pas familjes, mjedisi shoqëror është ambienti ku fëmija kalon më të shumtën e kohës, ku ndan sekretet e tij me të tjerët, vepron për të tejkaluar ndjenjat dhe mendimet e tij. Fëmija që bëhet pjesë e një ambienti të tillë, merr iniciativën e ndërtimit të marrëdhënieve të mira. mëson të jetojë në harmoni me moshatarët e tij. *Kjo lloj marrëdhënieje zhvillon aftësitë sociale si shoqërimi, solidarizimi, ndarjen me të tjerët dhe krijimin e miqësisë.* Fëmija, i cili bëhet anëtar i një grupi shoqëror, njeh vetveten, zhvillon personalitetin e vet dhe hedh hapat e para drejt botës së të rriturve (Yörükoğlu, 1986: 59-60).

Në grupin shoqëror, fëmijët mësojnë të mendojnë, vendosin dhe të veprojnë bashkarisht, e të tjera sjellje si këto. Në të njëjtën kohë, cilësi si: *besimi reciprok, respekti dhe përshatshmëria ndërmjet anëtarëve të grupit* kthehen në elementë të pazëvendësueshëm. Si anëtar i grupit përkatës, fëmija përvetëson sjelljet dhe vlerat e grupit. Për të nuk është e rëndësishme shoqëria, por mendimi dhe vlera që grupi i jep atij. Për këtë arsye ndikimi i grupit në zhvillim e personalitetit dhe moralit të fëmijës është i rëndësishëm (Tarhan, 2002: 105).

Mjedisi shoqëror i grupmoshave është ambient shoqërizimi. Ky ambient i përgatit ata për aktivitete të ndryshme e për mundësi mësimi: *të japësh, të marrësh, të ndashë punë*

gjatë bashkëpunimit, të ndjeshë kënaqësi nga veprimet e tjetrit dhe të mësosh si ndihet një njeri tjetër, besnikërinë, guximin, barazinë, motivimin e ndjenjës së pjesëmarrjes si dhe përforcimit të gjërave. Fëmijët dhe të rinjtë në mjedset shoqërore me grupmoshat, në njërën anë u përshtaten mjediseve, mësojnë normat dhe lidhen me to, si përfundim përvetësojnë vetveten, në anën tjetër mësojnë të shprehin qëndrimet dhe shprehin lirishëm gjykimet e tyre. Ky mjedis u mëson atyre bashkëpunimin dhe frymën e grupit, të fitojnë aftësinë e liderit si dhe kontrollin e liderit. Këto njohuri dhe aftësi atyre iu hyjnë në punë kur të rriten (Elkin, 1995: 88-93).

Grupmoshat dhe shokët, në të njëjtën kohë janë edhe modele që imitohen nga anëtarët e tjerë të grupit. Fëmijët fitojnë aftësi të reja duke vëzhguar veprimet e bashkëmoshatarëve të tyre. Shumë studime tregojnë se fëmijët ndikohen nga bashkëmoshatarët që marrin si shembull. P.sh., gjatë shpërndarjes së disa dhuratave midis shokëve të klasës, *disa fëmijë të moshës 4 dhe 5 vjeç, që dukeshin shumë bujar, kur u erdhi radha e tyre, u treguan shumë bujar me fëmijët e tjerë, të cilët nuk kishin parë më parë sjellje të tillë bujarie. Vetëm se tek fëmijët është më e madhe mundësia të imitohet sjellja e shpërndarjes së dhuratave sesa një sjellje ndëshkimore (Atkinson, 1995: 107).*

Veçanërisht fëmijët që kanë aftësi në fusha të caktuara, mirëprehen nga shokët në grup. Pranimi në grup u rrit vetëbesimin fëmijëve. Kështu që, fëmija, i shpreh lirshëm ndjenjat dhe mendimet e tij në grup. *Disa grupe shoqërore janë të mbyllura nga jashtë, janë grupe që ndërtojnë marrëdhënie mes vetes e janë në konflikt me vlerat shoqërore. Në të tilla grupe, sjelljet e anëtarëve mund të jenë shembull i keq për sjelljet e fëmijëve, kështu që mund t'i shtyjnë ata drejtë fajit. Për këto arsye, grupet shoqërore që jetojnë jashtë*

shoqërisë, shpesh herë mund të ndërtojnë identitete negative e të pamoralshme (Yörükoğlu, 1986: 64).

Fëmija para së të hyjë në periudhën e pubertetit ndikohet më shumë nga familja, ndërsa kur hyn në këtë periudhë shtohet ndikimi i mjedisit shoqëror dhe bashkëmoshatarëve. Përsa i përket moshës së adoleshencës, ndikimi që ky mjedis ka tek individit është në plan të parë. Kjo ndodh sepse mjedisi shoqëror e ul tensionin e brendshëm të të riut, atij i jepet më shumë besim për botën e jashtme, i jepet mundësia të njoh vetveten dhe të tjerët, e ndihmon në shoqërizim dhe e përgatit për jetën kolektive. *Duke qënë se në mjediset shoqërore sjelljet imitohen në mënyrë të njëjtë, ekziston mundësia që të ndikohen si pozitivisht ashtu edhe negativisht.* Nëse ky mjedis tregon sjellje morale të pa përshtatshme dhe të prishura, këto sjellje kthehen në zakone edhe për anëtarët e tjerë të grupit. Kjo ndodh sepse të rinjtë i përvetësojnë më shumë udhëzimet e shokëve dhe bashkëmoshatarëve (Köylü, 2000: 2).

Sikurse u theksua më lart, cilësitë morale të grupit shoqëror ndikojnë pozitivisht ose negativisht në formimin moral të fëmijës. Në formë të identifikimit me anëtarët e grupit, fëmija përvetëson sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Nëse cilësitë morale të grupit janë të mira, morali i fëmijës zhvillohet pozitivisht. Nëse grupi përmban cilësi të moralit të keq, është e pashmangshme që fëmija të mos jetë i prirur për të kryer faje, të përdorë drogë, të kryejë vjedhje, etj. (Tarhan, 2002: 105).

2.7.2.4. Shkolla

Arsimi ushqehet nga burime të ndryshme. Familja, grupet shoqërore, shkollat dhe mjetet e komunikimit masiv janë disa prej këtyre faktorëve. Ndër to, familja dhe shkolla zënë një vend të veçantë në jetën e fëmijëve. Që nga krijimi i tij njeriu është një qenie që edukohet. *Edukimi është procesi gjatë të cilit sjellja e një individ zhvillohet me anë të eksperiencës dhe me anë të dëshirës së vetë individit.* Qëllimi i edukimit: transmetimi i aftësive dhe njohurive të caktuara të individit, zhvillimi i sjelljeve dhe gjykimit të vlerave (Ertürk, 1982: 12).

Edukimi është njëri nga faktorët e rëndësishëm që ndikon zhvillimin moral të individit. Individu fillon jetën e shkollës me karakteristikat dhe ndjenjat e fituara në familje deri në moshën shtatëvjeçare, siç janë: mendimet, gjykimet, njohuritë, aftësitë dhe zakonet. Ndërsa në shkollë, duke u përballur me gjëra të reja dhe të ndryshme, çdo ditë me shokët dhe mësuesit, fiton dhe zhvillon karakteristika të ndryshme. *Ndikimi i edukimit në zhvillimin moral nuk shqyrtohet vetëm nga arsimtarët modernë por edhe ato klasikë.* Për shembull: *një arsimtar islam, Ibn Miskeveyh* shprehet kështu për edukimin dhe lidhjen e tij me moralin: njerëzit nga pikëpamja e karakteristikave morale nuk janë në të njëjtin nivel. Disa janë mirë, disa janë keq, disa janë të urtë e disa janë të zemëruar. Në mesin e atyre që kanë këto karakteristika ka shumë njerëz të rregullt. *Ato që mbartin nga lindja janë, zemërimi, kënaqësia, nervozizmi, pangopësia e të ngjashme me këto.* Duke neglizhuar zakonet e këqija, njeriu i pa trajnuar, rritet në gjendjen aktuale dhe gjatë gjithë jetës e ruan këtë gjendje. Ndërveprimi ndikues i karakteristikave të individëve dhe faktorët e mjedisit, të dyja këto duke i integruar me edukimin dhe përmbledhur në të marrin formën e

dëshiruar. Karakteristika të tilla morale si: *e mira, e keqja, e drejta, e gabuara*, mund të ndryshohen dhe zhvillohen vetëm me edukim, për ndryshe mund të spastrohen ose mtrashen dalëngadalë (Bilgin, 1998: 31).

Personaliteti i mësuesit e qëndrimet e tij karshi nxënësve pasqyrohen tek personaliteti i nxënësve. Nxënësit duke marrë si shembull mësuesin mundohen të identifikohen me të. *Për këtë arsye sjelljet e qëndrueshme dhe të ekuilibruara të mësuesit, me drejtësinë dhe dashurinë e treguar ndaj nxënësve, ndikon tek ata: sjelljen e zellshme e padurimin, por duke u përpjekur të sigurojë disiplinën në klasë mund të lerë ndikim negativ tek nxënësit. Një e vërtetë e madhe është se: **personi që jep bazat e dashurisë në mjedisin e përbashkët, nuk bën vetë padrejtësi.** Duke kritikuar padrejtësitë siguron zhvillimin e një ndërgjegje të ndjeshme tek nxënësit, nuk përdor fjalë të këqija, fyese apo poshtëruese. Një mësues në mënyrë të tillë u përçon nxënësve karakteristika pozitive, orienton zhvillimin e personaliteti të tyre në drejtimin pozitiv (Peker, 1994: 60-61).*

Lawrence Kohlberg, thekson: për të kontribuar në zhvillimin moral të nxënësve, arsimtarët duhet të dinë të edukojnë nivelin e zhvillimit moral. Sipas tij, materialet e përdorura në edukimin moral, duhet të përmbajnë mesazhe të përshtatshme sipas moshës së nxënësve. Por në të njëjtën kohë, mesazhi duhet të jetë një shkallë më lart nga niveli i zhvillimit në të cilin ndodhet nxënësi, që nxënësi të mundet të rritet në një nivel më të lartë.

Qëllimi i edukimit moral është arritja e individit të bëj gjykime mbi moralin. Çdo individ, duhet të jetë në gjendje të japë gjykimin e tij moral në formën e mendimit të lirë (Akarsu, 1982: 18).

Fëmijët dhe të rinjtë në shkolla duke përfitur njohuri në fusha të ndryshme në të njëjtën kohë përfitojnë edhe disa përvoja të reja. Ata mësojnë si të kenë marrëdhënie me njerëz të ndryshëm, përshtatjen me grup, sakrificat që kërkon jeta në shoqëri, tregojnë respekt ndaj mendimeve e të drejtave të të tjerëve. Atmosfera sociale në shkollë, niveli i drejtësisë që zotëron, ndikojnë në zhvillimin moral të fëmijës. *Në edukimin familjar e shoqëror përveç sjelljeve të mira mund të fitohen dhe sjellje të padëshiruara.* Përkrah edukimit shoqëror, me kalimin e kohës janë ndërtuar institucione të arsimit të planifikuar dhe programuar. Kur fëmija del nga familja, që është i vetmi institucion i socializimit të tij, njihet me një tjetër institucion social, shkollën (Akbaş, 2004: 27).

Edukimi i nxënësve me rregullat e sjelljes, vlerat shoqërore dhe kontributet në zhvillimin moral të tyre janë funksionet më të rëndësishme të shkollës. Në shkollë nxënësi, përveç të mësuarit konjitiv, mëson edhe respektin, mirëkuptimin, solidarizimin, etj. *Kerschenstainer*, i quan shkollat e sotme **“shkolla të librit”**, mbron idenë se shkollat kontribuojnë në një masë të caktuar në zhvillimin moral të fëmijëve (Kerschenstainer, 1977: 108).

Sipas *Halstead dhe Taylor*, shkolla u njeh dhe transmeton nxënësve vlerat ekzistuese të moralit, por bën të mundur edhe ndërtimin e vlerave të veta mbi to. Aktori më i rëndësishëm i zhvillimit moral në shkolla është mësuesi. Veçanërisht, ata ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e vlerave morale, por njëkohësisht kanë ndikim mbi ta. Nëse mësuesi është i drejtë dhe shfaq cilësi të personalitetit të mirë, kjo pasqyrohet pozitivisht edhe tek fëmijët (Halstead dhe Taylor, 2000: 169).

Shkolla kërkon nga çdo fëmijë që të zbatojë rregulla të caktuara e të mësojnë. Në këtë aspekt, ajo luan një rol të rëndësishëm në përfitimin e sjelljeve pozitive, si: *përgjegjshmëria, durimi dhe drejtësia*. Në të njëjtën kohë, shkolla u mëson fëmijëve aftësinë e të menduarit rreth vlerave morale e bën që ngjarjet e jetës t'i shohin nga dritarja e respektit, dashurisë dhe mëshirës (Kerschenstainer, 1977: 111).

2.7.2.5. Mjetet e komunikimit masiv

Në ditët e sotme, ndikimi i familjes dhe shkollës mbi sjelljet dhe qëndrimet e fëmijëve është më i ulët në krahasim me të shkuarën. Në botën e globalizuar, vendin e tyre po e zë me shpejtësi interneti dhe mjetet e komunikimit masiv. *Mjetet e komunikimit masiv dhe media janë mjetet, si: televizioni, radioja, interneti, gazetat dhe revistat, të cilat përdoren për të argëtuar masat, për t'i informuar dhe orientuar ata duke u përçuar lajme, informacione e mesazhe*. Njerëzit, nevojën e tyre për informacion e përballojnë lehtësisht me anë të mediave sociale, si televizioni dhe interneti e arrijnë të lidhen me to në to në çdo skaj të botës.

Dewey shprehet se ka diferenca të mëdha mes vlerave që iu mësohen brezave të rinj në shtëpi e shkollë dhe atyre që iu ofrohen në botën e jashtme, si rezultati i këtyre ka negativitete të shumta si, mbetja ballë për ballë me tëhuajësimin dhe erozionin e vlerave shoqërore. Nuk mund të ketë rregulla të sjelljes së ndryshe në shkollë, shtëpi apo mjedise të tjera. Sikurse sjellja është një, edhe rregullat e sjelljes duhet të jenë të njëjta (Dewey, 1976: 118).

Televizioni i drejtohet edhe syrit edhe veshit dhe për këtë arsye është më efektiv ndërmjetet e komunikimit masiv. Kurse radioja, duke qënë se është një mjet komunikimi që ndikon vetëm në vesh, nuk është ndikues sa televizioni. Ndërkohë që mjetet e komunikimit të shtypit siç janë gazetatat, revistat dhe libri ndikojnë syrin me anë të figurave e shkrimeve. *Mjetet e komunikimit masiv kanë një ndikim të gjerë tek njerëzit.* Sistemi i besimit ka fituar vlera gjykimi në shoqëri, duke bërë që të hiqet nga mjetet e komunikimit masiv në një kohë të shkurtër , e në vend të tyre të vendoseshin gjykime të reja për vlerat. Megjithatë, këto mjete nuk janë zotërueset e vetme të një ndikimi të madh. Shkalla e ndikimi të këtyre mjeteve është e varur nga marrëdhëniet sociale, formimi kulturor dhe besimi i shoqërisë (Doğan, 1991: 634).

Mediat masive luajnë një rol kryesor në formimin e opinionit publik, ato janë përçues të mendimit dhe besimit. Duke përsëritur vazhdimisht të njëjten gjë ato çrrënjisin mendimin, duke futur në mënyrë automatike gjykime dhe mendime të reja, nga ngjarjet e përditshme bëjnë që të humbë besimi duke përcjellë informacion të reja. Pavarësisht kësaj, individët, të cilët i kanë përvetësuar plotësisht normat dhe vlerat, nuk i ndryshojnë lehtë mendimet dhe gjykimet, nuk ndikohen, por kanë një lloj pavarësie nga mjetet e komunikimit masiv (İnceoğlu, 2000: 154).

Mjetet e komunikimit masiv, duke zgjedhur mjete të lehta e të thjeshta, përcjellin informacione të sakta vlerash në një kohë të shkurtër dhe i imponojnë shoqërisë vlerat e veta. Veçanërisht, televizioni luan një rol të rëndësishëm në përcjelljen e vlerave dhe informacioneve të dobishme brezit të ri, në socializimin e individëve dhe rritjen e unitetit social (Yılmaz, 2001: 80).

Duke filluar nga foshnjëria e vazhduar më tej në fëmijëri, një pjesë e mirë e fëmijëve e ndajnë kohën e tyre me televizionin. *Televizioni, tashmë, ka dalë nga të qenurit një mjet argëtimi për fëmijët, ai është kthyer në një mjet që ka zvogëluar ndjeshëm ndikimin e familjes tek fëmija.* Fëmijët fillojnë që dy vjeç të shohin çfarë shfaqet në televizor, kurse në moshën tre vjeçare zgjedhin vetë se çfarë të ndjekin dhe shikojnë. Fëmijët, shumë sjellje që nuk i kanë provuar i mësojnë nëpërmjet shikimit në televizion. Sado ndikime pozitive të ketë televizioni, ai ndikon negativisht në zhvillimin social të fëmijës (Yavuzer, 1992: 234).

Teoricienët e mësimit social tregojnë se fëmijëve që u tregohet një model agresiv, sjelljen agresive të modelit e përgjithësojnë në sjellje të tjera, kështu që si përfundim shfaqin reagime agresive. *Hulumtimet dhe eksperimentet tregojnë se sjelljet agresive të fëmijëve janë pasojë e imitimit të prindërve dhe i modeleve agresive parë në mediat masive, dhe si rezultat i kanë përvetësuar ato.* Ndërkohë, që, sipas disa studimeve të bëra me këtë temë, fëmijët që shikojnë skena agresive në filmat e shfaqur në televizor, janë shumë më agresivë se sa fëmijët që nuk shohin skena të tilla. Si përfundim, fëmijët që shikojnë dhunë dhe vrasje në filma, shfaqin sjellje më shumë agresive se të tjerët. Ky lloj programi televiziv i brenë dhe shkatërron mendimet dhe sjelljet morale, kështu që rrezikon të ardhmen e shoqërisë, bëhet shkak për vrazhdësi në sjelljet shoqërore të njerëzve (Yavuzer, 1992: 235).

Transmetimet televizive padyshim kanë një rëndësi të madhe në ndikimin ndaj fëmijëve. Me programet e përshtatme ato zhvillojnë dhe përforcojnë sjellje dhe mendime të larta morale tek fëmijët. Programet, të cilat mund të konsiderohen jo të përshtatshëm, duhen të kontrollohen në mënyrë që mos të transmetojnë tek fëmijët sjellje dhe mendime morale të këqija. Për këtë arsye *në vend të programeve apo filmave që kanë përmbajtje të*

dyshimta, me pije alkoolike, cigare, abuzime seksuale, apo me skena të rënda dhune, të vendosen programe që transmetojnë dashuri, mëshirë, dhembshuri, drejtësi, dashamirësi e trimëri. Kur fëmijës i paraqitet edhe e mira edhe e keqja, atëherë fëmija duhet të zgjedhë vetë midisi tyre. Megjithatë disa programe të fëmijëve u transmetojnë atyre vlera të shoqërisë. Sado që televizioni të ketë ndikim pozitiv, për arsye se shkakton dëme brenda familjes, ka ndikim negativ në zhvillimin social të fëmijës (Yavuzer, 1992: 234).

Njëra nga mënyrat e të mësuarit të fëmijëve është vëzhgimi, imitimi apo të marrurit shembull. Në krahasim me të rriturit, të rinjtë, në veçanti fëmijët, janë më të gatshëm për të mësuar. ***Sjelljet agresive dhe të dhunshme janë më të imitueshme*** (Sander, 1997: 72).

Ndërsa Kerr, kur vë theksin tek ndikimi i televizionit, shprehet se ai formon sjelljen e të rinjve dhe fëmijëve, ndikon në pikëpamjen e tyre për botën më shumë se familja dhe shkolla (Kerr, 1996: 143).

2.7.2.6. Ekonomia

Ekonomia nuk është vetëm mallra, xhirim parash, institucione dhe grumbullimi i informacioneve të jashtme. Ekonomia është një gurë themeli i rëndësishëm, që i jep formë pikëpamjes së njerëzve për të njohur botën (Ülgener, 1983: 17).

Ekonomia merret me çështje të tilla si, *prodhimi, konsumi, zhvillimi, rritja, dhe punësimi*. Qëllimi i ekonomisë është prodhimi në nivelin më të lartë të mundshëm, vendosja e ekulibrit të ofertës dhe kërkesës në treg, rritja e fuqisë punëtore, mundësimi i

objekteve ekzistuese, të përformojë në mënyrën më të mirë më qëllim rritjen e të ardhurave, e si përfundim, sigurim të barazisë për qyterarët e një vendi (Ülgener, 1983: 17).

Për të pasur një zhvillim të mirë ekonomik, është i rëndësishëm trajnimi dhe kualifikimi i forcës punëtore në masën e duhur dhe të nevojshme. Kjo njihet si një politikë efikase në zhvillimin e sotëm nga të gjitha shoqëritë. *Zotërimi i njohurive dhe aftësive të mira teknike rrit produktivitetin e njeriut e në të njëjtën kohë ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit.* Megjithatë, nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, vlerat kulturore dhe morale po humbasin, individualiteti vendoset në plan të parë, si pasojë individualiteti përkeqëson solidaritetin, si përfundim shfaqet depresioni tek njerëzit dhe shoqëritë. Në këtë aspekt, vetëm zhvillimi ekonomik nuk është i mjaftueshëm për lumturinë dhe qetësinë e individëve në shoqëri. Sipas *Demir*, ekonomia dhe morali janë elementë që kanë ndikim reciprok tek njëri-tjetri. Njëkohësisht, ekonomia kontribuon në zhvillimin e normave të moralit ose në formimin e sjelljeve të pamoralshme (Demir, 2003: 228).

Në veçanti, problemet ekonomike ndikojnë në zhvillimin moral të individëve. Problemi më i rëndësishëm në këtë çështje është papunësia. *Papunësia nuk mjaftohet duke ndikuar vetëm me rënien e nivelit të të ardhurave dhe mirëqenies së popullit, por njëkohësisht shkakton probleme shëndetësore, çrregullime në marrëdhëniet sociale dhe morale të jetës shoqërore e familjare.* Me shfaqjen e problemeve të shkaktuara nga papunësia, fillojnë trazirat sociale, plaçkitjet, dhuna, vetëvrasjet dhe sjelljet e pamoralshme (Çavdar, 1983: 173).

Një ndër fushat e ekonomisë ku vlerat morale kanë ndikim është punësimi. Punësimi është përdorimi i të gjithë faktorëve të prodhimit, që do të thotë gjetja e punës për të gjithë ata që janë në kërkim të një pune. Mbetja pa punë e atyre që duan të punojnë, përbën një problem kryesor individual dhe shoqëror. Individit i pa punë dhe familja e tij janë të detyruar të jetojnë nën standartet e shoqërisë dhe standartet e jetesës. *Papunësia është një shqetësim kalimtarë, por që bëhet shqetësim social.* Papunësia bëhet shkak i ushqyerjes së keqe, mundësi të ulëta edukimi, jetesë në kushte të ulëta shëndetësore, si pasojë bëhet shkak i përjetimeve të rënda psikologjike. Në një shoqëri ku papunësia është e lartë, është e pamundur që edhe ata që kanë punë të jetojnë në qetësi. Në një shoqëri apo tek një individ, ku nuk plotësohen nevojat fizike nuk mund të pritet përmirësim dhe zhvillim moral. Pa përparimin moral as burimet ekonomike nuk mund të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme (Şahin, 2002: 526).

Zhvillimi i aftësive morale të të rinjve e fëmijëve si dhe sigurimi i rritjes shoqërore bëhet i mundur përmes mundësive ekonomike. Për këtë arsye, arritja e gjithë segmenteve të shoqërisë në nivel të përshtatshëm socio-ekonomik, duhet që të gjithë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga shërbimet e edukimit me qëllim zhvillimin socio-kulturor, kështu që aktivitetet duhet të jenë të arritshme nga të gjitha segmentet e shoqërisë.

2.7.2.7. Kultura

Një nga faktorët që ndikon në zhvillimin moral është kultura. Zhvillimi moral dinamikat themelore i merr prej kulturës. *Kultura është mënyra e jetesës së një individi apo shoqërie bazuar tek zakonet, traditat, prejardhja, si dhe sjelljet e besimit në përgjithësi.*

Kultura është gjithë mënyra e jetesës së një shoqërie si dhe trashëgimia sociale e transmetuar nga njëri brez tek tjetri. Sipas *E.B.Tylor* kultura është një tërësi komplekse e aftësive dhe zakoneve që një anëtar i shoqërisë apo njerëzimi ka mësuar dhe fituar përmes traditës, zanatit, etj. (Acar, 1997: 133).

Njeriu jeton brenda vlerave dhe traditave që përmban mjedisi kulturor në të cilën gjendet, ai jeton brenda kësaj kulture. *Morali është pranuar në mjedisin e një kulture, është identifikuar dhe njohur me qëllim arritjen e objektivave në bazë të rregullave të vendosura.* Jashtë kësaj, qëllimet dhe rregullat kulturore, dikë e orientojnë për një kohë të caktuar, dikë tjetër e bëjnë që t'i përvetësojë këto rregulla e qëllime, duke i bërë të vetat dhe përdorur si rregulla të vetat. Ndërkohë që pas kësaj individi, zhvillon një qëndrim kritik e duke i kritikuar rregullat i përmirëson ato. Në këtë pikë individi vjen në formën e tij të pavarur (Cevizci, 1999: 19).

Njerëzit edhe pse mund të jenë internacionalizuar dhe asimiluar nuk heqin dorë nga vlerat sociale dhe morale edhe në kushtet më të pafavorshme. Vlerat, nga natyra e tyre e përgjithshme, përmbajnë vlera universale dhe besime morale. Pothuajse kudo, vrasja e një njeriu apo vjedhja janë të këqija, ndërsa drejtësia, dashamirësia dhe ndershmëria janë të mira. Shohim që kultura është një fushë dhe koncept që përfshin vlera. *Vlerat kulturore, i afrohen një individi si model ideal, se si ai duhet të sillet në shoqëri.* Vlerat dhe shembujt e sjelljes së kulturuar në shoqëri u transmetohen anëtarëve të rinj të shoqërisë nëpërmjet arsimit (Tezcan, 1996: 66).

2.7.3. Faktorët psikologjikë

Një nga faktorët themelor që ndikon moralin janë shkaqet psikologjike. Duke filluar nga përbërja e individit, mund të numërohen të gjithë faktorët që ndikojnë, të gjitha ndjenjat dhe mendimet morale. Ato mund t'i rendisim si më poshtë:

2.7.3.1. Identifikimi

Koncepti i identifikimit është një koncept që vjen nga psiko-analiza, në teorinë e *Frojdit* merr një rol të rëndësishëm. Identifikimi në konceptin psikonalitik, janë karakteristikat e bëra pa vetëdije, siç mund të jenë: ndjenjat e një personi ndaj një tjetri, mendimet, qëndrimet dhe sjelljet. *Fëmijët duke u rritur fillojnë t'iu ngjajnë natyrave të prindërve në qëndrime dhe sjellje.* Janë disa ngjashmëri habitëse midis prindërve dhe fëmijëve, siç janë mënyra e ecjes, mënyra e të folurit apo gjeste të tjera. Fëmijët dhe të rinjtë, duke përsëritur të njëjtën sjellje dhe qëndrim me prindërit, mendojnë se përthithin një pjesë të pushtetit dhe kompetencave të tyre (Atkinson, 1995: 114).

2.7.3.2. Empatia

Empati është aftësia e individit të vendosë veten në vendin e të tjerëve, është njohja sociale midis meje dhe rreth meje. Zhvillimi social i individit, është shtypja e tendencave vetjake apo individuale, duke mundësuar kështu shfaqjen e ndjenjës së komunitetit. *Identifikimi i vetes me të tjerët dhe integrimi me të tjerët quhet empati.* Kësaj ndjenje i referohemi me “ne”. Falë kësaj ndjenje, ndërkombëtarizohen mesimet shoqërore, vlerat si dhe bashkohen qëllimet (Ergil, 1994: 21). Aftësia e ndërtimit të empatisë shikohet kur,

individit bazuar tek pjekuria e tij morale arrinë ta marrë atë në nivele më të larta (Kohlberg, 1969:398). Falë aftësisë së empatisë, individit, arrinë të kuptojë ndjenjat, mendimet, nevojat, gjykimet e të tjerëve, duke e vendosur veten në vendin e të tjerëve, mund të veprojë si ata duke menduar ashtu, i pranon të tjerët ashtu siç janë dhe tregon respekt ndaj veprimeve të tyre.

2.7.3.3. Ndërgjegjia-vetëdija morale

Ndërgjegjia është përpjekja për të gjetur një gjykim mbi veprimet e njeriut, fuqia për të siguruar gjykime morale bazuar tek vlerat e vetë njeriut. Vetëdija morale gjithashtu përfshihet apo quhet ndërgjegjje, aftësia për të refuzuar çdo sjellje apo mendim të keq me arsye, udhëhequr nga e brendshmjia dhe pa e sforcuar veten (Freud, 1996: 98). Teoritë morale themelojnë ndërgjegjien e njeriut. Njeriu falë ndërgjegjies arrin të diferencojë të mirën nga e keqja.

2.7.3.4. Ndërgjegjia

Ajo është një nga sjelljet e ndryshme të njeriut, fuqia për të bërë zgjedhje e marrë vendime me anën e një përpjekje të caktuar. Dikush, që ecën i bazuar në drejtimin e të tjerëve, duhet të sillet moralisht bazuar tek drejtësia e ndërgjegjes së tij? Përgjigjja e kësaj pyetje është e rëndësishme. Pasi morali i një individit, nga e drejta tek një e drejtë tjetër është pikërisht mbizotërimi i ndërgjegjes së tij të lirë. *Sjellja morale është një sjellje që realizohet përmes ndërgjegjes së lirë.* Çdo individ i lirë, dëshiron t'i kontrollojë vetë ndjenjat, mendimet, gjykimet, qëndrimet dhe sjelljet e tij (Akarsu, 1982: 206). Për të folur për përgjegjësitë morale duhet që sjelljet e lira të realizohen si rezultat i ndërgjegjes. Sepse

morali e bën të përgjegjshëm. Për këtë arsye, ndërgjegjia e një njeriu të lirë, nuk është e mundur pa pasur qëndrime të përgjegjshme si rezultat i sjelljeve jashtë ndërgjegjies.

2.7.3.5. Personaliteti

Personaliteti është mënyra e të menduarit dhe e sjelljes së individit në përshtajte me mjedisin, por me karakteristika dalluese (Atkinson, 1995: 523). Personaliteti është kompleks i karakteristikave që e dallojnë një individ nga një tjetër, ku mund të hyjnë: interesat, qëndrimet, aftësitë, mënyra e të folurit, pamja e jashtme dhe mënyra e përshtatjes me mjedisin. Personaliteti i përvetëson të gjitha veçoritë fizike, mendore, ndjesore, sociale dhe morale (Binbaşoğlu, 1978: 212). *Personaliteti i një individ është përbërja dalluese e kompleksit të karakteristikave biologjike, psikologjike dhe sociale, të cilat duke u bashkuar realizojnë individin e lirë e të dallueshëm nga të tjerët.* Në përbërjen e personalitetit, një rol të rëndësishëm luan edhe mjedisi.

2.7.3.6. Zakonet, temperamentit

Zakonet dhe temperamentit, janë tregues të reagimit që jepet kundrejt ngjarjeve dhe situatave. Këto janë ndjenja që vijnë nga lindja dhe me zhvillimin e njeriut bashkohen sëbashku (Demir dhe Acar, 1997: 133). Janë tërësia e faktorëve biologjikë dhe ndjesorë të formuar nga personaliteti. Sipas përjetimeve ndjesore parë tek individ, njerëzit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Reagimet ndjesore të bëra nga njeriu shpjegohen me anë të fjalëve, zakoneve dhe temperamentit. Ka disa anë të reagimeve emocionale të cilat nuk mund të ndryshojnë. Kësaj i referohemi si temperamentit. Temperamentit është mënyra karakteristike e përjetimit emocional që e dallon një individ nga një tjetër. *Temperamentit i*

njeriut, përfshin ndikimin e gjesteve të trupit që shoqërojnë mënyrën e sjelljes dhe përjetimit. Reagimi hormonal u hap rrugë gjendjeve të tilla si, lekundjes shpirtërore, shqetësimit, prejkses së shpejtë, nxehtë, zemërimit, bezdisjes dhe mungesës së rehatisë. Është parë se temperamenti dhe qëndrimi ndikohen edhe nga sëmundjet (Baymur, 1994: 86–87).

2.8. Çfarë është vlera?

Ndryshimet e shpejta në shoqëritë e sotme ndikojnë edhe tek njeriu, i cili është anëtar i shoqërisë. Vlerat e shoqërisë ndryshojnë paralelisht bashkë me botën. Pavarësisht se deri më sot për konceptin e vlerës janë bërë diskutime të shumta për pikëpamje të ndryshme, si shkencore ashtu edhe filozofike, nuk është arritur në një konkluzion përfundimtar, se çfarë realisht përmbajnë këto vlera? Në përkufizimin e tij, *Fitcher* (1996: 143) thotë: vlerat janë “*masa që i japin kuptim shoqërisë*”, ndërsa *Theodorson*, (1979: 6) i përkufizon si “*rregulla të përgjithshme sjelljeje për të cilat ka vendosur shoqëria*”. Ato kryesisht kanë theksuar veçoritë orientuese të vlerës. Edhe *Supurka* dhe *Johnson* (1975: VII) bëjnë një përkufizim të ngjashëm, ku e shpjegojnë si një bukuri që orienton sjelljet e njerëzve

Ndërkohë që *Williams* duke iu referuar mjedisit kulturor që zhvillon vlerat shprehet: “*vlerat, janë standarte, anëtare të kulturës që përcaktojnë dhe dallojnë se çfarë është e mirë e çfarë është e keqe, çfarë duhet e çfarë jo, apo se çfarë është e bukur e çfarë jo*” (Williams, 1979: 27).

Vlera kryen një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore. Ajo u tregon njerëzve rrugën e sjelljes së tyre. Vlera ka të bëjë me përgjigjet e pyetjeve si “*çfarë është ndryshimi mes të*

drejtës dhe të gabuarës” dhe “*çfarë është kuptimi i jetës*”. Njeriu krijon vlerat e tij personale gjatë jetës në komunitet. Këto vlera, marrin formë nga kultura shoqërore (Bradshaw, 2001: 23). Vlerat që shfaqin shoqëritë zhvillohen përgjatë shekujve. Ato ndryshojnë nga personi në person dhe nga komuniteti në komunitet (Hitlin, 2004: 89). Një tjetër veçori e vlerave, është se ato janë fenomene që mësohen. Në ditët e sotme vlerat çmohen. Në fushën e arsimit bëhen studime të ndryshme për të gjetur rrugën e duhur për përcimin e tyre tek brezat e ardhëm. Hartohen projekte për të bërë të mundur, si mund t’iu përcillen fëmijëve në moshë të hershme çështje, si: *respekti, dashuria, ndarja, mirëkuptimi dhe largimi nga dhuna*. Por sikurse u theksua edhe më sipër, edhe pse vlerat mësohen, në kuptimin e plotë ato mësohen duke i përjetuar (Dökmen, 2000: 29).

Edhe pse mendohet se edukimi fillon në familje, prindërit e sotëm e kanë më të vështirë në krahasim me prindërit në të shkuarën. Në të shkuarën, vlerat e shoqërisë u përcilleshin fëmijëve me anë të mënyrës së jetesës, por ditëve të sotme kjo nuk është e mjaftueshme, pasi lypset edhe përkushtimi me vetëdije të plotë. Edhe pse vlerat ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën, në periudha të caktuara kohore nga shoqëritë, vlerësohen dhe lëvdohen më shumë disa sjellje. Shembuj mund të jenë sjellje, si: *drejtësia, respekti dhe miqësia*.

Nga pikëpamja sociologjike, vlera është besimi te rregullat e përgjithshme që pasqyrojnë mendimin dhe qëllimin e përbashkët, që janë pranuar nga njerëzit si të mirëqena dhe të nevojshme për vijimësinë e shoqërisë. Parë nga aspekti shoqëror, vlerat janë standardet themelore që përcaktojnë të nevojshmen dhe të panevojshmen, të drejtën dhe të gabuarën (Özlem, 2002: 36).

Sipas *Fichter (1990)*, funksionet dhe standardet e përgjithshme të vlerave janë:

1. Përcaktojnë vlerën sociale të njeriut dhe shoqërisë.
2. Tërheqin vëmendjen e njerëzve mbi kulturën materiale që duket e rëndësishme.
3. Shigjeton rrugët e sjelljes ideale në çdo shoqëri.
4. Udhëheq njerëzit në përzgjedhjen e roleve socialë.
5. Janë mjete të kontrollit shoqëror.
6. Luajnë rol si mjete solidarizimi në shoqëri.

Nisur nga vecoritë mbi të cilat shumë teoricionë kanë arritur konsensus, *Schwartz dhe Bilsky (1987: 26)*, i rendisin vlerat si mëposhtë:

1. Vlerat janë besimet. Por nuk janë ide plotësisht të pastra nga ndjenjat.
2. Vlerat kanë të bëjnë me qëllimet dhe sjelljet e njeriut për të arritur synimet që ka.
3. Vlerat janë mbi sjelljet dhe qëndrimet.
4. Vlerat orientojnë zgjedhjen dhe ndryshimin e besimeve.

Vlerat klasifikohen ndërmjet tyre sipas rëndësisë që mbartin. Shumë studiues vlerën e përcaktojnë si besimi i vërtetë që ndodhet brendashkruar mendimeve të njeriut ku ai vepron. Për këtë arsye, vlera u tregon rrugën veprave dhe sjelljeve të njeriut. Në një shprehje tjetër ajo sqaron se njeriu është zotëruesi i atyre që bën dhe si i bën. Nga kjo

pikëpamje, shihet se një pjesë e madhe e sjelljeve të njeriut formësohet nga vlerat. Kështu që, *vlera është mjete bazë që luan rol në rregullin e bashkëpunimit të individit, ndikon fuqinë zgjedhëse dhe artikulumin e njohurive, bën të dukshme fushat e vizionit, bërjen e zgjedhjeve midis alternativave, dhënien e vendimeve, zgjidhjen e problemeve e shqetësimeve* (Schwartz, 1992: 23). Vlerat luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin dhe orientimin e qëndrimeve dhe sjelljeve për të cilat është përgjegjës njeriu.

2.8.1. Klasifikimi i vlerave

Vlerat, sikurse kanë përkufizime të ndryshme, po ashtu kanë edhe klasifikime. Në studimet e kryera, vlerat janë shqyrtuar duke u klasifikuar sipas llojeve. *Allport, Vernon dhe Lindzey* (1960), i kanë shqyrtuar ato në gjashtë kategori si: *estetike, shkencore, ekonomike, politike, sociale dhe fetare*. Sipas *Morris*, gjenden tre lloje vlerash: *“Vlerat Faal”*, që transmeton dëshirat e njeriut dhe ndikimin e vlerave tek individit. *“Vlerat e Konceptuara”*, që janë vlera normative, të përhapura në shoqëri e të pranuar e të konceptuara nga të gjitha kulturat. *“Vlerat e Qëllimit”*, që janë rezultati i shtuar ndaj një ngjarjeje apo teme, duke qënë të pavaruar nga standartet normative dhe zgjedhejt e individit (Bilsky dhe Koch, 2000: 3).

Në lidhje me këtë temë, klasifikimi më i përdorur është ai i zhvilluar në vitin 1973 nga *M. Rokeach*. Në këtë klasifikim vlerat ndahen në dy kategori: *“Vlerat Terminale”*, përfaqësuese të vlerave që duhen marrë parasysh dhe që shihen si të nevojshme, dhe *“Vlerat instrumentale”* (Güngör, 1993: 61).

Vlerat formësojnë sjelljet morale, fetare dhe estetike të njerëzve. Për sa kohë njerëzit e vlerësojnë diçka, ajo shihet si diçka me vlerë në shoqëri. Parë në këtë aspekt, vërehet në shekuj një konflikt mbi mendimet se vlerat janë universale e se ato nuk ndryshojnë sipas kushteve. Por *vlerat ndikohen nga procesi i ndikimit reciprok të njeriut dhe shoqërisë*. P.sh., të qenit të fesë në qendër të shoqërisë, bën të mundur që feja të jetë burim i vlerave të larta. Nëse pozicioni qendror i fesë në shoqëri ndryshon, do të ndryshojnë vlerat dhe sjelljet (Topcuoğlu, 1999: 49).

Kur thua “vlerat” nuk bëjmë fjalë për një tërësi gjykimesh. Vlerat mund t’i ndajmë edhe sipas lidhjes që kanë me moralin: në vlera që kanë lidhje me moralin dhe në vlera që nuk kanë lidhje me moralin. Vlerat e lidhura me moralin bëjnë të njohur vështirësitë, na tregojnë se çfarë duhet të bëjmë. Vlerat që nuk kanë lidhje me moralin nuk kanë karaktersitika të tilla urdhëruese. Këto janë më tepër vlera të zgjedhjes njerëzore. Vlerat e lidhura me moralin ndahen gjithashtu në dy grupe: *vlerat universale* dhe *jo universale*. Ato që janë universale janë pranuar si konkluzion i përbashkët i njerëzve. Këto mund të bëhen shembull i teorive universale për të drejtat e njeriut (Lickona, 1991: 38). Ardhja e vlerave në një gjendje të tillë universale ndodh si pasojë e një kulture të caktuar, apo dhe nga një individ, ato kanë tendencën të pranohen në mënyrë të përgjithshme.

Përpos kësaj, mund t’i klasifikojmë edhe si vlera themelore dhe vlerat ndërmjetëse. Vlerat themelore ndahen në dy: *vlera personale* dhe *vlera shoqërore*. Në klasifikimin e vlerave shoqërore masa është që ato të jenë unike për individin dhe shoqërinë. P.sh., një botë në paqe dhe vëllazëri. Edhe vlerat morale mund t’i ndajmë në dy: *morale* dhe *aftësisë*. Vlerat morale kanë të bëjnë me sjelljet si drejtësia dhe përgjegjësia. Vlerat e llojeve të tjera

janë vazhdimisht në një marrëdhënie me vlerat morale. P.sh., respektimi i mendimit të tjetrit është nevojë shkencore dhe morale (Güngör, 1993: 39).

Ndërkohë që *Spranger* bën një klasifikim më ndarës sipas drejtimit të vlerave të dikujt, ai i klasifikon ato në **këto grupe**: *institucionale, ekonomike, estetike, sociale, politike dhe fetare* (Özgüven, 2003: 368).

Në përgjithësi vlerat mund t'i grupojmë në këtë mënyrë (Özlem, 2002: 90):

- 1.- Vlerat e kënaqësisë (**hedoniste**). (pozitive-kënaqësi, negative- dhimbje)
- 2.-Vlerat informative. (pozitive-e drejtë, negative-gabim)
- 3.- Vlerat morale. (pozitive-e mirë, negative-e keqe)
- 4.- Vlerat estetike. (pozitive-e bukur, negative-e shëmtuar)
- 5.-Vlerat fetare. (pozitive-shpërblime, negative-mëkate)

Tabela II.1 Ky klasifikim i vlerave tregohet në tabelën e mëposhtme

Vlerat terminale		Vlerat universale	
Një jetë e rehatshme	Qetësia e brendshme	Amicioz/i gatshëm	Forcë imagjinare
Një jetë emocionuese	Dashuria e vërtet	Horizonti i gjerë	Pavarësi
Ndjenja e suksesit	Siguria kombëtare	I talentuar	Intelektual
Një botë në paqe	Kënaqësia	I qeshur	I llogjikshëm
Bota e bukurisë	Shpëtimi	I pastër	I mbushur me dashuri
Barazia	Respekti për veten	Guximtar	Besnik
Besimi familjar	Njohja sociale	Falës	I sjellshëm
Liria	Miqësia e vërtetë	Dashamirës	I përgjegjshëm
Lumturia	Urtësi/Mençuri	I ndershëm	I vetkontrolluar

(Rokeach, 1973: 28).

2.8.2. Mësimi i vlerave

Nga pikëpamja e njeriut, pyetjes se çfarë duhet të jetë fundi i edukimit, është një nga temat e rëndësishme më shumë të diskutuara nga studiuesit. Në këto diskutime tre pika dalin në planë të parë: *zhvillimi i kapacitetit mendues e logjik të njeriut, forcimi i orientimit të ndjenjave dhe stërvitja e trupit*. Vazhdimi i jetës së njeriut në mënyrë të shëndetshme dhe realizimi me sukses i punëve të ndryshme, stërvitja e trupit dhe forcimi i trurit përcaktojnë dhe realizojnë qëllimin. Qëllimi i vërtetë nuk duhet të jetë edukimi i mendjes, por zhvillimi i përgjithshëm i njeriut. Edukimi vetëm i mendjes e sjellë njeriun në gjendjen e njohurive, por i mohon njeriut orientimet e tjera (Çamdibi, 1983: 39).

Kerschenstainer (1977: 8), i ka dhënë përgjigje pyetjes që pedagogët më të mëdhenj të historisë së edukimit kanë hasur: “*çfarë duhet të jetë finalizimi i edukimit?*”. Qëllimi më i rëndësishëm që duhet të realizojë edukimi, (Russell, 1999: 56) është të gjejë qëllimin e njeriut, t’i tregojë rrugën e arritjes. Formimi me dinjitet i individit është arritja më ideale e edukimit.

Për të arritur finalizimin e edukimit, shkolla duhet të ndikojë mbi brezin e ri me vlera e t’i kthejë ato në zakone. Përballë situatave negative që sjell shekulli, shkolla duhet t’u tregojë nxënësve zgjedhjet më të mira e në të njëjtën kohë duhet t’u afrojë strategji me qëllim për t’i arritur. Nëse të gjithë do të jemi në kërkim të një bote më të mirë edukimi, duhet që në shpirt të mbartim vlera (UNESCO, 2010: 1). Me këtë qëllim për të zhvilluar vlerat apo për t’i mësuar ato, në aktivitetet e treguara dhe literaturën e përditësuar shohin më shumë edukimin e vlerave (Suparka dhe Johnson, 1975: VIII). Në këtë drejtim edukimi

i vlerave plotëson UNESCO (2010:1). “për të treguar vlerat pozitive të fëmijëve dhe të të rinjve dhe për të përparuar në potencialin e tyre, sapo të zbulohen duhet t’i përparosh me aktivitete edukimi”.

Mund të themi se me plotësimin e edukimit të vlerave, vlerat në edukim mund të ndryshojnë sipas qëllimit. Parë nga një pikëpamje e përgjithshme edukimi i vlerave është vlerë shoqërore. Individu moral mund të plotësohet nëse tregon zell për t’i fituar këto vlera. Parë nga një perspektivë fetare, që dikush të bëhet më fetarë, duhet të tregojë përpjekje për të mësuar vlera fetare. Parë nga pikëpamja humaniste, për të zhvilluar potencialin e njeriut apo për të realizuar vetveten duhet bërë duke mbështetur qëllimin dhe duke e plotësuar atë me kohën. Edukimi i vlerave, duke iu referuar vendeve të ndryshme, si: Azi, Europë, Australi, SHBA dhe Amerikë Latine, aplikohet shumë më tepër sa e kemi dëgjuar. Sipas Lovant dhe Toomey (2009), edukimi i vlerave në arenën ndërkombëtare njihet me një sërë emrash, si: *edukimi moral, edukimi karakterial, edukimi etik, etj.*

Veugelers dhe Vedder (2003: 378), i referohet me emra të ndryshëm, si: *edukimi karakterial, edukimi moral, edukimi personal dhe shoqëror, edukimi qytetar, edukimi publik, edukimi fetar, edukimi demokratik dhe moralizues.* Në Amerikë njihet si edukimi i karakterit, në Angli si edukimi i vlerave, në litarutën e BE njihet më shumë si edukim qytetar. Edukimi i vlerave është i lidhur ngushtë me koncepte si: zhvillim shpirtëror, moral dhe kulturor. Edukimi i karakterit lidhet më shumë me koncepte si *edukimi i virtyteve, zakoneve personale dhe zhvillimit të aftësive.* Ky proces shumë dimesional dhe edukimi që shfaq edukimin e vlerave ka hyrë në programet e edukimit. Ai nuk mund të injektohet vetëm, por bashkë me konceptet e tjera. Në krijimin e vlerave, orientimi nuk duhet të jetë

vetëm edukimi në shkollë i fesë, i filozofisë dhe i mësimëve të tjerë të ngjashëm, por zbatimi pedagogjik i çdo mësuesi është element kryesor (Veugelers dhe Vedder, 2003: 386). Për arsye të kësaj karakteristike edukimi i vlerave duhet të aplikohet duke u qasur në mënyrë vepruese.

2.8.3. Përçimi i vlerave dhe familja

Njeriu nuk e ka nga lindja aftësinë e dallimit të së mirës nga e keqja, por i fiton shumë më vonë vlerat shoqërore dhe modelet e të sjellurit. Për këtë arsye vlera, para gjithëçkaje ka të bëjë me shoqërinë dhe institucionet e arsimit, por është një nismë që duhet të ketë vijimësi në çdo shtresë të shoqërisë (Aydın, 2000: 20). Ato duhet të jenë objekte studimesh, metodash mësimore të përdorura, qoftë dhe temash të teksteve që përfshijnë programet arsimore për mësimin e tyre.

Në formimin e karakterit të individit në socializimin e tij, në fazën e parë vërehet ndikim i madh i mjedisi me të cilin ai bashkëvepron. Prandaj, bëhet fjalë për shembullin që ai merr nga familja dhe më të mëdhenjtë. Pas familjes, me rritjen e moshës ndikojnë shoqëria dhe mësuesit (Durkheim, 2004: 33).

Familja është një nga institucionet sociale më të rëndësishme që historikisht ka ekzistuar në shoqëri. Në përgjithësi, familja është një institucion që kryen detyrat e ripërtëritjes së popullsisë, përçimit të kulturës kombëtare dhe socializimit të fëmijës (Aydın, 2000: 24). *Familja kryen një detyrë të rëndësishme në shoqëri, pasi që një shoqëri të mbijetojë, duhet të ketë lidhje me edukimin e fëmijëve, me vlerat dhe traditat shoqërore.* Sociologët e konsiderojnë familjen si një njësi pasqyruese. Teksa në *Kinë* dhe shoqëritë

Lindore, familja është një institucion qendror, në *Europën Perëndimore* ajo e ka humbur ndikimin e dikurshëm. Në shoqëritë ku mbizotëron **Islami**, **Budizmi** dhe **Krishtërimi** është më e fuqishme se në shoqëritë e tjera. Në institucionin e familjes përpunohen dhe u mësohen fëmijëve elementë të rëndësishëm të kulturës shoqërore. Në këtë mënyrë, fëmija që socializohet në familje është përcjellësi më i vogël i kulturës shoqërore (Bilgiseven, 1989: 29).

Sipas *Topcu*, familja është një shkollë morale. Mund të themi lirshëm se, veçanërisht në pikëpamjen e përcimit të vlerave shoqërore tek fëmijët, familja është më e rëndësishme se institucionet e tjera arsimore. Që në moshë të hershme, fëmija mëson sjellje që do ta çojnë para në jetë, dhe këto mësimë janë jetëgjata e nuk harrohen lehtë. Prandaj, *roli i familjes në edukimin e fëmijës nuk është vetëm t'i mësojë atij ato që nuk di, por duhet t'i transmetojë edhe vlerat shoqërore.*

2.8.4. Universaliteti i vlerës

Universaliteti i vlerës është një temë e debatueshme prej kohësh. *Lickona* (1991: 38) kur i ndan vlerat më dyshë, bazohet tek veçoritë e të qenit dhe të mos qenit universale. Universalet i pranon si trashëgimi të përbashkëta të njerëzimit. Dhe për të mbështetur idenë e të qenit universale jep si shembull *Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.*

Sipas *Poyraz*, masa e të qenit të vlerave universale, edhe sikur të jenë prodhim i një individi apo kulture të vetme, me kohë ato duhet të pranohen gjerësisht nga shoqëria. Vlerat e prodhuara nga njerëzit, zgjerohen kur janë të hapura dhe ndahen me persona të tjerë në shoqëri (Poyraz, 2007: 84). Duke filluar nga vitet 1980, *UNESCO* ka punuar për të zbuluar

vlerat e përbashkëta njerëzore, për këtë qëllim ka marrë ndihmën e *Club of Rome*. Në përfundim të studimit *Encyclopedia of Global Problems and Human Potential* ka botuar punimin me titull “*In Search of a Wisdom for The World: The Role of the Ethical Values in Education*”. Mbi realizimin e këtyre punimeve, në mars të 1997-tës në *Paris* dhe në dhjetor të 1997-tës në *Napoli të Italisë*, afro tridhjetë teologë, filozofë, antropologë, politikanë, sociologë, juristë dhe biologë paraqitën mendimet e tyre mbi problemet globale dhe vlerat universale. Si përfundim, bazuar në vendimet e marra përgjatë këtyre takimeve, u botua një deklaratë rreth vlerave globale, si: ***të drejtat e njeriut, drejtësisë, respektit ndaj feve***, etj. (Kim, 2000: 91).

Në mbledhjen e mbajtur në *Chicaggo* më 28 gusht - 4 shtator 1993, ku morën pjesë 6500 përfaqësues nga 120 religjione të mbarë botës, u hodhën themelet e vlerave dhe moralit universal. Në këtë kontekst, u arrit një marrëveshje: *për respektin ndaj njeriut, rendit ligjor dhe ekonomik, tolerancës dhe mirëkuptimit, barazisë gjinore*, etj. (Kim, 2000: 80-81).

Më 22 maj të vitit 1996, në takimin e *Inter Action Council (Vancouver)*, drejtuesit e shteteve arritën në përfundimin se pa vlerat universale nuk do të ishte e mundur një botë më e mirë. *Inter Action Council*, vuri në dukje katër vlerat themelore të deklaruara nga të katër religjionet, të cilat renditen si (Küng, 1998: 109-111):

1. Nuk duhet të vrasësh. (Respekt për njeriun).
2. Sillu mirë dhe drejtë. (Rend ligjor dhe ekonomik).

3. Tregohu tolerant ndaj kulturave.

4. Kulturë dhe të drejta të barabarta.

Një tjetër projekt i moralit dhe vlerave universale, i pranuar në mbarë botën, është dhe *The Earth Charter*. Teksti i këtij projekti u botua në mars të vitit 2000 në *Kosta Rika*. Përbëhet nga hyrja, katër kapitujt kryesorë dhe përfundimet. Në katër pjesët e tij gjenden katër principe kryesore dhe gjashtëmbëdhjetë principe dytësore. ***Katër principet kryesore janë:***

1. Jeta dhe respekti për të ndryshmen.

2. Tolerancë, dashuri dhe mbrojtje e jetës së shoqërisë nga mëshira.

3. Ndërtimi i shoqërive të drejta dhe demokratike.

4. Ndërtimi i kulturës së paqes dhe tolerancës ndaj kulturave dhe religjioneve të ndryshme (Supurka dhe Johnson, 1975).

Në marrëveshjet e mësipërme nuk bëhet fjalë vetëm për të mirën dhe mirëqenien e disa personave apo disa përfaqësuesve të feve, por dëshirohet e mira për të gjitha gjallesat që jetojnë në gjithë botën. Sigurisht që nuk mund të thuhet se këto principe janë morali dhe vlera universale, pasi nuk mund të presim që këto të mirëpranohen nga të gjithë. Por nëse marrim parasysh se ato janë pranuar nga shumica e shkencëtarëve mund të themi se është një përpjekje për të formuar një kornizë të moralit dhe vlerave universale.

Edhe pse nuk mund të flasim për vlera universale për të cilat bien dakort të gjithë individët, shoqëritë, religjionet dhe ideologjitë, më së paku kemi disa vlera të përbashkëta që u interesojnë si besimtarëve ashtu edhe jobesimtarëve. Zaten *qëllimi i moralit universal nuk është të ndërtojë një sistem vlerash të pranuar nga të gjithë, por është të tërheqë vëmendjen e njerëzve të fushës dhe të rrisë vetëdijen.*

KAPITULLI III: KONCEPTE TEORIKE E EDUKIMIT DHE ZHVILLIMIT MORAL

3.1. Lidhja e moralit me edukimin

Njeriu është krijuar si një qenie që edukohet dhe trajnohet. Edukimi është procesi që sjell ndryshimet e dëshiruara në sjelljen e dikujt me anën e përjetimeve personale (Ertürk, 1982: 12). Qëllimi i edukimit është t'i mësojë një shoqërie si dhe në çfarë kushtesh duhet të veprojë, në mënyrë që brezat e ardhshëm të vazhdojnë jetën e tyre më mirë dhe më të lumtur (Kocer, 1980: 5). Qëllimi final i edukimit është të edukojë njerëzit me moral të lartë dhe të qëndrueshëm (Kulaksızoğlu, 1998: 87).

Midis edukimit dhe moralit ekziston një marrëdhënie e ngushtë, e pandashme, e thellë dhe kuptimplote. Vlerat morale, mendimet, qëndrimet dhe mënyrat e sjelljes së njerëzve transmetohen tek brezi i ri i shoqërisë vetëm nëpërmjet edukimit (Tezcan, 1996: 66). Edukimi është rregulli i shoqërisë, i cili ndihmon në ruajtjen e paqes dhe sigurisë, e për këtë arsye është mjete kryesor që kontribuon në qëndrueshmërinë e shoqërisë. Me anë të edukimit është e mundur që të zvogëlohen diferencat e zhvillimit moral midis individëve. Morali i nxit individët të punojnë drejt arritjes së një shkalle më të lartë. Komunitetet dhe individët edukohen në lidhje me rregullat morale dhe parimet që mbizotërojnë në shoqëri, kjo u shërben atyre për të arritur nivele më të larta dhe të pozicionohen më mirë (Çileli, 1986: 279).

Studiuesit akademikë në lidhje me moshën që duhet të mësojë fëmija shprehen se, edukimi i fëmijës para se të arrijë një nivel të caktuar pjekurie nuk e ndihmon mësimin, por

e vështirëson atë. *Fillimi i edukimit dhe mësimin në moshë të herëshme ndikon në rendin-bimalari të fëmijës*. Por në rastin e edukimit moral ky pikëvështrim nuk është i saktë. Fillimi i edukimit moral në moshë gjashtë apo shtatë vjeçare tregon se procesi është tepër i vonuar. Padyshim që edukimi moral i fëmijës duhet të fillojë fill pas lindjes së tij (Bey, 2000: 52).

Në programet mësimore të shkollave janë përfshirë mësimet që transmetojnë vlera kulturore dhe morale tek fëmijët si dhe i zbatojnë ato në praktikë. Qëllimi i edukimit është rritja e njerëzve me moral, të zhveshur nga ndikimet e jashtme, të lirë, të pjekur, që vendosin për veprimet e tyre bazuar tek ndërgjegjia. (Erdem, 2006: 134). Sipas Kohlberg, qëllimi i edukimit moral është kalimi në nivelet më të larta të moralit. Një edukim i tillë nuk mund të jetë vetëm një kapitull mësimi, por një veçanti e gjithë sistemit të edukimit (Çileli, 1986: 114).

Ndërkohë që nxënësve u duhet të mësojnë rregullat morale dhe nevojën për të vepruar me përgjegjësi, në të njëjtën kohë ekziston mundësia që ata t'i përvetësojnë këto rregulla e mënyra sjelljeje. Kështu rriten individë që veprojnë bazuar tek morali, në përshtatje me shoqërinë, me ndjenjën e përgjegjësisë, që i njohin mirë kufijtë e të drejtave dhe përgjegjësi (Fidan dhe Erden, 1991: 58).

Ndërkohë që, padrejtësitë dhe pabarazitë e shfaqura në shkollë si dhe pengesat që hasin fëmijët për të ndërtuar një personalitet të drejtë, të lirë dhe të ndershëm, ndikojnë në formimin e sjelljeve imorale tek to. Këto gjendje mund të parandalohen me përhapjen e shkencës, edukimit dhe të vlerave morale të shoqërisë (Ercan, 1998: 125).

Një karakteristikë tjetër e shkollës është të ndikoi në ambientin përreth. Pastrimi i shkollës dhe i ambientit, mbrojtja nga shitja e substancave të dëmshme dhe nga njerëz të papërshtatshëm, do të thotë të mbrosh komunitetin dhe shoqërinë. Duke i dhënë rëndësi aktiviteteve studentore, krijimit të bibliotekave, vlerave kombëtare dhe shpirtërore, si dhe projekteve që transmetojnë kulturën, i jep rëndësi zhvillimit dhe rinovimit të shkollave dhe ambienteve, si dhe laun rol inkurajues për to. Në këtë mënyrë, sjellja e nxënësve dhe të rriturve në shkolla ndihmon realizimin e ndryshimeve positive (Bilgin, 1991: 128).

Statusi i institucioneve arsimore në shoqërinë moderne, roli dhe rregullat që ato luajnë, njihen si nga anëtarët e institucionit, po ashtu dhe nga individët e komunitetit rrethues. Mësuesit në institucionet arsimore, drejtorët e tyre, zyrtarët si dhe personat e ngarkuar me detyrën e konsulencës, po trajnohen gjithnjë e më shumë, sipas fushave të tyre. *Roli dhe ndikimi i punonjësve të arsimit dhe sidomos i mësuesve në zhvillimin moral të fëmijëve e të rinjëve është tepër i madh.* Një fëmijë në kopësht apo në parashkollor, gjatë kohës që është në shtëpi, zgjedh si model moral prindërit apo anëtarët e tjerë të familjes, kurse në moshën shkollore modeli i tij moral është mësuesi. Fëmija e pranon autoritetin e mësuesit, dhe sipas tij, çfarëdo që bën apo thotë mësuesi, është e drejtë. Për këtë arsye, në përgjithësi ai që imitohet më shumë është mësuesi (Yörükoğlu, 1986: 97).

Për një edukim moral të suksesshëm është e nevojshme pajisja e brezave të rinjë dhe njerëzve që ndryshojnë kohën me vlera universale. Për këtë arsye ndihet nevoja e mbajtjes së ritmit sipas risive, zhvillimeve në strukturën shoqërore dhe ndryshimeve në fushën e arsimit. Për të përmbushur këto nevoja është e rëndësishme që të rivlerësohen dhe rishikohen programet mësimore. Bashkë me globalizmin u rrit e njohura dhe informacioni

mbi çështje të ndryshme me të cilat përballet shoqëria e sotme, si: *krimi kibernetik*, *terrorizmi*, *racism*, etj. Në ditët e sotme ndihet nevoja e rishikimit të programeve dhe sistemve shkollore duke marrë parasysh se nevoja kërkon që t'u jepet zgjidhje problemeve të dala si dhe të kuptohet rëndësia e edukimit moral. Shoqëria, kryesisht, të rinjtë dhe fëmijët që pranojnë vlerat morale, do ta mundësojnë vazhdimësinë dhe rinovimin e vlerave vetëm me anë të edukimit. Brezi i cili ka fuqinë të krijojë vlera të reja, në përshtatje me kohën dhe moshën, me anën e një edukimi të tillë do të hedhë dritë drejtë të ardhmen (Variş, 1988: 5).

3.2. Edukimi moral

Edukimi moral luan një rol të rëndësishëm në sjelljen dhe mendimin e shëndetshëm të individëve. Vetëm brezat me moral mund të jenë arkitektë të së ardhmes. Qëllimi i edukimit moral është: kthimi në zakon i sjelljeve të drejta për të arritur moral të lartë. Sjellja e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme bëhen karakteri moral i njeriut. Në të njëjtën kohë, edukimi moral ndikon në krijimin e karakterit të duhur të njeriut, duke e vendosur atë gjithmonë përballë përshtatjes me kushtin e “drejtë”. Teoritë dhe konceptet e moralit kanë si qëllim të shpëtojnë personalitetin e njeriut nga krizat e të ndërtojë një shoqëri me personalitet. Morali është vlera bazë që e mban të shoqërinë në këmbë. Kjo vlerë do të thotë të llogarisësh çdo gjë, edhe shpërfilljen e individualizimit në shoqëri.

Parimet dhe rregullat morale, synojnë të shpëtojnë njerëzimin nga kriza e identitetit dhe të krijojnë një shoqëri që zotëron një personalitet të veçantë. Morali përfshin vlerat themelore që mbajnë në këmbë shoqërinë. Shpërfillja e këtyre vlerave, do të thotë

shpërfillje e vetë shoqërisë njerëzore. Nuk mund të flitet për jetën në komunitet në qoftë se çdo njeri mendon për interesat vetjake. *Njerëzit, kanë si qëllim sigurimin e mirëqenies së përgjithshme, ato janë të detyruar të jetojnë në komunitet e të ndërtojnë rrugë komunikimi të mira me të tjerët. Për të siguruar këtë është i nevojshëm sistemi.* Çdo komb, çdo epokë, çdo klasë, madje çdo individ ka një moral të veçantë, thënë ndryshe është zotëruar i një sistemi vlerash të lidhura me atë që quhet moral. Nuk mund të mendohet që jeta sociale mund të funksionojë normalisht pa pasur vlerat morale. Arsimi dhe edukimi moral është forca më e rëndësishme në ruajtjen e moralit shoqëror (Akarsu, 1993: 10).

Sipas *Kantit* qëllimi kryesor i arsimimit është realizimi i “*moralizimit*” në varësi të ligjit moral. Individu duhet të kryej veprime sipas ligjit moral dhe duhet të përpiqet të zhvillojë një personalitet autonom në kuadër të moralit me ndërgjegjen e një “*detyre shtëpie*”. Për këtë arsye *Kanti* mbron idenë se fëmijët duhet të mësohen që në moshë të vogël me detyrat e ‘*shtëpisë*’ dhe me ‘*disiplinë*’, duke paraqitur edukimin moral në mënyrë të përshtatshme me filozofinë morale. Ai shtron idenë se edukimi moral duhet të bazohet në rregulla dhe ligje të caktuara e jo në rregulla të disiplinës. Për këtë arsye ai thotë që ‘*veproni në mënyrë të tillë, sipas rregullave, në mënyrë që veprimi juaj të jetë një rregull i vlefshëm*’. Në këtë mënyrë, në edukimin moral ai mbron mësimin e fëmijëve për të vepruar në përputhje me udhëzimet e përgjithshme. Në këtë mënyrë fëmija mëson të veprojë sipas rregullave që ai i ka përcaktuar të vlefshme për të përgjithshmen e i ka perceptuar personalisht që janë të drejta. Në këtë mënyrë edukimi moral përgatit një terren të fortë në ndërtimin e karakterit të fëmijës. Sipas *Kantit* karakteri është zakoni i të vepruarit sipas ligjit të moralit dhe një fëmijë me karakter të formuar ndërmerr veprime të moralshme.

Gjithashtu, ai mbron idenë se në edukimin moral nuk ka vend për *‘dënim’* dhe *‘shpërblim’*. Sipas tij veprimi që realizohet vetëm për arsye të frikës së dënimit ose për arsye të dëshirës për shpërblim, nuk ka asnjë vlerë morale. Sjellje e moralshme quhet kur është sjellje e mirë, e virtytshme dhe kryhet në mënyrë të përshtatshme me ligjin moral. Nuk përbën vlerë dhe rëndësi kryerja e veprimeve nga fëmija, në qoftë se ai nuk e ka kuptuar dhe nuk e ka perceptuar çfarë është e mirë. E rëndësishme është që të veprojë mirë duke e kuptuar që është diçka e mirë, dhe të shmangë të keqen duke e kuptuar që është diçka e keqe. *Edukimi moral sipas Kantit, është të mësuarit e rregullave morale fëmijës, jo nëpërmjet forcës dhe frikës, por duke u mbështetur në të kuptuarit prej fëmijës, në shpjegimin dhe gjithpërfshirjen ndaj tij.* Vetëm në rast se fëmijës i është siguruar një edukim i tillë, fëmija do të mund të performojë sjellje të moralshme dhe të ndërgjegjshme e do të konsiderohet i edukuar (Kant, 1999: 35).

Edukimi moral, drejton në mënyrë të përshtatshme temperamentet e ndryshme të individëve, në këtë mënyrë mundëson zhvillimin e karakterit dhe zakoneve të mira. Karakteri dhe edukimi moral, i cili ka për qëllim të sigurojë harmoni me veten dhe të tjerët, si dhe sigurimin e zhvillimit të personalitetit të moralshëm të një individi dhe sigurimin e pjekurisë morale, është një veprimtari me anën dhe kontributet e saj individuale dhe shoqërore. Institucioni më i rëndësishëm që i përfitohen këto vlera dhe gjithashtu kontribuon në sistemin e vlerave është familja. Shkolla dhe institucione të tjera ndjekin institucionin e familjes. Rruga më e rëndësishme për të shmangur trendet problematike tek të rinjtë është edukimi i karakterit dhe edukimit moral nëpër shkolla (Aydın, 2003: 51).

Kur themi **“Edukimi moral”** menjëherë shënohet një fushë e cila në vetvete përbën edukimin. Duke marrë shkas nga kjo fushë mund të bëhet përshkrimi i edukimit moral: **“Edukimi moral, është procesi i përpjekjeve të individit për të realizuar ndryshimet e dëshiruara me mënyrën e jetesës së tij.** Një ndër objektivat e edukimit moral, është përfitimi i rregullave dhe parimeve të cilët do të ndihmojnë për të mbikqyrur sjelljet e mira dhe të këqija. **“...për të realizuar moralin e lartë, sigurimi i të kthyerit në zakon i sjelljeve të pjekura, sigurimi i zhvillimit të një personaliteti të moralshëm,”** nevojitet të shpalosen sjellje të tillë për të ndihmuar në lumturinë dhe perfeksionimin e vetes dhe të tjerëve (Bilgin dhe Selçuk, 1997: 102).

Përveç rolit thelbësor që luan familja në zhvillimin e edukimit moral të fëmijës, janë shumë efektivë institucionet e strukturuar dhe formale, shkollat, ku fëmijët kalojnë kohën më të madhe. Morali, i lidhur direkt me jetën njerëzore dhe kontribues në përpjekjet e jetesës njerëzore, gjithmonë ka qënë qëllimi dhe subjekti i edukimit. Veçanërisht në vitet e shkollës fillore, për shkak të fillimit të zhvillimit të personalitetit dhe individualitetit, duhet t’i jepet një prioritet i madh edukimit të vlerave morale, se pikërisht gjatë kësaj periudhe rriten personalitetet e gjeneratës. Në fakt, qëllimi është të përmbushen të gjitha aktivitetet arsimore e arritur edukimin moral, që është dhe mbetet detyrë shkollës dhe përgjegjësi e punonjësve të saj. Në këtë drejtim, përpjekjet e përbashkëta të të gjitha njësive dhe kurseve të shkollës janë të rëndësishme (Ekşi, 2006: 186).

Shkollat kanë tre qëllime të përgjithshme të rëndësishme.

Qëllimi i parë, dashuria për kombësinë, rritja e qytetarëve të moralshëm, humanë, që kanë adoptuar vlerat shpirtërore dhe kulturore të kombit të tyre.

Qëllimi i dytë, rritja e personaliteteve me qëllim zhvillimor, në trup, mendje, moral, shpirt dhe ndjenja të ekuilibruara dhe të shëndetshme.

Qëllimi i tretë, sigurimi i nje profesioni në përputhje me interesat dhe aftësitë e tyre individuale. Brenda qëllimeve të përgjithshme të arsimimit morali dhe edukimi moral zënë një vend të rëndësishëm. Qëllimi i fundit i arsimimit dhe shkollës është formimi i karakterit, domethënë të rritesh individë të moralshëm dhe të devotshëm.

Përgjithësisht qëllimi i edukimit moral është zhvillimi i pjekurisë morale të individit. Qëllimi i edukimit moral në shkolla është të ndihmojë periudhat e fazave të zhvillimit në të cilën ndodhen fëmijët ose të rinjtë, të shuajë efektet negative të ambientit jashtë shkolle mbi fëmijën, për t'i përgatitur ata që të jenë njerëz dhe qytetarë të mirë. Qëllimet e përgjithshme morale të lëndës së qytetarisë së arsimit fillor janë përcaktuar si më poshtë: *rritja e studentëve të virtytshëm të cilët njohin dhe respektojnë vlerat morale, aftësia e tyre për të përvetësuar vlerat morale, sigurimi i të spikaturit të efektit pozitiv të një sjelljeje të mirë.* Programi ngulmon, *së pari*, drejtimin nga shpirti i individit, vënia si qëllim e moralit në plan të parë tek individi, më pas, përpjekja për të siguruar bashkëveprimin me botën jashtë, me qëllim të rritjes së njerëzve paqësor dhe të respektueshëm ndaj shoqërisë (Güngör, 1998: 46).

Edukimi moral, duhet dhënë në bazë të karakteristikave morale dhe sociale të nxënësve. Një edukim moral i bazuar në autoritetin dhe forcën nuk mund të jetë i

sukseshëm. Nëpërmjet edukimit moral tek individit, duhet të zhvillohet një moral autonom (*i pavarur*) dhe jo një moral vartës ndaj të tjerëve. E rëndësishme është, që mos të jetë një etikë morale e kontrolluar nga jashtë, por një etikë morale e kontrolluar nga brenda. Duhet dhënë një arsimim demokratik e tolerant në mënyrë që në shkollat të kemi fëmijë që aplikojnë sjellje të moralshme. Një edukim moral i mbështetur në dashuri dhe tolerancë, apelon për ndërgjegjen e nxënësve, dhe i ndihmon ata të shprehin solidarizimin përtej besimit (Köylü, 2003: 88).

Edukimi i moralit fillon duke shpjeguar gradualisht rregullat ekzistuese. Në fakt, e vërteta është se këto njohuri duhet ta ndihmojnë fëmijën t'i adaptojë ato në jetën e tij që të mos mbeten vetëm njohuri informuese. *Njohuritë duhet të jenë edukative, bindëse, tërheqëse dhe përvetësuese.* Për të ushqyer ndjenjën e moralit dhe ndërgjegjes tek nxënësit, duhen theksuar shembuj të goditur tregimi jetuar më parë, afrimi i përjetimeve nga jeta për t'i tunduar ato, është jashtëzakonisht i dobishëm. Në këtë mënyrë, është detyrë e rëndësishme e edukimit moral *të mësojë dhe të ngulisë vlera morale si mirësia e të ndihmuarit dhe të bërit mirë dikujt tjetër, e keqja e gënjeshtërs dhe e shpifjes, respekti ndaj nënës dhe babait e ndaj të mëdhenjëve,* etj. Në edukimin e moralit, përgatitet terreni për zgjimin e ndjenjës së moralit dhe mundësimi i zhvillimit të saj, në të njëjtën kohë përgatitet terreni për zgjimin e vullnetit dhe ndërgjegjies dhe zhvillimin e tyre. Jo vetëm shembujt e mirë, por edhe afrimi i tabllave me shembuj të gjallë të së keqes, mund të ndikojë te fëmija dhe të krijojë tek ai ndërgjegjësimin e të qëndruarit larg së keqes. Fëmijëve mund t'u mësohen, shpjegohen e përvetësojnë në mënyrë racionale e të kënaqshme faktet, pse janë të shëmtuara e të dëmshme ndjenjat e sjelljet morale të këqija, pse janë të mira dhe të

dobishme ndjenjat dhe sjelljet morale me vlera të larta. Nxënësit “...*duhet t’i vihet si qëllim për jetën që ecën përpara, ndjenjat dhe mendimet e moralshme, ndjelljen e ideve dhe opinioneve në një mënyrë të shëndetshme, e për më tej vendimi moral dhe dhënia e gjykimit të jenë si rezultat i zbatimit të tyre...*” Shkurtimisht qëllimi i fitimi të njohurive morale e ndërgjegjes morale është që të jetë në gjendje të përgatisë një njeri të moralshëm. Edukimi moral ka vlerë në përcaktimin e sjelljes sonë morale, ka për qëllim vendosjen në ekuilibër të forcave, *forcat lëvizëse të jashtme dhe të brendëshme* dhe veçoritë morale të pranuar nga shpirti, të cilat synojnë që individi të jetë me një ndërgjegje të shëndetshme vigjilente dhe të fortë (Yavuz, 1998: 231).

Në edukimin moral për të realizuar qëllimet e parashikuara duhet që të transmetohet edukimi i duhur në përputhshmëri me zhvillimin e nxënësit. Termi i zhvillimit i referohet ndryshimit dhe progresit me faktorët e mjedisit. Me fjalë të tjera ky është “*të mësuarit*”. Zhvillimi moral nuk mund të mendohet i ndarë nga zhvillimi mendor dhe shpirtëror. Jeta jonë morale ndërtohet nga mbledhja e të gjitha këtyre elementëve: *ndjenjë, njohuri, sjellje*. Zhvillimi i moralit është i lidhur me faktin se sa përvetësohen dhe si përvetësohen vlerat dhe parimet morale të shoqërisë nga fëmija. Opinionet që i adresohen zhvillimit të moralit në lidhje me këtë dhe teoritë e zhvillimit të moralit do të analizohen në temat e mëposhtme (Güngör, 1998: 23).

Duke ditur nivelin e zhvillimit moral të fëmijëve, që përmendëm më lart, për të arritur, fituar e synuar arsimin moral, duke marrë parasysh gjetjet e gatshme morale është i rëndësishëm përcaktimi i temave dhe rregullimi i edukimit, sidomos duke bërë kujdes në përzgjedhjen e metodave. Në rast se nuk merret parasysh zhvillimi moral, përpjekjet për të

bërë një edukim moral në periudhë të gabuar dhe me metodat e gabuara, mund të shkaktojë te fëmijët efekte negative.

3.3. Qasjet në edukimin moral

Edukimi moral është një edukim vlerash, i cili apelon për fushat emocionale. Në edukimin e vlerave gjenden qasje të ndryshme. Njëra prej tyre është bazuar në teorinë e zhvillimit të Kohlbergut: "*gjykimit moral*", i njohur edhe si qasje: "*dilemë morale*". Dilemat janë probleme reale jetësore që bien ndesh me parimet e të dy vlerave. Sipas kësaj qasjeje, mësuesi është ngarkuar me detyrën për të dhënë shembuj të dilemës morale, gjithashtu ata duhet të ndihmojnë nxënësit për t'i zgjidhur dilemat e tyre. Gjatë krijimit të dilemave morale, ato duhet të jenë të lidhura me temën që trajtohet në mësim; mundësisht të jetë e thjeshtë, në vend të një përgjigjeje të vetme, duhet patur kujdes që të përfshijë opsionet e ndryshme të përgjigjeve, të cilat duhet të jenë të hapura. Qëllimi i dhënies së shembujve të dilemave morale në bazë të nivelit të nxënësve është për të nxitur tek ata konfliktin konjitiv, diskutime të ndryshme ku të vihet në punë dhe arsyetimi (Doğanay, 2006: 275).

Nga e shkuara deri në këto momente gjetja e përdorur më shpesh në temën e edukimit të vlerave është qasja, "*Mësimi i drejtpërdrejtë i vlerave*", që do me thënë "*ngulitje e vlerave morale*". Kjo qasje është teoria e shpjegimit mjaftueshmërisht mirë tek fëmijët, e asaj që është e mirë dhe e asaj që është e keqe. Ndërmjet metodave më shumë të përdorura për këtë qasje, janë: *leximi i historive frymëzuese, dëgjimi i situatave morale që mësuesit shpjegojnë*. Historitë e përdorura këtu, janë histori me tendenca morale, personale ose

imagjinare. Për më tepër, si metodë për ndryshimin e sjelljes në këtë qasje është përdorur dhe shpërblim. Në kohën që tregohet sjellje e denjë për vlerën nxënësi shpërblehet. Në veçanti, kjo metodë e përdorur gjerësisht nga prindërit dhe mësuesit nuk e ka të mjaftueshme kohën e dhënë për ta praktikuar në klasë, në këtë mënyrë vlera edukative që jep nuk është efektive dhe e qëndrueshme (Doğanay, 2006: 280).

Një qasje (*metodë*) tjetër e vlerës së mësimit është “*shpjegimi i vlerës*”.

Në kundërshtim me qasjen e drejtpërdrejtë të mësimit, kjo qasje mbështetet tek çfarë individi duhet të gjykojë në liri të plotë me mendjen e tij dhe jo të tjetrit, çfarë konsideron me vlerë dhe çfarë konsideron të pavlerë. Kjo është një metodë sipas të cilës mësuesit duhet të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë vlerat e veta. Kjo metodë, ndihmon që individi të jetë i vetëdijshëm për ndjenjat, besimet dhe prioritetet e tij, të njohë anët e dobëta dhe të forta, t’u dalë për zot atyre. Individi duhet të kuptojë e njohë vlerat në jetën e tij, të marrë vendime, të dijë t’i hedhë hapat sipas vendimeve që merr. Qasja e shpalosur nga *Simoni* me shokë, që mbështetet në hipotezën se nxënësit duhet të kenë vlerat e veta, se nuk janë në gjendje t’i kuptojnë haptazi ato, ka për qëllim t’i ndihmojë në këtë temë. Në këtë qasje janë përdorur metoda të ndryshme, si lojrat në klasë, ekspozita, e të ngjashme me këto, duke mos u sugjeruar një vlerë të caktuar, kështu që nxënësit janë inkurajuar t’i tregojnë vetë vlerat e tyre (Bacanlı, 2006: 36).

Mësuesi, që të mundet t’i ndihmojë nxënësit të zgjedhin dhe vlerësojnë sjelljet e tyre, brenda në klasë dhe jashtë saj në mënyrë të vetëdijshme, i rendit vlerat nga më e rëndësishmja tek ato më pak të rëndësishme. Për vlerat e shprehura kërkon që të sqarojnë

nëse duan të marrin pjesë ose jo. Sqarimi i vlerave ndodhet në mesin e shumë teknikave të përdorura, si: *diskutimi në grup, fleta e mendimeve, pyetjet me fund të hapur, autobiografia, sondazhet, intervistat, citatet, raportet*, etj. (Bacanli, 2006: 40).

“Analiza e vlerave” është një ndër qasjet e bëra në mësimin e vlerave. Ajo është një metodë që aplikohet kur problemet e vlerave nuk janë emocionale, por racionale. Kjo, në një farë mënyre, teston nëse problemi është real apo artificial. Nxënësit fitojnë aftësinë e të menduarit moral me anë të studimit të rastit. Në lidhje me studimin e rastit mësuesi jep udhëzime në lidhje me pyetjet, ndihmon nxënësit të zgjidhin problemin ose ta vlerësojnë atë. Kështu nxënësit mësojnë të zgjidhin probleme shkencore si dhe të hedhin hapat në zbatimin e problemve sociale (Akbaş, 2005: 88).

Për të integruar vlerat e nxënësve me sjelljet e tyre është e dobishme t'i udhëzojmë ata të vlerësojnë, zbulojnë, njohin dhe përshkruajnë vlerat e tyre. Për këtë arsye përdorimi i qasjes imponuese të moralit, edukimi moral, mund të mos jetë i suksesshëm. Për shkak se kushtet e ndryshme të të rinjëve nuk ndikohen nga imponimi apo këshillimi, por nga zgjedhja me vullnetin e tyre të lirë, duke dëshiruar dhe jo detyruar, merr një rëndësi më të madhe. *Synimi i edukimit moral është që për një individ të mbrojë edhe shoqërinë nga morali i keq, duke afruar sjelljen e duhur e duke mundësuar vazhdimësinë e saj.* Për këtë arsye fëmijët duhet të informohen në lidhje me sjelljet morale dhe imorale kudo, në familje, në mjedis e shoqëri, pasi në mënyrë të tillë fitohet një njeri i vlefshëm për jetën sociale. Fëmijët duke u përpjekur të zhvillojnë sjellje të mira e të pëlqyera, në të njëjtën kohë nuk bien pre e sjelljeve të këqija. Këto përpjekje e ndikojnë pozitivisht fëmijën, i mësojnë mendimet e drejta, e nxisin për të kërkuar më shumë. *Edukimi moral është baza për të*

mësuar etikën morale. Duke pasur parasysh karakteristikat e fëmijëve, duhet që atyre t'u sillesh mirë dhe afroresh me dashuri. Gjatë këtij procesi duhet të kujdesemi për mendjen, zemrën, vullnetin dhe ndjenjat e fëmijës. Në fëmijëri edukimi moral është më efikas se sa prioriteti që i jepet ndenjave dhe emocioneve. *Gjërat materiale nuk duhet të kalojnë moralin e shëndoshë dhe karakterin e lartë.* Qëllimi i edukimit moral është zhvillimi moral dhe zhvillimi i karakterit të njeriut. Edukimi moral është objektivi themelor i edukimit. Duke u pajisur më një edukim të tillë që në moshë të vogël, në familje, në shkollë e në shoqëri, fëmija bëhet më i përgatitur për jetën. Me pak fjalë, qëllimi i edukimit moral është se morali tek njerëzit përbën bazën e pjekurisë së tyre (Aydın, 2003: 53).

3.4. Çfarë është zhvillimi?

Edukimi është procesi i ndryshimit të sjelljeve njerzore sipas një qëllimi të caktuar. *Njerëzit i realizojnë sjelljet me anën e të mësuarit.* Ndikimi i edukimit dhe realizimi në një kohë të shkurtër bëhet duke i ditur nivelet e zhvillimit të njeriut, ky është përkufizimi që bëhet nga *Jaen Jacques Roussea* në lidhje me edukimin. *Zhvillimi:* janë quajtur zhvillimet e vazhdueshme dhe periodike tek njeriu, si pasojë e *të mësuarit, përvojës dhe pjekurisë.* Ky është një koncept më i gjerë që përfshinë ndërveprimin e faktorëve. Siç shikohet qartë edhe tek përkufizimi i zhvillimit, ai është një koncept i gjerë që përfshinë të mësuarit. Për këtë arsye mësimi nuk duhet të përdoret në vend të zhvillimit. Zhvillim është *ndryshimi i aspekteve fizike, mendimeve, ndenjave dhe qasjeve sociale, si dhe situata ku organet e njeriut kryejnë funksionet e përcaktuara*, pasi të gjitha këto i ka bashkë nga lindja e tij. Për të kuptuar më mirë se çfarë është zhvillimi, duhet që si fillim të bëjmë të qartë koncepte të tilla si: *rritje, pjekuri, mësim dhe gadishmëri* (Rice, 1997: 39).

Koncepti i zhvillimit është mënyrë për të lehtësuar jetesën e individëve, mënyrë e zhvillimit të aftësive për të përdorur mirë strukturat sasiore, si dhe mbuluar ndryshimet *psikologjike, sociale, njohëse dhe morale*. Zhvillimi fillon që në ngjizje me ndarjen e kromozomeve, ky proces përshpejtohet në disa periudha e në disa të tjera është më i qëndrueshëm. Me rritjen e moshës ndryshimi që ndodh në trup është i natyrshëm. Në sistemin e zhvillimit ndodhin ndryshime të pritshme, si: ***të muskujve, skeletit, ndryshim i sistemit endokrinor dhe ndryshime të tjera të brendshme***. Bazuar tek këto zhvillime pritet që bashkë me to të zhvillohet aftësia fizike e lëvizjeve, aftësia për të menduar më me efikasitet rreth ngjarjeve, zhvillimi i përbërjes emocionale si zhvillim i ekuilibrit apo i qëndrueshmërisë. Në këtë pikë rritja dhe zhvillimi ndodhin në një fazë të jetës së individit ku si procese të veçanta në vetvete përbëjnë harmoninë tërësore të tij. *Zhvillimi bashkë me rritjen përfshijnë pjekjen dhe mësimin.*

3.4.1. Rritja

Rritja lidhet me ndryshimet fizike që ndodhin me kohë tek individ. Si rritje njihen ndryshimet që lidhen me *rritjen e madhësisë së trupit, rritjen e peshës, si dhe ndryshimet që ndodhin tek organet e njeriut*. Me rritjen e individit pritet që bashkë me të të rritet edhe aftësia e të menduarit, ndryshimi i ndjenjave si dhe zhvillimi i qëndrueshmërisë. Pikërisht këtu thuhet se rritja dhe zhvillimi janë procese që përshatën në mënyrë harmonike me njëri-tjetrin. Zhvillimin dhe rritjen e ndjekin pjekuria dhe mësimi.

3.4.2. Pjekuria

Pjekuria është hyrja e organizmave që rriten në funksinet për të cilat janë krijuar si dhe përmbushin fuqitë fiziologjike. Pjekuria dhe rritja ndodhen në një marrëdhënie shumë të ngushtë me njëra-tjetrën. Gjatë pjekurisë shikojmë një pjesë të kufizuar të strukturës gjenetike. *Rritja dhe pjekuria tregojnë zhvillimin brenda kufinjve që lejon, pikërisht, kjo strukturë gjenetike.* Bebet dhe fëmijët, nën ndikimin e strukturave biologjike, shfaqin ndryshime të rregullta, sipas një rregulli të caktuar në sjellje, dhe si përfundim tek to ndodh pjekuria (Rice, 1997: 2). *Ndryshimet biologjike që ndodhin në organet e trupit, si dhe arritja prej tyre e funksionit për të cilën janë krijuar, përbën pjekurinë e njeriut.* Ky ndryshim është një ndryshim edhe në kontrollin e brendshëm të njeriut. Pjekuria është kushti i parë i mësimi. *Për të bërë dhe mësuar shumë gjëra në jetën tonë, duhet që si fillim të ndodhë pjekuria fizike dhe njohëse.*

3.4.3. Mësimi

Për t'u realizuar zhvillimi, bashkë me rritjen dhe pjekurinë është i nevojshëm edhe procesi i mësimi. Mësimi janë ndryshimet që ndodhin nga përjetimet dhe nga sjelljet që mbeten të përherëshme. Njeriu gjatë procesit të pjekurisë ndërvepron me mjedisin duke fituar eksperiencë, kësaj i referohemi si mësim. Fëmijët që kanë arritur një zhvillim të caktuar, duke vëzhguar prindërit apo mjedisin, e gjejnë veten duke mësuar sjellje të reja, me anë të mënyrës së të provuarit të gjërave. *Të mësuarit ndodh si rezultat i realizimit të ndërveprimeve të një individi me mjedisin.* Për të kryer disa veprime, bashkë me pjekurinë

është e nevojshme të merren edhe disa njohuri e aftësi. Për këtë arsye zhvillimi me pjekuri është një process që mësohet dhe formohet me veprime

3.4.4. Gatishmëria

Gatishmëria: është ardhja e njeriut në fazën që mund të bëj detyrën e zhvillimit përmes rrugës së pjekurisë dhe mësim. Detyra e zhvillimit, është sjellja që realizohet në një periudhë të caktuar të zhvillimit të njeriut. Për shembull, fëmijët në përgjithësi fillojnë të ecin kur janë 12 muajsh. Gjatë periudhës së rritjes vëzhgohen detyrat e zhvillimit të njërit sipas një radhe të caktuar, për çdo periudhë zhvillimi tregohet një integritet dhe vazhdimësi e caktuar. Për këtë arsye, *që të arrish të bësh detyrat e zhvillimit të një periudhe të mëvonëshme, si fillim duhet të keshë bërë detyrat e zhvillimit të periudhës së mëparëshme.* Në mënyrë të tillë, pra, duke bërë detyrat e zhvillimit të periudhës paraardhëse, njeriu përgatitet për periudhen pasardhëse. Gatishmëria është një gjendje e plotësuar, pasi për të realizuar një mësim të ri individi duhet të zotërojë mirë përjetimet e mëparshme dhe t'i ketë përvetësuar mirë ato (İnanç, 2005: 81).

3.5. Kriteret e zhvillimit

Kriteret e zhvillimit të njeriut, janë të gjithë kriteret universale që u përshatën harmonikisht njerëzve dhe që nuk ndryshojnë në varësi të kulturës, racës dhe origjinës. Zhvillimi njerëzor është realizuar në përputhje me këto parime. Kriteret i ndajmë në këtë mënyrë: (İnanç, 2005: 81).

1. Zhvillimi përbëhet nga ndërveprimi dhe pjesëmarrja mjedisore. Karakteristikat e marra nga prindërit me anë të pjesëmarrjes, zhvillimi i njeriut vihet re kur ai ndikon tek mjedisi.

2. Zhvillimi është i drejtë nga koka tek këmbët, nga qendra jashtë saj. Që prej ngjizjes pjesa e kokës së trupit të njeriut zhvillohet dhe rritet më parë se të tjerat. Pjesët e tjera të trupit rriten sipas radhës njëra pas tjetrës sëbashku me kokën.

3. Zhvillimi është i saktë nëse ndodh nga e përgjithshjma tek e veçanta, ai shikohet sipas një radhe të caktuar dhe është i vazhdueshëm. Zhvillimi i njeriut fillon me ngjizjen dhe vazhdon për gjatë gjithë jetës. *Periudhat e zhvillimit ndahen në dy grupe: **periudha përpara lindjes** dhe **periudha pas lindjes**.* Në periudhën pas lindjes bëjnë pjesë me radhë të gjitha fazat e rritjes, nga foshnjëria deri tek pjekuria. Brenda çdo faze shihen karakteristika të ndryshme.

4. Zhvillimi ndjek një kronologji të caktuar dhe është i vazhdueshëm. Zhvillimi është një tërësi që përfshinë të gjitha fushat, duke futur këtu, ***zhvillimin fizik, mendor, njohës, social, emocional** dhe **seksual***. Zhvillimet e një fushe të caktuar ndikohen nga zhvillimi i fushave të tjera.

5. Zhvillimi realizohet në mënyrë të integruar. Rritja dhe zhvillimi ndikojnë në fusha të tjera.

6. *Zhvillimi ka **diferenca individuale***. Procesi i zhvillimit të individit është i pavarur nga fundi i tij. Karakteristikat e trashëguara të individëve janë të ndryshme nga ato të

individëve të tjerë, po ashtu edhe ndikimi që kanë në mjedis është i ndryshëm nga ai i një tjetri.

Në rregullat e mësipërme të zhvillimit, periudhat e zhvillimit dhe mjedisi në të cilën ndodhet një fazë e caktuar, ndahen nga njëra-tjetra. Këto mund t'i emërtojmë si: *periudha e fëmijërisë, periudha e adoleshencës* dhe *periudha e pleqërisë*. Në çdo periudhë lidhja me fushat e tjera, siç janë: *zhvillimi social, fizik, mendor e moral*, merr emra dhe forma të ndryshme. Nga pikëpamja e edukimit, fushave të tilla si: *zhvillimi fizik, seksual* dhe *psikomotor* iu jepet hapsirë përpara fushave të tjera të zhvillimit, ku hyjnë, *zhvillimi mendor, social* apo *moral*. Përpara se të shqyrtojmë apo kalojmë tek fushat e zhvillimit, si fillim është me rëndësi të bëjmë një shpjegim lidhur me “*periudhat kritike*”.

3.6. Periudha kritike

Gjatë zhvillimit që të fitohen sjellje të caktuara është e nevojshme të ketë disa periudha. Një sjellje e caktuar nëse nuk mësohet në periudhën e saj, nuk mund të mësohet në periudhat e mëvonshme ose më e pakta bëhet tepër i vështirë mësimi i tyre. Këtyre periudhave u vihet emri, *periudha kritike*. Në lidhje me këtë periudhë merret shembulli i Viktorit, që është diku tek mosha 10-11 vjeç. Bëhet fjalë për një fëmijë të viteve 1800, në zonën pyjore të jugut të Francës. Viktori ishte në një gjendje që nuk fliste dhe ecte me këmbë e duar. Duke qënë se nuk ia tërhiqte vëmendjen asgjë, ai largohej i friksuar nga marrëdhëniet sociale me njerëzit. Me të u punua që të merrte edukim për një periudhë 5 vjeçare, Viktori mësoi vetëm disa fjalë. Përsëri jetonte i vetëm, duke mos krijuar marrëdhënie sociale. Studiuesit nga kjo situatë vunë re dy rregulla të rëndësishme të

zhvillimit: zhvillimi duhet të arrihet me kohë, ndërsa përvoja i përket periudhës kritike, çdo gjë mësohet duke përvetësuar si fillim karakteristikat e periudhës së mëparshme. Ky shembull jepet për të treguar rëndësinë e zhvillimit sipas kohës dhe radhës së gjërave (Seifert dhe Hoffnung, 1991: 14).

3.7. Fushat e zhvillimit

Studimi i zhvillimit bëhet duke e ndarë atë sipas fushave të tij. Ai përbëhet nga katër zona zhvillimi:

1. Zhvillimi fizik: zhvillimi i vazhdueshëm i geneve të trashëguara nga prindërit, zhvillimi i trurit, ndryshimet në aktivitetin fizik, përbërja hormonale dhe karakteristika të tjera si këto.

2. Zhvillimi mendor.

3. Zhvillimi psiko-seksual dhe psiko-social.

4. Zhvillimi moral. (Santrock, 1999: 17)

3.8. Periudhat e zhvillimit

Brenda fazave të zhvillimit, studiuesit e analizojnë atë në dimensionet e ndryshme. Sipas fushave që përfaqësojnë ata sjellin përkufizime të ndryshme: **Freudi** zhvillimin psikoseksual, **Erikson** zhvillimin psikosocial dhe **Piaget** zhvillimin njohës.

Tabela III.1 Periudhat e zhvillimit

<i>Faza</i>	<i>Mosha</i>	<i>Zhvillimi mendor</i>	<i>Zhvillimi psikoseksual</i>	<i>Zhvillimi psikosocial</i>	<i>Zhvillimi moral</i>
<i>Foshnjëria</i>	<i>0-18 Muaj</i>	<i>Ndjenja/Lëvizje</i>	<i>Gojor</i>	<i>Besim, mosbesim</i>	<i>Jokoshientë</i>
<i>Fëmijëria</i>	<i>18muaj-6 vjeç</i>	<i>Para veprimi</i>	<i>Mashkullor</i>	<i>Pavarësi, dyshim, iniciativë</i>	<i>Faza e parë</i>
<i>Periudha para pubertetit</i>	<i>6-12 vjeç</i>	<i>Veprime konkrete</i>	<i>Nënkuptuar / Latant</i>	<i>Angazhim, prapësi</i>	<i>Faza e dytë</i>
<i>Pubertetit</i>	<i>12-18 vjeç</i>	<i>Veprime abstrakte</i>	<i>Gjenital</i>	<i>Fitimi i identitetit, ngatërrimi i rolit</i>	<i>Faza e parë dhe e katërt</i>
<i>Rinia</i>	<i>18-30 vjeç</i>	=	<i>Gjenital</i>	<i>Imitimi/ Izolimi</i>	<i>Faza e pestë</i>
<i>Mosha e mesme</i>	<i>30-60 vjeç</i>	=	<i>Gjenital</i>	<i>Produktiviteti/ Recesioni</i>	<i>Faza e gjashtë</i>
<i>Pleqëria</i>	<i>60 e sipër</i>	=	<i>Gjenital</i>	=	=

Tabela: MC Devitt, T. M dhe Ormrod, J. E (2002), Zhvillimi dhe edukimi i fëmijës. New Jersey: botuar nga Pearson Education.

3.9. Zhvillimi moral

Në të gjitha kulturat, një nga detyrat bazë të socializimit është të sigurojë sjellje të mira gjatë zhvillimit të fëmijës dhe transmetojë një pjesë të mirë të bazave morale të fëmijës. Individit, i cili dëshiron të mbajë disa vlera të caktuara dhe realizojë disa sjellje të caktuara, ka një sistem rregullash që edhe pse mund të ndryshojnë nga kultura në kulturë, kanë një bazë të përgjithshme për sjelljet e drejta dhe të gabuara për shoqërinë. Pika më e rëndësishme për fëmijën është që t'i mësojë këto rregulla, në rast të mos përshtatshmërisë me të, të ndiejë shqetësim dhe ndihet në faj, ndërsa në rastet se përshtatet të sigurojë kënaqësi emocionale.

Zhvillimi moral është pjesa më e rëndësishme e zhvillimit të njeriut. Individët e një komuniteti, adoptimin e vlerave të ambientit në të cilin gjenden, e bëjnë përmes një procesi që synon krijimin e vlerave personale. Gjatë procesit të integritit të fëmijës në shoqëri është i rëndësishëm zhvillimi i vetëdijës rreth asaj çfarë është “*e mirë*” dhe asaj çfarë është e “*e keqe*”. Gjatë zhvillimit moral është shumë i rëndësishëm vetëkontrolli. Të gjitha ndjenjat, qofshin ato pozitive apo negative ndikojnë tek zhvillimi moral.

Një individ me zhvillim moral e kontrollon veten në bazë të rregullave dhe traditave të shoqërisë. Në se arrinë të kontrollojë vetveten dhe njerëzit që ndodhen në ambientin e përbashkët, atëherë ai demonstroi një zhvillim moral të qëndrueshëm. Qëllimi kryesor i zhvillimit moral është zhvillimi i parimeve universale të individit si dhe zhvillimi i koncepteve, “*e saktë*” dhe “*e gabuar*”, “*meritë*” dhe “*drejtësi*”, në përputhje me parimet e duhura (Aydın, 2003: 123).

Gjatë analizimit të zhvillimit moral tek fëmijët duhet të merren parasysh këto tre gjëra:

1. Si i kuptojnë fëmijët rregullat morale? Si i mendojnë ato?
2. Si sillen realisht me rregullat morale?
3. Çfarë ndjejnë mbi çështjet morale? (Santrock, 1999: 25).

Reagimet që merr nga mjedisi për sjellje të caktuara dhe përshtypjet e shprehura në lidhje me sjelljet morale janë thelbësore për individin. Edhe pse njerëzit i dinë rregullat morale, ata përsëri hasin vështirësi gjatë përshtatjes me to. Për këtë arsye, qëndrimet pozitive ndaj sjelljeve morale të fëmijëve ndihmojnë në përvetësimin dhe miratimin e

rregullave morale prej tyre. Çdo fëmije duhet t'i mësohen rregullat morale të shoqërisë ku jeton si dhe të pranojë *“të mirën”* dhe *“të drejtën”* (Santrock, 1999: 25).

Fëmijët i mësojnë sjelljet morale, në fillim nga nëna dhe babai, më pas nga ambienti ku ndodhen, nga shokët me të cilët shoqërohen, nga mësuesit dhe komuniteti. *Duke u rritur fëmijët zhvillojnë aftësinë e të kuptuarit të ndjenjave njerëzore dhe rregullave të shoqërisë.* Ndërkohë që niveli më i lartë i zhvillimit moral është, përshtatja me rregullat e shoqërisë të cilës i përket dhe mjedesin që e rrethon, dhe në të njëjtën kohë të arrijë të marrë vendime të drejta në mënyrë të pavarur dhe tregojë sjellje të përshtatshme.

3.10. Teoritë e zhvillimit moral

Koncepti moral, si fillim ishte temë që i përkiste filozofisë dhe fesë, më vonë u bë pjesë e njohurive psikologjike. Teori të ndryshme psikologjike u fokusuan në aspektet e ndryshme të zhvillimit moral. Psikologë të tillë, si *Sigmund Freud* e *Jean Piaget* filluan të merren me zhvillimin moral në fillimet e shekullit të XX. Më pas u ndoqën nga *Mësimet Sociale* dhe *Qasjet e Sjelljes* (Çileli, 1986: 9). Si rezultat i shqyrtimit të literaturës mbi zhvillimin moral është vënë re se ekzistojnë teori të ndryshme që shpjegojnë zhvillimin moral, se këto teori ndryshojnë nga njëra-tjetra. Nga të gjitha teoritë ekzistuese, më të përshtatshme për t'u pranuar, janë: *Teoria Psiko-Analitike*, *Teoria e Sjelljes* dhe *e Mësimet Social*, si dhe *Teoria e Zhvillimit Njohës* (Windler, 1995: 227).

3.10.1. Teoria psiko-analitike

Sigmund Freud (1856-1939), gjatë shpjegimit të përbërjes së njeriut dhe zhvillimit të tij, theksin kryesor e vë mbi zhvillimin e teorisë psiko-analitike të njeriut. Në të njëjtën kohë, zhvillimin moral të njeriut e analizon si nje process emocional paralel me zhvillimin e njeriut. Ai e analizon zhvillimin moral si proces të zhvillimit njerëzor, që ecën paralel me zhvillimin emocional. Zhvillimi i personalitetit është i ndarë në tre nën-sisteme: *uni, egoja dhe superegoja* (Çileli, 1986: 15).

“**Uni**”, është sistemi bazë i njeriut. Ai është bashkësia e të gjithë stimujve që ndodhen tek njeriu nga lindja. Si bazë janë stimujt seksual dhe të agresionit. Uni, kërkon kënaqësinë sipas punëve që kryen, këtë e bën në mënyrë të vazhdueshme. Ai i referohet perjetimeve dhe botës së fshehtë. Uni, nuk është në dijeni të botës së jashtme. Ai është fiks përtej botës së njohurive dhe është e vërteta përtej njohurive e rregullave.

“**Egoja,**” rezulton nga ndërvprimi i njeriut me mjedisin, ajo është elementi i vërtetë i bazuar tek njohurit e njeriut. Momentet e periudhës së njohurive formohen nga mendimet dhe ndjenjat. Egoja është rregulluesi i përbërjes së ndjenjave, është mundësuesi i ekuilibrit dhe përshtatjes. Funksione të tilla mendore, si: *egoja, arsyetimi, zgjidhja e problemit* dhe *vendimarrja* janë dëshirë e jashtme e unit. Të gjitha këto duke u përzier me *superegon* marrin një rol apo qëndrim pengues, dalin kundër dëshirave të unit. Egoja në një kuptim është përfaqësues i ID dhe vazhdimisht i tregon rrugën atij. Qëllimi i vërtetë i tij është t’i shërbejë uni dhe jo ta edukojë atë. Ajo nuk merret aspak me konceptet “*E mirë*” apo “*E keqe*”. Nëse situata është e përshtatshme i jep unit mesazhin “*Hajde bëje*”. Ajo nuk ka asnjë qëndrim moral. Egoja luan një rol të rëndësishëm. Egoja duke mos e zgjedhur mendimin, zonën, apo ndjenjën, bën që njeriu mos të ketë informacion në lidhje me këto.

Një ego selektive shumë e mirë i ngjan një aparati destilimi. Ngjarjet shpirtërore që i arrin vetë, mund të kenë shumë pak nivel vetëdije. Për këtë arsye nuk jemi në vetëdije të shumë përjetimeve të përditshme (Çağdaş dhe Seçer, 2002: 123).

“**Superegoja**”, është përfaqësuese e vlerave të brendëshme të vlerave tradicionale e shoqërore, transmetohet nga prindërit tek fëmijët përmes praktikave të ndëshkimit dhe shpërblimit. Është orientimi moral i njeriut. *Fëmija shpalos vlerat familjare, vlerat shoqërore dhe përcakton parimet morale dhe rolet përmes superegos.* Një ndërhyrje dhe pranim i tillë zhvillon ndërgjegjen. Superegoja dëshiron të veprojë sipas kriterëve të pranuar nga komuniteti dhe nga përfaqësuesit e tij duke përfshirë edhe ndalesat shoqërore. Ajo merr vendimin nëse sjelljet janë të drejta apo të gabuara. Superegoja zhvillon ndërveprimin midis fëmijës dhe të rriturve në mjedisin ku ndodhen. Superegoja përfshinë “*ndërgjegjen*” dhe “*individin ideal*”. Individin ideal për fëmijën është, personaliteti që fëmija kërkon të bëhet. Fëmijët vendosin në ndërgjegjen e tyre mënyrën e sjelljes që kërkojnë prindërit, për të mos u ndëshkuar dhe arrijnë të shpërblehen. Kjo vendosje, integrim i parimeve dhe mendimeve të prindërve realizon procesin e të mësuarit. Në mënyrë të tillë, fëmija fillon të përshtatet me rregullat edhe kur të tjerët nuk janë të pranishëm, duke u vetudhëzuar drejt moralit shoqëror (Güngör, 2003: 35).

Freudi mendon se morali është një problem social i të mësuarit që nuk është i lindur. Zhvillimi i personalitetit, paralelisht me të dhe zhvillimi moral, në të vërtetë realizohen gjatë fazave të zhvillimit që janë: *gojore, anale, mashkullore, latente dhe gjentiale.* Në të njëjtën kohë, formuesit e personalitetit, **ID**, egoja dhe superegoja, me përjashtim të superegos, dy ndarjet e tjera janë përfaqësuese të mira të moralit të njeriut. Zhvillimi i

superegos ndodh midis moshës 3 dhe 5 vjeç, por mund të rastisë edhe gjatë fazës së zhvillimit mashkullor. Gjatë kësaj periudhe fëmijët meshkuj përjetojnë karakteristikat e *Edipit*, ndërkohë që fëmijët vajza përjetojnë tiparet e *Elektrës*. Për arsye se nëna dhe babai janë të gjinisë së kundërt, në raste afrimiteti me prindin e gjinisë së kundërt ndjehen fajtor. Në fund të kësaj periudhe zhvillohet superegoja, vajza zgjedh të identifikohet sipas nënës dhe djali sipas babait, dhe në këtë mënyrë zgjidhet kompleksiteti i krijuar. Si përfundim fëmijët mësojnë rolet gjinore dhe rregullat e vendosura nga shoqëria (Freud, 1994: 92-93).

Sipas *Freudit* sjelljet njerëzore, si përfundim, shfaqen duke u ndërthurur me superegon. Superegoja formon fëmijërinë e njeriut së bashku me ndikimin nga më të rriturit. Përjetimet gjatë gjithë jetës ndikojnë në formimin e personalitetit të tij. Vlerat e trasmetuara nga familja dhe shoqëria si dhe rregullat morale e traditat përfaqësohen me superegon. Detyra kryesore e superegos është të shtypë ndjenjat që vijnë nga **ID** e nuk pranohen, si dhe ta drejtojë egon drejt qëllimeve morale (Freud, 1996: 23).

Nëna dhe babai janë burimi i parë dhe themelor i autoritet moral gjatë fazave të zhvillimit të fëmijës. Pa iu treguar fëmijëve dashurinë prindërore e sjelljet e përmbajtura, qëndrimet e ngurta dhe dënimet e ashpra kontribuojnë në zhvillimin e superegos (Yeşilyaprak, 2012: 126).

Freudi në fund të teorisë argumenton se personaliteti dhe zhvillimi moral i idnvidit plotësohet në 5 vitet e para të jetës. Por psikologë të tjerë, si: Peck (1936-2005) dhe *Havighurst* (1900-1991) nuk mendojnë se situata është kaq e ngushtë, por janë të mendimit se zhvillimi moral vazhdon edhe pas moshës 6 vjeçare. Së bashku me ta edhe vëzhgues të

Freudit, teoricienë si: *Eric Ericson (1902-1994)* dhe *Sullivan (1892- 1949)* duke e nxjerrë nga zhvillimi biologjik i japin rëndësi ndikimit social (Kağıtçıbaşı,1988: 249).

3.10.1. Eric Ericson

Eric Ericson, (1902-1994). Sipas tij, së bashku me përjetimet në familje gjatë viteve të para të jetës dhe momentet e rëndësishme në komunitet, zhvillimi i personalitetit është një process që zhvillohet e vazhdon gjatë gjithë jetës. Sipas *Freud* zhvillimi është një proces i pakohë, që ndodh gjatë fazave të ndryshme nga njëra-tjetra. Ai i përmbledh në 5 *faza kryesore: oral, anal, mashkullor, latant dhe gjenital*. Gjatë periudhës latente fëmija fiton parimet shoqërore. Ai vendos në plan të parë zhvillimin që i ndodh njeriut kur ndodhet në marrëdhënie me të tjerët, sipas tij zhvillimi fiton rëndësi, pikërisht, në këtë periudhë. Duke kaluar prej edukimit të *Freudit*, ai i bashkon mendimet e *Freud* bashkë me mendimin e vet lidhur me ndikimin që kanë marrëdhëniet me të tjerët tek zhvillimi. Ndërkohë që shumica e teorive të studiuesve pretendojnë se zhvillimi zakonisht përfundon në adoleshencë, *Freud* dhe *Ericson* janë të mendimit se karakteristika të zhvillimit vihen re edhe në moshë të rritur.

Në fakt, *Ericson* pohon një teori që tregon se zhvillimi shikohet gjatë gjithë jetës së njeriut. Baza e teorisë së tij është: përgjatë **8 fazave** të zhvillimit të njeriut dhe gjatë gjithë periudhave të zhvillimit, realizimi i detyrave biologjike dhe sociologjike të pritura nga një individ, bëhet duke u bashkangjitur emocionet. Në jetë njeriut, gjatë këtyre *8 periudhave*, i duhet të tejkalojë një seri krizash. Për kapërcimin me sukses të këtyre krizave luan një rol të rëndësishëm qasja dhe integriteti personal i njeriut. Mbështetja e marrë nga prindërit dhe

shkolla bëhet tipar pozitiv në zhvillimin e fëmijës. Fëmijët që jetojnë në një ambient të shëndetshëm e të sukseshëm, i tejkalojnë më lehtë krizat që hasin. Në këtë mënyrë, bëhet më i lehtë tejkalimi i fazave të tjera që has në jetë si dhe përshtatjen me situatat e reja (Coleman, 1980: 51).

Tabela III.2 8 Fazat e zhvillimit të njeriut sipas Eric Ericson

Nr	Periudha e Zhvillimit	Kriza e Zhvillimit
1	Periudha oral (0-1 vjeç)	Besimi Bazë / mosbesimi
2	Periudha anale (2-3 vjeç)	Pavarësia, Turpërimi, Paqëndrueshmëria
3	Periudha Gjinore (4-5 vjeç)	Iniciativa, Ndjenja e fajit
4	Periudha latente (6-11 vjeç)	Aftësitë, Kompetencat, Ndjenjë e paaftësisë
5	Adoleshenca (12-20 vjeç)	Fitimi i personalitetit, Ngratërimi i roleve
6	Periudha e rinisë (21-35 vjeç)	Marrëdhëniet e ngushta, Vetmia, Izolimi
7	Periudha e rritur (35-60 vjeç)	Produktiviteti, Joefikasiteti
8	Periudha e pleqërisë (e lartë)	Egoja, Integrimi, Dëshpërimi

Ericson refuzoi qasjen deterministe të *Freudit*, duke menduar se me anën e një qasjeje pozitive, njerëzit mund të përmirësojnë dhe rregullojnë gabimet e së shkuarës. Në teorinë e *Ericsonit* ambienti dhe kultura zënë një vend shumë të rëndësishëm. Sidomos kultura është faktor kryesor që ndihmon fëmijën në tejkalimin e krizave gjatë periudhave të zhvillimit. *Ericson* qartëson krizat, sjelljet dhe zhvillimin që shoqëron çdo periudhë zhvillimi. Sipas *Ericson*, periudha më e rëndësishme në jetën e njeriut është adoleshenca dhe për këtë arsye, ai i jep një vend të gjerë në teorinë e tij. Kjo është periudha kur, njeriu pyet veten “*kush jam unë?*” dhe kërkon përgjigjen e saj. Duke kërkuar përgjigjen e pyetjes *kush jam unë*, individi i jep vetes role të ndryshme. Kjo situatë i jep mundësinë fëmijës të

verë në funksion mekanizmin e imitimit dhe identifikimit. Ai fillon t'i imitojë të gjithë, *familjen, ambientin, shokët, mësuesit në shkollë*, me qëllim sigurimin e mjeteve për një komunikim masiv. Ata që arrijnë ta kalojnë me sukses këtë periudhë fitojnë identitetin e tyre, ata që nuk arrijnë ta kalojnë suksesshëm këtë fazë mbeten konfuzë në lidhje me rolin e tyre (Ewen, 1998: 223).

Pavarësisht se është pranuar gjerësisht, teoria e zhvillimit psiko-social të *Ericson*, shoqërohet me disa kritika. Idetë e paraqitura janë kryesisht bazuar në studime të kontrolluara, por që përbëhen edhe nga interpretime personale e subjektive. Në disa hulumtime të bëra për gratë duket qartë se teoritë zhvillohen si për meshkuj. Një kritikë tjetër që i bëhet kësaj teorie është se nuk shpejgohet bindshëm kalimi i fëmijës nga njëra periudhë në tjetrën. Gjithashtu në lidhje me konceptin e krizës së identitetit të sjellë në mënyrë popullore nga *Ericson* ngrihen diskutime të ndryshme, pretendohet se ky koncept mund të përgjithësohet për të gjithë të rinjtë.

3.10.1.1. Besimi themelor, mosbesimi

1. Periudha e parë: *Besimi themelor, mosbesimi (0-18 vjeç)*. Janë vitet e para të jetës. Kjo periudhë zgjat deri në një vjeç e gjysëm. Mund të quhet edhe si periudha ekuivalente me periudhën orale të periudhave të zhvillimit të *Freud*. Fëmijët e kësaj moshe mësojnë çfarë t'u jepet. Bazat themelore të besimit hidhen në këtë periudhë. Plotësimi i nevojave të fëmijës me qëndrueshmëri dhe stabilitet është një arsye e fortë e ndjenjës së besimit tek mjedisi. Nëse ndodh e kundërta, tek fëmija do të ndodhë po e njëjta gjë, do të trasmetohet mosbesim dhe paqëndrueshmëri e vazhdueshme. Një fëmijë i rritur në një

mejdís ku mungon vazhdimisht besimi, bëhet në të ardhmen i turpshëm dhe mosbesues tek vetja, për të ndërtuar marrëdhënie sociale. Ndryshe nga *Ericson, Frued* mendon se mungesat që fëmija has gjatë periudhës së zhvillimit, do të ndikojnë tek ai gjatë gjithë jetës. Nga ana tjetër *Ericson* pretendon se, këshillat mbi besimin fetar që fëmija i fiton prej prindërve, i transmetojnë atij besimin e brendshëm, kështu që për fëmijën bëhen bazë për të fituar besimin (Inanç, 2005: 153).

3.10.1.2. Autonomia, dyshimit dhe turpi

2. Periudha e dytë: Autonomia, dyshimit dhe turpi (18 muaj-3 vjeç). Kjo periudhë përfshinë moshën midis 18 muajve deri në tre vjeç. Vjen si ekuivalente e periudhës anale të *Frued*. Në këtë periudhë fëmijës i zhvillohet ndjenja e besimit dhe fiton besim se mund ta bëjë vetë një punë të caktuar. Për këtë arsye, duan të tregojnë se shumë punë mund t'i bëjnë vetë duke dashur që të jenë autonom në ato që bëjnë. Ata shfaqen të orientuar nga qëllimi duke u përpjekur të krijojnë komunikim verbal. Nuk duan që të jenë plotësisht të varur nga të tjerët. Me anë të përpjekjeve, ata përpiqen të rrisin besimin mbi rezultatet që do të arrijnë. Nuk duan që në punët që bëjnë t'u ndërhyjnë të rriturit. Nëse i pengojnë në punët që bëjnë inatosen dhe mërziten. Në kundërshtim me këtë, të rriturit kërkojnë që fëmijët, që në moshën dy vjeçare të veprojnë me norma siç kërkon shoqëria. Ata duan që fëmijët e tyre të jenë individë që përshtaten me shoqërinë. Kjo është nevojë e transferimit të kulturës. *Qëndrimet tepër mbrojtëse, kufizuese dhe ndëshkuese të prindërve, janë faktorë që pengojnë autonominë.* Fëmijët që nuk iu është dhënë mundësia, që nuk kanë përjetuar emocionin e kryerjes së një pune, në vitet e mëvonëshme bëhen të trembur, nuk mund të vendosin vetë, kanë mungesë vetëbesimi. Fëmijët që fajësohen vazhdimisht nga prindërit,

humbasin guximin, bëhen jo të suksesshëm e janë të zemëruar vazhdimisht. Si rezultat i kësaj mërziqeje shfaqet ndjenja e turpfit. Fëmijët e mësuar me tolerancën e prindërve, që e kanë ditur gjithmonë kufirin e përgjegjësive, kanë një zhvillim të shëndetshëm dhe me ndjenjë të lartë pavarësie (Bacanli, 2007: 91).

3.10.1.3. Iniciativa kundrejt ndjenjës së fajit

3. Periudha e tretë: *Iniciativa kundrejt Ndjenjës së Fajit (3-6 vjeç).* Kjo fazë është ekuivalente e periudhës mashkullore tek *Frued. Ericson* e përcakton këtë periudhë si koha e përcaktimit të seksit dhe si periudha e kureshtjeve të mëdha. Famija fillon të kuptojë në një mënyrë më të hapur rolin e vetes si dhe të pjestarëve të tjerë të familjes. Krijon marrëdhënie të ngushta me individët përreth. Për të zhvilluar aftësitë motorike ata marrin pjesë më shumë në marrëdhëniet shoqërore. Bëjnë kërkime të vazhdueshme për të shuar kuriozitetin dhe për të zbuluar gjërat e panjohura. Nëse dështojnë në këto veprime ata përshkohen nga një ndjenjë faji. Prindërit që i pengojnë fëmijët nga këto llojë veprimtarishë ktherhen në faktorë ndikues në zhvillimin e ndjenjës së fajit tek fëmijët duke përdorur kështu metoda të gabuara. Në këtë periudhë fillon të zhvillohet ndërgjegjja, koncepti i të drejtës dhe së gabuarës. Metoda e ndëshkimit për të kuptuar moralin nga prindërit bën që fëmija ta shikojë veten si fajtor. Së bashku me të parit të vetes si fajtor ai bëhet pengesë për të hyrë në ambientet sociale (İnanç, 2005: 67).

3.10.1.4. Shkathësia kundrejt ndjenjës së poshtërsisë

4. Periudha e katërt: *Shkathësia kundrejt ndjenjës së poshtërsisë (6-12 vjeç).* Kjo periudhë është ekuivalente e periudhës latente të zhvilluar nga *Frued*. Në këtë periudhë

përfshihen prindërit, mësuesit, anëtarët e tjerë të familjes si dhe bashkëmoshatarët e tjerë. *Në këtë moshë prindërit i japin guxim, mësuesi e mbron, ndërkohë që shokët e pranojnë.* Fëmijët, duke u përpjekur të prodhojnë e të arrijnë diçka, presin që rezultatin e këtij suksesi ta pranojnë edhe të tjerët. Fëmijët, po qe se shikojnë se si rezultat i suksesit lavdërohen, iu shtohet vetbesimi e përpiqen të japin më shumë nga vetja. Në të kundërt ata mendojnë se janë të pavlerë e sundohen nga ndjenja e poshtërimit. Problemi më i madh i kësaj moshe është inferioriteti dhe poshtërimi. Fëmija që zhvillon ndjenjën e poshtërimit nuk mund të krijojë marrëdhënie të shëndetshme me mjedisin dhe has probleme të keqpërshtatjes. Fëmijët që nuk motivohen mjaftueshëm, me të cilët mësuesit nuk përpiqen që ata të shfaqin aftësitë e tyre, humbasin vetëbesimin, zhvillojnë ndjenjën e poshtërimit dhe ndjenjën e inferioritetit. Për këtë arsye fëmijët kanë nevojë që prindërit dhe mësuesit t'u sillen në mënyrë pozitive që të mund të zhvillojnë vetëbesimin (Bacanli, 2007: 95).

3.10.1.5. Fitimi i identitetit kundrejt ngatërrimit të rolit

5. Periudha e pestë: *Fitimi i identitetit kundrejt ngatërrimit të rolit (12-18 vjeç).* Në varësi të hormoneve të ndryshme të sekretuara gjatë kësaj periudhe dhe ndryshimeve të mëdha në trup, fëmija është duke kaluar nga mosha e fëmijërisë në moshën e rritur. Duke u transformuar trupi i fëmijës në një trup të rritur, pritet që edhe roli të kalojë nga roli i fëmijës tek ai i të rriturit. *Fitimi i identitetit nga adoleshentët nuk është edhe aq e lehtë.* Kalimi i fëmijës nga identiteti i një fëmije tek identiteti i një të rrituri kërkon një serë përgjegjësishë dhe has në një serë problemesh. Në këtë periudhë shfaqet kriza e identitetit. Kriza, për të cilën e ka fjalën *Ericson*, nuk është e pranueshme për të gjithë. I riu i kësaj periudhe është në kërkim të përgjigjes për pyetjen **“kush jam unë”**. Për të krijuar

individualitetin e tij, si fillim kërkon që të shpëtoj nga ndikimi i prindërve. Kundrejtë kësaj, duke u përpjekur të krijojë personalitetin e tij, si fillim zbulon personalitetet e tjerë dhe kërkon modele të mundshme për veten e tij. Për këtë arsye, e identifikon veten me njerëz apo grupe të ndryshme. Në të vërtetë këta njerëz apo grupe nuk mund të sigurojnë individualitetin e të riut. I riu frikësohet nga marrja e përgjegjësisë sepse zgjedh të jetë kështu, ose mundohet të imitojë më të rriturit duke i demonstruar këto sjellje. I riu është në përpjekje të vazhdueshme për krijimin e një personaliteti të qëndrueshëm në vend të një personaliteti të përkohshëm. Edhe pse fitimi i identitetit është një proces që zgjat gjithë jetës, në këtë periudhë merr rëndësi të veçantë. Sepse në adoleshencë përballë me probleme të tilla si, *zgjedhja e profesionit, interesi për gjininë e kundërt*, etj. Duke qenë se i riu kërkon t'i zgjidhë këto probleme të individualitetit të mëparshëm, ai preferon të bëjë zgjedhje të reja në kërkim të një identiteti të ri. Në të njëjtën kohë i rritet interesi për çështjet shoqërore, duke shpjeguar pikëpamjen e vet për ato që i pranohen. Një mendim i tillë i hap të riut rrugë për marrëdhënie të reja dhe përpjekje të vazhdueshme për krijimin e individualitetit të tij. Në një periudhë të tillë i riu lumturohet kur vepron sëbashku me grupin. Kjo sjellje nuk është identiteti i vërtetë i adoleshentëve, por është reagimi i tyre për identitetin e vet kundër shoqërisë (Topçu, 1991: 24). *Ericson* ndalet shumë në këtë çështje dhe flet për periudhën e largimit nga problemet dhe etapën e marrjes së vendimeve mbi problematika të caktuara.

3.10.1.6. Afrimimeteti kundrejt largësisë

6. Periudha e gjashtë: *Afrimimeteti kundrejt largësisë (20-30 vjeç)*. Gjatë periudhës së adoleshencës përpiqet që të fitojë personalitetin, ndërkohë që gjatë kësaj periudhë

largohet nga masat e mëdha. I riu, tashmë, është gati të marrë përgjegjësi dhe të ndërtojë marrëdhënie më njerëzitet. Në këtë periudhë personi vendos standartet e bashkëshortit dhe familjes, është në një proces përpjekjeje për të arritur pavarësinë emocionale. *Marrëdhëniet me miqtë, të dashurit dhe me gjininë e kundërt fitojnë rëndësi*. I riu përpiqet të veprojë në kuadër të rregullave sociale në të cilën këto marrëdhënie ndërtohen, pasi fillon të bëhet më realist, dhe u jep fund konflikteve shoqërore. Miqësitë dhe shoqëritë e krijuara janë më të vërteta dhe punët e bëra janë më të vazhdueshme. Veprimeve emocionale ua zenë vendin ato më të logjikshme dhe më të menduara. Frika e lidhjes është ndjenja më e shpeshtë. Ndosht që kjo ndjenjë të jetë e shfaqur, por në shumicën e rasteve është e fshehtë. Në këtë periudhë dështimi bëhet shkak për zhvillimin e ndjenjës së vetmisë. Sidomos kur nuk krijon afrimet në rrethet miqësore, me bashkëshortin në shtëpi, largohet nga shoqëria dhe ndjenja e braktisjes është shumë e madhe (Inanç, 2005: 58).

3.10.1.7. Produktiviteti kundrejt recesionit

7. Periudha e shtatë: *Produktiviteti kundrejt recesionit (30-40 vjeç)*. Kjo periudhë përfshin moshën e mesme. Kjo është periudha që pritet të jetë më produktive në jetën e njeriut. Këtu koncepti i produktivitetit përdoret në kuptimin e krijimtarisë, vazhdimit të brezit dhe prodhimin e ideve. Karakteristikat e kësaj periudhe janë: *përgjegjësia ndaj fëmijës, rritja e fëmijëve, orientimi i tyre*. Këtu njeriu kërkon që të jetë i dobishëm për shoqërinë, aqsa edhe për familjen. Ata persona që nuk e përjetojnë këtë prodhimtari, pushtohen nga ndjenja e joefikasitetit. Sipas *Ericsonit* prodhimtari është **“nevoja e të qenit i nevojshëm”**. Një nga karakteristikat e kësaj periudhe është zhytja e njeriut me terpri në mos lënie të kohës për vetveten. Në anën tjetër joefikasiteti tregon hezitim dhe mospërpjekje për

të qenë i dobishëm. Kjo periudhë, në të njëjtë kohë, është dhe periudha e përjetimit të krizave të moshës. Bëhet pyetja *“pse punoj unë?”*, është koha e shfaqjes së një personaliteti egoist (Güngör, 1998: 43).

3.10.1.8. Integritet kundrejt dëshpërimit

8. Periudha e tetë: *Integritet kundrejt dëshpërimit (mosha 60 vjeç e lartë).* Kjo periudhë i përket moshës së pleqërisë. Në këtë periudhë të fundit të jetës së tij njeriu bën llogarinë e periudhave të mëparshme. *Nisur nga kjo bën autokritikë nëse e ka kaluar jetën kuptimplote apo jo.* Kërkon t’u japë përgjigje pyetjeve vlerësuse për jetën si; *“A munda ta jetoj mirë jetën e deritanishme?, A ia vlejti përjetimi i jetës?”*. Nëse njeriu ka mendimin se ia ka vlejtur jetimi i jetës, atëherë ai pajtohet me jetën, futet në integritet me veten. Nëse mendon se ka bërë një jetë të mbushur me pishmane, jeton në dëshpërim. Individët në këtë periudhë bëhen më të devotshëm dhe marrin pjesë më shumë në aktivitete social. Njerëzit produktivë në periudhat e mëparshme, këtë periudhë e kalojnë më kollaj. Kur pranojnë veten e kur shikojnë që pranohen nga të tjerët lumturohen shumë. Duke e pritur vdekjen me lehtësi , përpiqen që t’i jetojnë të lumtura vitet e fundit të jetës. Njeriu, i cili nuk ka arritur integritetin e vetes, duke menduar se e ka kaluar jetën kot, bie në dëshpërim. Humbja e fuqisë fizike, rënia e shëndetit dhe faktorë të tjerë si dalja në pension, shtojnë dëshpërimin e njeriut. Ai ka frikë nga vdekja dhe bëhet një person jo i lumtur (Aydın, 2003: 126).

Tabela III.3 Tabela e përmbajtjes së zvillimit psiko - social

Fazat	Kriza	Rezultati i ndodhur
0-18 muaj	Baza e besimit kundrejt mosbesimit	Lidhja me besimin ose mosbesimin

18 muaj- 3 vjeç	Autonomia kundrejt turpit	Suksesi ose dështimi në fitimin e pavarësisë
3-6 vjeç	Iniciativa kundrejt turpërimit	Miratimi nga shoqëria ose e kundërta
6-12 vjeç	Shkathësia kundrejt poshtërimit	Ndjenja e fajësisë ose e fajit
12- 18 vjeç	Fitimi i identitetit kundrejt ngatërimit të rolit	Fitimi i integritetit pozitiv ose negativ.
20-30 vjeç	Afrimiteti kundrejt largësisë	Ndërtimi i marrëdhënieve sociale pozitive ose negative me të tjerët
40-50 vjeç	Produktiviteti kundrejt jo efikasitetit	Fitimi i vlerave pozitive apo negative për familjen dhe shoqërinë
60 e sipër	Vet integriteti kundrejt dëshpërimit	Zhvillimi i integritetit apo të këqija në jetë.

3.11. Teoria e njohjes

Zhvillimi kognitiv, është procesi i zhvillimit që shpjegon dhe analizon se si një individ mund të hyjë në veprim dhe të marrë vendime që janë të pjekura moralisht. Dy teoricienët më të rëndësishëm që analizojnë zhvillimin moral duke e përafuar atë me zhvillimin mendor janë: *Jean Piaget (1896-1980)* dhe *Lawrence Kohlberg (1927-1987)*. Shkencëtari zviceran *J. Piaget*, avancoi teorinë duke u dhënë një shpjegim më të gjerë teorive njohëse të zhvillimit. Veç kësaj ai njihet si teoricieni që bëri për herë të parë një shpjegim sistematik mbi zhvillimin e gjykimit moral në punimin me titull: **“Gjykimi moral i fëmijës”** (Moral Judgment of the Child, 1932). Duke ndjekur atë, *L. Kohlberg* ideoi një teori të zhvillimit moral ku, si bazë e teorisë ishte teoria njohëse e zhvillimit mendor të *Piagetit* (Can, 2004: 127).

3.11.1. Jean Piaget

Jean Piaget (1896–1980). Ai zhvilloi një teori që erdhi si rezultat i vëzhgimit të kujdesshëm, bërë gjatë shumë viteve mbi zhvillimin mendor të fëmijëve, mbi aftësitë e të menduarit dhe arsyetuarit, si fëmija kalon në faza të ndryshme duke u pjekur. Në librin e tij **“Zhvillimi i gjykimit moral tek fëmijët”** (1932), ai sqaron zhvillimin moral tek fëmijët. Për të sqaruar zhvillimin moral tek fëmijët, ai zhvillon një teori në bazë të gjykimeve njohëse, sqaron qëndrimet e fëmijëve kundrejt rregullave shoqërore, kuptimin e së drejtës dhe të gabuarës. Gjatë lojës ai i pyet fëmijët në lidhje me këto rregulla, nga vijnë ato rregulla, nëse duhet që të gjithë t’u përshtaten rregullave, nëse ndryshojnë apo jo, ato. *Piageti*, në këtë studim klasik i vëshgon fëmijët duke luajtur *“misket”*. E zhvillon atë duke u bazuar tek rregullat. *Piageti* teorinë e tij *kognitive-njohëse*, e përmbledh duke e pranuar inteligjencën si një nga pjesët e funksionit biologjik dhe zhvillimin mendor si një zgjatim të zhvillimit biologjik, i cili ndodh duke u përshtatur me mjedisin (Ginsburg dhe Opper, 1988: 8).

*Sipas Piaget, zhvillimi mendor, realizon lidhjen me mjedisin nëpërmjet asimilimit, përshtatjes dhe organizimit. Analizues, për vite me radhë i zhvillimit mendor tek fëmijët, Piaget në fund të kërkimeve të tij konkludon se fëmijët shfaqin karakteristika të ndryshme strukturore duke ndjekur një rend hierarkik të ndarë në katër periudha bazë të zhvillimit mendor: **periudha e lëvizjeve të ndjeshme** (0-2 vjeç), **periudha para-operative** (2-7 vjeç), **periudha e veprimeve konkrete** (7-11 vjeç) dhe **periudha e veprimeve abstrakte** (11 vjeç e lartë). Ndërkohë që, përsa i përket moshës post-adoleshente është i mendimit që nuk ndodh ndonjë ndryshim i rëndësishëm mendor (Crain, 2005: 115).*

Piaget avancoi më tej me punën e saj mbi zhvillimin moral, duke argumentuar se në rrymën e zhvillimit moral janë të pranueshme edhe teoritë e zhvillimit mendor, pasi zhvillimi mendor dhe zhvillimi moral shfaqen paralelisht. *Piaget* për të analizuar gjykimin moral tek fëmijët ka vëzhguar lojrat e tyre, veç kësaj ka zhvilluar dy tregime të shkurta. Fëmijëve të moshave të ndryshme u tregon rregdhën dhe rregullat e lojës duke u bërë pyetje në lidhje me tregimet, më pas analizon përgjigjet e dhëna. Në fund të studimit, ajo i ndanë periudhat e moralit në **tre grupe**: *periudha e moralit* që varet nga faktorët e jashtëm, *periudha e para moralit* dhe *periudha e moralit autonom*. *Piaget* transformon në mënyrë të rregullt, zhvillimin moral, zhvillimin mendor dhe periudhën e moralit që lidhet me moshën deri tek morali autonom. *Piaget* për të analizuar gjykimet e fëmijëve, bën pyetje të ndryshme bazuar tek tregimet që janë në shembullin e dhënë prej tij. Ai i pyet të gjithë fëmijët në tregim, nëse janë në të njëjtin nivel fajtor, se cili fëmijë është më i llastuar e pse është i llastuar sipas gjykimit të tyre (Güngör, 2003: 75).

Historia 1: Një fëmijë të vogël, ndërkohë që po luan, e thërret e ëma për të ngrënë bukë. Fëmija hap derën e dhomës së ngrënies, përplas tepsinë që ndodhet në tryezën pas derës, ajo bie përtokë, bashkë më të bien e thyhen edhe **10 gotat** që ishin aty.

Historia 2: Një fëmijë tjetër kërkon, që të marrë në mënyrë të fshehtë, kavanozin me gurabije që ndodhet në katin e fundit të dollapit të kuzhinës. Duke dashur të marrë kavanozin, e përplas atë me gotat përballë dhe thyen një të një prej tyre.

Sipas *Piagetit*, fëmijët që futen në grupmoshën nën **9 vjeç**, e vlerësojnë një ngjarje si të drejtë apo të gabuar duke parë më të rritur e tyre, nuk i japin rëndësi faktit nëse sjellja është

e qëllimshme apo jo. Në shembujt e mësipërm, fëmija që thyen 10 gota është më fajtor se fëmija që thyen 1 gotë. Ndërkohë që fëmijët e grupmoshës më të madhe se **10 vjeç**, kur vlerësojnë një sjellje shikojnë qëllimin edhe e gjykojnë atë në bazë të nevojës që ka (Güngör, 2003: 56).

Në fund të kërkimit, ajo i ndanë periudhat e moralit në tre grupe: *periudha e moralit heteronome*, *periudha e moralit auotonom* dhe *periudha përpara moralit*. Ajo sqaron se zhvillimi moral është në një vijë të drejtë me zhvillimin mendor e lidhet me moshën, ndërkohë që periudha përpara moralit zhvillohet përpara periudhës autonome (Piaget, 2005: 194-198).

Periudhat e zhvillimit njohës sipas Piagetit: Pyetja kryesore që ngre *Piageti* është *“a nuk dinë asgjë fëmijët kur vijnë në këtë botë, dhe si ndodh që nga kjo gjendje ata arrijnë të mendojnë si t ë rriturit”*. Ajo përpiqet të kuptoj se si njeriu arrin të mendojë si i rritur. Përgjigjja e kësaj pyetje gjendet në periudhën e zhvillimit mendor. *Piaget* e vendos periudhën e zhvillimit mendor përpara periudhave të tjera.

3.11.1.1. Periudha e ndjenja - veprimeve

1. Periudha e ndjenjave-veprimeve (0-2 vjeç). Ndjenjat dhe veprimet motorike vijnë në plan të parë. Nuk ka akoma një mendim të vërtetë. Nuk ka asnjë logjikë në arsyetim dhe mendim. Reflektet lidhen me zhvillimin njohës. Fëmijët e kësaj periudhe i kryejnë duke marrë parasyshtë gjendjen e organeve dhe aftësinë e trupit për të vepruar (Yavuzer, 1992: 26).

3.11.1.2. Periudha përpara veprimeve

2. *Periudha përpara veprimeve (2-6 vjeç).* Në këtë periudhë mendimet logjike nuk janë zhvilluar akoma. Fëmija zhvillon njohuritë në bazë të simboleve. Edhe simbolizimi merr formën e imitimit. Fëmijët ose zhvillojnë simbolet e tyre ose përdorin simbole të gatëshme. Mendimet janë vetëm njëdrejtimëshe. Fëmijët e kohës së fundit të kësaj periudhe mund të bëjnë klasifikime dhe zhvillojnë gjuhën (Bacanli, 2003: 36).

3.11.1.3. Periudha e operacioneve konkrete

3. *Periudha e operacioneve konkrete (7-11 vjeç).* Veprimi me anë të bërit, të jetuarit e duke përdorur shqisat, janë karakteristika kryesore të kësaj periudhe. Ndërkohë që klasifikimin dhe renditjen e gjërave e bëjnë shumë kollaj, fëmijët përgatiten të fillojnë mendimin logjik. Ata arrijnë të ndajë imagjinatën nga e vërteta dhe përqëndrohen tek kjo e fundit (Can, 2004: 123).

3.11.1.4. Periudha e veprimeve abstrakte

4. *Periudha e veprimeve abstrakte (11 vjeç e lartë).* Sipas *Piagetit*, së bashku me adoleshencën fitohet karakteristika e të menduarit si i rritur. Mund të mendojë në mënyrë abstrakte. Në këtë periudhe mund të zhvillohet hipoteza, mund të bëj veprime bazuar tek logjika. Një aspekt tjetër i kësaj periudhe është kombinimi i ngjarjeve. Krijon sjelljen e tij të bazuar tek mendimet e tij. Mendimet janë më tolerante dhe më fleksibël. *Një nga karakteristikat e tjera të periudhës së adoleshencës është edhe egoizmi.* Të rinjtë e kësaj

periudhe mendojnë se mund të ndryshojnë botën. Mendojnë se mendimet e tyre janë mendimet më të drejta (Yavuzer, 1992: 30).

3.11.1.5. Periudha përpara moralit

Kjo periudhë njihet edhe si periudha e centralizimit. Fëmijët e moshës *4 deri në 7 vjeç* futen në grupin e fëmijëve të periudhës së para moralit. Në këtë moshë vihen re veprime që u përshtaten rregullave. Të gjithë u përshtaten rregullave të tyre. Fëmijët e kësaj moshe besojnë se rregullat e vendosura apo autoriteti i pranuar (*nënës, babit apo Zotit*) janë të shenjtë dhe të pandryshueshem. Pavarësisht kësaj, akoma, ndodhin shkelje të rregullave, sepse fëmija nuk është zotërues i mendimeve dhe ngjarjeve që vijnë nga jashtë. Rregullat e pranuar në mënyrë të pakuptuar i përshtat sipas vetes.

3.11.1.6. Periudha e varur nga jashtë. Periudha heteronome

Në këtë periudhë bën pjesë grupmosha e fëmijëve që ndjekin shkollën fillore, pra *fëmijët nga 6 deri në 10 vjeç*. Ata mendojnë se rregullat janë të pandryshueshme dhe se të gjithë duhet t'u binden këtyre rregullave. Pavarësisht përvetësimit të mirë të rregullave prapë se prapë vihen re gabime sporadike. Përsa u përket gjykimeve morale fëmijet janë të lidhur me të tjerët. I pranojnë rregullat e të rriturve pa pyetur. Me fëmijët e grupmoshës është edhe bashkëpunues edhe konkurrentë. Në këtë moshë famija di të vendos rregulla e t'u bindet atyre, por në të njëjtën kohë, ai beson se mund të ndryshojë rregullat po qe se është e nevojshme (Yavuzer, 2006: 78).

3.11.1.7. Periudha e pavarësisë. Bashkëpunimi i vërtetë

Mosha 11 dhe 12 vjeç është periudha e zhvillimit të moralit. Fëmija është zoti i rregullave të tij dhe në të njëjtën kohë zbatuesi i tyre. Nuk është i kënaqur me rregullat. Në këtë periudhë rregullat janë të mirëpërcaktuara e zbulohen edhe rregulla të reja. Vihen re sjellje *si reciprociteti* dhe *solidariteti*. Fëmijët mundohen të përtypin rregullat dhe t'i vlerësojnë ato, jo sipas rezultatit, por sipas qëllimit e kushteve. Në qoftë se bashkëpunon me shokët mund të ndryshojë edhe rregullat. Sidomos në këtë periudhë, fëmijët besojnë se rregullat shoqërore dhe gjykimet morale ndyshojnë. Ato mund të dalin edhe jashtë rregullave (Hetherington, 1993: 224).

Shmangien nga rregullat e mendojnë gjithmonë si të gabuar. Për shembull, nëse shpëtimi i jetës së dikujt është çështja kryesore, pranojnë që ambulanca t'i kalojë limitet e shpejtësisë (Güngör, 2003: 25). Prindërit nuk shikohen si vendosës të autoritetit. Fëmijët e kësaj periudhe janë duke kaluar fazën e veprimeve abstrakte të zhvillimit njohës të Piagetit. P.sh.: fëmija që të merret vesh me të tjerët nuk duhet të thotë gënjeshtër. Për fëmijët, të thuash të vërtetën në të njëjtën kohë, do të thotë të ndërtosh marrëdhënie të mira me të tjerët. Tashmë nuk i bën veprimet si rezultat i ndonjë ndëshkimi të mundshëm, por fillon të mendojë, se nuk është e drejtë të thuash gënjeshtër, se për të jetuar duhet të jeshë i përgjegjshëm. *Ky bashkëpunim është morali*. Përsëri autoriteti, i vendosur nga prindërit tek fëmijët, është prezent, por gjithësesi fëmija fillon të veprojë bazuar në eksperiencat e tij. Në mënyrë të tillë fëmija në vend të autoritetit, urdhërave dhe komandimit, fillon të hyjë në marrëdhënie bashkëpunuese. Rregullat nuk janë një rend i vendosur nga Zoti apo nga më të

rriturit, por janë marrëveshje të vendosura midis njerëzve për të arritur qëllime të caktuara (Çağdaş dhe Seçer, 2002: 120).

*Piaget mendon se mendimet e fëmijëve lidhur me tema si: **drejtësia dhe morali, mund të ndikohen në varësi të mjedisit dhe të pjekurisë, por për të konceptuar rregullat morale duhet të përparojë edhe zhvillimi i tij.***

Në këtë periudhë përfundimet e sjelljeve morale nuk kanë rëndësi, ajo që merr rëndësi është qëllimi i fshehur në të. Në këtë fazë fëmija me anë të empatisë zgjeron prespektivën e tij, mundohet të kuptojë pikëpamjet dhe mendimin e fëmijëve të tjerë. Sipas *Piagetit*, bashkë me zhvillimin moral të fëmijës është zhvilluar edhe kuptimi i drejtësisë (Çağdaş dhe Seçer, 2002: 124).

Tabela III.4 Hapat e zhvillimit moral sipas Piagetit

Hapat e moralit- të varura nga të tjerët	Hapat e moralit- të pavarura
<p style="text-align: center;"><u>Karakteristikat</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Absolute-Rregullat e pamohuara • Nuk i ndryshon rregullat asnjëherë • Vendosësi i rregullit është autoritar (Prindërit apo Zoti) • Sjelljet nuk janë të lidhura me qëllimin • Mund t'i shkelë rregullat një nga një 	<p style="text-align: center;"><u>Karakteristikat</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njëjtit rregull mund të mos i bindet në çdo vend apo kohë • Shkelja e rregullave ndryshon në bazë të kushteve dhe qëllimit • Rregullat mund të ndryshojnë sipas grupit.

3.11.2. Kohlberg

Lawrence Kohlberg (1927-1987). Ai zhvilloi edhe më tej teorinë e zhvillimit moral të *Piagetit*, duke u përqëndruar më shumë tek zhvillimi i gjykimit moral të bazuar tek fëmijët, duke u marrë më shumë me adoleshentët dhe të rriturit se sa fëmijët. Teoria e zhvilluar prej tij është teoria më e përdorur përse i përket zhvillimit moral. Ndërkohë që *Piageti* e sheh zhvillimin moral si një proces ndërtimi, *Kohlberg* i shikon parimet e moralit universal si një proces eksplorimi (Hetherington and Parke, 1993: 124). *Kohlberg* kur shqyrton zhvillimit moral është ndalur më shume tek konceptet e drejtësisë duke e ndarë në tre nivele. *Këto tre nivele kryesore i ndanë më tej secilin në nga dy periudha, duke bërë në total një ndarje prej 6 periudhash.* Çdo niveli duhet t'i jepet rëndësia e duhur, të fillojë përpara se fëmija të hyjë në nivelin tjetër. Sipas *Kohlberg*, individi ndodhet në dilemë morale, e krijon botëkuptimin e tij mbi moralin sipas reagimit moral që i jep dikujt. Këto periudha do të jepen më poshtë në formë të përmbledhur (Rest, 1983: 213).

3.11.2.1. Niveli përpara traditës

Është niveli më i ulët. Në gjykimet morale të fëmijëve mbizotëron egocentrizmi. Fëmija i vlerëson ngjarjet sipas rezultateve.

Faza 1. Bindja ndaj autoritetit dhe ndëshkimit: Përulet për të mos u ndëshkuar nga rregullat. Fëmija duke kërkuar të dijë nëse një sjellje është e drejtë apo e gabuar, shikon përfundimin e saj. Për të, sjellja që të ndëshkon është e gabuar, kurse sjellja që nuk të ndëshkon është e drejtë. Fëmija nëse beson që nuk do të ndërshkohet, atëherë i shkel rregullat. Fëmija pranon se është i lidhur me rregullat. Individi i kësaj periudhe nuk do t'ia

dijë për dëshirat e dikujt tjetër. Pikëpamjet e personit autoritat nuk i ndanë nga pikëpamjet e veta.

Faza 2. Individualizmi apo dobishmëria: Gjykimi moral bazohet tek rezultatet e dobishme të fituara prej individit. Fëmija në plan të parë vendos nevojat e tij, pastaj mendon për nevojat e të tjerëve. Nëse ka pasur dobi nga ndonjë sjellje për të, ajo është dhe sjellja e drejtë. Kështu që përshtatet me rregullat kur e shikon të nevojshme. Për fëmijën çdo gjë është kundër, mendimet e tij i gjen kundër të tjerëve. Në këtë priudhë është i rëndësishëm kuptimi i drejtësisë dhe barazia financiare. Çdo gjë që e bën të lumtur është “*e drejtë*”, është karakteristika kryesore e kësaj periudhe.

3.11.2.2. Niveli i traditës

Në këtë nivel vendin e egocentrizmit e zë mendimi empatik. Mendim empatik do të thotë t'i shohësh gjerat me syrin e të tjerëve. Merr parasysh rregullsinë e shoqërisë. Shumica e njerëzve ndodhen në këtë nivel.

Faza 3. Përshtatja midis njerëzve: Të qënurit i mirë, të marrurit me të tjerët, të qënurit i besueshëm dhe i drejtë, përshtatja me rregullat janë karakteristikat kryesore të kësaj periudhe. Pranojnë dhe mbështesin vendosësin e autoritetit. Fëmija bën veprime në përshtatshmëri me pritshmëritë e grupit në të cilin ndodhet. Për të marrë vlerësimin apo miratimin e njerëzve që për të janë të rëndësishëm, apo nga mjedisi rrethues që e vlerëson, bën vetëm ato veprime që janë të pranueshme nga këto njerëz. Në këtë mënyrë, duke u sjellë në mënyrë të tillë mendon se mund të fitojë dashurinë e nënës, babait, mësuesit apo shokëve.

Faza 4. Përshtatja me rregullat dhe ligjet: Kjo është një fazë në të cilën fëmija përpqet të veprojë bazuar tek rregullat përkatëse ligjore dhe sipas normave të sistemit shoqëror. Kjo fazë përfaqëson një ndenjje shumë të zhvilluar të moralit. Individët mësojnë të respektojnë të drejtat e individëve të tjerë.

3.11.2.3. Niveli pas traditës

Kjo është periudha e parë e moralit. Individu pranon parimet dhe vlerat morale të të tjerëve dhe i përshkruan këto parime duke i përshtatur sipas kushteve të tij. Në këtë periudhë fëmija është i pavarur nga vendsosësi i autoritetit, e zhvillon parimet e tij morale autonome. Shumë pak njerëz arrijnë ta kuptojnë moralin në këtë periudhë.

Faza 5. Marrëveshja shoqërore: Ligjet dhe rregullat që duhet të përshtatin individët, për arsye të dobishmërisë së tyre janë edhe të nevojshme. Ligjet zbatohen për të ruajtur rendin shoqëror, liritë themelore dhe për të garantuar jetesën. Për të plotësuar nevojat e komuniteti është i pashmangshëm zëvendësimi i rregulave të pamjaftueshme. Ligjet mund të ndryshohen në mënyrë demokratike.

Faza 6. Marrëdhëniet e moralit universal: Kjo periudhë përbëhet nga konceptet dhe parimet morale në nivel universal, përtej legjislacionit social dhe moralit individual. Mes konfliktit të rregullave sociale dhe parimeve morale universale, kjo fazë zhvillon kuptimin e duhur të moralit dhe individit demonstroi sjellje të përshtatshme me parimet universale të moralit.

Kohlberg mendon se pothuajse të gjithë fëmijët deri në moshën 10 vjeçare futen në periudhën e parë. Fëmijët pas moshës 10 vjeçare futen tek periudha e dytë, duke treguar sjellje që ndikojnë edhe tek të tjerët. Përsa i përket fazës më të lartë, asaj të gjashtë, mendon se vetëm mendimtarë si *Gandi* apo profetë si *Muhamedi* mund të arrijnë një nivel të tillë.

Tabela III. 5 Fazat e zhvillimit moral të Kohlberg

Periudhat dhe fazat	Karakteristikat
Periudha 1: Para Traditës	Niveli më i ulët ku egocentrimi moral është i theksuar.
Faza 1: Bindja ndaj autoritetit dhe ndëshkimit	Gjatë formulimit të gjykimeve morale, merr vendimet duke mos u dhënë rëndësi ndjenjave dhe mendimve të të tjerëve
Faza 2: Individualizmi	Individualizmi apo dobishmëria.
Periudha 2: Tradita	Është periudha ku zënë vend mendimet empatike.
Faza 3: Përshtatja midis njerëzve	Gjykimet morale formohen duke vlerësuar dhe marrë parasysh pritshmëritë e grupit, me qëllim
Faza 4: Përshtatje me ligjet dhe rregullat	Vepron bazuar tek rregullat përkatëse ligjore dhe sipas normave të sistemit shoqëror.
Periudha 3: Pas traditës	Përshtatja midis njerëzve.
Faza 5: Marrëveshja shoqërore	Rregullat dhe ligjet e shoqërisë janë ruajtëse të sigurisë. Rregullat e pamjaftueshme të shoqërisë duhen ndryshuar
Faza 6: Teoritë e Moralit universal	Ka pak njerëz që i përkasin parimeve të moralit universal.

3.11.2.4. Dilema Henze e Kohlberg

Gjatë kërkimeve të bëra për zhvillimin moral *Kohlberg* ka përdorur disa histori ku analizon se si i gjykojnë njerëzit teoritë e moralit. Njëra nga historitë në fjalë është edhe dilemma *Henz*.

Dilema e famshme e Henzit:

Një grua e sëmurë që vuan nga një lloj kanceri i veçantë është në shtratin e vdekjes. Mjekët besojnë se ekziston një ilaç që mund ta shpëtojë gruan. Ky ilaç ishte përmendur nga një farmacist në qytet kohë më parë. Çmimi i ilaçit është shumë i shtrenjtë. Ndërkohë, që edhe farmacisti nga ana e tij, kërkon më shumë se sa vlente në të vërtetë ilaçi. Ilaçi kushton 200 \$, farmacisti kërkon 2000 \$. Burri i gruas së sëmurë, *Henz*, kërkon para borxh nga të afërmit dhe institucionet zyrtare që ta mbështesin. Në fakt, vetëm 1000 \$ arriti që të mblidhte, dmth, sa gjysma e çmimit të ilaçit. *Henz* shkon tek farmacisti dhe i lutet t'ia japë më lirë ilaçin, duke i shpejguar se gruaja e tij është duke vdekur, ose që t'ia shlyejë pjesën e mbetur në një kohë të mëvonshme. Farmacisti i thotë: “Unë këtë ilaç e kam shpikur për të fituar para”. *Henz* përdor të gjitha mënyrat legale: kokën e ka të trubullt dhe mendon nëse duhet ta vjedhë apo jo ilaçin e nevojshëm për të shpëtuar të shoqen nga vdekja. A duhet që *Henzi* ta vjedhë ilaçin? Pse po, ose pse jo? (Kohlberg, 1969: 65).

Pyetjeve të ngritura nga *Kohlberg* nuk mund t'u jepet një përgjigje e vetme dhe e prerë. *Ajo ndryshon nga shoqëria në shoqëri, në vartësi të ndikimit fetar e social prej të cilët janë ndikuar rregullat morale*. Edhe pse punimi i *Kohlberg* në përgjithësi pranohet, në disa aspekte duhet bashkuar. Mungesa e vlefshmërisë së përgjithshme e mjeteve matëse të përdorura dhe mungesa e lidhjes së duhur midis mendimit moral dhe sjelljes morale. Koncepti nuk mund të ndahet në terma të saktë, dhe për t'iu përgjigjur dilemës duhet që të bashkohen të gjitha periudhat në të njëjtën kohë (Gökner, 2004: 126).

3.11.3. Carol Gilligan

Carol Gilligan (1936-), deklaron se mjedisi është në ndërveprim me moralin dhe etikën e njerëzve. Ai sqaron se morali kalon nëpër *tre faza* dhe se ***dashuria dhe mëshira*** janë bazat e tij. Sipas *Gilligan*, e rëndësishme në zhvillimin moral nuk është arritja e periudhës pasuese, siç shpjegon *Kohlberg*, por morali është fitimi i dashurisë. Ai, gjithësesi, mbron idenë e diferencave midis gjinive në zhvillimin moral. Meshkujt besojnë se baza e kuptimit moral është drejtësia, ndërkohë që femrat mendojnë se janë marrëdhëniet (Selçuk, 2005: 75).

3.11.4. John Dewej

John Dewej (1859-1952), është teoricieni i parë që zhvillimin moral e studion duke marrë paralelisht në konsideratë zhvillimin kognitiv. *Dewej* mendon se zhvillimi moral i individit ka lidhje me edukimin dhe zhvillimin e sistemit të vlerave në edukim. Në këtë proces edukimi ato që i ndikojnë sjelljet janë mendimet morale, në mënyrë të tillë janë hedhur bazat e gjykimit moral. Sipas *Dewej* zhvillimi moral ndahet në ***tre periudha*** (Yavuzer, 2006: 78).

Periudha para traditës dhe moralit: periudha kur individët bëjnë sjellje morale të ndikuara nga prejardhia biologjike e sociale.

Periudha e traditës: periudha kur individi përvetëson vlerat e grupit ku gjendet.

Periudha autonome: periudha kur sjelljet e individit kryhen duke i marrë vetë vendimin dhe vendos në pikëpyetje përvetësimin e sjelljeve të grupit gjendet.

3.12. Teoria e sjelljes dhe e mësimit social

Teoricienët e sjelljes dhe mësimit social i pranojnë sjelljet morale si sjellje mësimi. Proceset e mësimit që kryhen për të fituar sjelljen morale janë: *kushtëzimi, dënimi, shpërblimi, përforcimi, modeli* dhe *falsifikimi* (Çileli, 1986: 19).

Teoritë e mësimit të sjelljes janë themeluar gjatë viteve 1878-1958 nga John B. Watson. Ndërkohë që përfaqësues të tjerë të rëndësishëm të kësaj teorie janë: Ivan Petrovich Pavlov (1849-1936), Edward L. Thorndike (1874-1949), Edwin R. Guthrie (1886-1959), Clark L. Hull (1884-1952) dhe B. F. Skinner (1904-1990). Bazuar tek kjo teori vetëm sjelljet e dukshme, të prekshme, të matura, merren në vlerësim dhe llogaritje. Ndërkohë që sjelljet e tjera të vëzhgueshme, që nuk mund të maten, si: *ndjenjat, motivet, mendimet*, etj, refuzohen (Skinner, 1976: 24-29).

Sipas kësaj teorie, sjelljet morale janë sjellje të mësuara prej ndikimit të mjedisit dhe kushtëzimit të rezultatit. Ndikimi dhe roli i mjedisit është i rëndësishëm në zhvillimin moral. Sipas teoricienëve të mësimit të sjelljes *Pavlov e Skinner*, morali mësohet si rezultat i kushtëzimit nga ndikimi klasik i dënimit dhe shpërblimit. *Se cili veprim është i drejtë, e cili i gabuar, përfitohet duke e përforcuar përmes shpërblimit dhe dënimit. Ai që përforëcohet me anë të shpërblimit pranohet si i mirë, ai që përforëcohet me anë të dënimit pranohet si i keq* (Skinner, 2001: 6–11).

Fëmija i mëson sjelljet e mira dhe të këqija duke vëzhguar mjedisin dhe duke e imituar atë. Ata që formësojnë zhvillimin moral të fëmijës janë: *prindërit, shokët, grupi* dhe *mësuesit*. Për të arritur këtë, *mekanizimi i ndëshkimit dhe i shpërblimit zënë një vend të*

rëndësishëm për të marrë modelin e duhur e për ta imituar atë. Këto metoda përdoren kryesisht për fëmijët që e kanë ndërtuar individualitetin e tyre. Kështu që zhvillimi moral i fëmijës dallohet nga vlerat e drejta e të gabuara të normave kulturore, duke u përforcuar dhe pranuar si sjellje që zënë vend tek njeriu (Bandura, 2000: 238–239). Shkurtimisht, teoritë e sjelljes dhe mësimit social mësohen gjatë zhvillimit moral, përmes ndëshkimit dhe shpërblimit, ose përmes kuptimit të sjelljeve të të rriturve dhe duke i imituar ato.

KAPITULLI IV: MARRËDHËNIA E PRINDËRVE ME FËMIJËT

4.1. Marrëdhnia e prindërve me fëmijët

Për t'u pranuar sjellja e fëmijës është më mirë që, si fillim, të shkojë në një nivel të caktuar, të rritet si njeri konstruktiv dhe i përshtatshëm, kjo në një masë të madhe varet nga komunikimi me nënën dhe babain. Komunikim do të thotë informacion reciprok midis njerëzve, apo ndarja e qëndrimeve, emocioneve dhe sjelljeve. *Komunikimi në të njëjtën kohë është procesi gjatë të cilit njerëzit ndajnë mendimet dhe komunikojnë me njëri-tjetrin me apo pa vetëdije.* Suksesi i këtij procesi është themeli i lumturisë në jetën e individit. Nëna dhe babai duke komunikuar me fëmijën në një farë mënyrë pranojnë ekzistencën e tij, tregojnë respekt, e bëjnë të ndjehet i rëndësishëm dhe i vlefshëm, i japin mundësinë të bëjë sjelljen e duhur me dëshirën e tij. *Komunikim nuk është vetëm të flasësh, prindërit duhet të dinë mirë se kur, çfarë, si dhe ku duhet të flasin.* Në të njëjtën kohë, të mundohen të thjeshtojnë ngjarjet, duhet të vendosin kontaktin me sy më fëmijën, duke u tërhequr vëmendjen të kontrollojë, në u kuptua apo jo mesazhi i tyre (Yavuzer, 2000: 11).

Me komunikimin në familje, kuptohet shkëmbimi i informacionit midis prindërve dhe fëmijëve, midis anëtarëve të tjerë të familjes. *Fëmija mund të ndërtojë një edukim të mirë moral vetëm nëse arrin të ndërtojë një komunikimin të mirë në familje.* Për këtë arsye, komunikimi i shëndetshëm mes bashkëshortëve zë një vend të rëndësishëm në komunikimin e prindërve me fëmijët. Që të jetë komunikimi i mirë në familje duhet që individët ta ndajnë jetën me njëri-tjetrin. Të ndashë jetën nuk do të thotë të ndashë shtëpinë apo gjërat material. Të ndashë jetën do të thotë të marrësh kënaqësi nga gjërat e

përbashkëta, të ndashë lumturinë, dashurinë, e të përjetosh vështirësitë sëbashku. *Ndërtimi i një komunikimi të shëndetshëm ka të bëjë me gjendjen emocionale të prindërve.* Martesat jo të lumtura, vështirësitë ekonomike, mostregimi i interesit midis bashkëshortëve, të gjitha këto ndikojnë në krijimin e një komunikimi jo të shëndetshëm midis prindërve dhe fëmijëve.

Marrëdhëniet brenda familjes kërkojnë vëmendje dhe kujdes. Nëse qëndrimet bazë midis prindërve janë të gabuara, edhe komunikimi me fëmijën vihet në pikëpyetje. Problemet në martesë janë të pashmangshme, por ndikimi i fëmijëve nuk varet nga ekzistenca e problemeve, por pasqyrimi i këtyre problemve nga prindërit tek fëmijët. Përjetimi i ngjarjeve të rënda në disa familje, prindërit duke u munduar t'i mbajnë larg këtyre ngjarjeve fëmijët, apo duke mos i orientuar mirë ngjarjet në familje, dëmtojnë fëmijët gjatë këtij procesi. Sidomos situata të tilla si: *hyrja e bashkëshortëve në grindje serioze në praninë e të tjerëve, veprimi pa komunikuar me njëri-tjetrin apo qëndrimi larg njëri-tjetrit, janë arsye për fillimin e problemve tek fëmijët.* Plotësimi i prindërve me njëri-tjetrin, i fal fëmijës shumë qetësi dhe e bën të lumtur atë. Ankimi i prindërve për njëri-tjetrin tek fëmijët dhe nxitja e mendimeve negative për njëri-tjetrin, janë shkak për humbjen e besimit të fëmijës dhe ndikojnë në largimin e fëmijës prej prindërve (Aydın, 2012: 92-93).

Fëmijët dhe të rinjtë e sotëm kanë shumë më tepër mundësi zgjedhjeje se sa ata të brezave të kaluar. Por në të njëjtën kohë fëmijët gjenden përballë më shumë problemeve. Që fëmijët të mos përjetojnë humbje fizike apo psikologjike dhe ta tregojnë veten e tyre mirë, kanë nevojë për udhëzimet dhe këshillat e prindërve. ***Këshillimi mund të bëhet***

udhëzues i mirë, nëse ka dialog midis anëtarëve të familjes. Që të ekzistojë dialogu midis prindërve dhe fëmijëve, duhet t'i jepet rëndësi të drejtës së fjalës, zbulimit të problemve, si dhe dhënies së zgjidhjeve për to. Fëmijës që i dëgjohej fjala dhe i jepet rëndësi shikimi, ndjen se ka rëndësi. Kështu që ai lidhet më shumë me familjen, konsultohet në lidhje me hapat që hedh, kjo ndikon në zhvillimin e një personaliteti të qëndrueshëm (Önder, 2007: 27-28).

Fëmija që injorohet, që nuk merret seriozisht, e ndjenë veten të pavlerë. Nëse bën sjellje negative të tipit *“më dëgjoni mua!”*, do të thotë se po kërkon t'i dëgjohej zëri. Që të tërheqë vëmendjen e prindërve bën prapësira të ndryshme, bile shkon edhe më tej, duke gënjyer, vjedhur, e shfaqur qëndrime rebele. Fëmija që nuk dëgjohej i bën këto veprime që të percjellë mesazhin, *“ju lutem më dëgjoni mua”* (Gökmar, 2004: 124-125).

Çfarë mund të bëjnë prindërit në këtë situatë? Për çfarë do të vlejë komunikimi me fëmijën? Kjo çështje duhet trajtuar në dy drejtime.

Së pari, me anë të të *“dëgjuarit aktiv”*.

Së dyti, të sillemi me të duke ditur mënyrën si ai do që t'i flasim, ta dëgjojmë dhe si të përcjellim kërkesat tona. Kjo do të thotë që në vend të mesazhit ***“Ti”*** duhet të komunikojmë me ***“Unë”***. *Dëgjimi aktiv dhe mesazhi unë, ndihmon në krijimin e dialogut midis prindërve dhe fëmijëve e në kuptimin e ndjenjave të tyre.* Fitimi i vlerave të tilla, si: *drejtësia, integriteti dhe dëshira* ndihmojnë në krijimin e terrenit për të mësuar më kollaj besimin. Fëmija mëson të flasë për këto vlera dhe besime duke përgjuar e dëgjuar bisedat e më të rriturve, duke u përfshirë vetë në to, si në shkollë, apo ambientet familjare (Avcı, 2000: 12).

4.1.1. Dëgjimi aktiv

Dëgjimi aktiv tregon se kanalet e komunikimit me fëmijën janë të hapura. Fëmija e ka të nevojshme të komunikojë me prindërit dhe të tregojë ndjenjat e tij, kur i nevojitet diçka apo kur mërzitet për diçka. *Prindërit që përdorin metodën e dëgjimit aktiv, kërkojnë t'i kuptojnë ndjenjat e fëmijës e se çfarë po kërkon të komunikojë.* Për të kuptuar të vërtetën përsërit fjalët e fëmijës. Gjikimet, kritikata, qëndrimet këshilluese të prindërve dobësojnë dëgjimin aktiv dhe pengojnë fëmijën që të shprehë problemet e kërkesat. Dëgjimi aktiv nuk është thjeshtë të dëgjuarit e fëmijës pa thënë asgjë, apo pa plotësuar dëshirat e tij (Yörükoğlu, 1986: 24).

Për të qënë prindër dëgjues aktiv, duhet që:

- T'i japësh kohë fëmijës për ta dëgjuar. Është më i mirë qëndrimi sa më larg artikujve që shpërndajnë vëmendjen.
- Prindërit nuk është më e mira që t'i lejnë mënjane mendimet dhe pikëpamjet e tyre, por duhet të përgatiten që të marrin informacion nga fëmija i tyre.
- Mesazhet e duhura dëgohen, përmbledhen dhe i përsëriten fëmijës. Kështu i thonë *“dëgjim pasqyrues”*. Ajo që dëgohet nuk përsëritet në të njëjtën mënyrë, por vlerësohet se çfarë mendon e ndjen fëmija, pasi çdo fjalë e thënë mund të mos jetë një mesazh i saktë.
- Kur flet me fëmijën duhet patjetër që të krijosh kontakt shikimi. Duhet të tundësh kokën në formë miratimi, duhet t'i japësh reagime që po e dëgjon, pasi tregon interesimin si prind. Është e rekomandueshme që *fëmijën ta inkurajosh të flasë.*

- Konsiderata dhe respekti që tregojnë prindërit duhet të tregojë respekt dhe pranojë ato që thotë fëmija edhe nëse nuk u përshtatet me mendimet apo pritshmëritë e tyre. Kjo bëhet duke u bashkuar me fëmijën, duke e orientuar atë pa e gjykuar.

- Fëmijës i krijohet mundësi kur has probleme, i tregohen rrugëzgjdhje dhe i jepet guxim (Yavuzer, 2000: 63-64).

4.1.2. Pse është i dobishëm dëgjimi aktiv?

Dëgjimi aktiv zhvillon një komunikim të ngrohtë midis fëmijës dhe prindërve. **Fëmija që e ndjen se prindi po e dëgjon dhe e kupton, fillon që t'i dojë ato dhe krijojë ura lidhëse.** Krijohet respekt, dashuri dhe afërsi e thellë reciproke. Fëmija tregon problemin, prindi e dëgjon atë, kështu që zgjidhja e problemin bëhet më e lehtë. Fëmija që dëgjohe nga prindi arrin t'i dëgjojë të tjerët dhe kuptojë pikëpamjet e tyre. *Falë dëgjimit aktiv, fëmija i bën analizë aktive problemit, fiton aftësinë e të menduarit dhe të dhënimit zgjidhje problemit.* Me anën e kësaj metode prindërit e pranojnë se mendimet dhe ndjenjat e fëmijëve janë të ndryshme nga të tyre, e shikojnë veten si individë me mendime të veçanta. Dëgjimi aktiv i vërtet realizohet kur, prindërit ndërkohë që dëgjojnë fëmijën, arrijnë ta shohin botën me syrin e tyre duke mos i parë gjërat vetëm nga vetja.

Dëgjimi aktiv mes prindërve dhe fëmijëve mund të mos realizohet gjithmonë, ose mund të ndodhë që nuk është koha për dëgjim aktiv. Koha më e përshtatshme është kur fëmija përjeton probleme dhe nuk e ka nevojën e tyre. Në përgjithësi të gjithë fëmijët kalojnë probleme të tipit: *probleme me shokët, koha kur ai ndihet jo i lumtur*, etj. Prindërit janë gjithmonë pranë për t'u dalë zot problemeve të fëmijëve. Gjëja më e nevojshme që

duhet të realizohet është besimi tek fëmija se do arrijë ta zgjidhë problemin. Në dëgjimet aktive problemet familjare dëgjohen në shtëpi. Fëmija tregon problemin e tij, dukë u munduar të gjejë zgjidhjen, vetëm kështu i bën ballë problemit (Avci, 2000: 129).

Tabela e mëposhtme përmbanë kuptimin e shprehjeve dhe komunikimin verbal. Disa kalojnë nëpër libra si gabimet në komunikim, por gjithësesi edhe nëse shikohen si të tilla, nuk është e drejtë të merren përgjithësisht gabim.

Tabela IV.1 Komunikimi verbal dhe kuptimi

Fjalët	Mënyra e Komunikimit
Shko shpejt në dhomë!	Jep urdhër, udhëheqje.
Nëse nuk fle në orën 11, nuk ka të holla për ty!	Paralajmërim, frikësimi.
Duhet të mbyllësh gojën kur teshtinë!	Dhënia e mësimeve morale.
Pse nuk i vendos këpucët në dollap?	Jep këshilla, jep zgjidhje.
Buka hahet me dorën e djathë.	Mësim
Librat nuk janë për tu hedhur por për tu mësuar.	Ligjërim
Je shumë i ngathët.	Gjykim, kritikë.
Dakort. Ke të drejtë.	Të qënurit në të njëjtin mendim.
Mos qajë si bebet!	Vendosje e nofkave, ngacimim.
Kërkon të merrem me ty ndërkohë që jam i/ e lodhur.	Analizë, interpretim.
Të besoj ty. Ti je i suksesshëm.	Dhënia e besimit. Mbështetje.
Ku e mësove këtë?	Pyetje, testim.
A nuk mund të mësosh në vend që të shikosh filma vizatimor?	Devijim nga tema.

Nëse i përdorim gjithmonë këto rregulla komunikimi mund të jetë i gabuar. Përsa kohë që prindërit u japin këshilla fëmijëve, duhet të presin kohën dhe vendin e duhur për to (Aydin, 2012: 120).

4.1.3. Në vend të mesazhit “Ti”, mesazhi “Unë”

Disa sjellje të fëmijëve, prindërve mund t’u duken të papërshtatshme. Për të ndryshuar këto sjellje të papranuara në vend të mesazhit “**Ti**” duhet të jepet mesazhi “**Unë**”. Prindërit që komunikojnë me mënyra si: Mos e bëj!, Mëso!, Pse po ikën?, Duhet të jesh më mirë!, vendosin në shënjestër të drejtëpërdrejtë personalitetin e fëmijës. *Fëmija demonstroi reagime të nxehta dhe kokëforta ndaj këtyre mënyrave të komunikimit.* Në vend të kësaj, prindërit që përdorin mesazhin “**Unë**” marrin parasyshë ndjenjat e tyre (Göknar, 2004: 128).

Nëse mesazhi “**Ti**” e bën fëmijën kokëfortë, rezistues, nxitës, etj, mesazhi “**Unë**” i zbut të gjitha këto sjellje. Nëse prindërit duan që sinjerisht të komunikojnë me fëmijën, është më mirë mos t’u vënë në dukje gabimet. Përdorimi i mesazhit “**Unë**” bën të mundur që t’i tregojë fëmijës në mënyrë të sinqertë ndjenjat e tij. E mira e një komunikimi të tillë është se i bën të njohur fëmijës situatën e familjes, e ndihmon në zhvillimin e një komunikimi të sinqertë.

Tabela IV.2 Shembuj të komunikimit: “Ti” dhe “Unë”

Mesazhi-Ti		Mesazhi-Unë
Je shumë i prapë.	Ose	Zënkat e tua me shokët mua më mërzisnin shumë.
Nuk ke për tu rritur ndonjë herë		Mua më lumturon shumë fakti, nëse ti bëhesh një njeri i mirë.
Pse nuk më dëgjon mua?		Kur bën ato që të them më lumturon shumë.
Je dembel.		Si mund të të ndihmoj që të mësosh?

Pavarësisht gjithë këtyre fjalëve, fëmija mund të vazhdojë të tregojë sjellje të kundërta. Prindërit këtu duhet të tregohen të vendosur. Bile në situata kritike është e nevojshme një ndërhyrje më e shpejtë dhe energjike (Aydın, 2012: 121).

4.1.4. Ekuilibri i ndëshkimit dhe shpërblimit për të fituar kompetencat e moralit

Fëmija duhet të shpërblehet për veprimet e mira duke ia vlerësuar ato, e për të penguar sjelljet e këqija duhet të ndëshkohet, me qëllim edukimin dhe orientimin për tek sjelljet e mira. *Dhurata ose shpërblimi janë gjëra që jepen si rezultat i një sjellje të mirë, pas një suksesi të arritur, për të mirën e marrë do të dojë të jap më shumë në të ardhmen.* Dhurata është formë nxitëse për fëmijën që të përsëritë sjelljen e duhur dhe korrekte. Në të njëjtën kohë, fëmija do të japë më shumë nga vetja për të mirën e marrë në shkëmbim të shpërblimit. Dhurata është një mjet i mirë për të kënaqur fëmijën dhe për t'i kthyer sjelljet e duhura në zakone (Aydın, 2012: 145). Kur thua dhuratë, ajo mund të jetë një puthje, një fjalë vlerësuese, deri tek gjerat materiale, a dhuratat e mëdha që mund t'i bëhen (Atlı, 2002: 96).

4.1.4.1. Dhurata, ekuilibri në dhurata

Dhënia e dhuratave vend e pa vend, ndikon në llastimin e fëmijës. Dhënia e shpërblimeve në mënyrë të pakontrolluar bën që shpërblimi të humbasë vlerën në sytë e fëmijës, madje mund të kthehet në pengesë për qëllimin final. *Dhënia e dhuratave apo vlerësimi është diçka e mirë por prindërit duhet të bëjnë kujdes në disa pika.* Nga pikëpamja e edukimit, dhënia e dhuratave në jetën e përditshme, si pjesë e pandashme e saj, nuk është diçka e mirë. *Premtimi i dhuratave për raste si: bërja e detyrave të shtëpisë, apo*

rregullimi i dhomës, ndikojnë që fëmija të presë në bazë të premtimeve, shpërbilimi të kthehet në ryshfet, në të njejtën kohë bën që fëmija të jetë në pritmshëri të vazhdueshme.

Kur bëhen me qëllimin e mirë premtimet, për fëmijët që nuk mund të kenë sukses, nuk duhet të merren si ryshfet, por si mënyra për të përforcuar vullnetin, bile këto mënyra shërbejnë si ndihmë për ta (Aydın, 2012: 145).

Një nga gabimet që bëjnë vazhdimisht prindërit, është mësimi i fëmijëve me ryshfete, në mënyrë të tillë detyrohen ta bëjnë edhe për gjëra si janë detyrat dhe përgjegjësitë e ndryshme të fëmijëve. *Në fund të kësaj, rritet një fëmijë që nuk punon, por që kundërshton çdo gjë.* Sidomos, për gjërat që fëmijët i bëjnë më dëshirë, nuk është e nevojshme dhënia e dhuratave, pasi kënaqësia që merr fëmija për kryerjen e diçkaje e ngatërrohet nga ajo e marrjes së shpërblimit (Göknar, 2004: 96). *Nuk duhet të ngatërrojmë dhuratën nga ryshfeti, dhurata bëhet në fund të sjelljes, ndërkohë që ryshfeti është një premtim i bërë para.* Prindërit duhet të kenë kujdes në lidhje me shpërblimin si më poshtë:

Dhurata nuk duhet të jetë qëllimi i bërjes së një detyre apo përgjegjësie, por duhet të jetë fundi i kënaqshëm i një punë të mirë. Fëmija nuk duhet ta bëjë një sjellje të mirë për shkak të dhuratës që e pret në fund, por nga që e ndjen se ashtu duhet bërë. Cilësia e dhuratës mund të jenë gjëra materiale. Dhurata duhet të jetë në përshtatje me moshën e fëmijës, duhet të shërbejë si orientuese për mirë ndaj fëmijës. Teprimi në masë i dhuratës nuk siguron përfitimin e pritur, sidomos kur shpërblehen fëmijë të moshës së vogël. Dhurata ndikon më shumë për të fituar sjelleje të duhura nga fëmijët. Në moshën më të rritur, shpërblimi i bërë me gjëra materiale duhet të zëvendësohet nga ato me vlera shpirtërore (Aydın, 2012: 147).

Në shpërblimet shpirtërore mund të hyjë, një fjalë e ëmbël dhe e bukur, një puthje, vlerësim në sy të të tjerëve, etj. Mburrja dhe vlerësimi nuk duhet të bëhen në mënyrë të ekzagjeruar, duhet të jenë ekuilibriues, mos t'i japë fëmijës ndjenjën e superioritetit dhe të ndryshimt nga të tjerët (Göknar, 2004: 134). Shpërblimet shpirtërore janë shumë të rëndësishme për dinjitetin e fëmijës, si dhe për të peshuar ndjenjat dhe mendimet e tyre. Kjo ndikon që në vitet e ardhëshme, fëmija të demonstrojë sjellje të dobishme për veten, njerëzimin dhe shoqërinë, e në të njejtën kohë të marrë kënaqësi për to. Nëse prindërit i pranojnë veprimet e drejta të fëmijës dhe i bëjnë dhurata atij, ai bie në kënaqësi, përvetëson sjelljet e duhura dhe i bën ato me dashirë. Dashuria dhe vlerësimi duhet të jenë gjithmonë para shpërblimit, pasi fëmija duhet ta ndjejë vazhdimisht lumturinë prej dashurisë së falur nga prindërit. Në këtë mënyrë dhurata mund të jetë një mjet inkurajues (Aydın, 2012: 148).

Kur përpiqemi të shpërblejmë fëmijën, duhen veprimtari të tilla, si në: kinema, teatër, shëtitje, shikimi i ndonjë ndeshjeje. Këto mund të jenë një mënyrë e arsyeshme shpërblimi. Këto lloj shpërblimesh ndikojnë në socializimin e fëmijës. Nuk duhet premtuar për fjalët apo sjelljet e pabëra dhe të perealizuara, fëmija duhet të shpërblehet vetëm nëse e meriton vërtetë atë. Dhuratat pa i merituar, mund të çojë në përfundime të gabuara, siç është humbja e besimit nga prindërit (Göknar, 2004: 135).

4.1.4.2. Metodatat që pengojnë ndëshkimin dhe shpërblimin

Ndërkohë që dhuratat bëhen më qëllim inkurajimin e sjelljeve të dëshiruara, ndëshkimet bëhen më qëllim për heqjen e sjelljeve të padëshiruara tek fëmijët. *Ndëshkimi është masa e aplikuar ndaj një individi që kryen një faj, neglizhon apo gabon.* Burimi i

ndëshkimit është frika psikologjike e njeriut. Ndëshkimi nuk është lloj sjelljeje e dëshiruar. Ai merret si metodë për të siguruar disiplinë në edukim dhe në të njëjtën kohë është marrja në konsideratë e një sjelljeje të gabuar në mënyrën e duhur (Aydın, 2012: 149).

*Nëse dhurata jepet menjëherë bazuar në një sjellje të mirë, për sa i përket ndëshkimit është e rëndësishme të mos nxitohesh. Për të siguruar disiplinën e e nvojshme në familje dhe shkollë është e rëndësishme vendosja e një autoriteti karshi fëmijës. Kur vjen fjala për të përdorur këtë autoritet, shfaqet me të edhe koncepti i ndëshkimit. Sado moderne të jetë pedagogjia, sado që të mbështet ideja e mospranimi të ndëshkimit në edukim, po aq janë edhe mbështetësit e saj. Ata pretendojnë se ndëshkimi nuk është arsye e ndjenjave negative tek fëmijët siç janë; *nxehja, zemërimi, urrejtja, pasiguria apo bindja e tepruar, por mendojnë se në vend të tyre ta ndihmojnë fëmijën që në vend të hakmarrjes të pendohen për veprimet e bëra. Në një situatë të tillë duhet të formohet disiplinimi me kontroll të brendshëm përpara sesa fëmija të shfaqë një sjellje të tillë. Edhe kjo, pra metoda mësues-nxënës është e vlefshme për rregullat e fazës fillestare e me shpjegimin e pritshmërisë ndaj fëmijëve, më vonë ajo realizohet duke e mbështetur fëmijën (Dodurgalı, 1995: 99).**

Përpara se të aplikosh ndëshkimin, për të penguar sjelljet e padëshiruara nevojiten disa masa. Këto masa mund t'i rendisim si më poshtë: (Aydın, 2012: 157).

Tabela IV.3 Masat e marra për të penguar sjelljet e pa dëshiruara përpara ndëshkimit

<p>Përpara sjelljes</p>	<p>Shpjegimi parandalues për sjelljen. Ndryshimi i mjedisit fizik ku ndodhet fëmija. Gjatë sjelljes si shembull mund të jetë, nxitja e zhvillimit të zakoneve të mira.</p>
--------------------------------	--

Gjatë sjelljes	Gjetja e arsyes së sjelljes së gabuar. Ofrimi i alternativave për sjelljet e gabuara. Dhënia e reagimeve me fjale kundrejt sjelljeve të gabuara.
Pas sjelljes	Duke i treguar fundin e rezultatit të sjelljes, sigurimi i keqardhjes së tij. Përjetimi i rezultatit të sjelljes nga fëmija.

Studiuesi dhe teoricieni i zhvillimit moral *Martin Hoffman* (1970), i ka përmbledhur metodat e disiplinës në dy kategori.

4.1.4.3. Metoda e privimit nga mundësitë financiare dhe ndëshkimet fizike

Kjo metodë çon në shfaqjen e ndjenjave të thella të armiqësisë dhe agresionit tek fëmijët. Modeli i prindërit që aplikon ndëshkimin fizik, bën që fëmija t'i aplikojë ato në mënyrë brutale tek shokët. Një fëmijë, që ndëshkim nga një metodë e tillë nuk mendon dëmin, që mund t'u shkaktojë të tjerëve. *Metoda jofizike: është shprehja e fëmijës kundrejt sjelljeve të padëshiruara me anë të pakënaqësisë, nxehjes apo zemërimit.* Me këtë metodë fëmija privohet nga dashuria. Prindërit mundohen t'i tregojnë fëmijës pse është e nevojshme të ndryshojë sjelljen, duke i treguar dëmin që mund t'u sjellë të tjerëve. *Hoffman* është i mendimit se një sjellje e tillë kontribuon pozitivisht në zhvillimin moral.

Nga ndëshkimet fizike dhe financiare që diskutohet më shumë është rrahja. *Rrahja shfaqet dhe aplikohet nga prindërit si pasojë e një tendosje emocionale të bazuar tek sjelljet nervoze e shqetësuese të fëmijëve.* Por përsëri vihet re se një fëmijë i rritur në një mjedis të tillë zhvillon një personalitet të pasigurt, të paqëndrueshëm, të varur nga autoriteti, të prirur për të kryer faje, të turpshëm, egoist e të pavendosur. Sipas kërkimeve të bëra, presioni i

fortë dhe rrahja çojnë në orientim moral të keq siç është: *mosbesimi, gënjeshtria* apo *hipokrizia, madje disa dënime bëhen shkak për çrregullime psikologjike*. Rastet psikologjike dhe sociologjike negative mund t'i përmbledhim si më poshtë: *ikja nga shtëpia, të qënurit i mërzitur dhe i friksuar, armiqësor, dëmtimi i të tjerëve, etj.* (Yalçın, 2011: 23).

Disa *dijetarë islamë* si: *Ibn-i Sahnun, Kabusi, Ibn-i Miskeveyh, Gazali, Ibn-i Kayyim El Cezvi* dhe *Ibn-i Sina*, mbrojnë idenë se zgjidhja e fundit për t'u aplikuar është rrahja (Dodurgalı, 1995: 104, 105).

Ibn-i Miskeveyh, thotë se rrahjet dhe presioni bëhen shkak për zakone të këqija tek fëmijët, ato ndikojnë në fitimin e një personaliteti hipokrit (Aydın, 2012: 153). Ndërsa *Ibn-Sina* këshillon që, edhe kur fëmija është duke kryer një faj nuk duhet nxituar me ndëshkimin. Si fillim duhet inkurajuar me të mirë, pasi sjellja e butë ndikon shumë më tepër në korigjimin e gabimit. Ai është i mendimit se në fillim duhet qortuar, zgjidhje e fundit mund të jetë ndëshkimi (Çubukcu, 1978: 156). *Ibn-i Haldun* njëlloj si *Ibn-i Sina* dhe *Ibn-i Haldun*, del kundër idesë së rrahjes dhe ndëshkimit, si mënyrë për t'i bërë moral famijës dhe për t'i mësuar atij virtyte. Ai mendon se fëmija në kushte të tilla detyrohet të gënjejë dhe shfaqë zakone të këqija, si: *hipokrizia e dembelizmi*, kështu që do jetë jo i suksesshëm (Dodurgalı, 2012: 104, 105).

Prindërit duhet të jenë të ekuilibruar për sa i përket temës së ndëshkimit. *Ndëshkimi duhet të jepet rrallë dhe me qëllime të caktuara*. Kur është e nevojshme duhet të aplikohet

si zgjidhja e fundit, për shkak se të metat dhe disavantazhet e ndëshkimit janë të shumta.

Ato mund t'i rendisim si më poshtë:

- Ndëshkimi jep mesazhin: “*Këtë mos e bëj*”, por nuk e shpjegon arsyen pse nuk duhet bërë.

- Dashuria e fëmijës për personin që e ndëshkon fillon e ikën, ajo fillon të humbë. Mungesa e dashurisë në edukim është një disavantazh i madh.

- Ndëshkimi dëmton dinjitetin e fëmijës dhe e bën atë të humbasë respektin për veten.

- Ndëshkimi është shkak i ndjenjës së turp-it tek fëmijët.

- Fëmija i ndëshkuar bëhet kokëfortë e i mërziur.

- Nëse ndëshkimi është i rëndë dhe i pavend kompensimi është edhe më i vështirë.

- Fëmijët që ndëshkohet pa arsye kanë mundësinë e lartë ta aplikojnë atë në mjedisin rrethues (Atli, 2002: 98).

Një nga ndëshkimet materiale dhe shpirtërore është të privuarit. Për fëmijën privimi nga dashuria apo nga diçka që i pëlqen është ndëshkim. Ndëshkimi i dhënë duhet të ketë lidhje me gabimin, gjithashtu edhe masa e ndëshkimit. Në aspektin e qëndrueshmërisë së prindërve, koha midis gabimit dhe ndëshkimit nuk duhet të jetë e largët. P.sh.: mbledhja e të gjithë ndëshkimeve dhe dhënia e tyre në fund të javës është e dëmshme dhe e pakuptimtë. Ndonjëherë privimi i fëmijës nga diçka që i jepet është gjithashtu një ndëshkim, si p.sh., shkuarja në mbjedhje me shokët. ***Gjëja më e rëndësishme për fëmijën***

është dashuria. Rreziku i humbjes së dashurisë e mërzit shumë atë. Prindërit nuk duhet t'i thejnë fëmijët, për një kohë të gjatë, me ndëshkime të tipit: *pakënaqësi, qëndrimi pa folur, mungesa e lumturisë*, etj. Ndëshkimi i fëmijës duhet bërë sipas shkallës dhe rëndësisë që ai u jep gjërave, në bazë të tyre duhet privuar. Për shembull, pengimi nga shëtitja që e pret prej një kohe të gjatë. Ndëshkime të tilla përforcojnë ndjenjën e hakmarrjes tek fëmijët dhe i pengon ata në shumë sjellje të tjera (Cebeci, 1996: 165).

Ndërkohë që e ndëshkon fëmijën rekomandohet të merret parasysh nëse ka njohuri për të apo jo. Fëmijët nuk duhet të ndëshkohen mbi një temë që nuk kanë njohuri, nëse kryejnë një gabim duhen falur duke i përballur me shpjegimin e gabimit të bërë. Duke thënë prindërit se fëmija bëri gabim, dhuna e ushtruar mund ta çojë atë në kryerjen e një tjetër faji, atë të gënjerit. ***Fëmijët në shumicën e rasteve janë koshientë për gabimet e kryera, pasi i rrëfejnë ato pendohen.*** Prindërit duhet ta shikojnë këtë rrefim, duhet ta vlerësojnë atë duke rregulluar gabimin. Falja e gabimeve disa herë rresht mund t'i kthehet fëmijës në zakon. Aplikimi i ndëshkimit për çdo gabim të kryer nuk është i drejtë, fëmijës duhet t'i jepet mundësia e dëgjimit nëse është e mundur, pasi kjo është metodë ndikuese mbi të. Disa prindër ua ndërpresin fjalën fëmijës, i këshillojnë atë gjatë e gjatë. Kjo në shumicën e rasteve degjeneron në një metodë të pavlefshme (Köylü, 2003: 162). Ndëshkimi nuk duhet t'u jepet ndjenjave dhe mendimeve, por sjelljeve. ***Nuk ka arsye ndëshkimi për mendimet e fëmijëve, pyetjet e vazhdueshme të tyre, apo të folurit shumë.*** Edhe sjelljet e gabuara nuk duhen ndëshkuar që në fillim, por në qoftë se përsëriten, ato duhen sqaruar kur të mos ketë njeri dhe rregulluar në mënyrë të tillë. Prindërit nuk duhet t'i qortojnë sa herë të nxehen duke i besuar forcës, por dhe kur bëjnë gjera të mira duhen lavdëruar e shpërblyer.

Çështjet që duhen patur kujdes kur ndëshkohen fëmijët (Baymur, 1994: 161):

- Fëmija nuk duhet kërcënuar duke e poshtëruar.
- Fëmijët nuk duhen përkëdhelur duke i parë pozitivisht, nuk duhet të krijohen pritshmëri për bindje verbale.
- Nëse një sjellje nuk e parandalon dot, nuk duhet kërkuar që në fillim.
- Nuk duhet të aplikohen metoda disiplinore që krijojnë ndjenjën e fajësisë.
- Gjatë vendosjes së rregullave sipas moshës, duhet të shmangen rregullat dhe kufizimet kontradiktore
- Moshë e përshtatshme, ku rregullat duhet të shmangin rregullat kontradiktore dhe kufizimet (Cloud dhe Townsend, 2002: 90).

4.2. Mjetet dhe metodat e përdorura tek edukimi moral

Është shumë e rëndësishme të fokusohemi në mjetet dhe metodat të cilat përdoren për edukimin moral të fëmijës. *Që nga ninullat deri te lodrat që blejnë, nga programet televizive e deri te librat që lexojnë, nga këngët që dëgjojnë deri te poezitë që mësojnë përmendësh, e shumë e shumë gjëra si këto, ndikojnë fuqishëm në formimin e karakterit moral të fëmijës.* Veçanërisht në ditët e sotme, kur kemi një mori transmetimesh të filmave vizatimorë dhe jo vetëm, prodhim lodrash nga më të shumëllojshmet ndihet më shumë rëndësia e të qenit i vëmendshëm dhe tepër të kujdesshëm nga ana e prindërve në përzgjedhjen e tyre (Haner, 2014: 536).

4.2.1. Loja dhe lodrat

Loja, në përgjithësi, duket sikur nuk ka ndonjë përfitim, e mund të përkufizohet si aktivitetet e kyer për të shijuar kohën e lirë. Ky përkufizim në përgjithësi tregon pikëpamje që kanë të rriturit në lidhje me lojrat e fëmijëve. Ndërsa po ta shikojmë nga aspekti i fëmijës, për to është një përpjekje e një punë e rëndësishme (Cole dhe Morgan, 1985: 228).

Fëmija e fillon lojën bashkë me lindjen. Tek fëmijët parashkollorë loja është angazhimi i tyre i vetëm. Fëmijët një pjesë të mirë të kohës ia kushtojnë lojës. Loja për fëmijët është kapërcimi i lodhjes së trupit dhe shpirtit për të shpenzuar energjitë e tepërta, përgatitje për jetën, për të fituar kënaqësi, etj. ***Fëmijët në formimin e lojrave shikojnë klimën, kulturën, gjininë dhe efektin e moshës.*** Jetesa në gjeografi të ndryshme, zotërimi i një shoqërie ndryshe, të qënurit djalë dhe vajzë, të qënurit në moshë të ndryshme, janë një arsye e mirë për të luajtur lojra. Psikologu i famshëm *Piaget*, tregon se ka një lidhje midis lojës dhe zhvillimit mendor, përshtatja me lojën, loja me pretendime dhe klasifikimi i rregullave duke qënë si lojë (Yavuzer, 2007: 173).

Loja luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e zhvillimit fizik, mendor dhe emocional. Loja mprehë ndjenjat, zhvillon aftësitë, përmirëson mundësitë. Ajo është përgjegjëse për krijimtarinë e fëmijës, aftësinë e zgjidhjes së problemeve, dhe zhvillimin e gjuhës. Në sajë të lojës fëmijët shpëtojnë nga ankthi, pastrojnë instiktin, manifestojnë, në këtë mënyrë tentojnë të edukohen (Yörükoğlu, 2012: 67).

Loja në një kohë të përshtatshme bën gjimnastikën e inteligjencës së fëmijës. Kjo përmirëson aftësinë për të ndihmuar të kuptuarit e zhvillimit mendor. Aspekti më i

rëndësishëm është që loja mund të përcaktohet nga interesat e fëmijës. *Arkitekt Sinani* në fëmijëri luante me ndërtesa të vogla me harqe, kur u rrit me anë të magjive, ndërtuar prej duarve të tij, u bë një nga arkitektët më të njohur në të gjitha shoqëritë e botës, kjo falë zbulimit të interesit të tij në lodra gjatë fëmijërisë. *Fëmija duhet të vëzhgohet mirë, me çfarë luan, të zgjedhë lojrat që të mësojë prej tyre, ato të jenë relaksuese, pse jo duhet të orientohen drejt lojrave që përforcojnë imagjinatën e tyre.* Për t'u kujdesur nga lojrat me telefonë, fëmijës duhet t'i krijohet mundësia të argëtohet me diçka tjetër. Dimensioi tjetër në lojën e fëmijës është shoku i tij. Një lojë e veçantë është loja nga e cila fëmija nuk heq dorë. Miqtë rrinë vazhdimisht me fëmijët, ato gjithmonë krahasohen me të mëdhenjtë. Kjo përbën zhvillimin e personaliteti por luan një rol negativ në vetbesim. *Masa e duhur është që fëmijës të mos i gjendet një shok, por një shok i dobishëm* (Beşoğul, 1993: 29).

Loja i mundëson fëmijës socializimin. Veçanërisht lojërat në grup janë mjeti më i mirë i socializimit. Fëmija, sikurse e njeh mjedisin përmes lojës, kupton rregullat e shoqërisë dhe detyrohet t'u përshtatet rregullave, përmes lojës mund të arrijë t'i realizojë të gjitha këto. *Bile, ajo luan një rol të rëndësishëm përsa i përket tolerancës ndaj ndryshimeve, bashkëpunimit në punë, altruizmit dhe fitimit të sjelljeve të tjera të ngjashme.* Fëmija që e njeh mjedisin përmes lojës, po ashtu e transmeton atë përmes saj. Ai imiton ato që shikon dhe identifikon veten me njerëzit e marrë si shembull. Duke bërë këtë njeh veten, provon ndjenjat, zhvillohet dhe në fund vendos marrëdhënie njerëzore. Si rezultat i kësaj, duke e zhvilluar fëmijën, ai fiton sjellje pozitive (Senemoğlu, 2001: 80).

Në arsimimin e fëmijës, miqësia me të tjerët në lojë, ka një vend të pazëvendësueshëm. Fëmija fiton shume njohuri, sjellje dhe kuptime nga shoku me të cilin

luan. Këto, edhe sikur mos të jenë të gjitha pozitive, presin që fëmijën ta ndihmojnë deri diku. Fëmija imiton gjërat që ka mësuar nga fëmija me të cilin luan, e këto lloj sjelljesh i përvetëson. *Sidomos loja e prindërve me fëmijën është një nga mënyrat e afrimit dhe njohjes me të.* Fëmija, duke u takuar mjaftueshëm me shokun e lojës, fiton përvoja dhe hap terren për sjelljetë pranueshme morale dhe mësimin e tyre (Yavuzer, 2007: 185).

Përzgjedhja e lojërave dhe lodrave është një nga çështjet ku duhet treguar më së shumti kujdes. Gjërat, që më së shumti fëmija kalon kohën me to, janë mjetet të cilat shërbejnë dhe ndikojnë në zhvillimin e tij. *Lojërat janë të rëndësishme, sepse nga njëra anë e përgatisin fëmijën për jetën, ndërsa nga ana tjetër e ndihmojnë atë të fitojë dhe ruajë normat kulturoro-morale. Loja, është një nevojë shumë e natyrshme për fëmijën.* Duhet kushtuar një kujdes i veçantë, kur fëmijës i lejohe të luajë, loja të ketë një qëllim, mos të jetë shpenzim i kotë i kohës. Veçanërisht, kur prindërit luajnë me fëmijën e tyre, duhet t'i kushtojnë rëndësi hedhjes së themeleve të një komunikimi që zgjat përgjatë gjithë jetës. Kur prindërit nuk marrin pjesë në lojë, nuk luajnë me fëmijën e tyre, si fillim fëmija tenton ta anashkalojë këtë gjë, por për të tërhequr vëmendjen e prindërve bën sjellje të padëshiruara. *Prindërit duhet të kalojnë shumë kohë me fëmijën, kurrësesi nuk duhet ta nënvleftësojnë lojën e fëmijës.* Nënata, duhet t'i lejojnë fëmijët e tyre t'i ftojnë shokët në shtëpi, gjithashtu edhe fëmijët e tyre duhet t'i lejojnë të shkojnë në familjet e shokëve. Në mënyrë që t'i parandalojë fëmijët të shoqërohen me shokë e shoqëri të keqe, së pari duhet t'u japin mundësinë të shoqërohen me shokë dhe shoqëri të mirë. *Lojërat shërbejnë si mjet për formimin e një disipline natyrale për fëmijën.* Gjithashtu, ato janë një aftësim e trajnim gjatë procesit të zhvillimit të mendjes, shpirtit dhe trupit, shërbejnë si mjet për formësimin

dhe orientimin e ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve. Cilido prind që dëshiron ta kuptojë fëmijën e tij, që tek ai të formësohen sjelljet e dëshiruara, duhet medeomos që në jetën e fëmijës së tij të inkuadrojë lojërat. Duhet që normat dhe vlerat e jetës t'i mbështjellë me ambalazhin e lojës, në mënyrë që të futen natyrshëm në jetën e tij. Kjo është mënyra më e shëndetshme të futesh në komunikim e të orientosh drejtë një fëmijë (Atl1, 2002: 119).

4.2.2. Tregime dhe përralla

Historia, është një mjet pedagogjik i rëndësishëm për zhvillimin personal dhe shpirtëror në shumë fusha, që, është pranuar ndërkombëtarisht duke qenë se ndihmon zhvillimin psikologjik të fëmijët dhe të rinjtë. Roli i kuptimit të komunikimit merret parasysh në fusha të ndryshme, si: *sociologjinë, letërsinë, historinë, antropologjinë, teologjinë* dhe *fenë*. Historia, aq sa është e pranishme në shtëpi dhe ligjerata tradicionale, po aq zë një vend të rëndësishëm në teorinë dhe praktikën mësimore, sidomos në edukimin fetar e moral, në socializimin dhe kulturën e fëmijës. Historia pranohet si metoda më e mirë në qasjet arsimore, në arsimin e përgjithshëm, sidomos në edukimin fetar dhe moral. Historia është një mjet që siguron përvetësimin dhe marrjen e shembujve në arsimim. *Shpjegimi i temave fetare e morale me histori, i ndihmon fëmijët që të mësojnë më lehtë gjërat abstrakte*. Historia i përfshinë të gjitha përjetimet brenda saj. Në mënyrë të shpejt u tregon fëmijëve ngjarjet e ndodhura. Domethënë, *njeriu është heroi i historisë së tij*. Po ashtu, të gjithë dëgjojnë nga fillimi historitë e shkuara të të tjerëve. Për këtë arsye, historia rrit interesin e njerëzve në përgjithësi, por sidomos fëmijëve në veçanti (Ganzevoort, 1998: 23).

Empatia, është kuptimi i drejtë i mendimeve duke e vendosur veten në vend të atij që ke përballë. *Për të marrë ndjenja dhe eocione prej historisë mund të arrihet vetëm përmes mjetit të empatisë*. Njeriu që dëgjon apo lexon historinë, zgjedh një nga heronjtë e saj si model, pothuajse fillon të jetoj me karakterin e tij (Bilkan, 2001: 45). Dikush që lexon apo dëgjon histori, duke krijuar empati me rolet e heroit historik, identifikon vetveten duke e vendosur në të. Duke vendosur veten në rolin e protagonistit të historisë, njeriu që lexon apo dëgjon histori të ndryshme, merr si shembull sjelljet dhe marrëdhëniet e tij.

Temat abstrakte që u shpjgohen fëmijëve, apo sjelljet që merren si të mira apo jo të mira, shpjgohen vetëm me këshilla abstrakte. Efektifiteti i gjërave të shpjguara varet nga propocioni i përshkrimit të gjërave të përjetueshme dhe gjerave të shpejguara. *Fëmija merr si shembull sjelljet që dëshiron nëse i sheh ato edhe tek dikush tjetër*. Në këtë drejtim, shembulli i parë i fëmijës është familja dhe fëmijët në mjedisin rrethues. Leximi dhe shpjgimi i historisë fëmijës do të thotë t' i shpjgosh ngjarje prej të cilave mund të nxjerrë mësim. Historia nuk është vetëm një argëtim që merret përmes të lexuarit dhe dëgjuarit, në fakt ajo kthehet në një pjesë jete ku fëmija hyn tek personazhi kryesor e jeton sëbashku me të. ***Fëmijët, në përgjithësi, kanë tendencë të bëjnë empati me protagonistin që luan rolin e mirë, e në vend të tij vendosin veten***. Duke pëlqyer karakteristikat e tyre personale, fillon të mendojë protagonistin, fillon të ndjehet si ai. Legjendat përbëhen kryesisht nga protagonistë që i përkasin krijesave të tjera, të cilat edhe pse janë ngjarje imagjinare shprehen verbalisht bindëse për dëgjuesit (Sakaoğlu, 1999: 2). *Legjendat nuk janë pohime për të besuar ato që shpjgohen, historia është rezultat i jetës reale*. Tek legjendat, heronjtë janë të mbinatyrshëm, subjekte imagjinare, ngjarje apo sitata të paarsyeshme, por, duke i

nxjerrë nga bota e tyre ndikojnë mbi dëgjuesin. Karakteristika kryesore dalluese midis legjendës dhe historisë është “*imaginata*” (Bilkan, 2001: 13-14).

Legjenda është një formë letrare që përhapet në mënyrë të njëjtë për të gjitha shoqëritë, pavarësisht ndryshimeve në gjuhë, kulturë, fe, apo racë. *Në disa legjenda ka ndikim mitologjia.* Kurse historia është bazuar në një përrallë universale narrative, ajo është produkt i kulturës. Në legjenda përdoret koha e shkuar, ndërkohë që në histori për shkak të mundësisë së përjetimit, përdoret koha e shkuar dhe e afërt. Duke gjetur këto lloj ndryshimesh midis historisë dhe legjendës, të dyja përdoren në edukimin e fëmijëve, pavarësisht dallimeve mes tyre. *Historia është një mjet shprehës me efektivë. Falë teknikës së historisë edhe temat më të vështira bëhen të lehta,* duke përcjellë një ndikim që mbetet në kujtesë. Karakteri dhe natyra e njeriut lehtëson kuptimin e gjërave, nëse konceptet abstrakte mishirohen me ide reale, në këtë mënyrë mendimet vendosen më mirë në mendje e bëhen të përherëshme. Të vërtet e zhveshura dhe kutpimet abstrakte jo vetëm që harrohen më shpejt, por e lodhin mendjen dhe hutojnë atë (Bilgin, 1994: 51).

Në historitë që u lexohen apo mësohen fëmijëve gjenden disa karakteristika, të cilat Oğuzkan i rendit në këtë mënyrë:

1. Të jetë temë e përshtatshme për interesat e fëmijëve, për përvojën e jetës si dhe për forcimin e mendimit.

2. Të ketë një plan të thjeshtë dhe realist, nuk duhet të jetë në kundërshtim me mendimet e fëmijëve.

3. Të përmbajë lëvizje dhe ngjarje mbi rezultate logjike.

4. Të jenë konkrete, të drejtëpërdrejta dhe nuk duhet të shpërndajnë vëmendjen.

5. Të shpjegojnë mirë karakteristikat, nga pikëpamja e së vërtetës nuk duhet të lënë asnjë dyshim, ***heronjtë duhet të jenë të pranueshëm.***

6. Me fjali të shkurtëra e paragrafë të shkurtër, bazuar në biseda të bollshme, duhet të zotërojë rrëfimi i vazhdueshëm.

7. Të specifikohet çdo pjesë emocionale e situatës.

8. Analizat mendore të jenë të përshtatshme për nivelin e fëmijës (Oğuzkan, 1997: 101-102).

Kur interesat janë të bollshme dhe çdo gjë mësohet imtësisht, fëmijët që duan të rrisin njohuritë dhe zhvillojnë përvojën, mund ta bëjnë këtë përmes simboleve konkrete, të cilët përfshijnë koncepte dhe simbole që mund të jenë abstrakte dhe të pakuptueshëm. Koncepte abstrakte janë: *feja, patritizimi, morali, miqësia, drejtësia* dhe *toleranca*, që mund të transmetohen duke i konkretizuar në histori. Edhe pse mund të duken se po shqyrtohen në mënyrë kureshtare, kanë tendencë ta pranohen sistematikisht në filtrat e mendjes (Cox dhe Wolley, 2007: 681).

Fëmijët individë që ndodhen në periudhën e pubertetit kanë perceptime e përgjigje emocionale të ndryshme lidhur me këtë, përballë njerëzve dhe institucioneve, mund të zhvillohen qëndrime të reja që formojnë sistemin e tyre të vlerave (Yavuzer, 2001: 39). *Pas*

largimit nga familja njerëzit kanë tendencën të lidhen dhe grupohen diku. Njeriu është i lumtur nga të qenit pjestar i këtij grupi dhe fillon të përvetësojë mendimet e vlerat e tij. Në të njëjtën mënyrë, peronazhet e romaneve, historive dhe filmave tërheqin interesin e tyre (Cox dhe Wolley, 2007: 688).

Duke përfituar nga ndjeshmëria dhe tendenca e tyre, me anë të rrugës së empatisë, bëhen shembuj dhe për të tjerët, sigurojnë qëndrime dhe sjellje sociale të drejta brenda shokërisë së grupit (Vitz, 1990: 709-720). Për të dhënë vlerat e dëshiruara ekspozohen si heronj në mesin e tyre shoqëror, të nxitur nga histori dhe ngjarje të përpunuara, orientohen duke e percjellë mesazhin sipas nevojës. Në periudhën kur karakteri moral i fëmijës është në formësim e sipër, i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë, duhet përfituar nga krahasimet e prekshme, përngjasimet, imazhet dhe tregimet. *Tregimet dhe përrallat përmbajnë mesazhe të fshehta morale.* Madje në shumë prej tregimeve, që shumica e njerëzve i dinë, gjenden mësim të ndryshme. P.sh., *përralla e lepurit dhe breshkës*, në shikim të parë të jep përshtypjen e qortimit ndaj të nxituarit. Pas gjithë asaj që duket, fshihet dhe një tjetër mesazh: ***breshka** është simboli i durimit dhe i jetëgjatësisë.* Ndërsa, ***lepuri** është simboli i të riut që me fuqinë dhe shpejtësinë e tij nënvlerëson kundërshtarin,* pra që ***nuk vlerëson fuqinë e durimit dhe këmbënguljes.*** Të tilla tregime dhe përralla, filtrohen në subkoshiençën e fëmijës, i japin atij mësim të dobishme morale. Duke u munduar, që me sjelljet tona, t'i tregojmë fëmijës se ne e përcaktojmë vetë fatin tonë, në këtë aspekt tregimet dhe përrallat luajnë një rol domethënës (Aydın, 2012: 385).

4.2.3. Libri

Është shumë e domosdoshme që fëmija të njihet me librin qysh në moshë të vogël dhe me anë të tij të njohë heronjtë të cilët përfaqësojnë vlerat dhe kulturën tonë. Duhet treguar kujdes i veçantë në zgjedhjen e librave, me anë të të cilëve fëmijët njihen me personalitete dhe heronj idealë, të cilët mund t'i marrë si shembull për jetën e tij. Është e ditur se *fëmijët pas një moshe të caktuar fillojnë të kërkojnë dikë që ta kenë dhe marrin si shembull*. Krahas prindërve të tyre, fëmijët mund të marrin si shembull personalitete që prezantojnë shembuj dhe karaktere të larta morale, si heronj historikë, artistë, sportistë të suksesshëm dhe shkencëtarë. Personalitetin që marrin si shembull nuk e diskutojnë, kështu nga mënyra si flasin, si vishen, veset e mira deri tek veset e këqia, medeomos që do të ndikojnë në personalitetin e brishtë të fëmijës. Njohja e fëmijës me dikë që ka arritur sukses, ka bërë diçka të dobishme për njerëzimin në një fushë apo lëmë të caktuar, personalitete të njohura publike, heronj, shkencëtarë e intelektualë, që kanë karakter moral të lartë, krijojnë dhe rrisin vullnetin e iniciativën tek to. *Puna, sakrifica dhe guximi që kanë treguar këta personalitete në arritjen e idealeve dhe objektivave të tyre, sa u tërheqin vëmendjen, po aq ndikon në formimin e karakterit të tyre*. Duhet të theksojmë se marrja dhe pasja për model nga ana e fëmijës së një personaliteti të duhur e të përshtatshëm ndikon në formimin dhe rritjen e tij në mënyrë të shëndetshme (Öcal, 1991: 88).

4.2.4. Muzika

Gjykimet mbi vlerat morale si pjesë e shoqërisë, fitohen me kohën dhe e bëjnë ekzistencën e njeriut më domethënëse. *Muzika është një mjet ndikues edukimi që formëson*

modelet e vlerave përmes të të dëgjuarit absolut. Muzika shërben për të konsoliduar si botën e brendshme, ashtu dhe adresuar perceptimin e jetës, mendjes dhe zemrës drejtpërsëderjtë ose tërthortazi, të krijojë një ndjenjë morali apo jo morali, dhe më e rëndësishmja, ndërtimin dhe kuptimin moral të parimeve e natyrës njerëzore. *Muzika është transmetues ndërkombëtar i kulturës së një populli dhe pionere e elementeve identifikues të kombit.* Për një komb dhe një vend, muzika që mbart këto cilësi të rëndësishme, sigurisht, shoqëruar me historinë e shoqërisë, mban gjallë karakteristikat kulturore dhe morale. Marrëdhënien e shoqërisë me kulturën, prodhimin e traditës në shoqëri, muzika transmeton nga brezi në brez zakone dhe traditat kulturore, aspekte humanitare të individëve dhe kuptimin moral të koncepteve të përgjithshme të etikës. Ka një thënie të *Konfucit* që thekson marrëdhëniet midis muzikës dhe moralit të shoqërisë: ***“në doni të kuptoni nëse një vend është i drejtuar mirë apo jo, dëgjoni muzikën e tij, pasi muzika themelon shtetin, muzika prish shtetin”*** (Konfucyus, 1998: 30-31).

Në çdo shoqëri ka disa rregulla morale që rregullojnë marrëdhëniet e njerëzve. Edhe nëse këto rregulla ndryshojnë nga shoqëria në shoqëri gjenden edhe virtyte universale si: *mirësia, drejtësia, vërtetësia apo saktësia.* Aspektet shprehëse dhe komunikuese të muzikës janë filozofi të jetës që nuk i shpëtojnë të vërtetës. Në botën e sotme, ku vlerat sociale dhe marrëdhëniet njerëzore janë pakësuar, muzika përsëri është ndikuese në çdo segment të shoqërisë, kryesisht muzika popullore, por dhe muzika që i shpreh shoqërisë agresion me tekste dhe video shprehëse. Përjetimi i marrëdhënieve njerëzore përmes transmetimit të fjalëve dhe aspekteve të muzikës, ndonjëherë ndodh që te muzika të dominojë pjesa fizike e

emocionale, duke hequr shkundjen ajo bëhet qendër e audiencës. Muzika mund të shihet si fjalë ritmike e shplodhëse që i drejtohet trurit (Lull, 2000: 26).

Muzika mund të hyjë në çdo moment dhe vend të jetës tonë, sidomos gjeneratat e reja kujdesen të përgatiten për këtë stil social që ka hyrë në jetën e njerëzve duke zënë një vend gjithnjë e më të gjerë. Audiencia e muzikës popullore që quhet edhe si kulturë masive ndikohet nga këto tema në formë direkte dhe indirekte. Përdorimi i muzikës si mjet edukimi ka ndikim të madh, ajo ka mundësi të mëdha shprehëse, ajo është metodë me anën të së cilës fitohen vlera shoqërore dhe sjellje morale në shkollë. *Fëmijët të gjithë janë shumë të ndjeshëm ndaj muzikës.* Ajo përveç rolit pozitiv që ka te njeriu ndihmon edhe në pasurimin e qënies së tij, për këtë arsye shpesh muzika përdoret si instrument në trajtimin dhe kurimin e fëmijëve të cilët kanë sjellje të parregullta.

4.2.5. Teatri dhe kinemaja

Teatri dhe kinemaja janë nga mënyrat dhe mjetet më efektive të mësuarit tek fëmijët. Sepse fëmija e identifikon veten e tij me personazhe teatrale dhe kinematografike. *Shfaqjet teatrale apo kinematografike duhet të jenë të përshtatshme për moshën, gjininë dhe nivelin e zhvillimit të fëmijës.* Filmat dhe lojërat të cilat fëmija mund t'i marrë si shembull, duhet të jenë të dobishëm si nga ana e sjelljeve që do të përvetësojë ashtu nga ana e zhvillimit psikiko-emocional, shoqëror dhe social. *Frika, dhuna si dhe skena të cilat përmbajnë dhe tregojnë arritjen e objektivave dhe suksesit me anë të forcës brutale nuk mund të jenë një model i mirë identifikues.* Të tillë shembuj, ashtu sikurse janë në kundërshtim me metodologjinë e edukimit të fëmijës, po aq janë edhe faktorë negativë që ndikojnë në

sjelljet e tij. Përveç kësaj, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë që filmi të ketë përmbajtje socio-kulturale si dhe të jetë stimulues e realist. Prindërit duhet të tregojnë vëmendje të veçantë kur ta dërgojnë fëmijën e tyre në teatër dhe kinema (Gökmar, 2004: 86).

Nga pikëpamja e edukimit të fëmijës një nga mjetet ndikuese është edhe teatri. *Teatri është më efektiv se sa shpjegimi i mësimit prej mësuesit në klasë apo këshillat që bëjnë prindërit në shtëpi.* Teatri është mënyra indirekte e të folurit të fëmijëve si dhe ngarkesa e fëmijëve me përgjegjësi dhe zgjedhje. Përmes rrugës dramatike fëmija mëson për kulturën dhe gjeografinë e huaj, gjykimet dhe vlerat morale në mënyrë ndikuese. Fëmijët duke parë zgjidhjen e problemit me anë të teatrit, problemet e tyre duke i parë edhe tek dikush tjetër, njëkohësisht shikon si mund t'i zgjidh ato. Falë teatrit fëmija njeh personalitetin e vet, zhvillon ndjenjat e nevojshme dhe përparon në plotësimin e nevojave mendore dhe shpirtërore. *Vlerat sociale janë çështja kryesore të teatrit.* Një nga detyrat e edukimit është, pikërisht, edukimi i fëmijës për të qënë një qytetar i denjë dhe për t'i dhënë komunitetit nga vetja. Teatri po ashtu, rrit qytetarë të përshtatshëm me shoqërinë e sotme, krijon njerëzit e së ardhmes duke i armatosur me vlerat e përgjegjësisë. Teatri është ndikues i mirë për këto dy qëllime. Në skenë fëmijët shikojnë jetën e tyre, temat aktuale që lidhen ngushtë me jetesën, veprime që duhet t'u japin më tepër rëndësi, rrjedhshmërinë e ngjarjeve, zbavitjen, si dhe ballafaqohen me vlerat kombëtare dhe shpirtërore duke u lidhur më shumë me to (Morton, 1972: 12).

Me transformimin e trupit nga ai i periudhës së adoleshencës në atë të një të rrituri, fëmija fillon t'i luajë rolet e veta si një i rritur. *Adoleshenti është në përpjektje për të gjetur personalitetin, dhe mund të përjetojë një krizë të lidhur me këtë.* Ericson këtë fazë të jetës e

klasifikon si pikë pozitive dhe negative të zhvillimit të personalitetit me emrin: *“Trazirat e rolit-fitmi i personalitetit”* (Cüceloğlu, 1994: 68).

Kirza e identitetit për të cilën bën fjalë *Ericson*, edhe nëse nuk i përgjithësojmë të gjithë adoleshentët, bazuar në studime të bëra në SHBA, adoleshentët ndodhen në mesin e vrasjeve dhe vetëvrasjeve, në mesin e krimeve dhe përdorimit të drogave, të gjitha këto në grafikë rritës dhe tepër shqetësuese (Vitz, 1990: 709-720).

Adoleshenti që kalon krizën e personalitetit në çdo anë kërkon të identifikojë modele ideale. Këto modele mund të jenë të ndryshëm, të rëndësishëm, aktualë, dikush tregon dashuri dhe respekt, dikush jep besim dhe mbështetje. Adoleshentët, pa i gjykuar fare mund t’i pranojnë ato. *Me gjetjen e këtij modeli mund të zhvillojë një personalitet të shëndetshëm.* Përndryshe mund të zgjedhë modelin egabuar ose mund të shfaqë sjellje patologjike, siç është mbyllja e brendshme, etj. Heronjtë e filmave që mund të merren për model, që mund të jenë edhe shembuj të dobishëm të historisë, i ndihmon ata për të kaluar një krizë të tillë identiteti. Bile, në përputhje me vlerat morale dhe fetare këto modele kontribuojnë në zhvillimin e personalitetit dhe përgatitjen e fëmijëve për të ardhmen e tyre të sigurtë (Roof dhe të tjerët, 1993: 39).

Adoleshenti në këtë moshë është i interesuar mbi çështje sociale, është dyshues se e vërteta që sheh është vërtetë e tillë. Në këtë situatë, adoleshentët ngazëllesh shpejt, merakosen, nervozohen, kanë luhajtje të ndryshme emocionale, ulje e ngritje të humorit, duke qenë se nuk gjejnë atë që kërkojnë si pasojë e vështirësive të hasura, kështu që mund të bëjnë sjellje feminare. *Për këtë arsye ata kanë tendencën të mohojnë rregullat.* Kur

pengohen apo kur ndjejnë se janë të vetmuar mund të hyjnë në depresion, sugjerimet e gabuara mund t'i bëjë të shkojnë deri në vetëvrasje. Me këtë dëshirojnë, që së bashku me familjen dhe mejdisin ku jetojnë të mësojnë të vërtetat e prekshme. Për këtë arsye besojnë lehtë, tentojnë dhe miratojnë idetë dhe qëndrimet e shoqërisë. Nëse përshtatja nuk është e mjaftueshme mund të hyjnë në grupime të gabuara të shoqërisë, heqin dorë nga personaliteti duke zgjedhur të lidhet me komunitetin. Me fjalë të tjera, mund të refuzojë socializimin dhe kulturën në të cilën ndodhen, për t'i shpëtuar përgjegjësive tregon besim të tepruar, autoritet dhe lidhet më shumë me traditën (Doğan dhe Tosun, 2003: 129).

Nga njëra anë i japin rëndësi mendimit të ambjentit për ta, nga ana tjetër, mendojnë se janë më të drejtët dhe më origjinalët, kanë besim kur gjejnë ambient të përshtatshëm, shfaqen duke pritur të pranohen. Ky lloj të menduari fillon e zvogëlohet me zhvillimin e personalitetit (Erden dhe Akman, 2005: 114).

Tranzicionin e kësaj periudhe kalimtare, për ta tejkaluar në mënyrë indirekte dhe me sa më pak pasoja, adoleshentëve duhet t'u tregohet se jetojnë në komunitet dhe në përshtatshmëri më të. U duhen afruar zgjidhje për shumë probleme të ndryshme komunikimi. Duke dashur jetën, duke u përgatitur për të me durim dhe sjellje pozitive, dhe për t'i arritur të gjitha këto në edukim sugjerohet edhe shikimi i filmave serialë të përshtatshëm për këtë qëllim. Periudha e emëruar si "*Periudha pas Traditës*" nga Kohlberg, tregon se fëmijët e kësaj moshe janë në procesin e formimit të vlerave morale dhe idealeve të tyre. Ata fillojnë të kritikojnë sjelljen e tyre dhe të bashkohen me të rriturit. Së bashku me këtë, ato, në mënyrë ideale, ushqehen të pranohen nga të rritur prej të cilëve befasohen dhe lidhen me ta. Për të plotësuar personalitetin këshilla kryesore është

përvetësimi i sjelljeve dhe qëndrimeve. *Idealizimi i fëmijëve të kësaj moshe ndryshon nga femrat tek meshkujt.* Meshkujt i kushtojnë rëndësi ekselencës ndërkohë që femrat i kushtojnë rëndësi dashurisë. Me fjalë të tjera, meshkujt kërkojnë të realizojnë personalitetin ideal, ndërkohë që femrat kërkojnë të mbushin boshllëkun emocional (Vergote, 1981: 5). Si për vajzat edhe për djemtë, për të gjetur modelin ideal kanë nevojë t'u refletojnë në përdishmërinë e tyre. Këtë mund ta bëjnë edhe personazhet e filmave dhe serialeve, në mënyrë që të fitojnë sjelljet morale dhe mos heqin dorë nga edukimi. Megjithatë, çdo film që shikojnë nuk është i përshtatshëm për t'u parë, po ashtu me kohën atyre u zhvillohen mendimet mbi vlerat morale dhe kombëtare.

Televizioni edhe pse shërben si një faktor stimulues e nxitës i rëndësishëm, në të njëjtën kohë bëhet shkak i uljes së nivelit të komunikimit brenda familjes, luan edhe një rol ndikimi negativ në zhvillimin social të fëmijës. *Studimet eksperimentale kanë treguar se sjelljet agresive të fëmijëve vijnë së rezultat i mjeteve të komunikimit (mediatik) dhe nga ajo çfarë mësojnë e shohin nga prindërit.* Sipas rezultateve studimore fëmijët të cilët shohin filma me përmbajtje dhune shfaqin dhe bëjnë sjellje agresive. Të tillë programe për shkak të pasjes së një efekti ndikues të drejtpërdrejtë në sjelljet morale të fëmijës kërcënojnë edukimin e tyre. Nga ana tjetër emisionet me përmbajtje pozitive ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e sjelljeve të mira shërbejnë dhe si faktor i parandalimit e mbajtjes në kontroll të sjelljeve morale të dëmshme. Për këtë arsye duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë që në vend të programeve të cilat përmbajnë *cigare, lëndë narkotike e gjinore*, të zgjidhen apo zëvendësohen me *programe me përmbajtje mëshire, dhembshurie, drejtësie dhe bamirësie.*

4.2.6. Aforizmat (maksima) dhe proverba

Fjalët e urta në përgjithësi janë parime themelore, të cilat për të siguruar lumturinë e shoqërisë, shfaqin të mirën, të drejtën, duke treguar shëmbuj të bukur dhe të përshtatshëm. Për këtë arsye ato kanë një rëndësi të madhe në edukim. Individit që përdor thëniet e urta në edukim, njihet me kulturën dhe rregullat e shoqërisë. Në këtë aspekt, thëniet janë pjesë shpirtërore të shoqërisë, dhe fjalë që transmetojnë filozofinë e saj (Duruhan dhe İlhan, 2004: 120).

Idiomat janë grup fjalësh që zbulojnë tiparet më të rëndësishme të gjuhës, traditat dhe zakonet e shoqërisë, besimin dhe mënyrën e jetesës. Ato janë fjalë koncize, përfshirëse dhe kuptimplote (Aksoy, 1998: 52).

Lehtësuese të të kuptuarit të temave për të cilat flitet, zbuluese të kuptimit dhe në shumicën e kohës shprehin me pak fjalë atë që nuk mund ta shprehësh më një grup fjalësh. Ato lehtësojnë gjuhën e shoqërisë, transmetojnë gjurmët kulturore, me anë të pushtetit narrativ zbulojnë kuptime dhe i fuqizojnë ato. Shpesh herë përdoren për të mirëpritur, për t'u shprehur me kënaqësi dhe për të mbetur në kujtesë (Gündüzalp, 2007: 9).

Thëniet dhe idiomat aplikohen kur kërkon t'u shtosh vlerën fjalëve të tua, kur do të përforcosh kuptimin, për të gjetur prova mbi mendimin e shprehur, transmetimin e diçkaje që kërkon të shpjegohet gjatë me diçka ndikuese dhe të shkurtër. Për këtë arsye në arsimin fillor përdorimi i thënieve dhe idiomave zë një vend shumë të rëndësishëm për tejçimin e vlerave kulturore dhe karakteristikave të shoqërisë (Pala, 2002: 38).

Më poshtë jepen disa shembuj proverbash:

1. Për të shprehur ndershmërinë: *I drejti bie, por nuk mbytet.*
2. Për të treguar respekt ndaj të ndryshmes: *As gishtat e dorës nuk janë njësoj.*
3. Për të shprehur patriotizëm: *Duaje atdhenë si shqiponja folenë.*
4. Për të shprehur solidaritet: *Shoku i mirë njihet në ditë të vështirë.*

Në këtë mënyrë, fjalët e urta për vlerat njerëzore dhe universale, janë teknika të mira edukimi dhe të përshtatshme për të arritur qëllimin e kërkuar. *Thëniet dhe proverbat rrisin imagjinatën e fëmijëve, zhvillojnë dëshirën për letërsinë, ushqejnë ndjenja estetike, zgjerojnë kujtesën, përvetësojnë vlerat pozitive si dhe ndërgjegjësojnë në lidhje me traditat e kulturën e kombeve.* Një nga mënyrat për t'i shprehur fëmijës moralin e duhur është përdorimi i aforizmave dhe fjalëve të urta. Një fjalë e urtë, proverb i përzgjedhur me kujdes përmbledh një parim moral, ka efekt shumë më shumë se shumë fjalë. Ndikimi që kanë fjalë e urta e proverbat, të cilat janë trashëgimia kulturore e një populli, në edukimin e fëmijës është i padiskutueshëm. Në çdo proverb shihen qartë rrënjët dhe ndikimi i parimeve edukative. P.sh.: kur një fëmijë shkon te shtëpia e ndonjë shoku, ankohet nga mburrjet e shtëpisë së shokut, përdoret proverbi: *“Çdo gjel këndon majë plehut të tij”* (Aydın, 2012: 389).

4.3. Si mund të arrihet bashkëpunimi shkollë - familje për edukimin moral

Duan apo nuk duan ata, prindërit janë mësuesit e fëmijës së tyre. *Shkolla u jep fëmijëve edukimin që nuk mund ta marrin në shtëpi, por nuk mund ta zëvendësojë kurrësesi*

rolin e prindërve në edukim. Me fjalë të tjera mësuesi plotëson edukimin e prindërve. Për këtë duhet patjetër bashkëpunimi i shkollës me familjen. Komunikimi i vendosur midis familjes dhe shkollës mbështetin dhe i shërbejnë zhvillimit të fëmijës. Duke qënë se koha që fëmija kalon në shkollë është më e shkurtër se sa koha që kalon në familje, mësuesit e shkollës e kanë të nevojshme mbështetjen e prindërve. Një familje që siguron mbështetjen e fëmijës bën të mundur suksesin e tij edhe kur gjendja socio-ekonomike mund të mos jetë e mjaftueshme. Duke rritur suksesin në shkollë të fëmijës, edukimin e vlerave kulturore dhe kombëtare, shkolla dhe familja realizojnë objektivin e tyre. Për të arritur objektivin preferohet që këto dy institucion të bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt dhe të përshtatshme (Tutkun dhe Köksal, 2000: 220).

Dërvodeli (2011) në tekstin "Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar parakohe, me kohë dhe pas kohe", flet për rolin e familjes për përgatitjen e fëmijëve në nisjen e shkollës. Ai thekson se edukimi i fëmijëve në familje është një parakusht më se i nevojshëm për zhvillimin dhe formimin e drejtë të fëmijës. "Fëmijëve që u ka munguar një edukatë e shëndoshë në familje, janë adaptuar pastaj me vështirësi në mjedis të reja, sidomos në shkollë" (Dërvodeli, 2011: 38).

Ato duhet të jenë në një bashkëpunim të tillë, që të krijojë mjedis të qëndrueshëm dhe krijues, të ekuilibruar, social, të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për të rritur individin. Për të siguruar këtë si fillim familja duhet të njoh shkollën dhe pastaj shkolla familjen, për tema të caktuara duhet të jenë bashkëpunues dhe të ndihmojnë njëra-tjetrën (Oğuzkan dhe Oral, 1997: 105).

Në monografinë e *Dr. sc. Afërdita Deva- Zuna: “Edukimi i parashkollorit në familje”*, autorja i qaset kryesisht edukimit të fëmijës së moshës parashkollore në gjirin familjar. Meqenëse autorja ka përdorur një numër të madh të literature të pasur, duke shfrytëzuar mendimin pedagogjik të pedagogëve e psikologëve më të shquar botëror, ajo jep një pasqyrë të qartë të vlerës që ka familja në edukimin e drejtë të fëmijës parashkollor. *Roli dhe rëndësia e prindërve në zhvillimin dhe edukimin mendor të fëmijëve të moshës parashkollore në familje është i pamohueshëm*, duke marrë parasysh plasticitetin, ndjeshmërinë, aftësinë e tyre për të kuptuar shpejt aktivitetin e tyre (Deva dhe Zuna, 2003: 234).

Për të fituar sjelljen e dëshiruar dhe për të pasur sukses fëmija, *faktorët si familja, shkolla dhe mjedisi, zenë një vend të rëndësishëm*. Familjet që bashkëpunojnë me shkollat duke u interesuar për fëmijën, duke zgjidhur problemet, arrijnë sukses më të madh tek fëmija sa familjet që nuk veprojnë në të njëjtë mënyrë. Roli i bashkëpunimit të familjes me shkollën është jazhtëzakonisht i rëndësishëm në ndikimin që ka shkolla në zhvillimin social, emocional dhe akademik të fëmijës (Rosenblatt dhe Peled, 2002: 349-367).

Sipas *Berger* (1991), përparimi i fëmijës në shkollë lidhet ngushtë me rëndësinë që familja i ka dhënë edukimit në shtëpi. Puna e familjes në bashkëpunim me shkollën sikurse ndikon në suksesin e fëmijës në shkollë, po ashtu ndikon në rritjen e stadarteve dhe vlerave të shkollës dhe familjes, kështu që mund ta orientojnë më mirë fëmijën.

Sipas *Gordon*, ndikimi i prindërve tek fëmija është shumë i gjerë. Nga njëra anë prindërit në periudhën *0-6 vjeçi* plotësojnë të gjitha nevojat e domosdoshme të fëmijës dhe

janë njerëzit më të afërt për të, por nga ana tjetër janë edhe mësuesit e tij të parë. Rëndësia e rolit të prindërve në përcaktimin e identitetit edukativ të fëmijës kuptohet më mirë në periudhën e moshës nga zero deri gjashtë vjeç. Statusi i formuar në familje, vlerat e fituara dhe personaliteti i zhvilluar bëhen pjesë e fëmijës, duke i marrë me to paraqitet edhe në shoqëri (Gordon, 1993: 29).

Për krijimin e një mjedisi të favoroshëm për fëmijën duhet të ekzistojë një përpjekje e përbashkët midis familjes dhe shkollës. Përvojat e para të të mësuarit fëmija i merr në shtëpi, ato sigurojnë mbështetjen kur të hyjë në shkollë, ndërkohë që praktikrat e mësuesve rrisin mundësinë për të pasur sukses, shërbëjnë si modele për nxënësit e tyre. *Për të arritur këtë qëllim mësuesi duhet të njoh mirë rrethanat familjare të fëmijës në mënyrë që ta ndihmojë bazuar tek këto rrethana, këtë mund ta bëjë vetëm duke ndërtuar një urë të mirë komunikimi mes tyre* (Burns dhe të tjerët, 1992: 5).

Harmonia në familje, qasja mbështetëse e saj, si dhe pjesëmarrja e familjes në aktivitetet shkollore të fëmijës, kanë një ndikim të madh në suksesin e shkollës. Sipas një kërkimi të bërë nga Diaz (1989), gjëja e vetme ndikuese që i ndan nxënësit me rezultate akademike të ulëta si dhe me probleme në sjelljen në klasë nga ata me rezultate të kundërta, është interesimi dhe mbështetja që u bëhet nga familja. Në të njëjtin kërkim, prindërit e ngurtë e të paqëndrueshëm dhe jo shumë komunikues, janë një faktor i rëndësishëm për riskut që shoqëron suksesin e fëmijës në shkollë (Diaz, 1989: 11).

Situatat stresuese ndaj të cilave fëmija është i ekspozuar në fëmijërinë e hershme, *si: grindjet në familje, sjellja agresive e dikujt në mjedisin e tij, mund të ndikojnë që në*

jetën e fëmijës të shfaqen vështirësi në zhvillimin e proceseve mendore, në të mësuar, në shprehjen dhe kontrollimin e ndjenjave, si dhe problemet që mund të dalin në krijimin e marrëdhënieve të mira me njerëzit përreth tij. Dukuri të tilla mund ta ngadalësojnë përgatitjen e fëmijës për shkollë dhe të jenë shkak që fëmija të arrijë rezultate të dobëta gjatë shkollimit në shkollën e mesme dhe të lartë (Karaj, 2005: 45).

Bashkëpunimi dhe komunikimi i shëndëtshëm midis familjes dhe shkollës për të arritur suksesin, nuk është arsye që i intereson vetëm shkollës. Sikurse *Aslanargun (2007)* e shpjegon, kjo marrëdhëni ndihmon në forcimin e komunikimit midis insitucioneve, ndihmon parandalimin e ndodhive me probleme disiplinore në shkollë. Bashkëpunimi i fortë i familjes me shkollën, *qasja mirëkuptuese ndaj nxënësve, mbështetja dhe marrja në konsideratë e interesave dhe aftësive të fëmijës, ofrimi i aktiviteteve sociale, pjesëmarrja aktive e prindërve në shkollë, dhe mënyra të tjera si këto, shtojnë motivimin e nxënësit dhe ulin mundësinë e shfaqjes së sjelljeve të padëshiruara (Aslanargun, 2007: 119-135).*

Gjatë gjithë historisë së edukimit, rritja e suksesit të nxënësve dhe sigurimi i karaktersistikave pozitive në sjellje, ka ndodhur gjithmonë vetëm kur ka qënë qëllim i të dy palëve (Lickona, 1993: 12-15).

Ndjekja e procesit të zhvillimi të fëmijës nga prindërit dhe insitucionet arsimore, ndërhyrja kur është e nevojshme, si dhe gjetja e zgjidhjes kur haset një problem arsimor apo sjelljeje, realizojnw qëllimin e dëshiruar të palëve. Prandaj, ***qëllimi kryesor i shkollës nuk është vetëm ndërhyrja për të pasur sukses akademik, por në të njëjtën kohë duhet të kujdeset që të rrisë një njeri të mire*** (Dagget, 2003: 12).

Në edukimin në shkollë zënë vend edhe tema të tilla si: *nga cilat vlera themelore duhet të udhëhiqet jeta e njeriut, cila sjellje është e saktë dhe cila është e gabuar*, të gjitha këto në përputhje me fazën e zhvillimit të fëmijës. Në këtë kontekst, mësimi i vlerave është misioni më i vjetër i shkollës, por në të njëjtën kohë, sikurse ndodh në të gjithë botën, qëllimi i saj mbetet arsimimi (Ryan, 1993: 16).

Institucioni arsimor, që ka për detyrë të kryejë edukimin shoqëror të fëmijëve 3-6 vjeç, të sigurojë zhvillimin e rregullt fizik dhe mendor të tyre, t'u japë elementet e para të edukimit estetik, t'i pajisë me vetitë elementare të moralit dhe edukatës së punës, si dhe t'i përgatisë për të hyrë në jetë, është shkolla (Osmani, 1983: 89).

Planet mësimore, janë dokumentet më të rëndësishme sociale, kulturore për sigurimin e vazhdimësisë dhe të identitetit të një shteti. Një mjedis social apo një institucion arsimor përfshinë në programet e tij ndikime të tilla si, përmirësimin e përvojave të individit dhe pasurimin e tyre. Këto programe janë udhëzues të sjelljes së nxënësve, aktivitete mësimi, mësimdhënie dhe vlerësimi të gjitha këtyre. Në këtë kuptim, *rregulloret, programet e mësimi, festimi i ditëve të veçanta, klubet, shërbimet udhëzuese, sudimet shëndetësore, kurset e trajnimit, trajnimet kulturore, në arte dhe të ngjashme, të gjitha këto hyjnë në programet e edukimit.* Synimi i shkollave është transemtimi i vlerave, mësimi i këtyre vlerave nga nxënësit dhe kthimi i sjelljeve të mira në zakone. Duke i shpërblyer nxënësit për sjelljet e mira në këtë mënyrë tregohet një kujdes moral i cili mund të llogaritet edhe si kontribut në zhvillimin moral të fëmijës (Schaps dhe të tjerët, 2001: 40-41).

Mjedisi më i afërt i fëmijës gjatë formimit kulturor është familja dhe mjedisi social në të cilin gjendet, ai më pas realizohet në shkollë. Me kohën karakteri dhe morali i fëmijës formohet në përputhje me qëndrimet e mjedisit përreth. Një detyrë e rëndësishme e shkollës është zhvillimit i karakterit dhe i moralit të fëmijës. ***Shkolla ka ndikim edukativ, kulturor dhe shoqëror në karakterin e fëmijës.*** Shkolla punon në mënyrën të mirë për të formuar karakterin e fëmijës duke marrë parasysh fuqitë e fshehura të tij si dhe aftësitë e pashfaqura (Başaran, 2005: 280).

Disa teoricienë theksojnë në lidhje me zhvillimin psikologjik se, gjatë viteve të shkollës, *fëmija zhvillon kodet e vlerave morale, mirë apo keq*, në këtë moshë formësohet karakteri i tyre. Shumë teoricienë që lidhen me psikologjinë zhvillimore, në vitet e tyre shkollore, kanë zhvilluar kode morale, të mira apo të këqija, ka theksuar se formuan karakterin e këtij viti (O'Sullivan, 2004: 641).

Në këtë drejtim, edukimi moral dhe ai i karakterit zhvillohen duke i lejuar nxënësit të mbajë përgjegjësi, të bëjë zgjedhjen dhe të vë në veprim shkathësinë dhe aftësitë e fituara (Ryan dhe Bohlin, 1999: 29).

Vitet e fundit bota po përjeton kriza vlerash dhe kultuarash si pasojë e degjenerimit kulturor. I referohemi globalizimit, ndërkohë që më shumë vihet re ndryshimi teknologjik, heqja e kufijve, mbizotërimi i kulturave dominuese në çdo vend e moment, ndjeshmëritë e lirisë së shoqërive, etj. Me kalimin e kohës vlerat po humbin e nuk po funksionojnë më. Në mesin e brezave në rritje *vihen re prirje dhune, mungesë respekti ndaj prindërve dhe*

mësuesve, shkelje të rregullave sociale, sjellje të dëmshme dhe të rrezikshme, siç është vetëvrasja, etj. (Lickona, 1991; Ekşi, 2006: 45).

Ballafaqimi i shkollave me këto disavantazhe të kohës, i bën detyrat dhe përgjegjësitë e saj, më të vështira për t'u realizuar. Pasi ato nuk janë vetëm një mjedis ku mësohet dhe edukohet, duhet në të njëjtë kohë të krijojnë një mjedis social për nxënësit. Këtu edukimi i bërë me plan dhe me aktivitete të përfshira, iu transferon nxënësve vlerat dhe sjlljet e shoqërisë nga e shkuara deri në ditët e sotme. Me anë të planit edukativ, të formuluar në shkolla, fëmijët mësojnë vlerat dhe normat e nevojshme, me anë të përvetësimit të tyre arrijnë të përballen me jetën e përditshme dhe vështirësitë e jetës (Lickona, 1993: 9).

Për këtë qëllim, gjatë viteve të fundit, në vendet e përbëra me shumë kombe e shumë kultura, siç janë, Amerika, Anglia, Franca dhe Gjermania, janë zhvilluar programe që sigurojnë një bazë të përbashkët vlerash. Grupet e ndryshme etnike në vendet e zhvilluara, si edukimi karakterial, lidhet me gjendjen dhe bëhet sipas programeve të ndryshme të edukimit. Këtyre grupeve mund t'u shtohet një lëndë që mund të jetë e lidhur me atdhedashurinë apo njohuritë sociale. Në këto lëndë është bërë kujdes që individi të fitojë vlerat kryesore si: *dhembshuria, guximi, mirësjellja, drejtësia, krenaria, mëshira, besnikëria, këmbëngulja, respekti dhe përgjegjësia* (Gibbs dhe Earley, 1994: 9).

Parimet e vlerave të qarta mësohen së bashku me rritjen e individit, çdo shoqëri është në përpjekje që të rinjtë në ndërgjegjen e tyre t'i përvetësojnë këto virtyte (Lickona, 1998: 35). Në lidhje me formimin e karakterit dhe edukimin moral përgjegjësia kryesore bie mbi mësuesit (Lickona, 1993: 10).

Përgjegjësitë e mësuesit dhe aktivitetet që realizojnë komunikimin me familjen janë këto:

Mësuesi:

- **Modeli** i një mësuesi të mirë dhe të zgjuar, u sillet nxënësve me dashuri dhe respekt, mbështet sjelljet pozitive sociale. *Është një shembull i mirë, korrigjon sjelljet e dëmshme dhe debatet në klasë. Kur është e nevojshme i udhëzon nxënësit një nga një.*

- Nëse **mësuesi** u tregon respekt një e nga një nxënësve dhe i mbron një e nga një ato, ndjenë se ata i japin vlerë dhe përgjegjësi, kështu që, atëherë *formohet një komunitet moral.*

- **Rregullat** e klasës formohen bazuar tek forca e gjykimit moral të nxënësve, ndërkohë që ata u përshtaten rregullave vullnetarisht, *shihen raste të respektimit të të tjerëve* me sjellje që burojnë nga zhvillimi i karakterit.

- **Programet** mësimore të lëndëve të tjera akademike si: *letërsia, historia, shkenca,* apo *etika* sqarohen në mënyrë po aq të pasur sa edhe temat morale, për të mësuar vlerat përdoren mjete të zgjedhura, përmes kësaj kurrikule shpjegohen vlerat universale (Facing, History and Ourselves and The Heartwood Ethics Curriculum etj.)

- **Nxënësit** mësojnë të aplikojnë medimet e të tjerëve, t'i japin rëndësi pikëpamjeve të të tjerëve, arritjes së qëllimeve të përbashkëta, mësojnë të bashkëpunojnë me qëllim që të punojnë së bashku për të zhvilluar aftësitë.

- ***Për të zhvilluar mendimet*** morale tek nxënësit ata ndihmohen duke lexuar libra, duke bërë kërkime, duke shkruar kompozicione, duke mbajtur ditarë dhe duke zbatuar teknika debati.

- ***Nxënësit mësohen*** se si të zgjidhin mosmarrëveshjet me qëllim fitimin e vlerave dhe aftësive themelore të moralit.

- Për të përvetësuar vlerat që mësojnë në klasë zhvillohen sugjerime të përbashkëta në të gjithë shkollën. Për shembull drejtori ekzekutiv zhvillon kulturë morale pozitive duke u sjellë në përputhje me rregullat disiplinore. Tregon qasje komunitare në të gjithë shkollën, etj.

- ***Sigurojnë nxënësit dhe familjet e tyre*** se janë mësuesit e tyre me moral të parë e të rëndësishmit. Zhvillojnë vlerat themelore morale duke afruar mënyra të ndryshme për përmirësimin e vlerave dhe zhvillimin e shoqërisë, rregullave fetarë, etj. Duke kërkuar edhe ndihmën e medias mundohen të ndihmojnë familjet dhe bashkësitë në zhvillimin moral dhe të karakterit.

Sipas *Burns* (1992), rëndësia e ndërtimit të një komunikimi të rregullt midis prindërve dhe mësuesve është e madhe. Korespondenca me prindërit për ngjarjet shkollore, rregullat e shkollës, rregullin për marrjen e mendimit të prindërve në hartimin e fletëpalosjeve, janë mjete tradicionale të komunikimit. *Raportet individuale për nxënësit, telefonatat midis prindërve dhe mësuesve, mbledhjet midis tyre, takimet për të biseduar privatisht në lidhje me nxënësit, vizitat në shtëpitë e nxënësve për t'u njohur më nga afër me mjedisin familjar të tyre, afrimi i ditëve të hapura për prindërit, gjatë të cilave ata mund*

të vëshgojnë të gjitha aktivitetet që fëmija i tyre bën në klasë, janë hapësira komunikimi të përdorura ndër vite, që prindërit dhe mësuesit përdorin për të ndërtuar komunikim mes tyre (Bruns dhe të tjerët 1992: 6).

Edukimi moral i fëmijës që fillon në familje, formësohet në shkollë dhe vazhdon më tej në rrethin shoqëror. Për një edukim moral të shëndetshëm kërkohet një koordinim e bashkëpunim, një lidhje shumë e fortë ndërmjet familjes dhe shkollës. Shkolla është burimi i të marrurit dituri dhe vendi ku aplikohet edukata morale që fitohet në shtëpi. *Kur fëmija fillon shkollën sidoqë të jetë, i suksesshëm apo jo, prindërit nuk duhet ta demoralizojnë.* Përtej qënies një institucion shkolla është një fushë dhe zonë e jetës, shtëpia dhe vendi ku fëmija merr edukimin bazë. Në shkollë fëmija zgjeron horizontin dhe ka mundësinë e praktikimit të normave morale që fiton. Kur fëmija fillon shkollën, njeriu i parë me të cilin takohet dhe ballafaqohet është mësuesi. Si një burim diturie mësuesi për fëmijën është një këshillues dhe udhëzues. Sidomos në vitet e para të shkollës mësuesi për fëmijën është sikurse prindi. Madje edhe në rastet kur mësuesi bie në kundërshti me familjen, mësuesi në sytë e fëmijës ka gjithmonë të drejtë. Kur mësuesi në shumë çështje morale merret dhe pranohet si shembull, përgjatë gjithë jetës së tij, shumë sjellje të fëmijës tregojnë ndikimin e drejtpërdrejt të mësuesit. *Nëse një mësues sillet në mënyrë të sjellshme, është fisnik, bamirës dhe i respektueshëm edhe fëmija medeomos e imiton atë.*

Dashuria, gjithashtu, është një mjet shumë i rëndësishëm në dorën e mësuesit. Nëse një fëmijë përballë mësuesit të tij nuk ndjehet i qetë dhe nuk ka besim tek ai, atëherë mësuesi nuk mund të kontribuojë aspak në zhvillimin e tij moral. Një mësues i padëshiruar, jo i dashur nga fëmija, as mësimet nuk kanë ndikim dhe as sjelljet e tij nuk imitohen nga ai.

Shkolla, mësuesi dhe familja janë elementë të pashmangshëm në edukimin moral të fëmijës. Nëse do të kishin mundësi, prindërit duhet ta zgjedhin vetë mësuesin fëmijës së tyre. Duke i kushtuar vëmendje të madhe bashkëpunimit shkollë-familje prindërit duhet që t'i vizitojnë fëmijët e tyre në shkollë dhe të takohen rregullisht me mësuesin e tyre. *Prindërit nuk duhet t'i neglizhojnë mbledhjet e prindërve, orarin e vajtje-ardhjes në shkollë, shokët apo shoqet më të cilët fëmija shoqërohet, duhet të jenë gjithmonë nën vëzhgimin e tyre.* Gjithashtu duhet kushtuar një kujdes dhe vëmendje e posaçme që fëmija i tyre të krijojë raporte konstruktive dhe të drejta me shokët e shkollës, e për çdo sukses që arrijnë duhet të shpërblehen në mënyrën e duhur. Duke mbajtur kontakt me mësuesin duhet të zbatohen porositë dhe propozimet e tij në lidhje me fëmijën (Aydın, 2012: 183).

Me krijimin e një bashkëpunimi konstruktiv ndërmjet prindërve dhe mësuesve afrohet mundësia e njohjes së palëve edhe më mirë. Kritikata që vijnë nga ana e prindërve, e vështirësojnë pranimin e mësuesit nga ana e fëmijës si një model shembullor. *Kurrësesi prindërit nuk duhet të kritikojnë apo të flasin keq për mësuesin në sy të fëmijës.* Nëse të fëmija vëren një tendencë të tillë, duhet udhëzuar të bëjë një vlerësim sa më të paanshëm. *Hollingsworth e Hoover,* duke trajtuar si mësues nënën dhe babain, theksojnë se një sjellje e mirë që është përfutur nga ana e mësuesit në shkollë mund të rrënohet dhe prishet shumë kollaj nga prindërit në shtëpi. *Kjo është edhe një arsye ku del në pah dhe rëndësia e bashkëpunimit familje-shkollë.* Ato që bëhen dhe mësohen në shkollë nëse nuk mbështeten nga ana e nënës dhe babait e bën të pamundur që fëmija të bëhet i moralshëm dhe arrijë sukses (Vural, 2005: 150).

4.4. Sjelljet përfaqësuese për të cilatduhet të bëjnë kujdes nëna dhe babai në edukimin moral

Metoda më e mirë në edukim është shembulli i mirë i nënës dhe babait. Fëmija rritet dhe zhvillohet brenda famijes duke i marrë të rriturit si shembull. Me anë të kësaj rruge sjelljet e të rriturve ua kalojnë fëmijëve. Nëse veprimet e prindërve janë të qëndrueshme dhe të ekuilibruara, edhe zhvillimi individual e social i fëmijës do të jetë i tillë. *Edukimi fillon me lindjen e fëmijës dhe vazhdon gjatë gjithë jetës së njeriut, në këtë proces familja është mjedisi i parë edukativ i fëmijës.* Duke qenë se aspektet mendore, emocionale, shoqërore dhe morale të fëmijës formësohen në familje, ato që fitohen këtu vazhdojnë të ndikojnë në shkollë, në jetën e punës, apo dhe shoqëri. Fëmija në vitet e para sheh me syrin e nënës dhe të babait. *Besimi, morali, sjellja, gjykimi i vlerave,* ashtu siç janë tek prindërit transmetohen dhe tek fëmijët. Prindërit të cilët nuk kanë përputhshmëri në teroi dhe praktikë, shfaqin një model të paqëndrueshëm. Kjo krijon terren që karakteri i fëmijës të formohet në mënyrë të gabuar. Fëmija i precepton njerëzit në shoqëri sikurse precepton nënën dhe babain. Për këtë arsye studiuesit i mëshojnë shumë qëndrimeve dhe sjelljeve të mira të prindërve (Çakmak, 2012: 86).

Fëmija, me dashje ose pa dashje i vlerëson sjelljet e prindërve. Qëndrimi i prindërve ndaj ngjarjeve, forma e bisedimit, fjalët që përdorin, fëmijët i mësojnë duke marrë shembull prindërit. Për këtë arsye prindërit nuk mund t'i mësojnë fëmijës virtyte morale duke ua treguar por duke i përjetuar ato. Një nga gabimet më të mëdhaj që bëjnë prindërit është se: duke qenë se e kanë të vështirë t'i japin shembull fëmijës me qëndrimin dhe sjelljen e tyre e bëjnë këtë duke i këshilluar dhe kërcënuar (Meydan, 2012: 56).

Në syrin e fëmijës, nëna dhe babi dinë çdo gjë, janë të përkryer, janë qenie të përsosura. Duke i shtuar kësaj dashurinë dhe mëshirën e prindërve për fëmijën, njëriu më me ndikim tek ai është prindi. Të gjitha bisedat në shtëpi, uljet e ngritjet në marrëdhëniet me personat e familjes, shkurt të gjitha këto qëndrime e sjellje imitohen nga fëmija. Nga kjo pikëpamje sjelljet që dëshirojnë të shikojnë tek femija, prindërit duhet t'i shfaqin vetë, pasi ai imiton prej tyre. **Gjuha me efektive është gjuha e sjelljes.** Fëmijët kur janë në moshë të vogël imitojnë nga prindërit, *frikën, entuziazimin, qëndrimet dhe sjelljet* sikurse një letër karboni. “*Vepra*” është më e rëndësishme se fjala, fëmija zbaton atë që shikon e jo atë që dëgjon. Dhënia e edukimit me anë të sjelljes është më e saktë se sa edukimi me anë të këshillave. Bile, është e tillë që, dhunën që shikon në shtëpi ia ushtron shokëve në shkollë dhe vëllezërve më të vegjël në shtëpi (Yavuzer, 2000: 101).

Përpjekja e prindërve për të ndërtuar një jetë të qetë do të shërbejë edhe si modeli, si shembulli moral për fëmijën. Duke u përpjekur të bëjnë një jetë të tillë, do të thotë se fjalët nuk merren parasysh. ***Sjellja negative apo pozitive e prindërit është shembulli natyral i fëmijës.*** Këto mësimet fëmija i merr ndonjëherë duke vëzhguar sjelljet, ndonjëherë duke dëgjuar çfarë i thuhet, shkurt me anë të vëzhgimit. Duke marrë si shembull vazhdimet në mjedisin natyral të familjes, fëmija mëson me anë të **“imitimit”** ose me anë të **“përvetësimit”**. Është e natyrshme që shembujt negativë që përjetohen në familje të pasqyrohen tek fëmija. Në një kërkim, bërë tek *214 të rinj* me familje që kanë precedentë penalë, ose tek kushërinjtë e parë të tyre ka rezultuar se *54%* prej tyre janë me precedentë penalë. ***Shembulli pozitiv ka ruajtur fëmijën nga shembulli i keq.*** Sepse nëse qëndrimet negative vendosen në ndërgjegje, çrrënjësja e tyre në vitet në vazhdim nuk është

e lehtë. Duke qenë se nëna dhe babai për fëmijën janë njerëzit më të dashur dhe më të besueshëm, si fillim ai i imiton ato. *Të mësuarit me anë të imitimit ia zë vendin identifikimi.* Identifikimi, duke qenë një proces kërkimi për personalitetin, është përpjekja e fëmijës për t'i përngjasuar një të rrituri që e do shumë apo që është befasuar prej tij. Fëmija duke u socializuar e duke zhvilluar personalitetin ka nevojë që të identifikohet. Në etapën e parë të kësaj nevojë ndodhen prindërit. Në këtë situatë detyra më e madhe që u bie atyre është shfaqja e një modeli me sjellje morale, bërja e modelit pozitiv e të drejtë për fëmijën. Nuk duhet harruar se fëmijët nuk shkojnë te vendi që u tregon me dorë, ata ndjekin gjurmët e prindërve (Tarhan, 2006: 170).

4.4.1. Përshtatja midis nënës dhe babait

Përvetësimi i sjelljeve të dëshiruara nga fëmija bëhet kur së bashku me sjellje të bukura në familje, fëmija shikon përshtatshmëri midis prindërve. Kur nëna dhe babai duan ta edukojnë fëmijën duhet të ecin paralelisht, ***marrja e vendimeve duhet të bëhet një herë dhe në mënyrë të saktë.*** Një sjellje që nuk miratohet nga babai dhe nuk gjen mbështetjen e nënës, apo edhe kur ndodh e kundërta krijon një situatë të vështirë për të pasur një edukim të suksesshëm. Përshtatshmëria prindërve, si dhe, dashuria e besimi në familje e pjekin fëmijën; e bëjnë që të fitojë personalitetin e tij të qëndrojë me këmbët e tij. Fëmijën duke e dashur i shton besimin, duke e mbështetur i rrit vetërespektin, duke e mirëkuptuar e mëson të jetë tolerant e të veprojë i pavarur. *Në një familje të shëndetshme bashkëshortët janë të lidhur emocionalisht me njëri-tjetrin, kështu që i gjenden pranë njëri-tjetrit me kënaqësi.* Duke ndërtuar një ambient të tillë të lumtur e mbushës janë të ndërgjegjshëm dhe tregojnë respekt njëri-tjetrit. Bashkëshortë të tillë, që vazhdimisht komunikojnë dhe ndihmojnë

njëri-tjetrit, edhe në rritjen e fëmijës janë të suksesshëm. Fëmija i rritur në një familje të shëndoshë u përgjigjet në mënyrë të natyrshme nevojave dhe kërkesave të prindërve. *Bashkëshortët që krijojnë në familje komunikim me njëri-tjetrit nuk lënë hapësira për ngjarje e situata negative.* Autoriteti nuk është shqetësim. Secili është zotërues i të drejtave të barabarta. Ata janë njerëz që vazhdimisht i japin mbeshtetje njëri-tjetrit, besim dhe përpiqen për zhvillimin e tyre. Njerëz të tillë e shikojnë rritjen e fëmijës si një detyrë e përgjegjësi të rëndësishme dhe i çojnë në vend detyrat e tyre. ***Fëmija që ndodhet në një mjedis familjar paqësor dhe harmonik e zhvillon mirë personalitetin dhe plotëson me sukses zhvillimin personal.***

Në një familje jo të shëndetshme, ku mbizotëron ndjenja e konkurrencës ekziston në të njëjtën kohë edhe rivaliteti për autoritet. Familja është e detyruar t'i përulet këtij autoriteti, gjithmonë ndodh që vendos ai që ka në dorë autoritetin. Nuk mund t'i dalësh kundër e nuk ekziston guximi për të diskutuar. Nëse autoriteti është në dorën e babait, ai nuk i jep të drejtë nënës. *Në familje të tilla nuk i jepet mundësi individit të zhvillojë personalitetin, kështu që nuk mund të jetë i suksesshëm edukimi.* Nëse mosmarrëveshjet në familje nuk e lejojnë fëmijën që ta njoh personalitetin e tij, ndalojnë zhvillimi i personalitetit e nuk mund të ndodhë pjekuria e fëmijës. ***Fëmija edhe nëse rritet fizikisht, zhvillimi i tij psikologjik mbetet i mangët dhe i dobët*** (Gökmar, 2004: 93).

Papajtueshmëria e anëtarëve të familjes e lë fëmijën në mes të dy palëve. Duke parë një nënë tolerante e një baba të sertë dhe shtypës, fëmija nuk di kujt rregulli t'i përshtatet. Kështu që fëmija nuk mund të vendosë se cila është e mirë, e cila është e keqe. Nuk e kupton se kur, ku dhe se cila sjellje duhet ndjekur. *Qëndrimet e prindërve dhe fjalët e thëna*

qëndrojnë në të njëjtën gradë. Prindërit mund të hasin mospërputhshmëri për sa i përket edukimit të fëmijës, por më e rëndësishmja është mosdebatimi në sy të fëmijës. Metodrat e ndjekura në edukim dhe gabimet e fëmijës mund të diskutohen, por fëmijës duhet t'i paraqiten vetëm vendimet. Me mendimin për të ecur paralelisht, fëmija nuk duhet të turbullohet, nëna dhe babi duhet t'i japin mundësi mbështetjeje njëri-tjetrit (Aydın, 2012: 192-193).

KAPITULLI V: METODOLOGJIA

5.1. Metodatat e përdorura

Metodat e përdorur në këtë punim do jetë në funksion të realizimit të qëllimit të këtij punimi. Për këtë arsye kemi zgjedhur *metodën sasimore*, metodë e cila ka si qëllim për të matur, për të caktuar sasinë, për të analizuar dhe për të testuar të dhënat në mënyrë që të japë shpjegime, për të provuar korrelacion në mes të variablave dhe për zhvillimin e ligjeve të përgjithshme, të cilat mund të aplikohen në botë. Sipas Creswell:

“Në hulumtimin sasior objektivi është për të provuar apo për të verifikuar, në vend që ta zhvillojë atë. Kjo mënyrë fillon të studiojë përparimin e teorisë, mbledh të dhëna për ta provuar atë dhe reflekton se ku teoria është konfirmuar ose diskonfirmuar nga rezultati i studimit. Teoria bëhet një kornizë për të gjithë studimin, si model organizativ për pyetjet kërkimore ose hipotezave dhe për procedurën e mbledhjes së të dhënave. Studiuesi teston një teori duke përdorur hipotezat apo pyetje, të cilat, nga ana tjetër, përmbajnë variabla, që maten duke përdorur artikuj në një instrument” (Creswell, 1994: 87, 88).

Një veçori tjetër e metodës sasimore është që se ajo kombinon të dhënat primare me ato sekondare. Të dhënat primare janë rezultatet e marra nga pyetsorët që janë zhvilluar menjëherë të shkollat 9-vjeçare publike të qytetit të Tiranës. Ndërsa të dhënat sekondare janë rezultat i rishikimit të një literature të gjerë dhe bashkëkohore lidhur me ndikimin e familjes në edukimin dhe moralin e fëmijëve të tyre. Kjo literaturë është siguruar nga kërkime dhe studimeve të ndryshme të vendeve të rajonit dhe vendeve të tjera.

5.2. Kampionimi

Kampioni i këtij kërkimi përbëhet nga nxënësit djem dhe vajza të shkollave 9-vjeçare publike në qytetin e Tiranës. Shkollat janë përzgjedhur sipas metodës së kampionimit të

volitshëm (convenience sampling). Mostra e studimit u përcaktua nga mostrat e komoditetit (lehtësisë). Në marrjen e mostrave të volitshme, studiuesit thjesht përdorin si pjesëmarrës ata individë të cilët janë të lehtë për t'u arrirë. Njerëzit janë zgjedhur në bazë të disponueshmërisë së tyre dhe gatishmëris për t'iu përgjigjur (Gravetter dhe Forzano, 2015: 146). Sipas afërsisë me njëra tjetrën dhe numrit të nxënësve, anketat i janë dorëzuar drejtorive të shkollave përkatëse dhe klasave të 9-ta që do të plotësonin anketat.

Sipas informacionit zyrtar nga *Drejtoria Arsimore* numri total i nxënësve që studiojnë në këto shkolla është 5858. Arsyeja pse u zgjodhën vetëm shkolla 9 vjeçare në Tiranë është se Tirana ka pothuaj *1/3 e popullsisë* së vendit, duke patur kështu edhe numrin më të madh të shkollave e nxënësve gjithashtu. Madje, duke ditur se vitet e fundit është shtuar lëvizja e popullsisë nga qytetet dhe fshatrat e tjera drejt Tiranës, edhe kampioni ynë është më shumë gjithëpërfshirës duke bërë që familjet dhe vetë nxënësit të reflektojnë kulturë dhe edukatë të ndryshme.

Kampioni ynë ka anketat me pyetësorë të **2341 nxënësve** pasi **20 prej** tyre nuk kishin informacionin e nevojshëm dhe u hoqën nga databaza përfundimtare. Duke patur parasysh faktin se intervali i besimit për kampionin është **95%** dhe marzhi i gabimit është **±2%**, llogaritjet tregojnë se vlera e kampionit tonë kapi vlerën **2321**.

I njëjti përfundim është marrë edhe nga përdorimi i formulës së përcaktimit të kampionit (**SS=sample size**) kur **$z=1.96$, $p=0.6$, $1-p=0.4$ dhe $c=±2%$** .

$$SS = \frac{Z^2 * (p) * (1-p)}{C^2}$$

Të anketuarit, (*nxënësit*), të cilët morën pjesë në këtë vrojtim janë të gjinive, moshave dhe shkollave të ndryshme duke bërë që kampioni të ishte sa më përfaqësues.

5.3. Pse klasat e 9-ta?

Kohlberg, shprehet se zhvillimi moral realizohet në moshën e pubertetit (12-18 vjeç) dhe se në këtë moshë fëmija përjeton ndryshime në aspektin social, emocional, mendor dhe moral. Njëkohësisht këtë periudhë e ka përcaktuar si periudhën e përcaktimit të rregullave morale (Akbaba, 2011: 23).

5.4. Instrumentet

Në punimin me temë “Rëndësia e familjes në edukimin e moral” është përdorur si instrument vetëmteknika e vrojtimit me pyetësorë.

Sipas *Khandwalla*, (1976) nuk ka një metodë kërkimi që mund të konsiderohet si më e mirë. Secila nga metodat e përdorura shoqërohet me avantazhe dhe disavantazhe. Zgjedhja e metodës mund të bëhet duke u mbështetur në disa kritere. Mundësia për të përgjithësuar të dhënat duke përdorur metodën e kërkimit me pyetësorë vlerësohet e lartë në rastin e pyetësorëve. Si rezultat, përdorimi i pyetësorëve si metodë për mbledhjen e të dhënave në këtë punim mundëson **(1) hetimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet variablave të marrë në studim**, dhe **(2) tenton për të ‘plotësuar’ studimet e mëparshme që kanë**

përdorur kryesisht metoda cilësore, si psh analizë situatash. Sipas Field, (2005) ekzistojnë shumë rregulla për sa i përket vëllimit të zgjedhjes, por si rregull i përgjithshëm duhen 10-15 përgjigje për variabël (ky rregull vlen si për regresionin ashtu edhe për analizën faktoriale).

Përdorimi i pyetësorit si metodë për mbledhjen e të dhënave ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Shqetësimet kryesore në përdorimin e pyetësorëve kanë të bëjnë me vlerësimin e vlefshmërisë dhe besueshmërisë së tyre (Saunders dhe të tjerët, 2009). Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë (1985), cituar tek Hinkin (1995) njësitë matëse të pyetësorit duhet të tregojnë *vlefshmëri të përmbajtjes, vlefshmëri të lidhur me kriteret, vlefshmëri të konstruktit dhe qëndrueshmëri të brendshme*. Tre kriteret e para lidhen me vlerësimin e vlefshmërisë së brendshme të pyetësorit, e cila tregon aftësinë e pyetësorit për të matur atë që kërkuesi synon të masë (Saunders dhe të tjerët, 2009). Vlefshmëria e përmbajtjes i referohet shtrirjes në të cilën pyetësori afron mbulimin e duhur të pyetjeve hetuese. Një mënyrë për ta realizuar këtë është përdorimi i një paneli individësh për vlerësimin e pyetësorit. Vlefshmëria e lidhur me kriteret ka të bëjë me aftësinë e pyetjeve për të bërë parashikimet e duhura. Për këtë mund të përdoret analiza statistikore e korelacionit. Besueshmëria (*testimi i besueshmërisë*) ka të bëjë me faktin nëse pyetësori do prodhojë ose jo rezultate të qëndrueshme, në kohë të ndryshme dhe në zgjedhje të ndryshme. Një mënyrë për ta vlerësuar atë është matja e qëndrueshmërisë së brendshme, p.sh., nëpërmjet llogaritjes së *Cronbach alfa*.

5.5. Përse është zgjedhur vrojtimi me pyetësorë

Një nga strategjitë e kërkimit të përdorura për realizimin e studimeve është ajo e mbështetur në vrojtme me pyetësorë e cila është një nga teknikat e mbledhjes së të dhënave që i përkasin kësaj strategjie. Përdorimi i strategjisë së vrojtimit mundëson mbledhjen dhe analizën sasiore të të dhënave duke përdorur statistikën përshkruese dhe atë analitike. Gjithashtu të dhënat e mbledhura nëpërmjet kësaj strategjie mund të përdoren për të sugjeruar arsyetime të mundshme për lidhje të caktuara ndërmjet variablave dhe për të krijuar modele të këtyre lidhjeve.

Metodat e arritjes së qëllimit të studimit janë nga më të ndryshmet, duke parë dhe duke vlerësuar njëkohësisht avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tyre. Përdorimi i pyetësorëve si metodë për mbledhjen e të dhënave në këtë material mundëson jo vetëm analizimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet variablave të marrë në studim, por jep mundësinë edhe të disa rekomandimeve lidhur me ndikimin e familjes në edukimin, respektin dhe sjellje të nxënësve të shkollave 9 vjeçare.

Për arritjen e objektivave të këtij studimi dhe për të marrë opinionin e nxënësve lidhur me ndikimin që ka familja, shkolla dhe shoqëria në sjelljen, respektin dhe edukatën e tyre në jetën sociale në u realizua ky vrojtme me pyetësorë.

5.6.Hartimi i pyetësorit

Në këtë studim është përdorur anketa: *“Faktorët ndikues në përvetësimin e vlerave dhe sjelljeve morale të nxënësve të klasës së 9-të”*, me autor *Mevlut Kayase*:

Pyetësori për nxënësit (bashkëlidhur) përbëhet nga dy seksione:

Seksioni I: Ka informacion të përgjithshëm *lidhur me gjininë, moshën, shkollën ku studiojnë këta nxënës, vendbanimin,* etj. Gjithashtu në këtë seksion janë konsideruar të rëndësishme edhe informacionet lidhur *me statusin e prindërve të këtyre nxënësve, profesionet e tyre, situatën ekonomike si dhe lidhjen e tyre me fenë.*

Seksioni II: Përmban pyetjet më specifike lidhur me ndikimin që ka familja apo shoqëria në formimin e pjekurisë morale të tyre. Ky seksion përbëhet nga katër pjesë.

Pjesa A: Sjellja ndaj të tjerëve, e cila ka në qendër të pyetjeve të saj mënyrën qytetare të të sjellurit me të tjerët, si: *të ruhem i që të mos i lëndojmë njerëzit, të kërkojmë falje kur gabojmë, të kemi dhembshuri për të dobët dhe të pafuqishmit, të ndihmojmë njerëzit në nevojë,* etj.

Pjesa B: Toleranca dhe respekti, trajton pyetje dhe siguron informacion lidhur me *tolerancën ndaj të tjerëve, familjes, shokëve, të afërmit* etj. Të respektojmë të drejtat e të tjerëve, të sillemi tolerantë ndaj kritikave, të sillemi të kuptueshëm e tolerantë me njerëzit rreth nesh, këto janë disa nga çështjet e kësaj pjese.

Pjesa C: Edukata, si një element tjetër i rëndësishëm i formimit të çdo individi dhe nxënësi është trajtuar duke siguruar informacion nga pyetje të tilla si: *Njerëzit duhet t'i duam dhe t'i vlerësojmë pa bërë dallim feje, gjuhe apo rrace.* Duhet të kujdesemi t'i çojmë në vend përgjegjësitë tona, dhe të reagojmë ndaj padrejtësive. Nuk duhet t'i mashtrojmë të tjerët duke përdorur dobësinë e tyre. Pyetjet sërish janë matur duke bërë zgjedhjen se cili

nga faktorët (*familja, shkolla, shoqëria*) ka ndikuar më shumë në formimin dhe edukatën e tyre, pasqyruar jo vetëm në shkollë e familje po dhe në jetën e përditëshme.

Pjesa D: Respekti për familjen dhe shoqërinë, ka në qëndër të saj *respektin që duhet të kenë fëmijët ndaj familjes, ndaj shokëve dhe shoqeve të tyre apo dhe ndaj më të vegjëlve*. Pyetjet maten duke marrë vlerësimin e ndikimit nga familja, shkolla, mësuesit dhe shoqëria (*shoku/shoqja*). Si metodë matëse është përdorur shkalla ordinale.

Pyetjet janë formuluar në mënyrë të tillë, të jenë sa më të kuptueshme nga nxënësit duke zgjedhur përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor të cilat janë të shkallëzuara por edhe pyetje pohuese apo mohuese. Gjatë hartimit të pyetësorit një rëndësi të veçantë iu kushtua jo vetëm strukturimit të pyetjeve, por edhe formulimit të tyre në mënyrën e duhur me qëllim që përgjigjet të ishin të vlefshme dhe në dobi të synimit kryesor.

5.7. Testimi i pyetësorit

Pyetësori për nxënësit e *shkollave 9-vjeçare* u testua paraprakisht në 55 prej tyre, zgjedhur rastësisht në këto shkolla, për të parë nëse kishte probleme apo paqartësi në plotësimin e tij si dhe për të testuar besueshmërinë e vlefshmërinë e tij. Rezultati i testit pilot tregoi se pyetjet e pyetësorit në përgjithësi ishin të formuluar saktë. Pyetjet që nuk ishin të qarta, nga të cilat nuk mund të merrej informacioni i duhur u konsultuan me ekspertët e fushës dhe specialistin e statistikës për t'i sjellë ato të formuluar siç duhej. Pas këtij procesi pyetësori u shpërnda në shkollat 9-vjeçare të qytetit të Tiranës.

5.8. Besueshmëria dhe vlefshmëria e pyetësorit

Lidhur me testin e besueshmërisë, një mënyrë për ta vlerësuar atë është matja e qëndrueshmërisë së brendshme, p.sh.: nëpërmjet llogaritjes së *Koeficientit Cronbach Alfa*. Bazuar në llogaritjet për koeficientët *Cronbach Alfa* për matjen e qëndrueshmërisë së brendshme të pyetësorit u arrit në konkluzionin se vlera e tyre ishte më e lartë se 0.7, (*norma e lejuar*) duke treguar qëndrueshmëri të pyetësorit. Duke ditur se secila nga pyetjet paraqet një variabël, i cili mund të marrë më shumë se një përgjigje është menduar që në pyetjet e mbyllura alternativat e përgjigjeve të jenë sa më reale, në mënyrë që të merret informacioni i nevojshëm. Pra, gjatë hartimit dhe përshtatjes së tij u bë kujdes që të mbaheshin parasysh dy elementë kryesorë, si: *besueshmëria e cila ka të bëjë me faktin nëse pyetësi do të prodhojë ose jo rezultate të qëndrueshme në kohë të ndryshme për zgjedhje të ndryshme, si dhe vlefshmëria e pyetjeve*. Për të vlerësuar vlefshmërinë e përmbajtjes u përdor metoda e “*ekspertëve të fushës*” si statisticien, mësues, etj, të cilët morën pjesë në hartimin dhe përshtatjen e pyetësorit.

Anketa e studimit është zhvilluar me 2341 nxënës, ndërsa kampioni i zgjedhur përfundimisht përmban 2321 anketa pasi **20 prej** tyre u hoqën nga studimi sepse nuk përmbanin informacionin e nevojshëm dhe për analizimin e tyre është përdorur një koeficient besueshmërie **95%** dhe marzhi i gabimit është **±2%**.

5.9. Kufizimet e kërkimit

1. Popullsia e këtij kërkimi, kufizohet në shkollat 9-vjeçare tek nxënësit e klasave të nënta, të vitit shkollor 2014-2015.

2. Ky studim është zhvilluar në shkollat 9- vjeçare publike në qytetin e Tiranës dhe nuk përfshin ato private.

3. Kërkimi u zhvillua në këto shkolla: *“Ali Demi”, “Bajram Curri”, “Fan Noli”, “Gjon Buzuku”, “Jeronim de Rada”, “Lasgush Poradeci”, “Kongresi Manastrit”, “Mihal Grameno”, “Misto Mame”, “Musine Kokalari”, “Pjetër Budi”, “Ramazan Jarani”, “Skënder Çaçi”, “Siri Kodra”, “Sabahudin Gabrani”, “Vasil Shanto”, “Shkolla e Kuqe”, “1 Maji”, “4 Dëshmorët”, “Qazim Turdiu”, “28 Nëntori”, “Lidhja e Prizrenit”, “M. Q. Atatürk”, “Avni Rustemi”, “Dora D’ Istria”, “Ahmet Gashi”.*

4. Në këtë studim janë marrë për bazë vetëm mendimet e nxënësve, duke mos përfshirë prindërit dhe mësuesit.

5. Ky kërkim është kufizuar tek mjetet e aplikuara matëse si pyetësorët dhe nuk janë përfshirë intervistat.

6. Ky punim ka lidhje me faktorët që kryesisht ndikojnë në përfitimin e vlerave dhe sjelljeve morale të nxënësve.

7. Kampionimi i përdorur në këtë punim është rastësor.

Studimi është bërë bazuar vetëm në perceptimet e nxënësve. Nëse studimi do të bëhej bazuar në perceptimet e prindërve dhe mësuesve, atëherë mund të merren rezultate të tjera.

5.10. Puna në terren

Realizimi i kësaj ankete në shkollat *9-vjeçare shtetërore të qytetit të Tiranës* është realizuar duke marrë leje paraprakisht nga *Drejtoria Arsimore Tiranë*. Vrojtimi me pyetësorë është kryer në 26 shkolla 9- vjeçaretë qytetit të Tiranës nga 64 shkollashtetërore gjithësej.

Vizitat në *shkollat 9-vjeçare* u kryen në bashkëpunim me stafin drejtues dhe mësuesit e këtyre shkollave. Duke ditur se kishim një numër relativisht të madh prej 26 *shkollash* në gjithë *qytetin e Tiranës* u vendos që plotësimi i pyetësorëve të kryhej sipas një kalendari të përcaktuar më parë në mënyrë që të arrihej koha e përcaktuar për realizimin e tyre me sukses.

5.11. Mbledhja e të dhënave primare

Vrojtimi në terren ka filluar më muajin **4 Maj 2015** dhe grumbullimi i tyre kanë përfunduar më **5 Qershor 2015**. Me anë të vizitës nëpër shkolla është kontrolluar kthimi dhe mbledhja e anketave. Vrojtimi me pyetësorë është kryer në shkollat e përmendura më sipër

5.12. Analiza e të dhënave primare

Analiza e të dhënave është kryer nëpërmjet analizës deskriptive, tabelave të kryqëzuara (*crosstabulations*), testeve të pavarësisë, korelimet midis variablave, analizës faktoriale, ndërtimit dhe shqyrtimit të hipotezave, analizës së variancës (*ANOVA*), ndërtimit i ekuacionit të regresionit të shumfishtë linear, etj. Pra, *jo vetëm një analizë*


përshkruese por edhe një analizë analitike. Pjesë e këtij procesi ishte krijimi i databazës me të dhënat e grumbulluara, përpunimi dhe analiza e tyre. Përpunimi dhe analiza u realizua nëpërmjet paketave të programeve kompjuterike *SPSS 17.0 dhe Excel.*

KAPITULLI VI: ANALIZA E REZULTATEVE

6.1. Analiza e përgjithëshme statistikore

Në këtë studim kanë marrë pjesë **2321 nxënës** të **26 shkollave 9-vjeçare** të qytetit të Tiranës, nga të cilët **53% janë vajza** dhe pjesa tjetër me **47% janë djem**, kjo edhe për faktin se pjesa më e madhe e popullisë në tërësi dominohet nga femrat (*Grafiku VI. 1*).

Grafiku VI.1 Gjinia



Duke qënë se nxënësit e marrë në kampion studiojnë në shkolla 9- vjeçare, ata i takojnë moshave të ndryshme. Kështu tabela e mëposhtme tregon se pjesa më e madhe e kampionit tonë dominohet nga nxënësit e moshës **15 vjeç me 74.8%** të përgjithshëm të ndjekur nga nxënësit e moshës **14 vjeç me 18.1%**. Më pas renditen nxënësit e moshës **16 vjeç me 5.4%** ndërsa ata me moshë **12 dhe 13 vjeç zënë secili nga 0.8%** të kampionit.

Kampioni është marrë gjithpërfshirës por është fokusuar më së shumti tek klasat e larta në mënyrë që edhe informacioni i marrë prej tyre të ishte më i plotë e më i saktë.

Tabela VI.1 Shpërndaja e nxënësve sipas moshave

	<i>Denduria</i>	<i>Përqindja</i>
12 vjeç	19	.8
13 vjeç	19	.8
14 vjeç	420	18.1
15 vjeç	1737	74.8
16 vjeç	126	5.4
Total	2321	100.0

Shkollat në të cilat është zhvilluar vrojtimi në terren janë **26** ashtu siç paraqiten në **tabelën 2**, ku shkollat që kanë numrin më të madh të nxënësve kanë edhe peshën më të madhe në kampion, siç janë: shkolla *“Lasgush Poradeci”*, *“Jeronin De Rada”*, *“Fan Noli”*, *“Sabaudin Gabrani”* etj.


Tabela VI.2 Shpërndarja e numrit të nxënësve sipas shkollave

Nr	Shkolla 9 vjeçare	Numri i nxënësve
1	<i>Skënder Çaçi</i>	73
2	<i>Shkolla e Kuqe</i>	60
3	<i>Qazim Turdiu</i>	127
4	<i>Misto Mame</i>	74
5	<i>Siri Kodra</i>	64
6	<i>Sabaudin Gabrani</i>	126
7	<i>Kongresi i Manastirit</i>	97
8	<i>Bajram Curri</i>	52
9	<i>Jeronin De Rada</i>	142
10	<i>Pjetër Budi</i>	58
11	<i>Ali Demi</i>	91
12	<i>1 Maji</i>	105

13	<i>Lasgush Poradeci</i>	157
14	<i>Ramazan Jarani</i>	43
15	<i>Gjon Buzuku</i>	125
16	<i>Fan Noli</i>	129
17	<i>Lidhja e Prizrenit</i>	64
18	<i>28 Nëntori</i>	82
19	<i>4 Dëshmorët</i>	59
20	<i>Qemal Atatürk</i>	63
21	<i>Mihal Grameno</i>	120
22	<i>Vasil Shanto</i>	100
23	<i>Musine Kokalari</i>	108
24	<i>Avni Rustemi</i>	45
25	<i>Dora D'istria</i>	62
26	<i>Ahmet Gashi</i>	95
	Total	2321

Për të kuptuar më mirë kushtet sociale dhe familjare në të cilat jetojnë këta nxënës, ata janë pyetur në lidhje me statusin familjar të prindërve të tyre. Kështu ndër **2321 nxënës** të pyetur në shumicën e tyre me **92%** ata shprehen se ***jetojnë në familje normale ku nëna dhe babai jetojnë bashkë.*** Në **4.2%** të rasteve ata shprehen se ***prindërit e tyre jetojnë të ndarë ose janë divorcuar.*** Për pjesën tjetër të tyre ose babai ose nëna nuk jeton më apo rastet më të këqija kur këta nxënës i ***kanë humbur të dy prindërit*** respektivisht me **2.1%**, **0.8%** dhe **0.9%**.

Grafiku VI.2 Statusi familjar i prindërve



Profesionet që kanë prindërit e këtyre nxënësve janë të ndryshme. Kështu sipas Tabelës 3 shohim se pjesa më e madhe e baballarëve të tyre me **32.6%** merren me *biznes privat*, të ndjekur nga **23.3%** që shprehen se baballarët e tyre *punojnë në administratë publike* dhe **20.6%** janë thjesht *punëtor*. Pjesa tjetër janë *mësues* me **7.3%**, *të papunë* me **6.9%** ose *bujk* apo *emigrant* respektivisht me **4.8%** dhe **4.6%**.

Tabela VI.3 Profesionet për babain

	Denduria	Përqindja
<i>Bujk</i>	111	4.8
<i>Nëpunës</i>	541	23.3
<i>Emigrant</i>	106	4.6
<i>Mësues</i>	170	7.3
<i>Punëtor</i>	477	20.6
<i>Biznes privat</i>	757	32.6
<i>I papunë</i>	159	6.9
Total	2321	100.0

Gjithashtu i njëjti informacion *është marrë edhe për nënat e tyre*. Kështu **tabela 4** tregon se pjesa më e madhe e nënave të këtyre nxënësve *janë shtëpiake* me **29.4%**, pra duke i shërbyer familjes në punët e shtëpisë, kujdesin ndaj fëmijëve, edukimit dhe mbarëvajtjes së tyre. Në **23.5%** të rasteve ata shprehen se nënat e tyre *janë thjesht punëtore* të punësuar në sektorë të ndryshëm publikë apo privatë, të ndjekur nga **17.1%** që janë të *punësuar në administratë publike* dhe **13.4%** janë *mësuese*. Në biznes privat kryesisht *biznes familjar* janë rreth **12%** e tyre dhe pjesa tjetër me **0.9%** punojnë *jashtë vendit si emigrante* dhe 3.6% kryejnë profesione të tjera në sektorë të ndryshëm si *mjekësi* dhe *shërbime*.


Tabela VI.4 Profesionit për nënën

	Denduria	Përqindja
<i>Nëpunëse</i>	398	17.1
<i>Shtëpiake</i>	683	29.4
<i>Emigrante</i>	21	.9
<i>Biznes privat</i>	279	12.0
<i>Punëtore</i>	546	23.5
<i>Mësuese</i>	311	13.4
<i>Tjetër</i>	83	3.6
Total	2321	100.0

Pjesa më e madhe e nxënësve të cilët kanë marrë pjesë në këtë vërtetim *banojnë në qytet* me **97.4%** dhe një pjesë e vogël me **2.6%** banojnë *në fshat* (Grafiku VI. 3).


Kërkimi është bërë në klasat e nënta të shkollave në qytetin e Tiranës. Shkaku që nxënësit e ardhur nga fshati ndodhen në statistika mendohet se mund të jetë; këta nxënës bëjnë çdo ditë vajtje-ardhje rrugën për në Tiranë ose qëndrojnë pranë të afërmëve të tyre.

Grafiku VI.3 Vendbanimi



Një tjetër informacion i cili na mundëson një panoramë më të gjerë për familjet e këtyre nxënësve, është edhe *arsimimi i prindërve* të tyre. Grafiku i mëposhtëm tregon se pjesa më e madhe e tyre janë *me arsim të mesëm* respektivisht *baballarët* me **46.1%** dhe *nënat* me **45.5%**. Ndërsa *me arsim të lartë* rezultojnë që *nënat* të zënë **43.2%** ndërsa *baballarët* me **39.7%**. Me *arsim 8 vjeçar* janë respektivisht **7.5%** e *baballarëve* dhe **4.6%** e *nënave*. Ndërsa në dy nivelet e tjera të shkollimit *nivelin master dhe doktoraturë* kemi se **5%** e *baballarëve* kanë përfunduar studimet master dhe **1.7%** studimet *doktoraturë* dhe **4.7%** e *nënave* kanë përfunduar *studimet master* dhe **2%** *studimet e doktoraturës*. Pra ajo që vihet re edhe nga grafiku është që përgjithësisht nënat (femrat) janë gjithë ashtu të shkolluara madje si në rastin e studimeve të larta apo doktoraturë edhe më të shkolluara se meshkujt.

Grafiku VI.4 Edukimi arsimor i prindërve



Lidhur me *kushtet ekonomike të familjeve të këtyre nxënësve*, duke patur parasysh edhe kushtet ekonomike të vendit tonë, vërehet se pjesa më e madhe e tyre me **22.7%** kanë nivel mesatar të ardhurash [40 000-60 000 lekë të reja], të ndjekur nga **18.1%** e tyre ku të ardhurat e tyre janë [60 000-100 000 lekë të reja], ku **34%** e kryefamiljarëve të këtyre familjeve merren me biznes privat (Tabela 1 në ANEKS). **16.8%** e tyre kanë të ardhura që i takojnë intervalit [30 000-40 000 lekë të reja] ku **24.3%** e kryefamiljarëve (baballarëve) janë punëtorë. Mbi 100 000 lekë të reja janë **14.8%** e familjeve ku **40.5%** e tyre merren me biznes privat dhe **30.6%** janë të punësuar në administratë publike. Mbi 200 000 lekë të reja janë **14.3%** dhe **7.3%** e tyre kanë të ardhura më të ulëta se 30 000 lekë të reja dhe kryesisht ato familje kur kryefamiljari është i papunë apo thjesht punëtor (Tabela VI. 5).

Tabela VI.5 Niveli mesatar i të ardhurave në familje

	Denduria	Përqindja
<i>Më pak se 30,000 lekë</i>	169	7.3
<i>30,000 -40,000 lekë</i>	391	16.8
<i>40,000-60,000 lekë</i>	528	22.7
<i>60,000-100,000 lekë</i>	420	18.1
<i>Mbi 100, 000 lekë</i>	343	14.8
<i>Mbi 200, 000 lekë</i>	331	14.3
<i>Pa përgjigje</i>	139	6.0
Total	2321	100.0

Vlerësimi për faktorët që kanë ndikuar tek këta nxënës lidhur me sjelljen e tyre ndaj të tjerëve është matur nëpërmjet gjashtë pyetjeve kryesore dhe alternativat për faktorët e ndikimit janë: *familja, shkolla/mësuesit dhe shoku/shoqja*. Ky vlerësim jepet si në tabelën më poshtë nga ku vihet re se ndikimi i familjes si faktor kryesor në sjelljen ndaj të tjerëve në përgjithësi dhe për faktin se *duhet të kërkojmë falje kur gabojmë* në veçanti është vlerësuar me vlerën më të madhe krahasuar me alternativat e tjera duke zënë **65.9%** të faktorëve. Ndërsa pjesa tjetër mendojnë se ndikim më të madh *ka patur shkolla dhe shoqëria* respektivisht me **18.5%** dhe **15.6%** të përgjigjeve. *Alternativa –duhet të ndihmojmë njerëzit në nevojë*, ndikimi i familjes vërehet në **50.4%** të këtyre nxënësve të pyetur, i ndjekur nga *faktori shkolla/mësuesit* me **39.2%** dhe pjesa tjetër me **10.4%** ndikohet nga *shoku/shoqja*. Me **49.5%** të përgjigjeve për *faktorin – familja* janë vlerësuar gjithashtu edhe dy alternativat e tjera - *Duhet të kemi dhembshuri për të dobëtit dhe të pafuqishmit dhe të ruhem të mos i lëndojmë njerëzit* ndërsa faktori shoku/shoqja dhe shkolla kanë marrë respektivisht nga **32.5%** dhe **18.1%** të vlerësimit total të secilës prej tyre. Gjithashtu ndikimi i familjes është vlerësuar relativisht mirë edhe për dy alternativat e

tjera - të ndajmë gjërat që i kemi ne dhe të tjerët s'i kanë dhe duhet t'i ndajmë sendet tona me të tjerët respektivisht me **39.9%** dhe **37.8%** të përgjigjeve dhe pjesa tjetër ka vlerësuar shoku/shoqja respektivisht me **34.6%** dhe **34.9%**. Ndërsa ndikimi i faktorit shkolla/mësuesit ka marrë vlerësimin e **25.5%** dhe **27.3%** të secilës alternativë.

Tabela VI.6 Vlerësimi për faktorët e ndikimit tek sjellja ndaj të tjerëve

	<i>Familja</i>	<i>Shkolla/ mësuesit</i>	<i>Shoku/ shoqja</i>	<i>Total</i>
<i>Duhet të ndihojmë njerëzit në nevojë.</i>	50.4	39.2	10.4	100.0
<i>Duhet të kemi dhembshuri për të dobët dhe të pafuqishmit.</i>	49.5	18.1	32.5	100.0
<i>Duhet të ndajmë gjërat që i kemi ne dhe të tjerët s'i kanë</i>	39.9	25.5	34.6	100.0
<i>Duhet t'i ndajmë sendet tona me të tjerët.</i>	37.8	27.3	34.9	100.0
<i>Duhet të ruhem të mos i lëdojmë njerëzit.</i>	49.5	18.1	32.5	100.0
<i>Duhet të kërkojmë falje kur gabojmë.</i>	65.9	18.5	15.6	100.0

Edhe vlerësimi lidhur me tolerancën dhe respektin tregon gjithashtu të dhëna interesante. Kështu, edhe në këtë vlerësim ndikimi i familjes ka sërish vlerat më të larta krahasuar me dy faktorët e tjerë. Alternativa - *Edhe pse mund të jetë e dëmshme për ne nuk duhet të gënjejmë* ka marrë edhe vlerësimin më të lartë me **69.4%**, ndërsa alternativa me vlerësimin më të ulët (sa i takon ndikimit të familjes) renditet - *Duhet të respektojmë të drejtat e të tjerëve* me **32.3%** të përgjigjeve. Alternativa - *Nuk duhet t'i shqetësojmë të tjerët për dëshirat dhe kënaqësitë tona për* **56.3%** të përgjigjeve vlerëson familjen si faktor ndikues kryesor, më pas shoqërinë me **22.2%** dhe në fund me **21.5%** rendit faktorin

shkollë. Ndërkohë që faktori shkollë/mësues është vlerësuar më së shumti tek alternativa - *Edhe pse mund të mos jemi dakort me mendimin e tjetrit duhet ta dëgjojmë atë* me **38.2%**. Faktori ndikues shoku/shoqja ka vlerësim më të lartë në alternativën - *Duhet ta vendosim veten në vendin e të tjerëve dhe të mundohemi t'i kuptojmë ata* duke marrë edhe **36.8%** të përgjigjeve të kësaj alternative, e ndjekur nga faktori familje me **36.5%** dhe në fund faktori shkolla me **26.7%**.

Toleranca ka ndikim më të madh prej familjes me **51.1%**, po ashtu edhe *sjellja e kuptueshme dhe tolerante* me të tjerët është vlerësuar me **44%** të përgjigjeve, më pas renditet faktori shkollë me **36.8%** dhe në fund *shoku/shoqja* me **19.2%**(Tabela VI. 7). Pra, ndikimi i faktorit familje edhe në këtë seksion është i dukshëm, gjë që tregon se *familja është nisja dhe zhvillimi i edukimit bazë dhe i përsosmërisë së edukatës, sjelljes dhe tolerancës shoqërore* dhe jo vetëm.

Tabela VI.7 Vlerësimi për faktorët e ndikimit tek toleranca dhe respekti

	<i>Familja</i>	<i>Shkolla/ mësuesit</i>	<i>Shoku/ shoqja</i>	<i>Total</i>
<i>Duhet të sillemi tolerantë ndaj kritikave.</i>	51.1	31.4	17.5	100.0
<i>Duhet të sillemi të kuptueshëm dhe tolerantë me njerëzit rreth nesh</i>	44.0	36.8	19.2	100.0
<i>Duhet ta vendosim veten në vendin e të tjerëve dhe të mundohemi t'i kuptojmë ata.</i>	36.5	26.7	36.8	100.0
<i>Duhet të respektojmë të drejtat e të tjerëve</i>	32.3	52.1	15.6	100.0
<i>Edhe pse mund të jetë e dëmshme për ne nuk duhet të gënjejmë.</i>	69.4	16.8	13.8	100.0

<i>Edhe pse mund të mos jemi dakort me mendimin e tjetrit duhet ta dëgjojmë atë.</i>	37.5	38.2	24.3	100.0
<i>Nuk duhet t'i shqetësojmë të tjerët për dëshirat dhe kënaqësitë tona</i>	56.3	21.5	22.2	100.0

Lidhur me vlerësimin për ndikimin që kanë faktorët si familja, shkolla dhe shoqëria, sa i takon edukatës shohim se edhe në këtë vlerësim roli dhe ndikimi i familjes janë të rëndësishme dhe më të vlerësuara se dy faktorët e tjerë. Kështu, alternative që ka marrë edhe vlerësimin më të lartë të ndikimit që ka faktori **familje**, është: *Nuk duhet të gënjejme kurrë* me **69.7%** të përgjigjeve, ndoshta edhe për faktin se vesi i të gënjerit mbart dhe shoqërohet edhe vese të tjera të dëmshme, jo vetëm për nxënësit (fëmijët) por edhe për vetë familjen e shoqërinë në tërësi. Alternativa: *Duhet të kujdesemi t'i çojmë në vend përgjegjësitë tona*, është vlerësuar me **64.2%** për faktorin familja, e ndjekur nga faktori shkolla/mësuesit me **26.1%**, e më pas renditet faktori shoku/shoqja me vetëm **9.7%**. Vlerësim dhe ndikim të lartë kanë marrë edhe alternativat: *Nuk duhet të përdorim rrugë jo të drejta për përfitimet tona* dhe *Nuk duhet të vjedhim diçka që i përket dikujt tjetër*, respektivisht me **53.2%** dhe **50.6%** të përgjigjeve. Alternativa: *Njerëzit duhet t'i duam dhe t'i vlerësojmë pa bërë dallim feje, gjuhe apo race*, nuk vlerëson si faktor primar familjen por shkollën/mësuesit me **39.9%**, ndikimi i familjes vjen në vend të dytë me **38.3%** dhe në fund renditet faktori shoku/shoqja me **21.8%**. Alternativat: *Nuk duhet t'i mashtrojmë të tjerët duke përdorur dobësitë e tyre dhe të reagojmë ndaj padrejtësive që kanë renditur si faktor kryesor ndikimin e familjes duke i vlerësuar secilën prej tyre me **41.5%** dhe së fundi alternativa: *Kur gjejme diçka që s'na përket ne, duhet të mundohemi të**

gjejmë të zotin e saj ka vlerësuar ndikimin e familjes me **45.7%**, ndikimin e shkollës me **34.7%** dhe ndikimin që ka shoku/shoqja me **19.6%** (Tabela VI. 8). Edhe për këtë grup pyetjesh ndikimi i familjes mbetet i rëndësishëm duke treguar njëherësh qëndrueshmëri dhe besim tek vlerat dhe mbështetja që jep familja në çdo kohë. Kjo gjë merr edhe më shumë kuptim kur vlerësohet më së shumti nga vetë fëmijët e sidomos moshë të cilën ne kemi anketuar.

Tabela VI.8 Vlerësimi për faktorët e ndikimit të edukata

	<i>Familja</i>	<i>Shkolla/ mësuesit</i>	<i>Shoku/ shoqja</i>	<i>Total</i>
<i>Nuk duhet t'i mashtrojmë të tjerët duke përdorur dobësitë e tyre.</i>	41.5	25.6	32.9	100.0
<i>Nuk duhet të përdorim rrugë jo të drejta për përfitimet tona.</i>	53.2	29.5	17.4	100.0
<i>Duhet të reagojmë ndaj padrejtësive</i>	41.5	43.3	15.1	100.0
<i>Njerëzit duhet t'i duam dhe t'i vlerësojmë pa bërë dallim feje, gjuhe apo race.</i>	38.3	39.9	21.8	100.0
<i>Nuk duhet të gënjejmë kurrë.</i>	69.7	18.1	12.1	100.0
<i>Nuk duhet të vjedhim diçka që i përket dikujt tjetër</i>	50.6	26.2	23.2	100.0
<i>Duhet të kujdesemi t'i çojmë në vend përgjegjësitë tona.</i>	64.2	26.1	9.7	100.0
<i>Kur gjejmë diçka që s'na përket ne, duhet të mundohemi të gjejmë të zotin e saj.</i>	45.7	34.7	19.6	100.0

Tabela 9 tregon rezultatet e vlerësimit që kanë bërë nxënësit lidhur me respektin që ata duhet të tregojnë për familjen dhe shoqërinë. Edhe në këtë vlerësim ndikimi i faktorit

familje është dukshëm më i madh krahasuar me dy faktorët e tjerë. Kështu, alternativat të cilat kanë edhe vlerat më të larta të këtij ndikimi janë: *Duhet të sillemi me respekt ndaj nënës dhe babait* dhe *Duhet të sillemi me respekt ndaj të mëdhenjve* respektivisht me **72.4%** dhe **70.7%** ashtu sikurse edhe pritej. Ndërsa alternativat që kanë patur faktorin familje në vlerat më të ulëta krahasur me të tjerat janë: *Nuk duhet t'u ngjisim nofka shokëve/shoqeve dhe të tallemi me ta/to* dhe *duhet t'u qëndrojmë pranë shokëve/shoqeve në kohë të mira dhe të këqija*, respektivisht me **29%** dhe **27.8%** duke vlerësuar më shumë në këtë rast faktorin shoku/shoqja me **54.3%**. Ndërsa faktori shkolla/mësuesit vlerësimin më të madh me **31.2%** e ka për alternativën - *Duhet të jemi punëtorë për familjen dhe veten tonë*. Alternativa - *Duhet t'i duam më të vegjëlit* - gjithashtu ka marrë një vlerësim të lartë për faktorin familje me **69.2%** ashtu sikurse edhe pritej edhe në këtë rast pasi edukimi me dashurinë për motrat/vëllezërit apo shokët/shoqet më të vegjël edukohet dhe mësohet më tepër në familje, aty ku lidhjet janë më të forta dhe më të qëndrueshme, krahasuar me ambientet e tjera.

Tabela VI.9 Vlerësimi për faktorët e ndikimit tek respekti për familjen dhe shoqërinë

	<i>Familja</i>	<i>Shkolla/ mësuesit</i>	<i>Shoku/ shoqja</i>	<i>Total</i>
<i>Kur japim fjalën duhet ta mbajmë.</i>	56.7	13.9	29.4	100.0
<i>Duhet t'u qëndrojmë pranë shokëve/shoqeve në kohë të mira dhe të këqija</i>	27.8	17.9	54.3	100.0
<i>Nuk duhet t'i përdorim pa leje gjërat e të tjerëve</i>	48.7	27.8	23.5	100.0
<i>Duhet të sillemi me respekt ndaj të mëdhenjve</i>	70.7	22.4	6.9	100.0

<i>Duhet të jemi punëtorë për familjen dhe veten tonë</i>	61.7	31.2	7.2	100.0
<i>Duhet të duam për tjetrin atë që duam për veten</i>	47.4	23.1	29.5	100.0
<i>Duhet të sillemi me respekt ndaj nënës dhe babait</i>	72.4	19.4	8.2	100.0
<i>Nuk duhet t'u ngjisim nofka shokëve/shoqeve dhe të tallemi me ta/to</i>	29.0	31.2	39.8	100.0
<i>Duhet t'i duam më të vegjlit.</i>	69.2	17.7	13.1	100.0

6.2. Analiza faktoriale

Pjesë e rëndësishme e analizës statistikore lidhur me informacionin e marrë nga nxënësit *është analiza faktoriale* për të analizuar më hollësisht faktorët kryesorë që ndikojnë në edukimin dhe moralin e tyre dhe veçanërisht familja duke vazhduar më tej me *ndërtimin e ekuacionit të regresionit të shumfishtë linear.*

Për këtë qëllimisht është e nevojshme që të analizojmë secilin prej dy grupeve të variableneve. Fillimisht, duke llogaritur *Koefiçentin e besueshmërisë Cronbach Alpha*, i cili për variablat e pavarur në total ka vlerën **0.839**>**0.7** (*kufiri i lejuar*) duke treguar se besueshmëria e të gjithë këtyre pyetjeve së bashku është e lartë. Ndërsa koefiçenti i besueshmërisë për variablet e varur ka vlerën **0.744** gjithashtu një koefiçent të lartë besueshmërie. Shohim *koefiçentin Cronbach Alpha* si dhe peshat faktoriale të secilit prej variablove të pavarur që kemi marrë në këtë studim. Theksojmë se vlera kufi e peshave faktoriale e cila lejon faktorët të vazhdojnë analizën e mëtejshme është **0.4**.

Variabli i parë i pavaur është *Sjellja ndaj të tjerëve* i cili matet me **6 pyetje**. Analiza e peshave faktoriale e tyre tregon se pyetja e parë dhe e fundit largohet nga analiza pasi

peshat faktoriale të tyre janë më të vogla se **0.4** (Tabela VI. 10). Për pyetjet e tjera të cilat vazhdojnë analizën e mëtejshme llogarisim sërish *koefiçentin Crombah Alpha*, vlera e të cilit është **0.722>0.7** duke e kaluar kështu sërish kufirin e përcaktuar.

Tabela VI.10 Peshat faktoriale të variablit të pavarur - Sjellja ndaj të tjerëve

	<i>Peshat faktoriale</i>
<i>Duhet të ndihojmë njerëzit në nevojë.</i>	.355
<i>Duhet të kemi dhembshuri për të dobët dhe të pafuqishmit.</i>	.999
<i>Duhet të ndajmë gjërat që i kemi ne dhe të tjerët s'i kanë</i>	.590
<i>Duhet t'i ndajmë sendet tona me të tjerët.</i>	.516
<i>Duhet të ruhem të mos i lëndojmë njerëzit.</i>	.999
<i>Duhet të kërkojmë falje, kur gabojmë.</i>	.184

Extraction Method: Principal Component Analysis

Analizojmë variablin tjetër të pavarur - *Toleranca dhe respekti* cili matet me **7** pyetje. Nga të dhënat e tabelës 11 vërehet se nga analiza largohen tre pyetje (P.1, P.4, dhe P.7) pasi vlerat e peshave faktoriale të tyre janë më të vogla se **0.4** ndërsa pyetjet e tjera vazhdojnë analizën e mëtejshme duke patur një *koefiçent Alpha 0.661*.

Tabela VI.11 Peshat faktoriale të variablit të pavarur - Toleranca dhe respekti

	<i>Peshat faktoriale</i>
<i>Duhet të sillemi tolerantë ndaj kritikave.</i>	.368

<i>Duhet të sillemi të kuptueshëm dhe tolerantë me njerëzit rreth nesh</i>	.401
<i>Duhet ta vendosim veten në vendin e të tjerëve dhe të mundohemi t'i kuptojmë ata.</i>	.485
<i>Duhet të respektojmë të drejtat e të tjerëve</i>	.331
<i>Edhe pse mund të jetë e dëmshme për ne nuk duhet të gënjejmë.</i>	.626
<i>Edhe pse mund të mos jemi dakort me mendimin e tjetrit duhet ta dëgjojmë atë.</i>	.465
<i>Nuk duhet t'i shqetësojmë të tjerët për dëshirat dhe kënaqësitë tona</i>	.337

Extraction Method: Principal Component Analysis

Analizojmë edhe peshat faktoriale për variablin e tretë të pavarur – *Edukata– cili matet me 8 pyetje*. Kështu sipas të dhënave të tabelës 12 të peshave faktoriale shohim se nga analiza e mëtejshme largohet pyetja e dytë dhe e tretë pasi peshat faktoriale të tyre janë më të vogla se **0.4** ndërsa pyetjet e tjera vazhdojnë analizën e mëtejshme duke patur një koeficient Alpha me vlerë **0.736**.

Tabela VI.12 Peshat faktoriale të variablit të pavarur- Edukata

	<i>Peshat faktoriale</i>
<i>Nuk duhet t'i mashtrojmë të tjerët duke përdorur dobësitë e tyre.</i>	.487
<i>Nuk duhet të përdorim rrugë jo të drejta për përfitimet tona.</i>	.349
<i>Duhet të reagojmë ndaj padrejtësive</i>	.313
<i>Njerëzit duhet t'i duam dhe t'i vlerësojmë pa bërë dallim feje, gjuhe apo race.</i>	.475
<i>Nuk duhet të gënjejmë kurrë.</i>	.613
<i>Nuk duhet të vjedhim diçka që i përket dikujt tjetër</i>	.490

<i>Duhet të kujdesemi t'i çojmë në vend përgjegjësitë tona.</i>	.574
<i>Kur gjejmë diçka që s'na përket ne, duhet të mundohemi të gjejmë të zotin e saj.</i>	.477

Extraction Method: Principal Component Analysis

Të njëjtën analizë përdorim për të parë peshat faktoriale të variablit të varur - *Respekti për familjen dhe shoqërinë* i cili matet me **9 pyetje**.

Kështu referuar të dhënave të tabelës së mëposhtme vihet re se katër pyetje nuk e vazhdojnë analizën e mëtejshme pasi peshat faktoriale të tyre nuk e kalojnë vlerën **0.4**. Për pyetjet e tjera *koefiçenti Alpha është 0.723*.

Tabela VI.13 Peshat faktoriale të variablit të varur - Respekti për familjen dhe shoqërinë

	<i>Peshat faktoriale</i>
<i>Kur japim fjalën, duhet ta mbajmë.</i>	.188
<i>Duhet t'u qëndrojmë pranë shokëve/shoqeve në kohë të mira dhe të këqija</i>	.562
<i>Nuk duhet t'i përdorim pa leje gjërat e të tjerëve</i>	.341
<i>Duhet të sillemi me respekt ndaj të mëdhenjve</i>	.440
<i>Duhet të jemi punëtorë për familjen dhe veten tonë</i>	.353
<i>Duhet të duam për tjetrin atë që duam për veten</i>	.419
<i>Duhet të sillemi me respekt ndaj nënës dhe babait</i>	.504
<i>Nuk duhet t'u ngjisim nofka shokëve/shoqeve dhe të tallemi me 'ta/'to</i>	.507
<i>Duhet t'i duam më të vegjlit.</i>	.307

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Hipoteza 1: Te gjithë faktoret e sjelljeve dhe vlerave morale si (edukata, toleranca dhe respekti dhe sjellja ndaj te tjeve) ndikojnë tek respekti per familjen dhe shoqerinë.

Për t'iu përgjigjur dhe analizuar vërtetësinë e hipotezave u përdor analiza e regresionit të shumëfishtë (Field 2005) i cili ka formën: $Y_i = b_0 + b_1X_1 + b_2X_2 + \dots + b_nX_n + \epsilon_i$.

Një problem që ndeshet gjatë analizës së regresionit është '*multikolineariteti*'. Si rezultat, para nisjes së analizës lindi nevoja për të vlerësuar multikolinearitetin ndërmjet variablave të pavarur. Multikolineariteti ndodh atëherë kur një variabël i pavarur ka korrelacion të lartë me një grup variablash të tjerë të pavarur (Gerais dhe Terziovski, 2003). Prania e tij mund të çojë në konkluzione jo të sakta në lidhje me faktin se cili nga variablat e pavarur është statistikisht domethënës (Lind dhe të tjerët, 2002). Për të vlerësuar multikolinearitetin u ndërtua tabela e korrelacionit për variablat e pavarur. Prania e vlerave të larta të korrelacionit është shenjë e parë për praninë e multikolinearitetit (Gerais dhe Terziovski, 2003). Sipas Lind dhe të tjerët (2002), si rregull i përgjithshëm vlera të korrelacionit ndërmjet - 0,7 dhe 0,7 nuk shkaktojnë vështirësi. (*pra nuk janë problematike*)

Të dhënat e **Tabelës 14** tregojnë se vlerat e përfutuara nuk janë shqetësuese prandaj vazhdojmë më tej analizën. Madje, vlerat përkatëse të **VIF** (*variance inflation factor*) marrin vlera nga **1.292** deri në **1.422**, kur dihet që kufiri është **VIF=5**, apo *vlerat e Tolerancës* janë të gjitha më të mëdha se **0.2** duke varjuar nga **0.703** deri në **0.774**.

Tabela VI.14 Korrelacioni midis variablave të pavarur

	<i>Sjellja ndaj të tjerëve</i>	<i>Toleranca dhe respekti</i>	<i>Edukata</i>
<i>Sjellja ndaj të tjerëve</i>	1		
<i>Toleranca dhe respekti</i>	.373**	1	
<i>Edukata</i>	.467**	.435**	1

Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Duke ju referuar ndërtimit të ekuacionit të shumfishtë linear si dhe vlerave të **Sig.** të cilat janë **0.000<0.05**, për të gjithë variablat e pavarur shohim se të gjithë variablat e pavarur ndikojnë tek variabli i varur që lidhet me respektin ndaj familjes dhe shoqërisë, duke shpjeguar edhe **27.5%** të ndryshimit të vlerave të variancës së tij. Kjo gjë konfirmohet, gjithashtu edhe nga fakti se për $\alpha=5\%$ dhe $F(3;2317)=294.041$ kemi që vlera e **Sig=0.000**, (Tabela VI. 15).

Të gjithë koeficientët β janë pozitivë, ç'ka tregon se rritja e vlerave për secilin nga variablat e pavarur shoqërohet me rritjen e vlerave të variablit të varur. Ndikimin më të madh e ka variabli i pavarur –**edukata**, pasi **koeficienti β_3** është më i madh se dy koeficientët e tjerë. Kështu referuar kësaj analize forma e përgjithëshme e ekuacionit tonë është:

$$(Respekti ndaj familjes dhe shoqërisë) = 0.801 + 0.096 (Sjellja ndaj të tjerëve) + 0.193 (Toleranca dhe respekti) + 0.230 (Edukata).$$

Tabela VI.15 Analiza e regresionit të shumfishtë midis variablave të pavarur dhe variablit të varur

<i>Modeli</i>	<i>R²</i>	<i>R² i rregulluar</i>	<i>t</i>	<i>Sig.</i>
Kostantja	.276	.275		.000
Sjellja ndaj të tjerëve			7.414	.000

Toleranca dhe respekti			11.818	.000
Edukata			12.943	.000

Këtu është vërtetuar hipoteza e hedhur.

Hipoteza 2: Gjinia nuk është faktor që ndikon në përvetësimin e sjelljeve dhe vlerave morale.

Për t'i dhënë përgjigje kësaj këtyre pyetjeve i referohemi testit të pavarësisë **Chi Square**. *Testi i pavarësisë Chi Square* përdoret për të testuar nëse dy variabla cilësorë janë të pavarur apo jo nga njëri-tjetri. Një vlerë e vogël e *Chi Square* tregon se **hipoteza zero** (*që variablat janë të pavarur*) nuk pranohet dhe se dy variablat janë të varur nga njëri-tjetri. Proçedura përfshin krahasimin e frekuencave të vrojtuar të qelizave me frekuencat e pritura. Frekuencat e vrojtuar të qelizave janë vlerat aktuale që i takojnë qelizave përkatëse dhe frekuencat e pritura janë vlerat që priteshin të ishin në këto qeliza nëse midis këtyre dy variablave cilësorë nuk do të kishte asnjë mardhënie (lidhje). Thelbi i këtij testi është diferenca midis frekuncave të vrojtuar dhe atyre të pritura në secilën prej qelizave të tabelës. Ndërkohë që vlerat e frekuancave të vrojtuar merren drejtpërdrejt nga të dhënat, frekuencat e pritura llogariten duke shumëzuar me totalin e rreshtit me totalin e kolonës dhe duke e pjesëtuar me totalin e përgjithshëm.

Testi i Pavarësisë Chi Square e cila përdoret kryesisht për të dhënat cilësore ashtu sikurse janë edhe variablat tanë. Testi *Chi Square* (χ^2) është një nga metodat më të përhapura për testimin e hipotezave për të dhënat cilësore. Ashtu siç edhe ne e dimë, të

dhënat cilësore që paraqiten në këto lloj të dhënash janë shumë të rëndësishme. Të vetmet statistika përmbledhëse për këtë lloj të dhënash janë *frekuenca* dhe *përqindja*. Tabelat e *testit Chi Square* janë pikërisht të përshatshme për këto lloj të dhënash. Koeficienti të cilit ne i referohemi është *Koeficienti Pearson Chi Square*. Supozimi ynë është të dy variablat janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe kjo hipotezë hidhet poshtë nëse vlera e *koeficientit Chi Square*, e cila shprehet nëpërmjet *Asymp.Sig.(2-sided)* është më e vogël se **p=0.05** (5%) duke ditur se kemi marrë një interval besueshmërie **95%**.

Duke iu referuar të dhënave për *testin e pavarësisë Chi square* (Tabela 4 në ANEKS) shohim se vlera e *Asymp. Sig. (2-sided)* = **0.281** > **0.05** gjë që tregon se ndikimi i vlerave morale nuk varet nga gjinia e fëmijëve. Kjo gjë konfirmohet, gjithashtu edhe nga analiza sipas *Testit* e cila tregoi se, pavarësisht se vlerat e mesatareve të këtij ndikimi janë pothuaj të barabarta si për vajzat dhe për djemtë ($M_{\text{vajza}}=1.75$ dhe $M_{\text{djem}}=1.72$), nuk ka kuptim të flitet për dallime midis tyre, pasi *vlera Sig.(2-tailed)* = **0.137** > **0.05** (Tabela 5 në ANEKS).

Këtu është vërtetuar hipoteza e hedhur.

Hipoteza 3: Me rritjen e nivelit social-ekonomik në familje ulet edhe ndikimi i familjes në përfitimin e sjelljeve dhe vlerave morale.

Për të marrë një përgjigje të saktë për këtë hipotezë i referohemi *analizës ANOVA* dhe *testit Post Hoc sipas Proçedurës Tukey*.

Së pari, i referohemi *analizës ANOVA*, ku për $F(6:2314)= 6.496$ vlera e *Sig.=0.000* < **0.005**, pra kjo gjë na tregon se ka kuptim të flitet për dallime midis ndikimit të

familjes në vlerat e moralit midis familjeve që kanë nivele të ndryshme të ardhurash (Tabela 6 në ANEKS). Prandaj vazhdojmë me analizën e mëtejshme për të parë ku vërehen më së shumti këto dallime (Tabela 7 në ANEKS) tregon pikërisht vlerat e *testit Post Hoc* nga i cili dallohet qartë se familjet me të ardhura mesatare mujore, të cilave janë më të ulëta se 30 000 lekë të reja dhe familjet me të ardhura mesatare mujore më të larta se 100 000 kanë dallime midis tyre, lidhur me vlerësimin e ndikimit të familjes në përfitimin e vlerave morale të fëmijëve të tyre, pasi vlera e **Sig = 0.014 < 0.05** duke treguar se familjet me të ardhura mesatare më të ulëta se 30 000 lekë të reja kanë një vlerësim mesatar më të lartë ($M=1.81$) se grupi tjetër i familjeve me të ardhura më të larta se 100 000 lekë të reja ($M=1.66$).

Dallime në këtë vlerësim vërehen gjithashtu edhe midis grupit me të ardhura mujore mesatare, [30 000- 40 000 lekë të reja] ku vlera e mesatares **M=1.83** dhe grupeve [60 000 – 100 000],[mbi 100 000] dhe [mbi 200 000] me vlera respektivisht **1.77, 1.66** dhe **1.68**, duke treguar se familjet me të ardhura mesatare më të ulëta e vlerësojnë më shumë rolin e familjes në edukimin, sjelljen dhe moralin e fëmijëve të tyre. Gjithashtu, edhe tek familjet me të ardhura mesatare [40 000-60 000] dhe grupit të familjeve me të ardhura më të larta se 100 000 vërehen dallime, pasi vlera e **Sig. = 0.022 < 0.05**. Kjo na çon në përfundimin se me rritjen e nivelit të të ardhurave në familje bie ndikimi dhe roli i familjes lidhur me sjelljen, edukimin dhe moralin e fëmijëve të tyre. Kjo gjë pasqyrohet edhe në faktin se grupi i familjeve me të ardhura të larta janë homogjene midis tyre, pra nuk kanë dallime lidhur me ndikimin e tyre tek morali dhe sjellja e fëmijëve, por dallimet qëndrojnë tek ky grup dhe familjet me të ardhura mesatare e të ulëta (Tabela 8 në ANEKS).

Këtu është vërtetuar hipoteza e hedhur.

Hipoteza 4: Në familjet me nivel të lartë edukimi, ndikimi i familjes në përfitimin e sjelljeve dhe vlerave morale është më i ulët krahasuar me familjet me nivel arsimor më të ulët.

I referohemi sërish analizës *ANOVA* e cila tregon se vlera e **Sig =0.483>0.05**, gjë që tregon se nuk ka kuptim të flitet për dallime statistike të rëndësishme midis vlerësimit të ndikimit të familjes për edukatën, sjelljen dhe moralin dhe nivelit arsimor të babait (*Tabela 9 në ANEKS*). Të njëjtën gjë analizojmë edhe për nivelin arsimor të nënës. *Tabela 10 në ANEKS* tregon se vlera e **Sig.=0.019<0.05** duke treguar se ekzistojnë dallime në vlerësimin e ndikimit të familjes në sjelljen dhe edukatën e fëmijës në ato familje ku nëna është më e arsimuar. Të shohim se ku janë dallimet më të mëdha: Nga testi *Post Hoc*, vërehet se dallimet qëndrojnë midis atyre familjeve ku nëna ka arsim të mesëm dhe familjeve ku nëna ka arsim master, pra me një edukim arsimor më të lartë, pasi vlera e **Sig.=0.042<0.05** (*Tabela 11 në ANEKS*). Po cili prej tyre ka vlerë më të lartë, vlerësimi tek roli dhe ndikimi i familjes, tek sjellja dhe edukata e fëmijëve? Përgjigjen e jep vlera e mesatares për secilin nga këto dy grupe ku $M_{\text{Arsim mesëm}}=1.76$ dhe $M_{\text{Master}}=1.62$, duke arritur në përfundimin se familjet ku nëna ka arsimin të mesëm kanë vlerësim dhe ndikim më të lartë, krahasuar me familjet ku nëna ka arsim më të lartë (*Arsim master*), ndoshta edhe për faktin se këto nëna janë më të përkushtuara pas punës, karrierës. Pasi rendin pas sigurimit të të ardhurave më të larta apo duke punuar me orare të gjata mënjanojnë sado pak e pa dashje mbështetjen e fëmijëve të tyre. Grupet e tjera janë homogjene midis tyre.

Këtu është vërtetuar hipoteza e hedhur.

Pyetja kërkimore 1: *A vërehen dallime midis nxënësve që banojnë në qytet dhe atyre që banojnë në fshat, lidhur me ndikimin e familjes në sjellje dhe vlera morale?*

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje përdorim **Testin t** për zgjedhjet e pavarura duke parë fillimisht *statistikat Levene* për homogjenitetin e tyre. Kështu *Tabela 12* në ANEKS tregon se **vlera e Sig. (2-tailed) =0.000<0.05**, gjë që tregon se grupet nuk kanë homogjenitet, prandaj i referohemi testit të krahasimit të mesatareve të tyre, nga ku për $\alpha=5\%$ dhe **t(2.588)** kemi që **vlera e Sig.=0.012<0.05**, gjë që tregon se ka kuptim të flitet për dallime midis familjeve që banojnë në qytet dhe atyre që banojnë në fshat, lidhur me vlerësimin e ndikimit të familjes tek morali dhe sjellja e fëmijëve të tyre. Madje, duke vazhduar më tej analizën shohim se vlera mesatare e këtij vlerësimi për familjet që jetojnë në qytet është: **$M_{\text{qytet}}=1.73$** , ndërsa për familjet që jetojnë në fshat e kemi: **$M_{\text{fshat}}=1.89$** , pra më e lartë çka tregon se këto familje ende e ruajnë ndikimin më të madh lidhur me rolin e tyre sa i takon sjelljes, edukatës dhe moralit që duhet të kenë fëmijët e tyre, pavarësisht se edhe situata sociale, ekonomike e kulturore e tyre ka ndryshuar. Ky ndikim, në këto familje mbetet ende më i lartë krahasuar me familjet e zonave urbane e sidomos atyre në kryeqytet a qytete të mëdha.

Pyetje kërkimore 2: *A ka kuptim të flitet për dallime të rëndësishme statistikore sa i takon respektit për familjen dhe shoqërinë tek nxënësit e shkollave të ndryshme? Në se po, ku vërehen më së shumti këto dallime?*

Për të analizuar këtë pyetje kërkimore i referohemi analizës ANOVA. Kështu Tabela 15 në ANEKS tregon se vlera e $\text{Sig.}=0.00<0.05$ tregon se ka kuptim të flitet për dallime të rëndësishme statistikore midis nxënësve të këtyre shkollave sa i takon vlerësimit që ata kanë për familjen dhe shoqërinë. Po ku vërehen këto dallime? Analiza e Testit Post Hoc tregon se dallimet më të mëdha janë vërejtur midis vlerësimit qëi kanë bërë nxënësit e shkollës “Skënder Çaçi” dhe nxënësve të shkollës “1 Maji”, “Gjon Buzuku”, “Lidhja e Prizrenit”, “4 Dëshmorët”, “Qemal Atatürk” dhe “Musine Kokalari” pasi vlerat e Sig për secilën prej krahasimeve janë respektivisht 0.013, 0.000, 0.036, 0.002, 0.003 dhe 0.010. Gjithashtu vlerësimi mesatar i shkollës “Skënder Çaçi” është 1.55 ndërsa për shkollat e tjera ky vlerësim mesatar është respektivisht 1.88, 1.94, 1.89, 1.97, 1.95 dhe 1.88. pra, kjo shkollë ka vlerësim më të ulët krahasuar me të tjerat. Gjithashtu, dallime vërehen edhe midis vlerësimit që kanë bërë nxënësit e “Shkollës së Kuqe” (mesatarja =1.47 me nxënësit e shkollës “Fan Noli” (mesatarja = 1.37) dhe midis shkollës “Gjon Buzuku” me shkollat “Qazim Turdiu” dhe “Fan Noli”. Vlerësimi mesatar për nxënësit e shkollës “Gjon Buzuku” është 1.94 ndërsa për shkollat e tjera ky vlerësim ka vlerat respective 1.68, 1.37. Pra, vlerësimi më i ulët vërehet vetëm tek shkolla “Fan Noli”. Pra, përfundimisht mund të themi se midis shkollave nxënësit reflektojnë vlerësim të ndryshëm, sa i takon respektit ndaj familjes dhe shoqërisë (*Tabela 15 dhe Tabela 15/1 në ANEKS*).

Pyetja kërkimore 3: *A mund të themi se ndikimi i familjesi sjelljes dhe vlerave morale është më i lartë tek familjet ku prindërit jetojnë bashkë?*

Sipas analizës ANOVA për $F(4:2316)=0.707$ kemi që **vlera e Sig.=0.587>0.05**, gjë që tregon se nuk ka kuptim të flitet për dallime të rëndësishme statistikore midis familjeve të

cilat jetojnë bashkë apo të ndara dhe vlerësimet për ndikimin e saj tek sjellja, edukata dhe morali i fëmijëve të tyre (*Tabela 16 në ANEKS*).

KAPITULLI VII : KONKLUZIONE

7.1. Konkluzione

Duke pasur parasysh faktin që zhvillimi moral përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit të personalitetit, ai zhvillon një koncept se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar gjatë procesit të socializimit të fëmijës. Bashkë me zhvillimin moral nga individi pritet të pasqyrojë e provojë veten në shoqërinë ku jeton përballë rregullave shoqërore.

Edukimi i individit në ditët e sotme menaxhohet nga ana e institucioneve arsimore. Megjithëse edukimi dhe arsimimi është i detyrueshëm duke filluar që nga mosha 6-7 vjeç nuk mund të thuhet se familja e ka lënë totalisht funksionin edukues të fëmijës. Fëmija mëson brenda familjes me anë të komunikimit dhe imitimit. Thënë ndryshe, shumë njohuri, aftësi, qëndrime të pamësuar në shkollë fëmija i fiton në mesin e familjes.

Çdo familje përpiqet t'i transmetojë fëmijës në mënyrë të vetëdijshme vlerat kombëtare, kulturën shoqërore dhe sjelljet pozitive të përvetësuar nga vetë ajo. Për këtë arsye familja zë një vend shumë të rëndësishëm në fitimin e vlerave morale nga ana e fëmijës. Sigurisht që rëndësia e të rriturve në zhvillimin e individit nuk ngelet e kufizuar vetëm me nënën e babanë. Veçanërisht, nëse merret parasysh zhvillimi individual, vihet re ndikimi i individëve të tjerë rreth tij. Rrethi më i ngushtë dhe më i afërt për fëmijën përbëhet nga njerëzit më të rëndësishëm për të si; nëna, babai, të afërmit, vëllezërit, motrat, bashkëmoshatarët dhe mësuesit.

Më poshtë do t'i hedhim një sy rezultateteve të përfutuara nga studimi i bërë me qëllim matjen e rëndësisë së familjes në fitimin e vlerave morale të nxënësve të arsimit fillor, pjesë e sistemit arsimor formal në Tiranë, Shqipëri. Në mesin e shkollave që morën pjesë në anketë me më shumë nxënës janë “Lasgush Poradeci”, “Jeronim De Rada”, “Fan Noli” dhe “Sabahudin Gabrani”. 0,8% e nxënësve pjesëmarrës në anketë ishin të moshës 12-13 vjeç, 18 % të moshës 14 vjeç, 5,4 % të moshës 16 vjeç dhe 74,8 % të moshës 15 vjeç. Pjesa më e madhe e nxënësve janë të moshës 15 vjeç (Tabela VI.1). Nxënësve u janë bërë pyetje për të kuptuar jetën e tyre sociale, gjendjen ekonomike dhe gjendjen e familjes. 92 % e familjeve përbëhej nga të dy prindërit që jetonin së bashku, 4,2 % jetonin me prindër të divorcuar. Vetëm 0,8 % prej nxënësve kishin humbur nënën, 2,1 % kishin humbur babanë dhe 0,9 % prej tyre kishin humbur të dy prindërit. Siç vihet re në shumicën e rasteve fëmijët jetojnë bashkë me të dy prindërit (Grafiku VI. 2).

97,4 % e prindërve që morën pjesë në anketë jetonin në qytet, 2,6 % në fshat. Ky studim është bërë në qendër të Tiranës dhe numri i fëmijëve të ardhur nga fshati është i pakët. Këta nxënës vijnë në Tiranë ose qëndrojnë tek të afërmit e tyre. Nga ana profesionale pjesa më e madhe e baballarëve është parë se janë biznesmenë 32,6 % ndërsa 29,4 % e nënave janë shtëpiake (Grafiku VI. 3). Nëse u hidhet një sy nivelit arsimor të prindërve vihet re se në shumicën e rasteve kanë arsim të mesëm; 46,1 % e baballarëve dhe 45,5 % e nënave kanë arsim të mesëm. Prindërit të cilët kanë arsimin fillor kanë bërë studime pasuniversitare apo doktorature janë me një përqindje të ulët (Grafiku 4). Nëse shohim gjendjen ekonomike të familjeve vihet se 22,7 % prej tyre kanë të ardhura mesatarisht 40.000-60.000 në muaj. 14,3 % e familjeve kanë të ardhura mujore mbi 200.000 (Tabela VI. 5).

Vihet re se të gjithë faktorët e sjelljes si arsimi, toleranca, dhe sjellja ndaj të tjerëve luajnë një rol ndikues në familje dhe shoqëri. Në përfundim të analizave të realizuara është parë se të gjithë këta faktorë ndikojnë direkt tek familja dhe shoqëria (Tabela VI. 15).

Është arritur në përfundimin se ndryshimi seksual nuk është një faktor aktiv dhe i rëndësishëm në fitimin direkt apo indirekt të vlerave morale. Në përfundim të analizave të bëra vihet re se gjinia nuk luan një rol efektiv në përfitimin e vlerave morale nga nxënësit e klasës së 9 (Tabela 4 në Aneks). Kjo gjë konfirmohet gjithashtu edhe nga analiza sipas Testit t e cila tregoi se pavarësisht se vlerat e mesatareve të këtij ndikimi janë pothuaj të barabarta si për vajzat dhe për djemtë ($M_{\text{vajza}}=1.75$ dhe $M_{\text{djem}}=1.72$) nuk ka kuptim të flitet për dallime midis tyre pasi vlera $\text{Sig.}(2\text{-tailed}) = 0.137 > 0.05$ (Tabela 5 në ANEKS).

Nëse i hedhim një sy historisë së shoqërisë vëmë re se gjendja socio-ekonomike zhvillohet bashkë me zhvillimet e bëra në arsim. Në shoqëritë kur zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë është i kufizuar edhe arsimi nuk zhvillohet por mund të themi se tek vlerat morale vihen re ndryshime. Niveli i lartë socio ekonomik i familjes tregon se familja luan një rol më të zbehtë në fitimin e vlerave morale. Sipas rezultateve të analizës së bërë vihet re se niveli ekonomik i familjeve ndikon në ndryshimin e vlerave morale. Këta ndryshime vihen re tek familjet me të ardhura mujore 30.000-100.000 lekë. Tek familjet me të ardhura nën 30.000 lekë këta ndryshime vihen re më shumë (Tabela 7 në ANEKS). Ndërkohë që mesatarja e ndryshimit tek familjet me të ardhura nën 30.000 lekë paraqitet 1,81 tek familjet me të ardhura mujore mbi 100.000 lekë kjo mesatare është 1,66. Në të njëjtën mënyrë edhe tek familjet me të ardhura 30.000-40.000 lekë vihen re ndryshime dhe ndikimi tek vlerat morale është mesatarisht 1,83. Tek familjet me të ardhura 60.000-100.000 lekë

mesatarja paraqitet 1,77. Mesatarja e ndikimit tek familjet me të ardhura mujore mbi 100.000 lekë është 1,66 dhe tek ato me të ardhura mbi 200.000 është 1,68 (Tabela 6 në ANEKS). Sipas rezultateve të Anovas ekziston një ndryshim në mes gjendjes ekonomike të familjeve dhe fitimit të vlerave morale (Tabela 6 në ANEKS). Me rritjen e nivelit ekonomik të familjeve bie dhe ndikimi i familjes në fitimin e vlerave morale. Familjet me të ardhura më të pakta janë më efektive në transmetimin e vlerave morale fëmijëve të tyre.

Nëse shohim nivelin arsimor të familjeve vihet re se fëmijët e familjeve me një nivel të lartë arsimor janë më pak të ndikuar nga vlerat morale se fëmijët e familjeve me një nivel të ulët arsimor. Në përfundim të analizës së bërë ku merret parasysh niveli arsimor i prindërve dhe profesionet e tyre vihet re se këta ndryshime ndodhin kur niveli arsimor i nënës është i lartë (Tabela 10 në ANEKS). Kur u hidhet një sy ndryshimeve vihet re se shumica prej tyre ndodhin tek nënat me arsim të mesëm ose ato që kanë përfunduar studime pasuniversitare. Ndikimi i nënës me arsim të mesëm është 1,76 nëndrsa ndikimi i nënës me studime pasuniversitare është 1,62 (Tabela 11 në ANEKS). Mendohet se ndikimi i nënave me master apo doktoraturë në fitimin e vlerave morale është më i ulët për arsye se nuk arrijnë të ndajnë kohë për fëmijët për shkak të ngarkesës profesionale apo dëshirës për të bërë karrierë. Në përfundim të këtyre analizave duket e pakuptimtë të diskutohet ndikimi i nivelit arsimor të babait në transmetimin e vlerave morale tek fëmija (Tabela 9 në ANEKS). Në përfundim të analizave të bëra ku merret për bazë niveli arsimor i prindërve dhe profesionet e tyre vihet re se familjet me një nivel më të ulët arsimor janë më efektive në transmetimin e vlerave morale tek fëmija.

Është kërkuar përgjigje për pyetjen se a ndikon jetesa në qytet apo fshat e prindërve në transmetimin e vlerave morale tek fëmija. Në të njëjtën kohë është kërkuar përgjigje për pyetjen se cili faktor familjar është më efektiv tek fëmijët që jetojnë në qytet e ato që jetojnë në qytet në përfitimin e vlerave morale. Në përfundim të analizave të bëra vihet re se fëmijët të cilët jetojnë në fshat përfitojnë më shumë vlera morale se fëmijët që jetojnë në fshat megjithëse ekzistojnë ndryshime në nivelet socio-ekonomike dhe kulturore. Ndikimi i familjes tek fëmijët që jetojnë në fshat është 1,89 ndërsa tek fëmijët që jetojnë në qytet është 1,73 (Tabela 12 në ANEKS).

Është kërkuar përgjigje për hipotezën nëse ndikon jetesa bashkë apo e ndarë e prindërve në fitimin e vlerave morale të fëmijës. Në përfundim të analizave të bëra është parë se jetesa e përbashkët apo e ndarë e prindërve nuk ndikon në fitimin e vlerave morale të fëmijës (Tabela 16 në ANEKS).

Është kërkuar përgjigje për ekzistencën e ndonjë ndryshimi mes shkollave në reflektimin e respektit ndaj familjes dhe shoqërisë, nëse ka atëherë në cilën shkollë është kur krahasohet shkolla “Skender Çaçi” me shkollat “1 Maj”, “Gjon Buzuku”, “Lidhja e Prizrenit”, “4 Dëshmorët”, “Qemal Atatürk”, “Musine Kokollari” mesatarja e kësaj shkolle është më e ulët në reflektimin e respektit ndaj familjes e shoqërisë. Mesatarja e shkollës “Skender Çaçi” është 1,55. Më pas vijjnë shkollat e tjera: “1Maj” 1.88, “Gjon Buzuku” 1.94, “Lidhja e Prizrenit” 1.89, “4 Dëshmoret” 1.97, “Qemal Atatürk” 1.95, “Musine Kokollari” 1.88. Edhe mesatarja e shkollës “Shkolla e Kuqe” është 1,47. Ndërsa mesatarja e shkollës “Fan Noli” është 1,37. Ekzistojnë ndryshime në mes shkollës “Fan Noli” dhe shkollave tjera si “Gjon Buzuku” e “Qazim Turdiu”. Vlera e “Gjon Buzikut” është 1,94

ndërsa e “Qazim Turdiut” është 1,68. Vlera e “Fan Nolit” është 1,37. Këta shkolla pasqyrojnë vlera më të larta se shkolla “Fan Noli” e cila zotëron indeksin më të ulët të vlerave (Tabela 15/1 në ANEKS).

Nëse vlerat morale i vlerësojmë sipas katër kategorive atëherë mund t’i rradhisim kështu: Edukim, tolerancë dhe respekt, sjelljet ndaj të tjerëve, respekt ndaj familjes e shoqërisë.

Në mes të këtyre vlerave tek grupi “sjellja ndaj të tjerëve” jemi përpjekur të gjejmë përgjigje ndaj pyetjes se ku i fitojnë vlerat nxënësit me anë të 6 pyetjeve ku përfshihen ndarja e sendeve me të tjerët, ndihmesa e personave në nevojë, të mos ofendosh njerëzit, të tregohesh i mëshirshëm ndaj të dobtëve, të kërkosh falje për veprimin e gabuar, diçka që kemi ne por nuk e kanë të tjerët. Në përfundim të analizës është parë se tek pyetja nëse kërkojnë falje për një veprim të gabuar familja luan faktorin më të rëndësishëm sepse 69,5% e nxënësve këtë sjellje e kishin fituar në familje ndërsa 18,5 % e tyre në shkollë. Në të njëjtën mënyrë është në rastin e ndihmesës ndaj personave në nevojë 50,4 % e nxënësve, tek vlera e shprehjes së dhembshurisë ndaj të dobtëve 49,5 %, tek mosofendimi i të tjerëve 49,5 % e nxënësve e kanë mësuar nga familja. Ndërsa tek pyetjet rreth ndarjes së gjërave me të tjerët apo çështjes së të pasurit të diçkaje që nuk e ka tjetri 39,9 % dhe 34,9 % e nxënësve pohojnë se e kanë mësuar nga familja. Ndërkohë që këta 6 pyetje e nxjerrin në plan të parë faktorin familje faktori i bashkëmoshatarëve renditet në vendin e dytë. Vlera si mosofendimi i njerëzve 32,5 % dhembshuri ndaj të dobtëve 32,5 % ndarja e gjërave me të tjerët 34,6 % e nxënësve i kanë mësuar nga bashkëmoshatarët. Ndërkohë që tek pyetja në kërkimin e ndjesës në rast të veprimeve të gabuara nxënësit kanë zgjedhur familjen si

faktorin e parë, faktori i dytë është zgjedhur shkolla. Mesatarja e mësimit të kësaj vlere nga shkolla është 18,5 % (Tabela VI. 6).

Kategoria e dytë e vlerave morale është toleranca dhe respekti . Sjelljet në këtë kategori janë: të respektosh kritikën, të respektosh njerëzit përreth, të respektosh të drejtat e të tjerëve, të mos thuash gënjeshtër, të dëgjosh mendimin e tjetrit edhe në rast se nuk je dakord me të etj. Në këtë kategori gjenden 7 pyetje. Nxënësit u janë përgjigjur pyetjeve si në grupin e parë, në katër pyetje nxënësit janë shprehur se këta vlera i kanë mësuar nga familja. Tek përgjigjet e këtyre 4 pyetjeve familja rradhitet si faktori i parë. Tek toleranca ndaj kritikave 51,1 %, respekt e tolerance ndaj njerëzve përreth 44,0%, të mos thuash asnjëherë gënjeshtër 69,4% dhe të dëgjosh tjetrin edhe nëse nuk të pëlqen mendimi i tij 56,3 %. Pyetjes se duhet të vendosim veten në vendin e tjetrit për ta kuptuar nxënësit janë përgjigjur se nuk e kanë mësuar nga familja përkundrazi këtë vlerë e kanë mësuar nga shokët. Përqindja e kësaj vlere është 36,8%. Faktori familje zë vendin e dytë në këtë pyetje me 36,5 %. Në të njëjtën mënyrë edhe dëgjimi i tjetrit me 38,2 %, respektimi i të drejtave të të tjerëve me 52,1% vihet re se janë mësuar nga shkolla, pra nga mësuesit. Tek të dy pyetjet faktori shkollë rradhitet i pari. Në përfundim të analizave të bëra vihet re se nxënësit kanë zgjedhur familjen në 4 pyetje, shkollën në 2 pyetje dhe bashkëmoshatarët në 1 pyetje. Megjithëse për ne është e dëmshme pyetja në lidhje me mosthënien e gënjeshtërve është pyetja me vlerat më të larta(Tabela VI. 7). Tek respektimi i të drejtave të të tjerëve faktori familje është më i ulëti me 32,3 %. Në mesin e këtyre vlerave nxënësit janë shprehur se sjellje si toleranca ndaj kritikave, mirëkuptimi ndaj njerëzve përreth, mosthënia e gënjeshtërve, mosshqetësimi i të tjerëve për dëshirat tona i kanë fituar nga familja. Ndërsa

respektimi i të drejtave të të tjerëve, dëgjimi i mendimit të tjetrit edhe nëse nuk je dakord i kanë mësuar nga bashkëmoshatarët.

Kategoria e tretë e vlerave morale është edukata. Vlerat e kësaj kategorie janë: të mos bëjmë hile, të mos provojmë rrugë të padrejta për interesat tona, të reagojmë ndaj padrejtësive, të vlerësosh njerëzit pa bërë dallime fetare apo racore, të mos gënjes, të mos vjedhësh, të plotësosh përgjegjësitë, të kërkosh të zotin e sendit që ke gjetur në këtë grup gjenden 8 pyetje. Në mesin e pyetjeve 6 pyetjeve nxënësit u kanë dhënë përgjigje se i kanë mësuar nga familjet dhe tek dy pyetje janë shprehur se i kanë mësuar nga shkolla. Tek 4 pyetje faktori shkollë është zgjedhur si faktori i dytë pas familjes. Në këtë grup vetëm vlera nuk duhet të mashtrojmë të tjerët duke përdorur dobësitë e tyre është mësuar nga shokët menjëherë pas familjes me 32,9 %. Tek vlera duhet të gjejmë zotëruesin e sendit të gjetur 45,7%, duhet të tregohemi të kujdesshëm në plotësimin e përgjegjësive me 64,2 %, nuk duhet të vjedhim gjërat që u përkasin të tjerëve 50,6 %, nuk duhet të gënjejmë kurrë 69,7%, nuk duhet të përdorim rrugë të padrejta për interesat tona 53,2 %, nuk duhet të mashtrojmë duke përdorur dobësitë e të tjerëve 41,5 % është përzgjedhur faktori familje në vend të pare (Tabela VI. 8).

Tek vlerat reagimi ndaj padrejtësive me 43 ,4 % dhe vlerësimi i të tjerëve pa bërë dallime fetare e racore me 39,9 % është përzgjedhur faktori shkollë. Tek këta dy pyetje faktori familje ka zënë vendin e dytë. Përqindjet e familjes janë 41,5% dhe 38,3%. Në përfundim të analizave vihet re se familja është përzgjedhur si faktori më efektiv tek 6 pyetje. Vetëm tek reagimi ndaj padrejtësive dhe vlerësimi i të tjerëve pa bërë dallime racore e fetare nuk është përzgjedhur familja por është parë se këta janë sjellje të fituara në shkollë

nga mësuesit. Sjelljet e mësuara në familje janë: të mos mashtrosh, të mos përdorësh rrugë të padrejta për interesat tuaja, të mos gënjesh, të mos vjedhësh, të plotësosh përgjegjësitë dhe të kërkosh zotëruesin e një objekti të gjetur. Tek ky grup tek mosthënia e gënjeshtrove faktori familje është përzgjedhur me vlerën më të lartë me 69,7 % (Tabela VI. 8).

Kategoria e katërt e vlerave morale është respekti ndaj familjes e shoqërisë. Në këtë kategori gjenden 9 pyetje rreth familjes e shoqërisë, shokëve, sjelljeve që kanë lidhje me respektin. Nëse na duhet të klasifikojmë sjelljet në këtë grup: të mbash fjalën e dhënë , të përkrahësh shokët në kohë të mira dhe të këqija, të mos përdorësh gjërat e të tjerëve pa leje, të respektosh nënën dhe babanë, të duash më të vegjlit, të punosh për të mirën e familjes dhe vendit tonë, të dëshirosh për të tjerët atë që dëshiron për veten, të mos u ngjisësh nofka shokëve.

Në anketën e bërë nxënësve kur janë pyetur se ku i kanë mësuar këta sjellje në 7 pyetje kanë dhënë përgjigje se i kanë mësuar nga familja, në 2 pyetje janë përgjigjur se i kanë mësuar nga shokët. Tek mbajtja e fjalës së dhënë 56,7 %, mospërdorimi i gjërave të të tjerëve pa leje 48,7 %, respektimi i më të mëdhenjve 70,7 %, të punosh për të mirën tënde dhe të vendit 61,7%, të dëshirosh për të tjerët atë që dëshiron për veten 47,4 %, të respektosh prindërit 72,4 % dhe të duash më të vegjlit 69,2%. Tek këta sjellje familja është përzgjedhur si faktori i parë. Tek sjelljet si qëndrimi pranë shokëve në kohë të mira dhe të vështira me 54,3 % dhe mos vendosje të nofkave me 39,8 % faktori shokët është përzgjedhur si faktori i parë. Në këtë grup respekti ndaj nënës dhe babait ka marrë më shumë përqindje me 72,4 %. Në përfundim të analizave të bëra vihet re se edhe këtu shumica e sjelljeve janë mësuar nga familja (Tabela VI. 9).

7.2. Rekomandime

Në kuadrin e rezultateve dhe gjetjeve të arritura në studim mund të bëjmë këta sugjerime:

- Duhet të tregohet edhe më shumë kujdes dhe vëmendje lidhur me edukimin e fëmijëve me normat më të mira të qytetarisë dhe moralit shoqëror jo vetëm nga institucionet arsimore por edhe nga familja gjithashtu;
- Roli i familjes për një edukim dhe sjellje qytetare e reflektuar kjo edhe tek sjellja dhe edukata e fëmijëve të tyre në shkollë e kudo, duhet të jetë në qendër të formimit të personalitetit të çdo fëmije;
- Nevojitet më shumë bashkëpunim midis familjes dhe institucioneve arsimore, jo vetëm në drejtim të procesit mësimor, por edhe të edukimit dhe sjelljes së fëmijëve, si një element nga i cila fillon dhe zhvillohet nxënësi por edhe shoqëria në tërësi.
- Për të arritur nivelin e dëshiruar të edukimit moral në familje mund të organizohen aktivitete të ndryshme edukuese si seminare, konferenca, ditë të familjes për të rritur nivelin arsimor dhe informativ të prindërve. Në këtë mënyrë edukimi moral i dhënë në familje do të mbështesë qëllimin e edukimit të njeriut të mirë, shembull për shoqërinë.
- Të rinjtë e marrin edukimin moral në familje, me anë të rrugës së aktiviteteve edukuese dhe nga institucionet arsimore. Tek degët në universitet si sociologji, psikologji, edukim dhe degët e lidhura ngushtë me individin dhe marrëdhënien e tij

me shoqërinë mund të vendosen lëndë si ‘edukimi në familje’, ‘edukimi i vlerave dhe familja’ të cilat pasqyrojnë një realitet social duke informuar kështu të rinjtë rreth kësaj teme.

- Mund të mendohet përgatitja e librave të shkollës nga specialistë të psikologjisë, edukimit dhe konsulencës , shfrytëzimi i njohurive të specialistëve në mënyrë që të dalin në plan të parë principet morale.
- Të rinjtë të cilët kërkojnë një model për veten deri në një moshë të caktuar kanë nevojë për modele, që do t’i ndihmojnë në zhvillimin e vlerave morale të dëshiruara. Në të njëjtën kohë qëllimi i edukimit të një qytetari model dhe një njeriu të mirë gjendet brenda qëllimeve kryesore të Ministrisë së Arsimit. Mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e këtij qëllimi. Mësuesit me performancë të lartë, me aftësi të larta komunikuese dhe të cilët janë modele pozitive për fëmijët duhet ti kushtojnë rëndësi dhe praktikës së mësimit bashkë me teorinë në mënyrë që të jenë sa më të dobishëm për brezat e rinj.
- Në qytetet e mëdha dhe kryesore të vendit mund të hapen qendra shoqërore të familjes ku të punësohen specialistë të zhvillimit moral të cilët do të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që mund të hasin familjet e të rinjtë. Këta institucione mund të ndikojnë pozitivisht në rifreksimin e njohurive të familjeve në këtë çështje dhe të mbajnë gjallë lidhjen me fëmijët.

7.2.1. Rekomandime për studimet e mëpasme

- Një studim i ngjashëm me studimin e realizuar mund të bëhet edhe në shkollat e fshatit në periferi të Tiranës apo në qytete të tjera duke u fokusuar mbi faktorët efektive në fitimin e vlerave morale.
- Një studim i ngjashëm mund t'u bëhet prindërve dhe mësuesve bazuar në anketë për të mësuar mendimin e sugjerimet e tyre.

BIBLIOGRAFIA

- Acuner, H. Y. (2004). 14 -16 Yaş Arası Gençlerde Ahlaki Yargı Gelişimi ve Ahlak Eğitimi. (Tezë Doktrature e Pabotuar), 19 Mayıs Üniv. Sosyal Bilimler Enst. Felsefe ve Din Bilimleri Ana Bilim Dalı.
- Addad, M., Leslau, A. (1990). Immoral Judgement, Extraversion, Neuraticism, and Criminal Behavior. *International Journal of Offender Therapy and Comparative Criminology*, V. 31/1.
- Adler, A. (1996). Sorunlu Okul Çocuđu. (Përkth. K. Şipal), Cem Yay., İstanbul.
- Anderson, Gordon, L. (1984). *Indemnity for World Peace. Restoring The Kingdom*, Ed: Deane William Ferm, Paragon House, New York.
- Akarsu, B. (1993). Ahlak Öğretileri. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Akbaba, S. (2011). Farklı Öğretim Kademelerinde Okutulan Masalların Kohlberg'in Moral Gelişim Evreleri Açısından İncelenmesi. *Eğitim ve Bilim*, C: 26, Sayı: 121.
- Akbaş, O. (2004). Türk Milli Eğitim Sisteminin Duyuşsal Amaçlarının İlköğretim 8.Sınıf Öğrencilerinde Gerçekleşme Derecesinin Deđerlendirilmesi. Gazi Üniversitesi Eğitim Bilimleri Enstitüsü (Tezë Doktrature e Pabotuar), Ankara.
- Akbaş, O. (2005). Deđer Öğretiminde Yeni Yaklaşımlar. İlköğretim Sosyal *Bilgiler Dersi* (4-5. Sınıflar) Öğretim Programı, M.E.B. Ankara.
- Aksoy, Ö. A. (1998). Atasözleri ve Deyimler Sözlüğü. C.1, I-II, İnkılap Yay., İstanbul.
- Allport, G. W., Vernon, P. E., and Lindzey, G. (1960). *A Study of Values*. (3 ed.) Boston, Houghton Mifflin.
- Althof, W., Graz, D. (2004). Lawrence Kohlberg: Deutsches Institut für Internationale Pädagogische Forschung German Institute for International Educational Research Mitglied der Leibniz-Gemeinschaft Frankfurt.
- Arslan, A. (2001). Felsefeye giriş. İstanbul, Vadi Yayınları.
- Aslanargun, E. (2007). Okul Aile İşbirliği ve Öğrenci Başarısı Üzerine Tarama Çalışma. Manas Üniversitesi, Sosyal Bilimler Dergisi; 18. pp: 119-135.

- Ashford, N. (2009). Özgür Toplumun İlkeleri. (Përkth.: Can Madenci), Brommatryck and Brolins, Ankara.
- Atkinson, L. R. (1995). Psikolojiye Giriş. (Përkth. Kemal Atakay), Sosyal Yay., İstanbul.
- Atkinson, R. L., Richard C. Atkinson, Ernest, R. H. (1995). Psikolojiye Giriş. (Përkth. K. Atakay), Sosyal Yay., İstanbul.
- Atlı, G. (2002). Aile ve Çocuk Eğitimi Üzerine Sohbetler. Etüt Yayınevi, İstanbul.
- Audi, R. (1979). The Cambridge Dictionary of Philosophy. Cambridge University Press, New York.
- Avcı, H. (2000). Çocuk Eğitimi mi Anne Baba Eğitimi mi ? Sızıntı Dergisi, sayı: 256. Marrë nga: <http://www.sizinti.com.tr/konular/ayrinti/cocuk-egitimi-mi-anne-baba-egitimi-mi.html> (Parë më 10 korrik 2015).
- Aydın, M. S. (1991). Tanrı-Ahlak İlişkisi. T.D.V. Yay., Ankara.
- Aydın, M. Z. (2003). Ahlak Öğretiminde Örnek Olay İncelemesi. Nobel Yayınları, Ankara.
- Aydın, M. Z. (2000). Kurumlar Sosyolojisi. Vadi Yay., Ankara.
- Aydın, M. Z. (2012). Ailede Ahlak Eğitimi. Timaş, İstanbul.
- Bacanlı, H. (2003). Gelişim ve Öğrenme. Nobel Yay., Ankara.
- Bacanlı, H. (2006). Duyuşsal Davranış Eğitimi. Nobel Yay., Ankara.
- Bandura, A. (2000). Self-Efficacy: The Exercise of Control. W.H. Freeman and Company, New York.
- Başaran, İ. E. (1990). Eğitim Psikolojisi. Gül Yay., Ankara.
- Başaran, İ. E. (2005). Eğitim Psikolojisi, Gelişim, Öğrenme ve Ortam. Nobel Yayınları. Ankara.
- Baymur, F. (1994). Genel Psikoloji. İnkılap Kitabevi, İstanbul.
- Berger, E. H. (1991). Parent Involvement: Yesterday and Today. The Elementary School Journal, Vol.91, No.3, pp. 209-219.

- Beşođul, İ. (1993). Çocuk Bakımı ve Terbiyesi. Tuđra Yayınları, İstanbul.
- Bey, M. S. (2002). Eğitim ve Toplumsal Sorunlar Üzerine Konferanslar. Ed: Osman Kafadar dhe Faruk Öztürk, Kültür Bakanlığı Yay., Ankara.
- Bilgin, B. (1998). Eğitim Bilimi ve Din Eğitimi. Gün Yayıncılık, Ankara.
- Bilgin, B. Selçuk, M. (1997). Din Öğretimi Özel Öğretim Yöntemleri. Gün Yayıncılık, Ankara.
- Bilgin, B. (1991). İslam ve Çocuk. D.İ.B Yay., Ankara.
- Bilgiseven, A. K. (1989). İslamiyetin Önerdiği Ferdiyetçi Aile Yapısında Kadın Hakları ve Ülkemizdeki Durum. 1. Aile Şurası Bildirileri, Ankara: Başbakanlık Aile Araştırma Kurumu.
- Bilkan, A. F. (2001). Masal Estetiđi. Timaş Yayınları, İstanbul.
- Bilsky, W., Koch, M. (2000). On the content and structure of values: Universals or methodological artefacts? J. Blasius, J. Hox, E. de Leeuw and P. Schmidt (Eds.), Social Science Methodology in the New Millennium Proceedings of the Fifth International Conference on Logic and Methodology, Cologne
- Binbaşıođlu, C. (1978). Gelişim Psikolojisi. Yay Yayınevi, Ankara.
- Binbaşıođlu, C. (1998). Geleneksel Kültüre Göre Türkiye'de Çocuk Eğitimi Üzerinde Bir Araştırma. K. B. Y., Ankara.
- Bradshaw, Y., Healey, J. F. and Smith, R. (2001). Sociology for a New Century. Pine Forge Press.
- Broom, L. and Selznick, P. (1956). Sociology. Published by Row, Peterson and Company, New York.
- Burns, C. P., Roe, B. D. and Ross, E. P. (1992). Teaching Reading in Today's Elementary Schools. Boston Houghton Mifflin Company.
- Can, G. (2004). Kişilik Gelişimi. Gelişim ve Öğrenme Psikolojisi. Ed: B. Yeşilyaprak, Pegem A Yay., Ankara.
- Cebeci, S. (1996). Din Eğitimi ve Türkiyede Din Eğitimi. Akçağ Yay., Ankara.

- Cevizci, A. (1999). Felsefe Sözlüğü. Paradigma Yay., İstanbul.
- Cole, L., Morgan, J. J. B. (1985). Çocukluk ve Gençlik Psikolojisi. (Përkth. Belkıs Halim Vassaf), M.E.B Yay., İstanbul.
- Coleman, J. C. and Hendry, L. (1980). The Nature of Adoloscence. London, Methuen Press.
- Cox, V. and Wolley, J. D. (2007). Development of Beliefs About Storybook Reality. Development Science, 10(5), 681-693.
- Crain, W. (2005). Theories of Development: Concepts and Applications. Prentice-Hall, Upper Saddle River, New Jersey.
- Creswell, J. W. (1994). Research Design: Qualitative and Quantitative Approaches. Sage Publications, London.
- Cücelođlu, D. (2002). İçimizdeki Çocuk. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Cücelođlu, D. (1994). İnsan ve Davranışı. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Cloud, H. and Townsend, J. (2002). Anne Faktörü. (Përkth. Emel Aksay), Sistem Yayıncılık, İstanbul.
- Çađdaş, A., Seçer, Z. (2002). Çocuk ve Ergende Sosyal ve Ahlak Gelişimi. Edt: Ramazan Arı, Nobel Yayıncılık, Ankara.
- Çakmak, F. (2012). Din Eğitimiinde Program Geliştirme ve Aile Faktörü. İğdır İlahiyat Fakültesi Dergisi, Vol: I. pp: 86-87.
- Çamdibi, H. M. (1983). Şahsiyet Terbiyesi ve Gazâli. Han Neşriyat, İstanbul.
- Çavdar, T. (1983). İşsizliđin Sosyal Etkileri. Cumhuriyet Dönemi Türkiye Ansiklopedisi, Cilt:5. pp.1170–1177. İletişim Yay., İstanbul.
- Çiftçi, N. (2003). Kohlberg'in Bilişsel Ahlak gelişimi Teorisi: Ahlak ve Demokrasi Eğitimi. Deđerler Eğitimi Dergisi, Cilt/Vol.1, Sayı:1, İstanbul: Eğitim Danışmanlıđı ve Araştırmaları Merkezi.
- Çileli, M. (1981). 14-18 Yaşları Arasındaki Öğrencilerde Ahlaki Yargının Zihinsel

- Gelişim Psikolojisi Yaklaşımı İle Değerlendirilmesi. A.Ü.E.F., (Tezë Doktrature e Pabotuar) Ankara.
- Çubukçu, İ. A. (1978). İslam'da Terbiyenin Önemi. Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, Vol.12, No.22. 152-156.
- Dagget, W. R. (2003). Addressing The Issue of Character International Center for Leadership in Education. Inc. In New York.
- Demir, Ö. (2003). İktisat ve Ahlak. Liberte Yay., Ankara.
- Demir, Ö. dhe Acar, M. (1997). Sosyal Bilimler Sözlüğü. Vadi Yay., Ankara.
- Dërvodeli, J. (2011). Dallimet në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe paskohe. Prishtinë
- Deva-Zuna, A. (2003). Edukimi i parashkollorit në familje. Prishtinë.
- Dewey, J. (1976). Okulda Ahlak Eğitimi. (Përkth. A. Ferhan Oğuzkan), Ankara Üniversitesi Eğitim Bilimleri Fakültesi Dergisi, Marrë nga: <http://www.dergiler.ankara.edu.tr/dergiler/40/496/5860.pdf> (Parë më 02 qershor 2015)
- Diaz, S. L. (1989). The Home Environment and Puerto Rican Children's Achievement: A Researcher's Diary. The National Association for Education Conference, Hulston.
- Dodurgalı, A. (1995). İbn Sina Felsefesinde Eğitim. Marmara Üniversitesi, İlâhiyat Fakültesi Vakfı. İstanbul.
- Dodurgalı, A. (2012). Ailede Din Eğitimi. Vol. 3. İstanbul. Timaş Yayınları,
- Doğan, İ. (2008). Sosyoloji. Pegem Yayınları, Ankara.
- Doğan, M. (1991). Türkiye'de Aileye ve Aile Fertlerine Tesirleri Açısından Kitle Yayın Araçları. Türk Aile Ansiklopedisi, AAK Yay., Ankara, C:2
- Doğan, R., Tosun, C. (2003). DKAB Öğretimi 6-8. Pegem Yayınları, Ankara.
- Doğanay, A. (2006). Değerler Eğitimi. Hayat Bilgisi ve Sosyal Bilgiler Öğretimi. (Ed. Cemil Öztürk) Pegem A Yayıncılık, Ankara.
- Dökmen, Ü. (2002). Varolmak, Gelişmek, Uzlaşmak. Sistem Yay., Ankara.

- Draz, M. A. (1993). Kur'ân Ahlakı. (Përkth. Emrullah Yüksel-Ünver Günay), İz Yay., İstanbul.
- Durkheim, E. (1986). Meslek Ahlakı. (Përkth. Mehmet Karasan), M.E.B Yayınları, İstanbul.
- Durkheim, E. (2004). Ahlak Eğitimi. Dokuz Eylül Yay., İzmir.
- Durkheim, E. (2004). Ahlak Eğitimi. (Përkth. Oğuz Adanır), Dokuz Eylül Yayınları, İzmir.
- Duruhan, H., İlhan, B. (2004). Eğitim-Öğretimle İlgili Bazı Atasözü ve Deyimlerimizin Öğrenme-Öğretme Süreci Bakımından İrdelenmesi. Milli Eğitim Üç Aylık Eğitim ve Sosyal Bilimler Dergisi, 164.
- Ekşi, H. (2006). Din Eğitimi, Gençlik ve Kişilik, Gençlik, Din ve Değerler Psikolojisi. Ed: Hayati Hökeleli, DEM Yayınları, İstanbul.
- Elkin, F. (1995). Çocuk ve Toplum, Çocuğun Toplumsallaşması. (Përkth. Nazife Güngör), Gündoğan Yay., Ankara.
- Ercan, F. (1998). Eğitim ve Kapitalizm: Neoliberal Eğitim Ekonomisinin Eleştirisi. ÖES ve Bilim Yay., İstanbul.
- Erdem, H. (2006). Ahlak Felsefesi. Hü-Er Yay., Konya.
- Erden, M., Akman, Y. (2005). Gelişim ve Öğrenme. Arkadaş Yayınları, Ankara.
- Ergil, D. (1994). İnsan ve Toplum. Turhan Kitabevi, Ankara.
- Ersanlı, K. (1996). Benliğin Gelişimi ve Görevleri. Eser offset, Samsun.
- Ertürk, S. (1982). Eğitimde Program Geliştirme. Yelkentepe Yay., Ankara.
- Ewen, R. B. (1998). An Introduction to Theories of Personality. Lawrence Erlbaum Associates Publishers, New Jersey.
- Feather, N. T. (1988). Moral Judgement and Human Values. British Journal of Social Psychology, 27(3), pp. 239-246
- Fichter, J. (1990). Sosyoloji Nedir? (Përkth. N. Çelebi), Anı Yay., İstanbul.
- Field, A. P. (2005). Discovering statistics using SPS, Sage Publication. London.

- Fidan, N. dhe Erden, M. (1991). Eđitime Giriř. Feryal Matbaacılık Yay., Ankara.
- Freud, S. (1994). Psikanalize Yeni Giriř Dersleri. (Pėrkth. S.Budak), ˆteki Yay., Ankara.
- Freud, S. (1996). Totem ve Tabu. (Pėrkth. K. Sahir Sel), Sosyal Yay., İstanbul.
- Fukuyama, F. (1998). Gven, Sosyal Erdemler ve Refahın Yaratılması. (Pėrkth. A. Buđdaycı), TİB Yay., Ankara.
- Ganzevoort, R. (1998). Proposal for a Narrative Analytical Technique in Empirical Theology. Journal of Empirical Theology 11(2). pp. 23-40.
- Geralis, M., Terziovski, M. (2003). A quantitative analysis of the relationship between empowerment practices and service quality outcomes. Total Quality Management and Business Excellence 14 (1): 45-62.
- Gibbs, L. J. and Earley, E. J. (1994). Using Children's Literature to Develop Core Values. Bloomington, 362: pp. 7-40. Phi Delta Kappa.
- Ginsburg, H. P. and Opper, S. (1988). Piaget's Theory of Intellectual Development. (3rd Ed.). Englewood Cliffs, Prentice-Hall, New Jersey.
- Gordon, T. (1993). Etkili ˆğretmenlik Eđitimi. (Pėrkth. Emel Aksay dhe Birsen ˆzkan), Ya-Pa Yayınları, İstanbul.
- Gorman, M., Duffy, J. and Heferman, M. (1999). Service Experience and the Moral Development of College Students. Religious Education, 89(3), pp. 422-431.
- Gˆknar, ˆ. (2004). Bilinçli ˆocuk Yetiřtirme. Arkadař Yayınları, Ankara.
- Guillaume, P. (1970). Psikoloji. (Pėrkth. Refia řemin), İEF Yay., İstanbul.
- Gndz, T. (2003). İřlam, Gençlik ve Din Eđitimi. Dřnce Yayınları, İstanbul.
- Gndzalp, S. (2007). Deyimler ve ˆykleri. İstanbul: Zafer Yayınları.
- Gngr, A. (2002). Geliřim ve ˆğrenme. Toplumsal ve Duygusal Geliřim. Anı Yayıncılık, Ankara.
- Gngr, E. (1993). Deđerler Psikolojisi zerinde Arařtırmalar. Amsterdam, Trk Akademisyenler Birliđi Vakfı Yayınları, Hollanda.
- Gngr, E. (1998). Ahlak Psikolojisi ve Sosyal Ahlak. ˆtken Neřriyat, İstanbul.

- Güngör, E. (2003). Sosyal Meseleler ve Aydınlar. Ötüken Neş., İstanbul.
- Gürün, O. A. (1991). Psikoloji Sözlüğü. İnkılap Kitabevi, İstanbul.
- Gravetter, F. & Forzano, L. A. (2015). Research methods for the behavioral sciences. Cengage Learning.
- Halstead, J. M. and Taylor, M. J. (2000). Learning and teaching about values: a review of recent research. Journal of Education, 30. 2, 169 – 202. Cambridge.
- Hançerlioğlu, O. (1982). Felsefe Sözlüğü. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Haner, R., Çayıroğlu, Y. dhe Avcı, A. (2014). Kadın ve Aile İlmihali. Işık Yayıncılık Ticaret, İstanbul.
- Hart, D., Atkins, R. and Ford, D. (1999). Family Influence on the Formation of Moral Identity in Adolescence: longitudinal analyses. Journal of Moral Education, V. 28, N. 3, pp. 375-386.
- Hauser, M. and Others. (2007). A Dissociation Between Moral Judgments and Justifications. Mind & Language, Vol: 22. No: 1, Blackwell Publishing. pp. 1-21. San Francisco.
- Hetherington, A. K. and Gelman, S. A. (1995). Child Psychology: A Contemporary Viewpoint. Mc Graw Hill, New York.
- Hetherington, E. M. and Parke, R. D. (1993). Child Psychology: A Contemporary Viewpoint. Mc Graw Hill, New York.
- Hinde, R. A. (2002). Why Good is Good; The Source Of Morality. Routledge USA.
- Hinkin T. R. (1995). A review of scale development practices in the study of Organizations. Journal of Management, Vol. 21, No. 5, pp. 967-988.
- Hitlin, S. and Pliavin, J. A. (2004). Values: Reviewing a Dormant Concept, Annual Review Sociology. 30, 95-80
- Hoffman, M. L. (1970). Moral development. Carmichael's manual of child psychology. John Wiley, New York.
- Hökelekli, H. (1993). Din Psikolojisi. T.D.V. Yay., Ankara.

- Humphreys, T. (2002). Çocuk Eğitiminin Anahtarı: Özgüven. (Përkth. T. Anapa) Epsilon Yayınevi, İstanbul.
- İnanç, B. Y. (2005). Gelişim Psikolojisi. Nobel Yay., Ankara.
- İnceoğlu, M. (2000). Tutum-Algı-İletişim. İmaj Yay., Ankara.
- Kağıtçıbaşı, Ç. (1988). İnsan ve İnsanlar. Evrim Yay., İstanbul.
- Kanad, H. F. (1948). Pedagoji Tarihi. 4. Basım, Milli Eğitim Basımevi, Ankara.
- Kant, I. (1964). Critique of Judgement. (Trans. James Creed Meredith), Clarendon Press, Oxford.
- Kant, I. (1999). Pratik Aklın Eleştirisi. (Përkth. İ. Kuçuradi, Ü. Gökberk dhe F. Akatlı). T.F.K. Yayınları, Ankara.
- Karaj, Dh. (2005). Psikologjia e Zhvillimit të Fëmijës. Progress, Tiranë.
- Kaya, M. (1993). Bazı Kişisel Değişkenlere Göre Üniversite Öğrencilerinin Ahlaki Yargıları. Ondokuz Mayıs Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, (Tezë Doktrature e Pabotuar), Samsun.
- Kaya, M., Aydın, C. (2011). Üniveriste Öğrencilerinin Dini İnanç ile Ahlaki Olgunluk Düzeyleri Arasındaki İlişkinin İncelenmesi. 19 Mayıs Üniv. İlahiyat Fak. V. 30 (4)
- Kerr, S. T. (1996). Toward a Sociology of Educational Technology. In D. Jonassen (Ed.). Handbook of Research on Educational Technology, Simon & Schuster/Macmillan, New York. pp.143-169.
- Kerschenstainer, G. (1977). Karakter Kavramı ve Terbiyesi. (Përkth. H. Fikret Kanad), Milli Eğitim Basımevi, Ankara.
- Kıncal, Y. R. (2011). Eğitim Bilimine Giriş. Remzi Kitabevi, Ankara.
- Kim, Y. (2000). Philosophy and the Prospects for a Universal Ethics. In God and Globalization, Volume 1, Religion and the Powers of the Common Life, Ed. by Max L. Stackhouse and Peter J. Paris, Harrisburg, Pennsylvania, Trinity Press, pp. 69-104.
- Kiraz, C. (2005). Kur'an'da Ahlak İlkeleri- Tevrat, Zebur ve İncil'le Mukayeseli Bir Çalışma. (Tezë Doktrature e Pabotuar), Uludağ Üniversitesi SBE.

- Koçer, H. A. (1980). Eğitim Tarihi. AÜEF Yay., Ankara.
- Kohlberg, L. (1969). Stage and Sequence: The Cognitive Developmental Approach to Socialization. Ed. by D. A. Goslin. Handbook of Socialization Theory and Research. Rand McNally, Chicago. pp.347-480.
- Konfüçyüs. (1998). Büyük Bilgi. Müzik Hakkında Notlar. (Përkth. Muhaddere N. Özerdim), M.E.B Basımevi, İstanbul.
- Köse, A. (1997). Neden İslam'ı Seçiyorlar. İ.S.A.M Yay., İstanbul.
- Köylü, M. (2000). Yetişkin Din Eğitiminin Teorik Temelleri. Etüt Yay., Samsun.
- Köylü, M. (2003). Çocukluk Dönemi Ahlak Gelişimi. Din Eğitimi Araştırmaları Dergisi, Sayı: 12, İstanbul.
- Kulaksızoğlu, A. (1998). Ergenlik Psikolojisi. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Küng, H. dhe Kuschel, K. J. (1995). Evrensel Bir Ahlaka Doğru. (Përkth. N. Aşikoğlu), Gün Yay., Ankara.
- Küng, H. (1998). A Global Ethic for Global Politics and Economics. Oxford University Press, New York.
- Khandwalla, P. (1976). The Design of Organizations. Harcourt Brace Jovanovich, New York.
- Kraja, M. (2013). Pedagogjia Shkollat Shqipe me Program Plotueses. Shtepia botuese "Extra-R", Tirane.
- Krebs, D. L., Denton, K. (1997). The Forms and Functions of Real- Life Moral Decision-Making Journal of Moral Education, Vol. 26(2). 128-131.
- Larry, P. N. (2001). Education in The Moral Domain. Cambridge University Press, New York.
- Leenders, I.; Daniel, B. (2005). Moral/non-moral Domain Shift in Young Adolescence in Relation to Delinquent Behavior. British Journal of Developmental Psychology, Vol. 13(1), London, pp. 65-79.
- Lickona, T. (1991). Educating for Character. Bantam books, New York.

- Lickona, T. (1993). *The Return of Character Education*. Bantam books, New York.
- Lickona, T. (1998). *Character Education: Seven Crucial Issues, Action in Teacher Education*, (4) 20.
- Lickona, T. (1992). *Education for character, How Our Schools can Teach Respect and Responsibility*. Bantam books, New York
- Lind, D. A., Marchal, W. G., Mason, R. D. (2002). *Statistical Techniques in Business & Economics*, McGraw-Hill Irwin, 11th Edition.
- Longman. (2005). *Dictionary of Contemporary English*, (4.'th), M.A. Houghton Mifflin, Boston.
- Lull, J. (2000). *Populer Müzik ve İletişim*. (Përkth. Tuba İblağ), Çivi Yazıları, Ankara.
- Ma, H. K. (1989). *Moral Orientation and Moral Judgement in Adolescents in Hon Kong, Mainland and England*. *Jounal of Cross-Cultural Psychology*, Vol.20/2, pp.152-177
- Menderes, F. (2005). *Bilgili, Çocuğun Eğitimi ve Karşılaşılan Güçlükler*. Beyan Yayınları, İstanbul.
- Meydan, H. (2012). *İlköğretim Okullarında Değerler ve Karakter Eğitimi*. (Tezë Doktrature e Pabotuar), Sakarya Üniv., S.B.E.
- Morton, M. (1972). *The Arts and The Soviet Child*. Riverside, New Jersej.
- Navaro, L. (1987). *Çağdaş Anne/Baba Eğitimi Neleri Kapsayabilir? Ya-Pa 5. Okul Öncesi Eğitimi ve Yaygınlaştırılması Semineri*, Antalya.
- Nucci, L. P. (2001). *Education in the moral domain*. Cambridge University Press, Cambridge.
- Oğuzkan, Ş., Oral, G. (1997). *Okul Öncesi Eğitimi*. M.E.B.Yayınları, İstanbul.
- Onur, B. (1991). *Gelişim Psikolojisi. Yetişkinlik, Yaşlılık, Ölüm*. İmge Kitapevi, Ankara.
- Osmani, Sh. (1983). *Fjalor i Pedagogjisë*. Botimet enciklopedike, Shtypshkronja e Re, Tiranë.
- O'Sullivan, S. (2004). *Books to live by: Using Children's Literature for Character*

- Education, *The Reading Teacher*. (57), 7, pp.640-645.
- Öcal, M. (1991). *Din Eğitimi ve Öğretiminde Metodlar: (Temel Eğitim ve Orta Öğretimde). Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, İstanbul.*
- Öğretir, A. D. (1999). *Alt ve Üst Sosyo-Ekonomik Düzeyde Altı Yaş Çocuklarının Sosyal Oyun Davranışlarıyla Ana-Baba Tutumları Arasındaki İlişkinin İncelenmesi. (Tezë Master e Pabotuar), G.Ü.S.B.E. Çocuk Gelişimi ve Ev Ekonomisi Eğitimi Anabilim Dalı, Ankara.*
- Önder, A. (2007). *Ailede İletişim: Konuşarak ve Dinleyerek Anlaşalım. Morpa Kültür Yayınları, İstanbul.*
- Özgüven, İ. E. (2001). *Ailede İletişim ve Yaşam. Pdrem Yayınları, Ankara.*
- Özgüven, İ. E. (2003). *Psikolojik Testler. Pdrem Yayınları, Ankara.*
- Özlem, D. (2002). *Değerler Sorununda Nesnelcilik. Bilgi ve Değer Sempozyum Bildirileri (Ed.S. Yalçın), Vadi Yay., Ankara.*
- Pala, İ. (2002). *Atasözleri Sözlüğü. LM Yayınları, İstanbul.*
- Peker, H. (1994). *Çocuk ve Suç. Çocuk Vakfı Yay., İstanbul.*
- Piaget, J. (2005). *Çocuğun Gözüyle Dünya. (Përkh. İ. Yerguz), Dost Kitabevi, Ankara.*
- Poyraz, H. (2007). *Değerlerin Kuruluşu ve Yapısı. R. Kaymakcan, S. Kenan, H. Hökelekli, Ş. Aslan, Değerler Eğitimi Uluslararası Sempozyumu, Dem Yay., İstanbul.*
- Razon, N. (1981). *Tembel Çocuk. Eğitim ve Bilim (Temmuz), Cilt: 6, Sayı: 32. Ankara.*
- Rest, J. R. (1983). *Morality. In: J. H. Flavell & E. M. Markman (Eds). Handbook of Child Psychology. Vol. 3 Cognitive Development, New York.*
- Rice, F. P. (1997). *Child and Adolescent Development, Prentice-Hall Inc, New Jersey.*
- Richards, D. (1986). *Produktive and Effective Schools. Illinois: The Annual Conference of The American Finance Association, Chicago.*
- Rodney, R. (1987). *The role of planning in cognitive development. Cambridge University Press, Cambridge.*
- Rokeach, M. (1973). *The Nature of Human Values. The Free Press, New York.*

- Ross, W. D. (1993). Aristoteles. (P rkth. Ahmet Arslan), Ege  niversitesi Yay.,  zmir.
- Roof, W. C. (1993). Religion and Narrative. Riview of Religious Research 34 (4).
- Rosenblatt, Z. and Peled, D. (2002). School ethical climate and parental involvement. Journal of Educational Administration, 40(4), 349-367.
- Russell, B. (1999). Eđitim  zerine. (P rkth. N. Bezel), Say Yayınları,  stanbul.
- Russell, B. (1991). Batı Felsefe Tarihi. (P rkth. H.Vehbi Eralp), Sosyal Yay.,  stanbul.
- Ryan, K. and Bohlin, K. E. (1999). Building Character in Schools: Practical Ways to Bring Moral Instruction to Life, Jossey-Bass, San Francisco.
- Ryan, K. (2002). Moral Education, Encyclopedia of Education. Edit: James W. Guthrie, Second Edition, Vol: 5, Macmillan Press, New York.
- Sander, R. H. (1997). Experimenting With Class-Based Affirmative Action. Journal of Legal Education, 47(4), 472-503.
- Sandin, R. T. (1992). The Rehabilitation of Virtue-Fundations of Moral Education. Prager Publishers, New York.
- Santrock, W. J. (1999). Psychology and the Notes: ‘A Visual Companion’ McGraw-Hill Higher Education, New York.
- Sartre, J. P. (1996). Varoluşculuk. (P rkth. Asım Bezirci), Say Yay.,  stanbul.
- Saunders, M., Lewis, P., Thornhill, A. (2009). Research Methods for Business Students, FT-Prentice Hall, 5th Edition.
- Savater, F. (2001). Ođluma Ahlak  st ne Ođ tler. (P rkth. Őadan Karadeniz), İletiřim Yayınları,  stanbul.
- Seifert, K. L. and Hoffnung, R. J. (1991). Child and Adolescent Development. Boston, USA.
- Sel uk, Z. (2005). Geliřim ve Ođrenme. Nobel Yay., Ankara.
- Senemoglu, N. (2001). Geliřim, Ođrenme ve Ođretim Kuramdan Uygulamaya. Gazi Kitabevi, Ankara.

- Schaps, E., Schaeffer, E., McDonnell, S. (2001). What's Right And Wrong in Character Education Today. Education Week, 9.
- Schwartz, S. H., Bilsky, W. (1987). Toward a Psychological Structure of Human Values. Journal of Personality and Social Psychology, Vol.53.
- Schwartz, S. H. (1992). Universals in the content and structure of values: Theoretical advances and empirical tests in 20 countries. In Z. Zanna (Ed.). Advances in experimental social psychology (Vol. 25, pp. 1-65), Academic Press, New York.
- Skinner, B. F. (1976). A Case History in Scientific Method. Psychological Research: The Inside Story. Ed: Michael H. Siegel, New York.
- Skinner, B. F. (2001). The Design of Cultures. Behavior and Social Issues, Vol: 11, No:1, pp. 4-13.
- Spohn, W. (2000). Conscience and Moral Development. Theological Studies, Vol.61(1).
- Stark, R. (1987). Sociology. Wadsworth Publishing Company, California, USA.
- Suparka, D. P. and Johnson, P. L. (1975). Values education: The Earth Charter. www.earthcharter.org (Parë më 17 mars 2015).
- Şahin, H. (2002). Türkiye Ekonomisi. Ezgi Kitabevi, Bursa.
- Şengün, M. (2003). Ahlak, Ahlaki Gelişim, Ahlak Eğitimi, Psiko-sosyal Dinamikleri. Feryal Matbaası, Ankara.
- Tarhan, N. (2002). "Psikolojik Savaş Gri Propaganda". Timaş Yay., İstanbul.
- Tarhan, N. (2006). Ahlak. Köprü Dergisi, 2. Vol., Ahlak Sayısı.
- Temel, Z. F. (1991). Yetiştirme Yurdunda ve Ailesi Yanında Kalan 14-18 Yaş Grubundaki Gençlerin Cinsiyet Rolü Kimlikleri ile Moral Gelişimlerinin Bazı Değişkenlere Göre İncelenmesi". (Tezë Doktrature e Pabotuar), HÜSBE, Ankara.
- Tezcan, M. (1996). Eğitim Sosyolojisi. Feryal Matbaası, Ankara.
- Topçu, N. (2005). Ahlak. Dergah Yay., İstanbul.
- Topçu, S. (1991). Gençlik Çağı ve Problemleri. Türk Yurdu, Cilt 1. Temmuz, Ankara.
- Topçuoğlu, F. (1999). Diksiyon ve Konuşma Eğitimi. Pegem Yayınları, Ankara.

- Trautner, H. M. (1991). Lehrbuch der Entwicklungspsychologie (Bd. 2: Theorien und Befunde). Göttingen: Hogrefe. Verwendet: pp.16–23.
- Turiel, E., Edward, C., Kohlberg, L. (1978). Moral Development in Turkish Children, Adolescent, and Young Adults. *Journal of Cross-Cultural Psychology*, Vol. 9, No.1, pp.75-86.
- Tural, N. K. (2002). Öğrenci Başarısında Etkili Okul Değişkenler. *Ankara Üniversitesi Eğitim Bilimleri Fakültesi Dergisi*, Cilt: 35, Sayı: 1-2.
- Tutkun, Ö., Köksal, A. (2000). Okul Aile İşbirliğinde Yeni Yaklaşımlar. *Eğitim Araştırmaları Dergisi*.
- Tuzgöl, M. (1998). Ana-Baba Tutumları Farklı Lise Öğrencilerinin Saldırganlık Düzeylerinin Çeşitli Değişkenler Açısından İncelenmesi. (Tezë Master Pabotuar), Hacettepe Üniversitesi, Ankara.
- Ülgener, S. F. (1983). Zihniyet Aydınlar ve İzm'ler. Mayaş Yay., Ankara.
- UNESCO. (2010). Living Values Education Overview. Marrë nga: <http://www.livingvalues.net> (Parë më 17 skurt 2015).
- Valentine, T. S. (1996). Moral Education and Inspiration Through Theatre. *Philosophy of Education Yearbook*.
- Variş, F. (1988). Eğitim Bilimine Giriş. AÜEF Yay., Ankara.
- Vergote, A. (1981). Ergenlikte Din. (Përkth. E. Fırat) *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 24.
- Veugelaers, W. and Vedder, P. (2003). Values in Teaching. *Teachers and Teaching: theory and practice*, 9.(4), 377-389.
- Vural, B. (2005). Öğrencinin Başarısı için Aile-Okul Birlikteliği. Hayat Yay., İstanbul.
- Williams, R. M. (1979). Change and stability in values and value systems: A sociological perspective. M. Rokeach (Eds.), *Understanding Human Values* (pp.15-46). Free Press, New York.
- Vitz, P. C. (1990). *Psychology as Religion: The Cult of Self-Worship*. 2nd ed. Grand Rapids, Michigan.

- Yalçın, N. (2011). Türkiye’de Çocuk İstismarı ve Çözüm Önerileri. (Tez e Master e Pabotuar), Beykent Üniversitesi Sosyal Bilimler Ensitüsü, İstanbul.
- Yavuz, K. (1998). Günümüzde Din Eğitimi. Çukurova Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Yayınları, Adana.
- Yavuzer, H. (1992). Çocuk Psikolojisi. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Yavuzer, H. (1995). Yaygın Anne-Baba Tutumları, Ana-Baba Okulu. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Yavuzer, H. (2003). Çocuęu Tanımak ve Anlamak. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Yavuzer, H. (2007). Ana Baba ve Çocuk. Remzi Kitabevi, İstanbul.
- Yavuzer, H. (2000). Eğitim ve Gelişim Özellikleri ile Okul Çaęı Çocuęu. Remzi Kitabevi, İstanbul (botimi i pestë).
- Yılmaz, H. (2002). Sevgili Anne ve Babacıęım Lütfen Bu Kitabı Okur musunuz? Çizgi Kitabevi, Konya.
- Yılmaz, Y. (2001). Kültürel Etkileşim ve Toplumsal Deęişimde Televizyonun Etkileri. İletişim Fakültesi Dergisi, M.Ü.D. Yay., İstanbul.
- Yörükoęlu, A. (1986). Gençlik Çaęı. T.İ.B. Yay., Ankara.
- Yörükoęlu, A. (2012). Çocuk Ruh Saęlığı. Özgür Yayınları, Ankara.

ANEKS

Tabela 1: Lidhja midis profesionit të babait dhe nivelit mesatar të të ardhurave familjare :

<i>Profes. i babait</i>	<i>Të ardhurat mujore mesatare në familjen tuaj</i>							
	Më pak se 30,000 lekë	30,000 - 40,000 lekë	40,000- 60,000 lekë	60,000- 100,000 lekë	Mbi 100, 000 lekë	Mbi 200, 000 lekë	Pa përgjigje	Total
Bujk	10	23	24	20	19	12	3	111
%	5.9%	5.9%	4.5%	4.8%	5.5%	3.6%	2.2%	4.8%
Nëpunës	26	51	145	115	105	75	24	541
%	15.4%	13.0%	27.5%	27.4%	30.6%	22.7%	17.3%	23.3%
Emigrant	9	24	25	14	10	20	4	106
%	5.3%	6.1%	4.7%	3.3%	2.9%	6.0%	2.9%	4.6%
Mësues	10	35	39	26	20	26	14	170
%	5.9%	9.0%	7.4%	6.2%	5.8%	7.9%	10.1%	7.3%
Punëtor	41	125	120	89	44	33	25	477
%	24.3%	32.0%	22.7%	21.2%	12.8%	10.0%	18.0%	20.6%
Biznes privat	21	93	147	143	139	155	59	757
%	12.4%	23.8%	27.8%	34.0%	40.5%	46.8%	42.4%	32.6%
I papunë	52	40	28	13	6	10	10	159
%	30.8%	10.2%	5.3%	3.1%	1.7%	3.0%	7.2%	6.9%
Total	169	391	528	420	343	331	139	2321
%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 2: Edukimi arsimor i babait dhe lidhja me fenë

Edukimi arsimor i babait tuaj:	Sa të lidhur janë prindërit tuaj me fenë?				Total
	Shumë	Konsiderueshëm	Pak	Aspak	
Arsim 8 vjeçar	47	61	47	18	173
%	9.4%	7.5%	6.7%	5.9%	7.5%
Arsim i mesëm	232	371	314	154	1071
%	46.4%	45.7%	44.7%	50.2%	46.1%
Arsim i lartë	187	329	286	120	922
%	37.4%	40.5%	40.7%	39.1%	39.7%
Master	24	34	44	13	115
%	4.8%	4.2%	6.3%	4.2%	5.0%
Doktoraturë	10	17	11	2	40
%	2.0%	2.1%	1.6%	.7%	1.7%
Total	500	812	702	307	2321
%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 3: Edukimi arsimor i nënës dhe lidhja me fenë

Edukimi arsimor i nënës tuaj:	Sa të lidhur janë prindërit tuaj me fenë?				
	Shumë	Konsiderueshëm	Pak	Aspak	Total
Arsim 8 vjeçar	36	33	24	13	106
%	7.2%	4.1%	3.4%	4.2%	4.6%
Arsim i mesëm	224	387	305	140	1056
%	44.8%	47.7%	43.4%	45.6%	45.5%
Arsim i lartë	200	345	321	137	1003
%	40.0%	42.5%	45.7%	44.6%	43.2%
Master	24	33	42	10	109
%	4.8%	4.1%	6.0%	3.3%	4.7%
Doktoraturë	16	14	10	7	47
%	3.2%	1.7%	1.4%	2.3%	2.0%
Total	500	812	702	307	2321
%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 4: Testi i pavarësisë midis variablit- përvetësimi i vlerave morale dhe gjinisë:

Gjinia	Ndikimi i vlerave morale			Total
	Familja	Shkolla/mësuesit	Shoku/shoqja	

Femër	342.1	869.8	19.1	1231.0
Mashkull	302.9	770.2	16.9	1090.0
Total	645.0	1640.0	36.0	2321.0
Chi-Square Tests				
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	
Pearson Chi-Square	2.542 ^a	2	.281	
Likelihood Ratio	2.540	2	.281	
Linear-by-Linear Association	2.225	1	.136	
N of Valid Cases	2321			

a.0 cells (.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 16.91.

Tabela 5: Për lidhur me variablin – përvetësimi i vlerave morale dhe gjinisë

	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
								95% Confidence Interval of the Difference	
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	Lower	Upper
Equal variances assumed	7.552	.006	1.492	2319	.136	.029	.020	-.009	.068
Equal variances not assumed			1.489	2265.6	.137	.029	.020	-.009	.068

Tabela 6: ANOVA për ndikim e familjes tek përvetësimi i vlerave morale dhe gjendjes ekonomike të tyre

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	8.634	6	1.439	6.496	.000
Within Groups	512.573	2314	.222		
Total	521.206	2320			

Tabela 7: Testi Post Hoc.

(I) Të ardhurat mujore mesatare në familjen tuaj	(J) Të ardhurat mujore mesatare në familjen tuaj	Mean Difference (I-J)	Std. Error	Sig.	95% Confidence Interval	
					Lower Bound	Upper Bound
Më pak se 30,000 lekë	30,000 -40,000 lekë	-.021	.043	.999	-.15	.11
	40,000-60,000 lekë	.044	.042	.943	-.08	.17
	60,000-100,000 lekë	.115	.043	.101	-.01	.24
	Mbi 100, 000 lekë	.149*	.044	.014	.02	.28
	Mbi 200, 000 lekë	.131	.044	.051	.00	.26
30,000 - 40,000 lekë	Më pak se 30,000 lekë	.021	.043	.999	-.11	.15
	40,000-60,000 lekë	.064	.031	.388	-.03	.16
	60,000-100,000 lekë	.136*	.033	.001	.04	.23
	Mbi 100, 000 lekë	.169*	.035	.000	.07	.27
	Mbi 200, 000 lekë	.151*	.035	.000	.05	.26
40,000-60,000 lekë	Më pak se 30,000 lekë	-.044	.042	.943	-.17	.08
	30,000 -40,000 lekë	-.064	.031	.388	-.16	.03
	60,000-100,000 lekë	.072	.031	.228	-.02	.16
	Mbi 100, 000 lekë	.105*	.033	.022	.01	.20
	Mbi 200, 000 lekë	.087	.033	.113	-.01	.18
60,000-100,000 lekë	Më pak se 30,000 lekë	-.115	.043	.101	-.24	.01
	30,000 -40,000 lekë	-.136*	.033	.001	-.23	-.04
	40,000-60,000 lekë	-.072	.031	.228	-.16	.02
	Mbi 100, 000 lekë	.033	.034	.959	-.07	.13

	Mbi 200, 000 lekë	.015	.035	.999	-.09	.12
Mbi 100, 000 lekë	Më pak se 30,000 lekë	-.149*	.044	.014	-.28	-.02
	30,000 -40,000 lekë	-.169*	.035	.000	-.27	-.07
	40,000-60,000 lekë	-.105*	.033	.022	-.20	-.01
	60,000-100,000 lekë	-.033	.034	.959	-.13	.07
	Mbi 200, 000 lekë	-.018	.036	.999	-.12	.09
Mbi 200, 000 lekë	Më pak se 30,000 lekë	-.131	.044	.051	-.26	.00
	30,000 -40,000 lekë	-.151*	.035	.000	-.26	-.05
	40,000-60,000 lekë	-.087	.033	.113	-.18	.01
	60,000-100,000 lekë	-.015	.035	.999	-.12	.09
	Mbi 100, 000 lekë	.018	.036	.999	-.09	.12

The mean difference is significant at the 0.05 level.

Tabela 8: Tukey

<i>Të ardhurat mujore mesatare në familjen tuaj</i>	<i>N</i>	<i>Subset for alpha = 0.05</i>		
		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
Mbi 100, 000 lekë	343	1.66		
Mbi 200, 000 lekë	331	1.68		
60,000-100,000 lekë	420	1.70	1.70	
40,000-60,000 lekë	528	1.77	1.77	1.77
Më pak se 30,000 lekë	169		1.81	1.81
30,000 -40,000 lekë	391			1.83
Sig.		.126	.066	.131

Tabela 9: Vlerësimi i ndikimit të familjes tek morali dhe niveli arsimor i babait.

	<i>Sum Squares of</i>	<i>df</i>	<i>Mean Square</i>	<i>F</i>	<i>Sig.</i>
Between Groups	.779	4	.195	.866	.483
Within Groups	520.428	2316	.225		
Total	521.206	2320			

Tabela 10: ANOVA – vlerësimi i ndikimit të familjes tek morali dhe niveli arsimor i nënës.

	<i>Sum of Squares</i>	<i>df</i>	<i>Mean Square</i>	<i>F</i>	<i>Sig.</i>
Between Groups	2.647	4	.662	2.955	.019
Within Groups	518.559	2316	.224		
Total	521.206	2320			

Tabela 11: Testi Post Hoc

<i>(I) Edukimi arsimor i nënës tuaj:</i>	<i>(J) Edukimi arsimor i nënës tuaj:</i>	<i>Mean Difference (I-J)</i>	<i>Std. Error</i>	<i>Sig.</i>	<i>95% Confidence Interval</i>	
					<i>Lower Bound</i>	<i>Upper Bound</i>
Arsim vjeçar	Arsim i mesëm	.017	.048	.997	-.11	.15
	Arsim i lartë	.042	.048	.910	-.09	.17
	Master	.150	.065	.139	-.03	.33
	Doktoraturë	.157	.083	.324	-.07	.38
Arsim mesëm	Arsim 8 vjeçar	-.017	.048	.997	-.15	.11
	Arsim i lartë	.025	.021	.757	-.03	.08
	Master	.133*	.048	.042	.00	.26
	Doktoraturë	.140	.071	.277	-.05	.33
Arsim lartë	Arsim 8 vjeçar	-.042	.048	.910	-.17	.09
	Arsim i mesëm	-.025	.021	.757	-.08	.03
	Master	.108	.048	.158	-.02	.24
	Doktoraturë	.115	.071	.481	-.08	.31
Master	Arsim 8 vjeçar	-.150	.065	.139	-.33	.03
	Arsim i mesëm	-.133*	.048	.042	-.26	.00
	Arsim i lartë	-.108	.048	.158	-.24	.02
	Doktoraturë	.007	.083	1.000	-.22	.23
Doktoraturë	Arsim 8 vjeçar	-.157	.083	.324	-.38	.07
	Arsim i mesëm	-.140	.071	.277	-.33	.05
	Arsim i lartë	-.115	.071	.481	-.31	.08
	Master	-.007	.083	1.000	-.23	.22

The mean difference is significant at the 0.05 level.

Tabela 12: Testi t për Vlerësimin e ndikimit të familjes tek morali dhe vendbanimit të familjeve

Vlerësimi i ndikimit të familjes	Levene's Test for Equality of Variances	t-test for Equality of Means	95% Confidence

tek morali								Interval of the Difference	
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	Lower	Upper
Equal variances assumed	15.702	.000	2.468	2319	.014	.152	.061	.031	.272
Equal variances not assumed			2.588	63.6	.012	.152	.059	.035	.269

Tabela 13 ANOVA

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	.035	3	.012	.052	.984
Within Groups	521.171	2317	.225		
Total	521.206	2320			

Tabela 14: Testi i pavarësisë midis vlerësimit të ndikimit të familjes në sjellje dhe moral dhe lidhjes me fenë

Sa të lidhur janë prindërit tuaj me fenë?	Ndikimi i familjes tek sjellja dhe morali			Total
	Familja	Shkolla/mësuesit	Shoku/shoqja	
Shumë	137	358	5	500
Konsiderueshëm	229	570	13	812
Pak	196	493	13	702
Aspak	83	219	5	307
Total	645	1640	36	2321
Chi-Square Tests				
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	
Pearson Chi-Square	1.683 ^a	6	.946	
Likelihood Ratio	1.801	6	.937	
Linear-by-Linear Association	.105	1	.746	
N of Valid Cases	2321			

a. 1 cells (8.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 4.76.

Table 15: Analiza ANOVA lidhur me respektin ndaj familjes dhe shoqerise dhe shkollave

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	55.947	25	2.238	7.964	.000
Within Groups	644.870	2295	.281		
Total	700.818	2320			

Table 15/1: Procedura Tukey

Shkolla ku ju studioni:	N	Subset for alpha = 0.05					
		1	2	3	4	5	6
Fan Noli	129	1.37					
Avni Rustemi	94	1.47	1.47				
Jeronim De Rada	142	1.54	1.54	1.54			
Skender Çaçi	73	1.55	1.55	1.55			
Ali Demi	91	1.64	1.64	1.64	1.64		
Vasil Shanto	100	1.64	1.64	1.64	1.64		
Dora D'istria	62	1.65	1.65	1.65	1.65	1.65	
Misto Mame	74	1.66	1.66	1.66	1.66	1.66	1.66
28 Nentori	82	1.67	1.67	1.67	1.67	1.67	1.67
Ramazan Jarani	43	1.67	1.67	1.67	1.67	1.67	1.67
Qazim Turdiu	127	1.68	1.68	1.68	1.68	1.68	1.68
Shkolla e Kuqe	60		1.77	1.77	1.77	1.77	1.77
Sabaudin Gabrani	126		1.77	1.77	1.77	1.77	1.77
Pjeter Budi	58		1.78	1.78	1.78	1.78	1.78
Mihal Grameno	120			1.78	1.78	1.78	1.78
Lasgush Poradeci	157			1.78	1.78	1.78	1.78
Siri Kodra	64			1.80	1.80	1.80	1.80
Ahmet Gashi	45			1.80	1.80	1.80	1.80
Kongresi I Manastirit	97			1.85	1.85	1.85	1.85
Bajram Curri	52				1.87	1.87	1.87
1 Maji	105				1.88	1.88	1.88
Musine Kokalari	108				1.88	1.88	1.88
Lidhja e Prizrenit	64				1.89	1.89	1.89
Gjon Buzuku	125				1.94	1.94	1.94
Qemal Ataturk	63					1.95	1.95
4 Deshmoret	60						1.97
Sig.		.065	.059	.054	.083	.060	.067

Tabela 16: ANOVA

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	.636	4	.159	.707	.587
Within Groups	520.571	2316	.225		
Total	521.206	2320			

SHTOJCA I

PYETËSOR PËR NXËNËSIT:

Unë quhem **Ayşe Kutlu** dhe po përgatit tezën e doktoraturës me temë: **“Rëndësia e familjes në edukimin moral”**. Në këtë anketë nuk kërkohen informacione identifikuese si emri, për këtë arsye mos e shkruani emrin tuaj. Përgjigjet që do të jepni do të jenë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm nga studiuesi për të kryer punimin akademik. Gjithashtu, informacionet nuk do të vlerësohen individualisht, por në grup. Përgjigjet tuaja të sinqerta dhe realiste, do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të besueshme dhe të vlefshme për këtë punim. ***Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!***

SEKSIONI I

TË DHËNA TË PËRGJITHËSHME:

P.1 Gjinia 1. Femër, 2. Mashkull (1) (2)

P.2 Moshë 1. 12 vjeç, 2. 13 vjeç, 3. 14 vjeç, 4. 15 vjeç, 5. 16 vjeç (1) (2) (3) (4) (5)

P.3 Shkolla ku ju studioni: _____

P.4 Gjendja e prindërve: 1. Jetojnë bashkë, 2. Jetojnë të ndarë/divorcuar, 3. Nëna ka vdekur, 4. Babai ka vdekur, 5. Kanë vdekur të dy (1) (2) (3) (4) (5)

P.5 Profesioni i babait: 1. Bujk, 2. Nëpunës, 3. Emigrant, 4. Mësues, 5. Punëtor, 6. Biznes privat, 7. I papunë, 8. Tjetër (specifiko) (1) (2) (3) (4) (5) (6) (7) (8)

P.6 Profesioni i nënës suaj: 1. Nëpunëse, 2. Shtëpiake, 3. Emigrante, 4. Biznes privat, 5. Punëtore, 6. Mësuese, 7. Tjetër (specifiko) (1) (2) (3) (4) (5) (6) (7)

P.7 Vendbanimi: 1. Fshat, 2. Qytet (1)(2)

P.8 Edukimi arsimor i babait tuaj: 1. Arsimit 8 vjeçar, 2. Arsimit mesëm, 3. Arsimit lartë, 4. Master, 5. Doktoraturë (1) (2) (3) (4) (5)

P.9 Edukimi arsimor i nënës tuaj: 1. Arsimit 8 vjeçar, 2. Arsimit mesëm, 3. Arsimit lartë, 4. Master, 5. Doktoraturë (1) (2) (3) (4) (5)

P.10 Të ardhurat mujore mesatare në familjen tuaj. 1. Më pak se 30,000 lekë
2. 30,000 -40,000 lekë, 3. 40,000-60,000 lekë, 4. 60,000-100,000 lekë, 5. Mbi 100,000 lekë, 6. Mbi 200,000 lekë. (1) (2) (3) (4) (5) (6)

P.11 Sa të lidhur janë prindërit tuaj me fenë? 1. Shumë, 2. Konsiderueshëm, 3. Pak, 4. Aspak (1) (2) (3) (4)

SEKSIONI II:

MATËSI I PRIORITETIT TË FAKTORËVE NDIKUES NË FORMIMIN E PJEKURISË MORALE

A. SJELLJA NDAJ TË TJERËVE

P.12: Sipas mendimit tuaj cili nga faktorët (*familja, shkolla/mësuesit apo shoku/shoqja*) ndikon më shumë lidhur me sjelljen tuaj ndaj të tjerëve? Ju lutem zgjidhni vetëm një të njërën nga alternativat për secilën nga alternativat e mëposhtme:

Nr	Alternativat	1.Familja, 2.Shkolla/mësuesit, 3.Shoku/shoqja,
1	Është e rëndësishme të ndihmosh njerëzit në nevojë.	(1) (2) (3)
2	Duhet të kemi dhembshuri për të dobët dhe të pafuqishmit.	(1) (2) (3)
3	Duhet të ndajmë gjërat që i kemi ne dhe të tjerët s'i kanë	(1) (2) (3)
4	Duhet t'i ndajmë sendet tona me të tjerët.	(1) (2) (3)
5	Duhet të ruhem të mos i lëndojmë njerëzit.	(1) (2) (3)
6	Duhet të kërkojmë falje kur gabojmë.	(1) (2) (3)

B. TOLERANCA DHE RESPEKTI

P.13: Sipas mendimit tuaj cili nga faktorët (*familja, shkolla/mësuesit apo shoku/shoqja*) ndikon më shumë tek toleranca dhe respekti? Ju lutem zgjidhni vetëm një të njërën nga alternativat për secilën nga alternativat e mëposhtme:

Nr	Alternativat	1.Familja, 2.Shkolla/mësuesit, 3.Shoku/shoqja,
1	Duhet të sillemi tolerantë ndaj kritikave	(1) (2) (3)
2	Duhet të sillemi të kuptueshëm dhe tolerantë me njerëzit rreth nesh.	(1) (2) (3)
3	Duhet ta vendosim veten në vendin e të tjerëve dhe të mundohemi t'i kuptojmë ata.	(1) (2) (3)

4	Duhet të respektojmë të drejtat e të tjerëve.	(1) (2) (3)
5	Edhe pse mund të jetë e dëmshme për ne nuk duhet të gënjejmë.	(1) (2) (3)
6	Edhe pse mund të mos jemi dakort me mendimin e tjetrit duhet ta dëgjojmë atë.	(1) (2) (3)
7	Nuk duhet t'i shqetësojmë të tjerët për dëshirat dhe kënaqësitë tona	(1) (2) (3)

C. EDUKATA

P.14: Sipas mendimit tuaj cili nga faktorët (*familja, shkolla/mësuesit apo shoku/shoqja*) ndikon më shumë tek edukata? Ju lutem zgjidhni vetëm një të njërën nga alternativat për secilën nga alternativat e mëposhtme:

Nr	Alternativat	1.Familja, 2.Shkolla/mësuesit, 3.Shoku/shoqja
1	Nuk duhet t'i mashtrojmë të tjerët duke përdorur dobësitë e tyre.	(1) (2) (3)
2	Nuk duhet të përdorim rrugë jo të drejta për përfitimet tona.	(1) (2) (3)
3	Duhet të reagojmë ndaj padrejtësive.	(1) (2) (3)
4	Njerëzit duhet t'i duam dhe t'i vlerësojmë pa bërë dallim feje, gjuhe apo race.	(1) (2) (3)
5	Nuk duhet të gënjejmë kurrë.	(1) (2) (3)
6	Nuk duhet të vjedhim diçka që i përket dikujt tjetër.	(1) (2) (3)
7	Duhet të kujdesemi t'i çojmë në vend përgjegjësitë tona.	(1) (2) (3)
8	Kur gjejmë diçka që s'na përket ne, duhet të mundohemi të gjejmë të zotin e saj.	(1) (2) (3)

D. RESPEKTI PËR FAMILJEN DHE SHOQERINË

P.15: Sipas mendimit tuaj cili nga faktorët (*familja, shkolla/mësuesit apo shoku/shoqja*) ndikon më shumë tek respekti për familjen dhe shoqërinë? Ju lutem zgjidhni vetëm një të njërën nga alternativat për secilën nga alternativat e mëposhtme:

Nr	Alternativat	1.Familja, 2.Shkolla/mësuesit, 3.Shoku/shoqja
1	Kur japim fjalën duhet ta mbajmë.	(1) (2) (3)

2	Duhet t'u qëndrojmë pranë shokëve/shoqeve në kohë të mira dhe të këqija.	(1) (2) (3)
3	Nuk duhet t'i përdorim pa leje gjërat e të tjerëve.	(1) (2) (3)
4	Duhet të sillemi me respekt ndaj të mëdhenjve.	(1) (2) (3)
5	Duhet të jemi punëtorë për familjen dhe veten tonë.	(1) (2) (3)
6	Duhet të duam për tjetrin atë që duam për veten.	(1) (2) (3)
7	Duhet të sillemi me respekt ndaj nënës dhe babait.	(1) (2) (3)
8	Nuk duhet t'u ngjisim nofka shokëve/shoqeve dhe të tallemi me ta/to.	(1) (2) (3)
9	Duhet t'i duam më të vegjlit.	(1) (2) (3)